



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 138

Tiranë – E premte, 1 gusht 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 47/2025, datë 3.7.2025	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030..... 19527
Dekret i Presidentit nr. 279, datë 28.7.2025	Për shpallje ligji..... 19543
Ligj nr. 52/2025, datë 3.7.2025	Për markat tregtare..... 19543
Dekret i Presidentit nr. 280, datë 29.7.2025	Për shpallje ligji..... 19594
Ligj nr. 53/2025, datë 3.7.2025	Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë..... 19594
Dekret i Presidentit nr. 281, datë 29.7.2025	Për shpallje ligji..... 19645
Ligj nr. 55/2025, datë 3.7.2025	Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa..... 19645
Dekret i Presidentit nr. 282, datë 30.7.2025	Për shpallje ligji..... 19663
Dekret i Presidentit nr. 260, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 19663
Dekret i Presidentit nr. 261, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 19664

Dekret i Presidentit nr. 262, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19664
Dekret i Presidentit nr. 263, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19664
Dekret i Presidentit nr. 264, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19665
Dekret i Presidentit nr. 265, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19665
Dekret i Presidentit nr. 266, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19665
Dekret i Presidentit nr. 267, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19665
Dekret i Presidentit nr. 268, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19666
Dekret i Presidentit nr. 269, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19666
Dekret i Presidentit nr. 270, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19666
Dekret i Presidentit nr. 271, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19667
Dekret i Presidentit nr. 272, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19667
Dekret i Presidentit nr. 273, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19667
Dekret i Presidentit nr. 274, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19668
Dekret i Presidentit nr. 275, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19668
Dekret i Presidentit nr. 276, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19668
Dekret i Presidentit nr. 277, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19668
Dekret i Presidentit nr. 278, datë 28.7.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19669

**LIGJ**
Nr. 47/2025**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË**
KOMBËTARE KUNDËR
NDËRHYRJEVE TË HUAJA DHE
DEZINFORMIMIT 2025–2030

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave t'i propozojë Kuvendit projektakte ligjore, si dhe të miratojë akte nënligjore të propozuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj Strategjie.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr. 279, datë 28.7.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

STRATEGJIA KOMBËTARE
KUNDËR NDËRHYRJEVE TË HUAJA
DHE DEZINFORMIMIT
2025–2030**PASQYRA E PËRMBAJTJES**

LISTA E AKRONIMEVE

FJALORTH

KONTEKSTI

NË NIVEL GLOBAL

NË NIVEL RAJONAL

NË NIVEL KOMBËTAR

QËLLIMI I STRATEGJISË

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

OBJEKTIVI I: Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore

Përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe mekanizmave të monitorimit për proceset zgjedhore

Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e financimeve politike

Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimi ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja

OBJEKTIVI II: Mbrojtja e Sigurisë Kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse

OBJEKTIVI III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve të tjerë kritik

Forcimi i mekanizmave ligjzbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonomi

Adresimi i kërcënimeve ndaj sektorëve strategjikë dhe sistemit financiar të ekonomisë

OBJEKTIVI IV: Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias, si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik kundër dezinformimit

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin

Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si dhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit

UDHËRRËFYESI I STRATEGJISË
KOMBËTARE KUNDËR NDËRHYRJEVE TË
HUAJA DHE DEZINFORMIMIT



LISTA E AKRONIMEVE

FIMI	Manipulimi dhe ndërhyrja e informacionit të huaj
MSHI	Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve
Kuvendi i RSH-së	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
KM	Këshilli i Ministrave
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministria e Brendshme
MAPA	Ministri për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
AIMS	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
BSH	Banka e Shqipërisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
RTSH	Radiotelevizioni Shqiptar
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKSK	Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike të Shqipërisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
AKSHE	Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve
AMI	Agjencia për Media dhe Informim
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
CSIRT	Computer Security Incident Response Team
SOC	Security Operation Center
EMI	Edukimi për Median dhe Informacionin
BIRN	Balkan Investigative Reporting Network
SCIDEV	The Center for Science and Innovation for Development
FAKTOJE.AL	



FJALORTH

Dezinformim¹ – informacion i rremë ose çorientues, i cili në mënyrë akumulative:

a) krijohet, paraqitet dhe shpërmdahet për përfitim ekonomik ose për të mashtruar qëllimisht publikun; dhe

b) mund të shkaktojë dëm publik, kuptuar si kërcënime ndaj proceseve demokratike politike dhe vendimmarrëse, si dhe ndaj të mirave publike, si mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, mjedisit, sigurisë etj.

Manipulim dhe ndërhyrje e informacionit të huaj (*Foreign Information Manipulation and Interference (FIMI)*) – në kuptim të ndërhyrjes së huaj, u referohet përpjekjeve të qëllimshme dhe të koordinuara nga aktorë shtetërorë ose joshetërorë për të manipuluar mjediset e informacionit, në mënyrë që të arrihen objektiva strategjike, politike, sigurie etj.

Misinformim (*misinformation*) – informacion i rremë ose i pasaktë i përhapur pa qëllime keqdashëse, megjithëse efektet e tij mund të jenë të dëmshme.

Keqinformim (*malinformation*) – informacion faktik i shtrembëruar me dashje për qëllime mashtruese apo manipulimi.

Propagandë – në kuptim të ndërhyrjes së huaj, informacion i krijuar për të manipuluar një audiencë specifike të synuar drejt një sjelljeje ose besimi të caktuar, shpesh si pjesë e një fushate të zgjatur nga një aktor shtetëror me një agjendë politike.

Tregim/narrativë armiqësore – histori specifike e zhvilluar për të diskredituar ose për të shpifur ndaj një objekti të caktuar.

Aktivitet informativ armiqësor – një gamë e gjerë veprimesh të koordinuara, të krijuara për të mbjellë mosbesim dhe për të manipuluar opinionin, që zakonisht përfshijnë një ose të gjitha metodat dhe teknikat e tilla, si: meme mashtruese, teori konspirative, imazhe ose video të falsifikuara, citate të nxjerra jashtë kontekstit, ose thjesht gënjeshtër të përhapura me qëllim manipulimi.

Kërcënim hibrid – aktivitet keqdashës, shpesh i kombinuar me mjete ushtarake dhe joushtarake, në formë të fshehtë dhe/ose të hapur, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin

ekonomik, dislokimin e grupeve të parregullta të armatosura (*Proxy*), si dhe përdorimin e forcave të rregullta.

Lufta hibride – përdorimi i mjeteve ushtarake dhe joushtarake, si dhe mjeteve të fshehta dhe/ose të hapura, përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, vendosjen e grupeve të armatosura të parregullta dhe përdorimin e forcave të rregullta, për të krijuar dyshimin te publiku i synuar, me qëllim destabilizimin dhe nxitjen e ndasive shoqërore.

Kapital gërryes (*Corrosive Capital*) – flukset e paqarta të kapitalit, që nuk janë të orientuara nga tregu dhe kanë si objektiv të shfrytëzojnë boshllëqet e qeverisjes, për të ndikuar në zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale në vendet përfituese.

KONTEKSTI

Strategjia Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit është dokument me karakter kombëtar, që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe pasqyron zhvillimet strategjike të politikave shtetërore për sigurinë e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit demokratik shqiptar.

Strategjia synon garantimin e mbrojtjes së interesave kombëtarë përmes një qasje të koordinuar dhe efektive për të përballuar sfidat e ndërhyrjeve të huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin, në ruajtje të stabilitetit dhe integritetit të proceseve demokratike të vendit.

Ndërhyrjet e huaja keqdashëse në formën e dezinformimit dhe të manipulimit të informacionit në proceset demokratike paraqesin kërcënime hibride, të cilat kanë marrë përmasa globale gjatë dekadës së fundit, duke synuar uljen e besimit në institucionet themelore të shtetit dhe funksionimin e shëndetshëm të shoqërisë demokratike.

Ky fenomen ka ardhur si rezultat i përhapjes së qëllimshme dhe të organizuar të dezinformimit, të cilat kërcënojnë jo vetëm stabilitetin e shoqërive demokratike, por edhe rendin dhe sigurinë e shteteve. Njëkohësisht, ky proces ka detyruar aktorë ndërkombëtarë të rëndësishëm, si Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të angazhohen në ndërmarrjen e masave ligjore dhe institucionale për të mbrojtur sigurinë, ekonominë dhe proceset demokratike.

¹ <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/2018-code-practice-disinformation>



Sfera e informacionit digjital është shndërruar në një hapësirë publike të rëndësishme për diskutim dhe shkëmbim idesh, por, po ashtu ka evoluar në një arenë rivalitetesh gjeostrategjike dhe konkurrencash mes aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, që po përdorin teknologjitë për të manipuluar opinionin publik dhe për të cenuar demokracinë. Kjo dinamikë e ka rritur presionin mbi mjedisin e informacionit të hapur, duke bërë të domosdoshëm angazhimin për mbrojtjen e vlerave universale, si të drejtat e njeriut dhe liria e shprehjes në raport me sigurinë publike.

Ndërhyrja e huaj keqdashëse përfshin veprime të hapura dhe të fshehta nga aktorë shtetërorë dhe joshetërorë, të cilat synojnë elemente të cenueshme të shteteve dhe shoqërive demokratike, me qëllim dobësimin e funksionimit të institucioneve demokratike, sundimit të ligjit dhe sigurisë së brendshme, duke përdorur instrumente politike, diplomatike, ushtarake, ekonomike, financiare, ligjore apo të shërbimeve inteligjente etj. Ky synim përfshin, gjithashtu, ndikimin në partitë dhe vendimarrjen politike, sistemin gjyqësor dhe median, duke kërcënuar seriozisht integritetin shtetëror dhe atë shoqëror.

Ndërhyrja e huaj synon të zhbëjë kufijtë dhe ekuilibrat mes paqes, krizës dhe konfliktit, duke prodhuar qëllimshëm situata të paidentifikueshme, të paqarta dhe komplekse në identifikimin dhe gjurmimin e burimit, por edhe në paralizimin e procesit të vendimarrjes politike, apo cenimin e besimit të qytetarëve në mekanizmat garantues të rendit kushtetues dhe të drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu, ndikimi mund të shfaqet edhe në procese ekonomike/financiare për të fituar ndikim në sektorë kyç strategjikë, të manipulojë ose të marrë kontroll mbi mjedisin informativ, si dhe në cenimin e funksionimit të infrastrukturës kritike.

Për Shqipërinë, kjo çështje është veçanërisht e mprenhtë, duke pasur parasysh interesin kombëtar, kontekstin e procesit të integritetit evropian dhe përpjekjet për forcimin e institucioneve demokratike në vend. Si shoqëri, nevojitet të ndërtojmë një front të fuqishëm mbrojtës për të siguruar mundësinë që shtetasit shqiptarë të informohen nga burime të besueshme dhe të krijojnë gjykim të pavarur dhe të

bazuara në fakte. Ky angazhim i përbashkët duhet të jetë i koordinuar dhe i qëndrueshëm, duke ofruar mundësinë për forcimin e vlerave demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të luftuar manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit të huaj (FIMI) gjatë dekadës së fundit (2014–2024), veçanërisht si përgjigje ndaj kërcënimeve në rritje nga sulmet kibernetike, ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimi. Megjithatë, pavarësisht përparimeve në disa fusha, vijohet të ketë hapësira të qenësishme në nivel ligjor, institucional dhe shoqëror, që krijojnë ekspozim ndaj ndërhyrjeve të huaja².

Mungesa e një përkufizimi të qartë dhe e instrumenteve ligjore të dedikuara për trajtimin e FIMI-së, së bashku me kapacitetet e kufizuara institucionale dhe burimet e pamjaftueshme, krijon boshllëqe në përgjigjen kombëtare, në mënyrë gjithëpërfshirëse, ndaj kërcënimeve gjithnjë e më të sofistikuara hibride. Ligji nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”³, përfshin disa elemente që kontribuojnë në mënyrë indirekte në luftën kundër FIMI-së, veçanërisht përmes përqendrimit në reagimin ndaj incidenteve kibernetike, shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Ndërkohë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2023–2028⁴ adreson një sërë kërcënimesh të lidhura me FIMI-në, veçanërisht përmes fokusit në sigurinë kibernetike, kërcënimet nga intelijenca e huaj dhe luftën hibride.

Peizazhi mediatik në Shqipëri paraqet sfida të shtuara në kontekstin e FIMI-së. Përqendrimi i lartë i pronësisë së medias, i dominuar nga interesa ekonomikë me ndikim të zëshëm, krijon një mjedis të përshtatshëm për vetëcensurën dhe potencialisht për ndikimet e huaja. Shumë media *online* operojnë me mungesë transparence, në lidhje me pronësinë dhe financimin e tyre, shpesh pa politika të qarta editoriale ose pa respektuar standardet etike të gazetarisë. Kjo gjendje krijon një terren të përshtatshëm për përhapjen e dezinformimit, si nga aktorët vendës, ashtu edhe nga ata të huaj⁵.

Përhapja e dezinformimit në Shqipëri është lehtësuar nga nivelet e ulëta të edukimit mediatik dhe besimi i kufizuar në institucionet publike. Fushatat e

² https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania_SCiDEV.pdf (f. 5)

³ <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/ligj-2024-03-21-25-5.pdf>

Faqe | 19530

⁴ <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2024/02/08/14/6f7acb09-5b35-4f1b-83a8-bab03464a153;q=strategj>

⁵ https://scidevcenter.org/wp-content/uploads/2024/10/FIMI-Analytical-Report-Albania_SCiDEV.pdf (f. 6)



ndërgjegjësimet publik dhe integrimi i edukimit mbi dezinformimin dhe sigurinë kibernetike në sistemin arsimor do të ndihmojnë në forcimin e aftësive të qytetarëve për të identifikuar informacionin e manipuluar dhe për të rezistuar ndaj ndikimeve të huaja keqdashëse.

Studime të realizuara nga shoqëria civile⁶ kanë shqyrtuar përhapjen e shpejtë të dezinformimit në mediat shqipfolëse, duke evidentuar raste të shpërndarjes së informacioneve të rreme nëpërmjet mediave të lidhura me interesa të huaja. Mjedisi mediatik i polarizuar dhe joprofesional ka favorizuar shpërndarjen e dezinformimit përmes titujve sensacionalë dhe pa verifikim të informacionit, duke kontribuar në rritjen e paqartësisë në shoqëri, përkeqësimin e situatës së besueshmërisë së mediave, e duke shtuar mundësitë për manipulime dhe përhapje të narrativave të huaja.

Një tjetër fenomen i evidentuar është kapaciteti i kufizuar i medias tradicionale dhe digjitale për të ofruar informim profesional e të pavarur. Shpesh publikohen deklarata nga subjekte politike dhe jo vetëm, pa verifikim paraprak, duke kontribuar kështu në rritjen e ndasive sociale e duke lehtësuar krijimin e një mjedisi shoqëror të ndikueshëm nga aktorët e huaj keqdashës. Mungesa e transparencës financiare, kapacitetet e pamjaftueshme për verifikimin e informacionit dhe interesat ekonomike të mediave, frenojnë zhvillimin e një mjedisi mediatik të qëndrueshëm dhe të besueshëm.

NË NIVEL GLOBAL⁷

Teknologjitë në zhvillim paraqesin sfida të reja për sigurinë ndërkombëtare, me një gamë të gjerë kërcënimesh, që përfshijnë sulmet kibernetike, manipulimin e informacionit dhe keqpërdorimin e inteligjencës artificiale për qëllime strategjike. Dezinformimi dhe lufta hibride janë bërë mjete kyçe për aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë, të cilët kombinojnë propagandën, manipulimin e informacionit dhe aktivitetet kibernetike për të

destabilizuar shoqëritë dhe për të cenuar besimin në institucionet demokratike.

Këto fushata të organizuara mund të përdorin taktika të sofistikuara për të ndikuar në opinionin publik, duke përfshirë aktorë shtetërorë, grupe interesi apo individë, me qëllime të ndryshme, për t'i përhapur nga korporatat deri tek ekstremistët. Me kosto të ulët dhe përhapje të shpejtë, dezinformimi është shndërruar në një armë të fuqishme në luftën hibride, e cila synon të cenojë kohezionin shoqëror, stabilitetin institucional dhe sigurinë kombëtare.

Kriza globale e shkaktuar nga pushtimi rus i Ukrainës ka nxjerrë në pah strategjitë e ndikimit keqdashës të saj, të cilat synojnë të cenojnë stabilitetin demokratik dhe integrimin euroatlantik të vendeve të ndryshme, duke ndjekur një qasje agresive përmes një kombinimi taktikash hibride, duke përfshirë dezinformimin, mbështetjen për lëvizjet separatiste dhe instrumentalizimin e varësive ekonomike dhe energjetike për të ushtruar presion mbi shtetet.

Katër kërcënimet kryesore që burojnë nga ky ndikim keqdashës përfshijnë:

1. Cenimin e agjendës euroatlantike dhe të ndikimit perëndimor;
2. Destabilizimin dhe dobësimin e qeverive vendëse përmes mjeteve hibride;
3. Promovimin e autoritarizmit për të penguar zhvillimin e demokracive funksionale; dhe
4. Dëmtimin e marrëdhënieve të vendeve të synuara me BE-në, SHBA-në dhe NATO-n.

NË NIVEL RAJONAL⁸

Ballkani Perëndimor mbetet një rajon i ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve të huaja dhe fushatave të dezinformimit, për shkak të historisë së tij të pasluftës, tranzicionit demokratik dhe sfidave të vazhdueshme ekonomike e institucionale. Këto dobësi e bëjnë rajonin veçanërisht të cenueshëm, dhe dezinformimin një element destabilizues politik, për të dobësuar besimin e qytetarëve tek

⁶ Përhapja e dezinformimit rus në mediat shqipfolëse - DisInfo.AL, <https://disinfo.al/diplomacia-publike-e-kines-ne-shqiperi/>, <https://disinfo.al/propaganda-e-iranit-ne-gjuhen-shqipe/>, DisInfo.AL, <https://faktoje.al/dezinformimi-per-politikat-e-be-se/>, <https://faktoje.al/wp-content/uploads/2024/07/Studimi-mbi-dezinformimi-shqip.pdf>, <https://faktoje.al/category/projekte/iniciativa-rajonale-per-luften-ndaj-disinformimit/>

⁷

https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2021/4/pdf/2104-factsheet-cyber-defence-en.pdf

<https://www.nato-pa.int/download-file?filename=/sites/default/files/2023-10/CDS%20resolution%20483%20-%20DISINFORMATION.pdf>

<https://ec.europa.eu/sites/default/files/documents/2024/Study%20international%20norms%20on%20FIMI.pdf>

⁸

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)



institucionet dhe për të penguar integrimin euroatlantik.

Kaosi informativ në rajon pasqyron tensionet politike dhe sociale, ndërsa narrativat e bazuara në identitet etnik dhe fetar përdoren për të manipuluar opinionin publik dhe për të përkeqësuar ndasitë. Prezenca e korrupsionit përkeqëson situatën, duke amplifikuar mungesën e besimit midis qytetarëve dhe qeverive të tyre, duke krijuar kështu një terren të përshtatshëm për përhapjen e dezinformimit.

Në Ballkanin Perëndimor dezinformimi është, gjithashtu, një mjet i përdorur nga aktorë të huaj për të ndikuar proceset demokratike dhe orientimin gjeopolitik të rajonit.

Për shkak të vendndodhjes strategjike dhe rëndësisë në tregtinë dhe sigurinë evropiane, Ballkani Perëndimor është shndërruar në një fushëbetejë moderne të rëndësishme në konkurrencën për pushtet global, ku aktorë të ndryshëm synojnë të avancojnë interesat e tyre përmes mekanizmave, si financimi politik, ndikimi në informacion dhe investimet strategjike, të cilat krijojnë varësi ekonomike dhe politike⁹.

Nëpërmjet fushatave të organizuara të dezinformimit dhe propagandës, Rusia ka synuar të nxisë ndasi politike, etnike dhe fetare, duke krijuar tensione të brendshme që dobësojnë institucionet demokratike dhe pengojnë procesin e anëtarësimit në BE dhe në NATO. Kjo qasje reflekton një model të njohur të strategjisë së saj, e cila synon të cenojë kohezionin politik dhe social të shteteve, duke përdorur mjete jokonvencionale për të arritur objektivat gjeopolitike.

Në këtë kontekst, Shqipëria luan një rol kyç stabiliteti përmes forcimit të bashkëpunimit rajonal, rritjes së kapaciteteve mbrojtëse dhe qëndrueshmërisë institucionale përballë këtyre kërcënimeve. Si një vend i angazhuar për integrimin evropian dhe vend anëtar i NATO-s, Shqipëria promovon sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, duke synuar një mjedis më rezistent ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve të huaja. Përmes politikës së saj diplomatike dhe bashkëpunimit strategjik me partnerët ndërkombëtarë, Shqipëria mbetet një faktor thelbësor në forcimin e arkitekturës së sigurisë rajonale dhe në mbrojtjen e vlerave demokratike në

këtë hapësirë gjeopolitike komplekse dhe me shumë sfida.

NË NIVEL KOMBËTAR¹⁰

Shqipëria, si vend me orientim euroatlantik dhe anëtar i NATO-s, përballlet me kërcënime nga aktorë globalë, që synojnë të destabilizojnë vendin dhe të pengojnë proceset eurointegruese. Fushatat dezinformuese, lajmet e rreme dhe ndërhyrjet në proceset demokratike synojnë dobësimin e demokracisë, cenimin e balancave të aleancave strategjike dhe orientimin negativ në perceptimin publik. Aleati më i madh i interesit publik në këtë betejë është media dhe për këtë arsye garantimi i transparencës, profesionalizmit, lirisë së shprehjes dhe integritetit të saj, mbeten sfidat kryesore në përballimin e këtyre kërcënimeve.

Krahas institucioneve, organizatave, ekonomisë dhe infrastrukturës digjitale dhe asaj kritike të Shqipërisë, një terren i synuar i manipulimit dhe dezinformimit të huaj ka qenë dhe mbetet edhe mjedisi i informimit dhe i komunikimit masiv/publik. Qëllimet e depërtimit të huaj në këtë fushë variojnë që nga përhapja e mesazheve dhe e informacioneve që cenojnë imazhin e Aleancës Euroatlantike dhe sistemit të demokracisë liberale tek dezinformimi lidhur me krizat, proceset dhe zhvillimet aktuale globale, si dhe përpjekja për të nxitur përçarje, keqorientim dhe konfuzion informues në radhët e vetë shoqërisë shqiptare.

Rusia përbën aktualisht kërcënimin kryesor të sigurisë për aleancën perëndimore, pjesë e së cilës është sot edhe Shqipëria. Pikërisht në këtë kontekst merr formë dhe zhvillohet edhe manipulimi informues, që vjen prej këtij vendi. Forma kryesore e manipulimit rus është dezinformimi, por ndeshen edhe raste të propagandës dhe të keqinformimit.

Kanalet kryesore të dezinformimit rus në Shqipëri dhe më gjerë janë, RT International dhe Sputnik – dy rrjete televizive të kontrolluara nga shteti me prezencë të ndjeshme edhe në mjedisin global *online* – të cilat, nëpërmjet platformave të tyre ndërkombëtare i shërbejnë qëllimeve të politikës së jashtme të Kremlinit. Por, publiku shqiptar është i ekspozuar edhe ndaj mesazheve dezinformuese që vijnë prej gazetës Pravda (dikur organ i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik), e cila është e vetmja media e këtij vendi që ka një seksion në

⁹ ALBANIAN_The Vulnerability of Albanian Politics to Foreign Interference_FINAL.pdf
Faqe | 19532

¹⁰ NDI_The Vulnerability of Albanian Politics to Foreign Interference_FINAL..pdf



gjuhën shqipe. Gjithsesi, duhet nënvizuar, se, pavarësisht pranisë së atyktushme, operacionet dezinformuese ruse gjejnë shumë pak terren në Shqipëri, për shkak të orientimit të fortë gjeopolitik properëndimor të shoqërisë.

Nga monitorimet e kryera në mediat shqiptare tradicionale, ato *online*, si dhe të rrjeteve sociale, rezulton se linjat kryesore të diskursit dezinformues rus, që kanë depërtuar në to janë: paraqitja e SHBA-së dhe e NATO-s si agresive dhe si kërcënim për Rusinë; përlegjia e pushtimit rus të Ukrainës; diskretitimi i luftës së Ukrainës në mbrojtje të sovranitetit territorial të saj; paraqitja e Perëndimit si armiqësor dhe rusofob dhe si faktor pengues për përpjekjet e paqes në Ukrainë; diskretitimi i BE-së dhe akuza për humbjen e sovranitetit të shteteve të saj; retorika e mosnjohjes së Kosovës si shtet i pavarur; evokimi i së ashtuquajturës ndihmë të dikurshme ruse ndaj Shqipërisë etj.

Në fushata dezinformuese, apo propogandistike, në plan global janë përdorur intensivisht si “*trolls*” dhe “*bots*”, po ashtu edhe influencerat, për të amplifikuar ndikimin dhe arritjen e tyre te publiku global. Ndërkohë janë përdorur edhe kapacitetet e algoritmeve për të mundësuar përhapjen e gjerë të informacioneve të rreme, shumëfishimin elektronik artificial të postimeve, operimin e llogarive false për nevoja të fushatave të targetuara etj. Gjithsesi, kur bëhet fjalë për mediat tradicionale apo digjitale shqiptare, këto taktika apo mjete të aktorëve të tretë nuk kanë pasur një prani apo përdorim të zëshëm.

Parandalimi i ndërhyrjeve të huaja është thelbësor për mbrojtjen e integritetit kombëtar dhe demokratik, në kushtet kur Shqipëria, për shkak të boshllëqeve në kuptimin e këtij fenomeni, mbetet jo pak e ekspozuar ndaj tij.

Shqipëria synon parandalimin, identifikimin dhe kundërveprimin aktiv ndaj këtyre fenomeneve, duke nënvizuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm për të adresuar këto çështje, kryesisht përmes edukimit publik e mediatic, përmirësimit të legjislacionit dhe bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar.

QËLLIMI I STRATEGJISË

Republika e Shqipërisë përcakton si qëllime strategjike ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse,

pacenueshmërinë e shoqërisë, shtetit, infrastrukturës kritike, ekonomisë, si dhe qasjen sistematike dhe gjithëpërfshirëse për reagim efektiv dhe të menjëhershëm.

Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve, që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse, përfshirë dezinformimin. Ajo ka objektiv përballimin e sfidave të mundshme në të tashmen dhe të ardhmen, duke marrë në konsideratë mjedisin gjeostrategjik.

Tipari themelor i Strategjisë është respektimi i shtetit të së drejtës dhe referimi në praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo strategji mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi¹¹. Ajo respekton marrëveshjet, traktatet e konventat ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, duke synuar përafrimin dhe përputhshmërinë me standardet evropiane dhe euroatlantike.

Shqipëria do të vijojë bashkëpunimin me strukturat e dedikuara të NATO-s dhe të BE-së për mbrojtjen ndaj FIMI-së dhe sulmeve kibernetike, përmes shkëmbimit të informacionit, trajnimeve dhe zhvillimit të infrastrukturës teknologjike për zbulimin dhe kundërshtimin e kërcënimeve hibride.

Përballë kërcënimeve të tilla, Shqipëria duhet të investojë në mënyrë domethënëse në përmirësimin e mbrojtjes kombëtare, të infrastrukturës kritike dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, si detyrim ndaj shtetasve dhe angazhimeve ndërkombëtare të saj.

Në këtë kuadër, angazhimi për një mjedis informacioni të hapur, transparent, profesional dhe të besueshëm është më domethënës se kurrë, që duhet të vijë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, mediave tradicionale/digjitale, dhe aktorëve ndërkombëtarë, për të garantuar që Shqipëria të jetë rezistente në këto sfida, duke siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe demokratike.

Qëndrueshmëria nënkupton aftësinë e shtetit dhe të shoqërisë për të përballuar ndërhyrjet e huaja sporadike, të vazhdueshme dhe intensive, për të

¹¹ Ligji nr. 14/2024, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 83/2024, “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”.



mënjanuar/minimizuar ndikimin negativ dhe për të rivendosur funksionalitetin e plotë në rast dëmtimi.

Identiteti, historia kombëtare dhe orientimi euroatlantik i Shqipërisë shërbejnë si elemente unifikuese për forcimin e kohezionit shoqëror dhe mobilizimit kundër FIMI-së. Promovimi i kulturës, traditave dhe kontributit të diasporës shqiptare në arenën ndërkombëtare ndihmon në ndërtimin e një mjedisi informues më rezistent ndaj manipulimit. Përmes koordinimit të ngushtë kombëtar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria do të forcojë rolin e saj si një vend rezistent ndaj FIMI-së.

Për Shqipërinë, si anëtare e NATO-s dhe kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, siguria kombëtare është e ndërvarur me zhvillimet e sigurisë ndërkombëtare. Ndërhyrjet e huaja hibride kërkojnë një përgjigje të koordinuar kombëtare dhe ndërkombëtare. Zbatimi i programeve të bashkëpunimit dy- e më shumëpalëshe dhe i standardeve të integritetit do të lidhet ngushtë edhe me vijimin e kontributit konkret të Shqipërisë në interes të paqes e sigurisë rajonale e globale.

Siguria e Republikës së Shqipërisë është e pandashme nga siguria e rajonit euroatlantik. Për këtë arsye, Strategjia bazohet në dokumentet strategjike themelore të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Bashkimit Evropian (BE). Ajo mbështetet në parimin e solidaritetit midis aleatëve të NATO-s dhe vendeve anëtare të BE-së.

Ruajtja e stabilitetit dhe e sigurisë ndaj sfidave të ndërhyrjeve të huaja keqdashëse do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit legjislativ specifik, zbatimit rigoroz të tij dhe monitorimit periodik. Garantimi afatgjatë i interesave kombëtarë kërkon përafrimin e legjislacionit në këto fusha në përputhje me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

Strategjia kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit është një strategji aktive veprimi, e cila përcakton interesat, objektivat dhe prioritetet e vendit, mekanizmat dhe masat kryesore për realizimin e tyre. Synimi është mbrojtja dhe garantimi i interesave kombëtarë dhe atyre strategjikë, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, rritjes së vigjencës dhe përgjigjes energjike ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse në procese demokratike, infrastrukturë kritike dhe ekonomi.

Në funksion të përballjes e adresimit të sfidave të ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin, do të ngrihet një strukturë e dedikuar, me përgjegjësi për identifikimin, analizimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimtarive të lidhura me FIMI-në në agjenci dhe institucione të ndryshme publike.

Rolet, detyrat dhe kanalet e komunikimit për secilin aktor: institucione publike, akademi, shoqëri civile, media dhe sektorin privat do të përcaktohen qartë në aktet ligjore e nënligjore, në zbatim të kësaj Strategjie, me synim sigurimin e një platforme të përbashkët për shkëmbimin e burimeve, inteligjencës, ekspertizës dhe të dhënave mbi rastet dhe kërcënimet e FIMI-së.

Republika e Shqipërisë angazhohet të forcojë mbikëqyrjen parlamentare për ndërhyrjen e huaj, përfshirë dezinformimin, duke rritur kapacitetet institucionale dhe ekspertizën për identifikimin, analizimin dhe adresimin e këtyre kërcënimeve.

Përdorimi bashkëkohor i informacionit në mbështetje të sigurisë kombëtare është thelbësor. Sigurimi i shpejtë dhe i saktë i informacionit është i lidhur pazgjidhshmërisht me vendimmarrjen e duhur dhe veprimet e shpejta për neutralizimin e pasojave që mund të dëmtojnë sigurinë kombëtare. Strategjia e vlerëson informacionin si një faktor shumë të rëndësishëm për forcimin e sigurisë kombëtare, duke respektuar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të qytetarëve, si dhe lirinë e mediave. Ruajtja e sigurisë kombëtare kërkon më së pari ndalimin e përdorimit të informacionit për qëllime manipulimi të ndërgjegjes publike.

Republika e Shqipërisë do të hartojë një kornizë të përbashkët bazuar në evidenca dhe në vlerësim risku, që mundëson identifikimin, analizimin dhe përgjigjen ndaj FIMI-së në mënyrë sistematike, të koordinuar dhe të vazhdueshme. Korniza duhet të optimizojë krijimin, shkëmbimin dhe aktivizimin e njohurive, duke u mbështetur në standarde me burime të hapura dhe bashkëpunuese, si dhe duke siguruar transparencë dhe efikasitet në menaxhimin e të dhënave.

Republika e Shqipërisë, për të mundur përgjigje më të shpejtë e më efektive do të përdorë modele analitike për të vlerësuar sa shpejt mund të përhapet një narrativë manipuluese dhe ndikimin e saj.

Republika e Shqipërisë, në referim të rekomandimeve të lëna në progresraportet e



Komisionit Evropian, do të garantojë transparencë financiare dhe marrëdhënieve të pronësisë të njëjtë për median tradicionale dhe atë digjitale, që ushtron veprimtari në territorin shqiptar. Ky angazhim do të përmbushet në çdo rast në linjë me standardet e lirisë së shprehjes të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, sipas Aktit Evropian për Lirinë e Medias, Aktit për Shërbimet Digjitale, Aktit për Tregun Digjital etj.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

OBJEKTIVI I: Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, zbuluar dhe analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore

Përforcimi i mbrojtjes ligjore dhe i mekanizmave të monitorimit për proceset zgjedhore

Republika e Shqipërisë do të marrë masa për të mbrojtur integritetin e zgjedhjeve dhe proceset demokratike nga ndërhyrjet e huaja, duke zbatuar një qasje gjithëpërfshirëse të harmonizuar me praktikën më të mira të BE-së, OSBE-së/ODIHR-it, Komisionit të Venecias dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Masat strategjike do të përfshijnë forcimin e sigurisë kibernetike, rritjen e transparencës financiare, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim garantimin e integritetit zgjedhor dhe rritjen e rezistencës ndaj kërcënimeve hibride dhe kibernetike.

Republika e Shqipërisë do të rishikojë kuadrin ligjor kombëtar për forcimin e mekanizmave të financimit politik, duke synuar rregullime efikase që ndalojnë mundësinë e financimit të fushatave dhe partive politike, nga burime të dyshimta ose të huaja, dhe parandalimin e përdorimit të fondeve të paligjshme për mbështetje të kandidatëve ose subjekteve politike me qëllime ndërhyrjeje.

Republika e Shqipërisë do të krijojë mekanizma mbikëqyrës të pavarur dhe efektivë, duke fuqizuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me burime teknologjike dhe financiare, për monitorimin e financave politike në kohë reale, dhe duke ngritur një autoritet efikas për mbikëqyrjen e transparencës financiare dhe adresimin e shkeljeve, duke vendosur sanksione të qarta për shkeljet që lidhen me mosrespektimin e transparencës dhe burimeve të paligjshme të financimit.

Republika e Shqipërisë do të ndërtojë një kuadër të plotë rregullator për vlerësimin paraprak,

auditimin dhe certifikimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) të përdorura në proceset zgjedhore, me synim forcimin e besimit publik në përdorimin e tyre. Ky kuadër do të përcaktojë standarde për sigurinë kibernetike të databazave dhe pajisjeve zgjedhore, identifikimin e dobësive dhe vendosjen e procedurave të sigurisë, duke përfshirë edhe mekanizma të garantuar për rikuperim në rast emergjencash.

Republika e Shqipërisë angazhohet të hartojë dhe të zbatojë një plan të detajuar emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike gjatë fushatave zgjedhore, procesit të votimit dhe administrimit zgjedhor, si elementet thelbësore të garantimit të sigurisë së proceseve demokratike.

Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e financimeve politike

Republika e Shqipërisë do të ndërmarrë masa për forcimin e transparencës në veprimtarinë financiare të partive politike, për të siguruar monitorimin e burimeve financiare dhe të shpenzimeve të partive politike, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve të huaja dhe ruajtjen e integritetit të proceseve zgjedhore.

Republika e Shqipërisë, në funksion të transparencës së veprimtarisë financiare gjatë fushatave zgjedhore, do të miratojë rregulla për reklamat politike *online* dhe ato në rrjetet sociale, përfshirë deklarimin e sponsorëve dhe burimet e financimit.

Republika e Shqipërisë do të implementojë një kuadër të qartë ligjor për të garantuar ndalimin e financimeve nga burime të huaja në proceset zgjedhore, duke përfshirë zhvillimin e një platforme digjitale për transparencë financiare, forcimin e kapaciteteve të institucioneve mbikëqyrëse dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për identifikimin dhe sanksionimin e financimeve të paligjshme, si pjesë e përpjekjeve për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe avancimin në procesin e integritetit në BE.

Republika e Shqipërisë angazhohet të rregullojë shpenzimet e palëve të treta gjatë proceseve zgjedhore, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie, në përputhje me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e financimit të fushatave elektorale.

Republika e Shqipërisë do të rregullojë aktivitetin e palëve të treta në fushatat zgjedhore, duke synuar



deklarimin e burimit të financimit dhe lidhjet e tyre. Mekanizmat e mbikëqyrjes për aktivitetet e palëve të treta duhet të forcohen, duke përcaktuar, gjithashtu, sanksione të qarta për shkeljet. Një databazë publike për kontributet e palëve të treta mund të përmirësojë më tej llogaridhënien dhe transparencën.

Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimi ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja

Republika e Shqipërisë do të adresojë dezinformimin dhe manipulimin e informacionit nëpërmjet krijimit të një njësie të dedikuar koordinuese për monitorimin dhe reagimin aty për aty, në bashkëpunim me institucionet e reja të fushës.

Republika e Shqipërisë angazhohet për zhvillimin e fushatave të gjera ndërgjegjëse për qytetarët, të përqendruara në identifikimin e taktikave të dezinformimit dhe nxitjen e mendimit kritik, për të garantuar reagimin publik ndaj fushatave të manipulimit të informacionit, në partneritet të ngushtë me shoqërinë civile dhe me median. Në këtë kuadër, do të sigurohet mbështetje për edukimin dhe trajnimin e qytetarëve, në mënyrë efikase, në funksion të ndërgjegjësisë dhe rezistencës ndaj dezinformimit dhe manipulimeve mediatike.

OBJEKTIVI II: Mbrojtja e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse

Republika e Shqipërisë, në funksion të sigurisë kombëtare, duhet të forcojë aftësinë për të zbuluar hershëm aktivitetet hibride armiqësore, identifikimin e burimit të tyre, si dhe aftësinë për reagim të menjëhershëm. Republika e Shqipërisë duhet të jetë në gjendje të identifikojë ndërhyrjet hibride dhe të reagojë ndaj tyre në mënyrë të duhur.

Republika e Shqipërisë do të garantojë qëndrueshmërinë e sigurisë, mirëfunksionimin shtetëror dhe të shoqërisë, përmes qasjes gjithëpërfshirëse të rezistencës dhe reagimit që kërkon ky fenomen. Kjo qëndrueshmëri do të konsolidohet duke identifikuar dhe energjizuar menjëherë pikat e dobëta që mund shfrytëzohen nga autorët e ndërhyrjes hibride.

Republika e Shqipërisë do të forcojë kapacitetet e entiteteve përgjegjëse publike e private të elementeve të infrastrukturës kritike, për të garantuar funksionalitetin në rastet kur mund të jenë objektivi i ndërhyrjes hibride.

Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të forcojë aftësinë për të identifikuar dobësitë dhe për të kryer teste për simulimin e efekteve të ndërhyrjes hibride

në infrastrukturën publike dhe atë kritike. Në këtë fushë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë duhet të kërkojë të rrisë bashkëpunimin me sektorin privat, median, organizatat jofitimprurëse dhe sistemin arsimor.

Republika e Shqipërisë do të ndërtojë një sistem të komunikimit strategjik që do të jetë në gjendje të ndajë informacion në mënyrë efektive, koherente, të besueshme dhe në kohë me publikun dhe audienca të tjera të caktuara. Ky sistem duhet të veprojë si në mënyrë të vazhdueshme dhe preventive, ashtu edhe në përgjigje të emergjencave dhe krizave specifike. Sistemi duhet të bazohet në koordinimin dhe sinkronizimin e aktiviteteve të komunikimit mes të gjitha ministrive dhe institucioneve publike.

Për të kundërshtuar me efektivitet ndërhyrjet hibride, duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional. Republika e Shqipërisë do të rrisë aftësinë e koordinimit dhe të ndarjes së informacionit mes të gjithë aktorëve të brendshëm të rëndësishëm, me qëllim të mbulimit të të gjithë spektrit të mjeteve që përdoren nga ndërhyrjet hibride dhe ofrimit të një ndërgjegjësimi të qëndrueshëm të situatës me cilësi të përshtatshme.

Republika e Shqipërisë do të verifikojë rregullisht gatishmërinë e sistemit të saj të sigurisë për të kundërshtuar ndërhyrjen hibride përmes stërvitjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet e këtyre stërvitjeve do të përdoren në përpjekjet e mëtejshme për të bërë sistemin e sigurisë më efikas.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO dhe BE është instrumenti kryesor për të dekurajuar autorët e ndërhyrjes hibride. Prandaj, Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në aktivitete dhe iniciativa të NATO-s dhe të BE-së për kundërshtimin e ndërhyrjes hibride. Republika e Shqipërisë do të synojë të përdorë aftësitë e NATO-s dhe të BE-së për kundërshtimin e ndërhyrjes hibride, si dhe të kontribuojë në mënyrë të prekshme në këto aftësi.

Solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë mes aleatëve të NATO-s dhe shteteve anëtare të BE-së përbëjnë një instrument efektiv për parandalimin e ndërhyrjes hibride dhe përgjigjen ndaj manifestimeve të saj specifike. Prandaj, Republika e Shqipërisë do të mbështesë aktivisht unitetin dhe solidaritetin e aleatëve të NATO-s dhe shteteve anëtare të BE-së, duke përfshirë mundësinë e identifikimit kolektiv të aktiviteteve hibride



armiqësore, që mund të dekurajojnë autorët që të vazhdojnë aktivitetin e tyre.

Republika e Shqipërisë do të vijojë bashkëpunimin me NATO-n dhe me BE-në, që është thelbësor për të mbuluar të gjithë spektrin e mjeteve hibride të përdorura. Në këtë drejtim, Republika e Shqipërisë do të kontribuojë në aktivitetet e iniciativave të tjera ndërkombëtare, përfshirë Qendrën Evropiane të Ekselencës për Kundërveprimin ndaj Kërcënimeve Hibride në Helsink, Finlandë.

Republika e Shqipërisë do të zhvillojë aftësitë reaguese për të dekurajuar aktorët e ndërhyrjeve hibride, duke mundësuar një përgjigje efikase dhe në kohë, me fokus të veçantë në rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe partnerëve shoqërorë, me qëllim mbrojtjen e interesave të saj.

Republika e Shqipërisë angazhohet të vazhdojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin me NATO-n dhe BE-në, me qëllim forcimin e mbrojtjes kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin, si partneritete jetike për shfrytëzimin e ekspertizës teknike, shkëmbimin e inteligjencës dhe burimeve kibernetike.

Republika e Shqipërisë do të avancojë kapacitetet kombëtare për monitorimin dhe reagimin ndaj incidenteve kibernetike, duke forcuar CSIRT dhe SOC, si dhe duke vendosur mekanizma të detyrueshëm raportimi dhe penalitete për shkeljet e sigurisë.

Republika e Shqipërisë angazhohet për përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin privat, përmes forcimit të partneritetit dhe krijimit të mekanizmave të përbashkët për parandalimin dhe reagimin ndaj këtyre kërcënimeve.

OBJEKTIVI III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe e sektorëve të tjerë kritikë

Forcimi i mekanizmave ligjzatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonomi

Forcimi i kuadrit ligjor dhe i praktikës, që mbrojnë ekonominë kombëtare nga ndikimet dhe ndërhyrjet keqdashëse të huaja në sektorë të rëndësishëm, si investimet strategjike dhe ato të huaja, financimi i infrastrukturave kritike dhe procedurat e prokurimit publik. Ky objektiv synon identifikimin e boshllëqeve ligjore dhe zhvillimin e masave të integruara për të parandaluar ndërhyrjet e huaja që mund të dëmtojnë interesat ekonomikë dhe sigurinë kombëtare.

Republika e Shqipërisë angazhohet të miratojë kuadër rregullator për krijimin e një mekanizmi të shqyrtimit të investimeve të huaja, në përputhje me direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian, duke vendosur standarde të qarta mbi sigurinë kombëtare, infrastrukturën dhe teknologjitë kritike, si dhe mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe pluralizmit mediatik. Ligji i ri do të synojë rritjen e transparencës në investime dhe adresimin e sfidave që lidhen me teknologjitë e avancuara dhe ndikimin e investimeve në konkurrencën e tregut.

Republika e Shqipërisë do të ndërmarrë reforma ligjore për përmirësimin e mëtejshëm të akteve rregullatore për tregjet e kapitalit, në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE-së, zhvillimin e burimeve alternative të financimit dhe kufizimin e keqpërdorimit të sistemit financiar nga aktorë të huaj.

Republika e Shqipërisë, me qëllim garantimin e sigurisë kombëtare e mbrojtjen e interesit publik, synon të forcojë mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike, duke adresuar rreziqet e ndikimit të huaj në sektorët strategjikë, si: energjia, transporti, mbrojtja, teknologjia e informacionit, media dhe kujdesi shëndetësor, nëpërmjet mekanizmave ligjorë, diversifikimit të burimeve të furnizimit dhe partneritetit strategjik.

Republika e Shqipërisë do të promovojë investime në teknologji të sigurta dhe të certifikuara, duke inkurajuar operatorët për modernizimin e rrjeteve dhe zëvendësimin e infrastrukturës së amortizuar, apo të pasigurt.

Republika e Shqipërisë do të forcojë transparencën dhe edukimin financiar, duke rritur ndërgjegjësimin mbi rreziqet që dezinformimi paraqet për stabilitetin ekonomik dhe sigurinë kombëtare.

Adresimi i kërcënimeve ndaj sektorëve strategjikë dhe sistemit financiar të ekonomisë

Analizimi i rasteve të mundshme të ndërhyrjeve të huaja që mund të çojnë në destabilizimin e ekonomisë dhe të sektorëve të tjerë strategjikë, përfshirë sistemin financiar, që dikton nevojën për zhvillimin e politikave për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja që mund të dëmtojnë stabilitetin ekonomik, duke përfshirë mbrojtjen e sektorëve kyç dhe garantimin e sigurisë të sistemit financiar.

Ndërhyrja hibride përdor mjete politike, diplomatike, informative, ushtarake, ekonomike,



financiare, inteligjente, por pa përjashtuar përdorimin e instrumenteve ligjore dhe në dukje legjitime për të arritur objektiva armiqësore dhe për të minuar interesat e Republikës së Shqipërisë. Shpejtësia, shtrirja dhe intensiteti i ndërhyrjeve hibride janë rritur, pjesërisht si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së re.

Republika e Shqipërisë do të përdorë një sistem dhe transparent kontrolli për investimet e huaja në sektorët strategjikë të ekonomisë dhe ndërmarrjet kyçe, veçanërisht ato që janë pjesë e infrastrukturës kritike apo të tjera që kanë rëndësi të veçantë publike.

Republika e Shqipërisë, në funksion të qëndrueshmërisë ekonomike dhe zvogëlimit të ndikimeve të huaja në ekonomi, angazhohet të diversifikojë marrëdhëniet tregtare, të promovojë konkurrueshmërinë, duke synuar reduktimin e varësisë nga tregje të caktuara.

Republika e Shqipërisë angazhohet të forcojë sigurinë e infrastrukturës së telekomunikacionit, nëpërmjet një kuadri rregullator për certifikimin e furnitorëve dhe pajisjeve, në përputhje me standardet e BE-së.

Republika e Shqipërisë synon të rrisë transparencën dhe mbikëqyrjen e zinxhirit të furnizimit të pajisjeve të rrjeteve kritike, duke garantuar auditime të rregullta dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurt.

OBJEKTIVI IV: Mbrojtja dhe forcimi i lirisë së shprehjes, lirisë së medias, si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik kundër dezinformimit

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin

Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe forcimi i mediave të pavarura për të identifikuar, për të ekspozuar dhe për të rritur edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi rreziqet e dezinformimit dhe manipulimit të informacionit, përfshirë krijimin e mekanizmave për monitorimin dhe analizën e përmbajtjeve të rreme dhe përhapjen e informacionit të saktë dhe të verifikuar.

Republika e Shqipërisë angazhohet të sigurojë pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile gjatë hartimit të kuadrit të ri rregullator, për të adresuar ndërhyrjet e

huaja, përfshirë dezinformimin, për të garantuar një balancë të drejtë mes mbrojtjes së sigurisë dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive themelore, si liria e shprehjes dhe e privatësisë.

Republika e Shqipërisë angazhohet në përafrimin e plotë të *Acquis* të BE-së në fushën e shërbimeve digjitale, inteligjencën artificiale dhe median¹², për të siguruar një hapësirë më të sigurt dhe të drejtë digjitale për qytetarët dhe bizneset.

Republika e Shqipërisë do të nxisë, do të mbështesë dhe do të promovojë krijimin e rrjetit universitar të solidaritetit kundër ndërhyrjeve të huaja, përfshirë dezinformimin, i cili do të zhvillojë metoda të reja inovative për zbulimin e fushatave të dezinformimit, duke përdorur teknologjinë.

Republika e Shqipërisë angazhohet të mbështesë dhe të inkurajojë zhvillimin e *start-up*-eve dhe projekteve teknologjike, që përqendrohen në zgjidhje si analiza e dezinformimit, kontrolli i fakteve, dallimi i *deep fake* dhe siguria kibernetike.

Republika e Shqipërisë angazhohet për forcimin e kapaciteteve institucionale në nivel kombëtar për parandalimin, zbulimin dhe analizimin e dezinformimit, përmes zhvillimit të programeve të trajnimit, aftësimit të specialistëve të komunikimit dhe përmirësimit të komunikimit strategjik të entiteteve publike. Institucioni përgjegjës për komunikimin strategjik do të ketë një rol kyç në koordinimin dhe zhvillimin e këtyre kapaciteteve në të gjithë administratën publike. Në këtë proces, një bashkëpunim i ngushtë me shoqërinë civile dhe median është thelbësor për të forcuar qëndrueshmërinë demokratike dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi sfidat e dezinformimit.

Nxitja e raportimit investigativ dhe gazetarisë së pavarur në nivel kombëtar për të fuqizuar gazetarinë e bazuar në fakte, si një mjet thelbësor për të kundërshtuar përhapjen e informacionit të manipuluar dhe për të garantuar transparencë.

Republika e Shqipërisë angazhohet për të nxitur dhe për të mbështetur shoqërinë civile dhe median, duke promovuar gazetarinë profesionale, iniciativat vetërregulluese dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik për median. Një ekosistem mediatik i pavarur dhe financiarisht i qëndrueshëm është thelbësor për lirinë e shprehjes, aksesin e

¹² DSA (Akti për Shërbimet Digjitale), EMFA (Akti Evropian për Lirinë e Medias), DMA (Akti për Tregun Digjitale) dhe AIA (Akti për Inteligjencën Artificiale).
Faqe | 19538



qytetarëve në informacion të besueshëm dhe forcimin e demokracisë. Diversifikimi i modeleve të financimit dhe transparenca financiare e mediave tradicionale dhe atyre digjitale janë elemente kyç në garantimin e pavarësisë dhe funksionimit të tyre të pandikuar afatgjatë, duke përmirësuar dhe klimën e punës së gazetarëve profesionistë.

Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si dhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit.

Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë që promovojnë aksesin në informacion të besueshëm dhe mbrojtjen e lirisë së medias, përfshirë edukimin digjital të qytetarëve, zhvillimin e aftësive për të dalluar informacionin e rremë, për të rritur sigurinë dhe etikën në përdorimin e internetit, si dhe për të garantuar mbrojtjen e të gjitha lirive themelore.

Republika e Shqipërisë do të investohet në mënyrë të vazhdueshme në ndërgjegjësimin e

shoqërisë në tërësi për ekzistencën dhe natyrën e ndërhyrjes hibride. Kundërveprimi ndaj ndërhyrjes hibride do të jetë, gjithashtu, pjesë e programeve edukative dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit. Në këtë drejtim, do të forcohet bashkëpunimi mes qeverisë, sektorit privat, sistemit arsimor, mediave dhe shoqërisë civile.

Republika e Shqipërisë angazhohet për përfshirjen e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI) dhe zhvillimin e aftësive digjitale, në kurrikulat e shkollave dhe universiteteve, si dhe të krijojë programe trajnimi për mësuesit dhe administratën publike, në funksion të zhvillimit të një brezi qytetarësh të informuar dhe me aftësi të mira, për të dalluar dhe për të përballuar dezinformimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

Media do të publikojë në mënyrë të dukshme politikat editoriale dhe standardet për moderimin e përmbajtjes, duke i dhënë audiencës mundësinë të kuptojë qartë proceset e përzgjedhjes së lajmeve dhe verifikimit të fakteve.

UDHËRRËFYESI I STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR NDRËHYRJEVE TË HUAJA DHE DEZINFORMIMIT			
Qëllimi i këtij udhërrëfyese është të përshkruajë hapat në vijim që duhen ndjekur për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të Strategjisë përmes një procesi afatgjatë dhe gjithëpërfshirës, bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të hartojë dhe miratojë planin e veprimit në zbatim të Strategjisë brenda vitit 2025, duke siguruar mbështetjen buxhetore të nevojshme për planin e masave dhe investimeve. Gjatë hartimit të nismave legislative, Këshilli i Ministrave dhe institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë zhvillimin e një procesi të gjerë konsultimi, të mbështetur në praktikatat më të mira ndërkombëtare, kryesisht në ato të BE-së dhe NATO-s. Zbatimi i Strategjisë dhe i plan-veprimit do t'i nënshtrohet në vijimësi mbikëqyrjes parlamentare dhe duhet të jetë i harmonizuar rregullisht me dokumentet kombëtare. Sistemi i koordinimit ndërqeveritar do të përfshijë një autoritet rregullator dhe mbikëqyrës politikash, të pavarur të ngritur me ligj (Kuvendi i RSH-së) dhe një institucion në nivel ekzekutiv për koordinimin operacional, përgjegjës për zbatimin e politikave/Strategjisë, si dhe për monitorimin/rishikimin e planit të veprimit të Strategjisë dhe harmonizimin e tij me dokumentet e tjera strategjike.			
OBJEKTIVI I: NGRITJE DHE KONSOLIDIM I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR TË PARANDALUAR, PËR TË ZBULUAR DHE PËR TË ANALIZUAR NDRËHYRJET E HUAJA NË FUSHATAT ZGJEDHORE			
FUSHAT DHE OBJEKTIVAT	PËRSHKRIMI	AFATI KOHOR	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
Fusha 1.1: Përforsimi i mbrojtjes ligjore dhe i mekanizmave të monitorimit të proceseve zgjedhore			
1.1.1 Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor	Amendimi i kuadrit ligjor zgjedhor me objekt rregullimin e financimeve nga burimet të huaja, të dyshimta dhe fushatën hije. Rishikimi i rregulloreve për parandalimin e përdorimit të fondeve të paligjshme nga subjektet/kandidatët zgjedhorë.	15 muaj	Kuvendi i RSH-së KQZ MD
1.1.2 Një kuadër rregullator për vlerësimin paraprak dhe auditues për sistemet TIK në proceset zgjedhore Auditimi dhe certifikimi i databazave të zgjedhësve dhe i pajisjeve zgjedhore	Miratimi i akteve ligjore që parashikojnë procedura për vlerësimin paraprak dhe auditimin e sistemeve TIK të përdorura në zgjedhje. Këto procedura duhet të vlerësojnë sigurinë e sistemeve TIK zgjedhore, identifikimin e dobësive dhe certifikimin sipas standardeve ndërkombëtare. Gjithashtu, të parashikohen procedura <i>back-up</i> për rastet eventuale të mosfunksionimit të sistemeve TIK. Me qëllim vlerësimin paraprak të sistemeve TIK në proceset zgjedhore, të hartohet një studim fizibiliteti i gjendjes aktuale të sistemeve TIK të KQZ-së dhe të përdorura në proceset zgjedhore.	15 muaj	KQZ MB AKSK AKSHI KLSH
1.1.3 Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike	Miratimi i protokolleve reaguese dhe i procedurave emergjente për sulme kibernetike gjatë periudhës zgjedhore, ditën e votimit dhe administrimin e procesit zgjedhor.	12 muaj Në vijimësi	KQZ MM MB AISM



	Zhvillimi i simulimeve dhe i testeve periodike për sulme kibernetike gjatë periudhës zgjedhore, ditën e votimit dhe administrimin e procesit zgjedhor.		SHISH AKSK AKSHI KDIMDHP
Fusha 1.2: Rritja e transparencës dhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e financimeve politike			
1.2.1 Hartimi i legjislacionit për ndalimin e financimeve të huaja	Miratimi i akteve ligjore që ndalojnë financimet e huaja për partitë politike dhe fushatat zgjedhore, përfshirë sanksionet.	12 muaj	Kuvendi i RSH-së Këshilli i Ministrave MD KQZ
1.2.2 Krijimi i një platforme digjitale për transparencë financiare	Ngritja e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë reale të burimeve financiare dhe shpenzimeve të partive politike, që të garantojë publikim të plotë për qytetarët dhe mediat.	12 muaj	KQZ MD
1.2.3 Miratimi i kuadrit rregullator për veprimtarinë lobuese	Miratimi i një ligji që rregullon veprimtarinë lobuese, ku të rregullohen çështjet në raport me ndërhyrjen e huaj, në përputhje me standardet ndërkombëtare.	24 muaj	Këshilli i Ministrave MD MAPA KQZ
1.2.4 Ngritja e një regjistri kombëtar për transparencën e aktiviteteve të lobimit	Krijimi i një databaze publike që regjstron aktivitetet e lobimit dhe burimet financiare të lidhura, në përputhje me standardet ndërkombëtare.	24 muaj	Këshilli i Ministrave MD MAPA KQZ
1.2.5 Fuqizimi i mbikëqyrjes financiare	Përmirësimi i kapaciteteve të KQZ-së dhe rishikimi i mekanizmit për monitorimin e financave të partive politike.	Në vijimësi	Kuvendi i RSH/ Komisioni përgjegjës parlamentar KQZ
1.2.6 Angazhimi në programe ndërkombëtare në fushën e sigurisë mbi proceset zgjedhore	Organizimi i trajnimeve dhe i projekteve ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe ndarja e përvojave në fushën e sigurisë mbi proceset zgjedhore.	Në vijimësi	MEPJ AKSHI AKSK KQZ
1.2.7 Rregullimi i veprimtarisë së palëve të treta në fushatat zgjedhore	Miratimi i rregullave për regjistrimin dhe deklarimin e burimeve financiare dhe lidhjeve të palëve të treta dhe sanksionimi i shkeljeve. Krijimi i një databaze publike ku të pasqyrohen deklaratimet.	12 muaj	Kuvendi i RSH-së MD KQZ KDIMDHP
Fusha 1.3: Forcimi i përgjegjësisë dhe koordinimi ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja			
1.3.1 Krijimi i një njësie të dedikuar për monitorimin e dezinformimit	Ngritja e një njësie për monitorimin e dezinformimit dhe reagimin në kohë reale ndaj tij.	12 muaj	Kuvendi i RSH-së/ Komisioni përgjegjës parlamentar KQZ MD
1.3.2 Rregullime për transparencën financiare të reklamave politike në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore	Miratimi i kritereve të qarta për transparencë financiare, duke përfshirë deklarimin e burimeve të financimit.	12 muaj	MD KQZ AMA
1.3.3 Koordinimi ndërkombëtar për ndarjen e informacionit mbi kërcënimet hibride dhe/ose ndërhyrjet e huaja	Përfshirja në mekanizma ndërkombëtarë të ndarjes së informacionit dhe bashkëpunimit me NATO-n dhe me BE-në për adresimin e kërcënimeve hibride.	Në vijimësi	MEPJ MM AKSHI AKSK etj.
1.3.4 Ndërveprimi me struktura ndërkombëtare dhe qendra ekspertize për ndërhyrjet e huaja	Bashkëpunimi me struktura ligjzbatuese dhe kërkimore në rajon dhe në Evropë me objekt parandalimin e ndërhyrjeve të huaja.	Në vijimësi	MEPJ MM KQZ
Fusha 1.4: Sanksionimi i ndërhyrjeve të huaja dhe forcimi i kuadrit ligjor			
1.4.1 Kuadër rregullator për financimet e paligjshme dhe ndërhyrjet e huaja, në proceset zgjedhore	Miratimi i kuadrit rregullator për financimet e paligjshme dhe ndërhyrjet e huaja, sipas standardeve ndërkombëtare të fushës.	12 muaj	Kuvendi i RSH-së MD KQZ AKSK
1.4.2 Përmirësimi i rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale	Harmonizim i rregullimit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në kontekstin e sigurisë zgjedhore.	9 muaj	KDIMDHP; MD MB KQZ AKSK
Fusha 1.5: Ndërtimi i kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi publik			
1.5.1 Organizimi i trajnimeve për administratën zgjedhore	Hartimi i moduleve të trajnimit sipas standardeve ndërkombëtare. Organizimi i trajnimeve për administratën zgjedhore.	12 muaj Në vijimësi	KQZ Institucionet e reja të fushës
1.5.2 Fushata ndërgjegjësuere për qytetarët	Zhvillimi i fushatave informative në median tradicionale dhe digjitale, organizimi i eventeve publike dhe debatet për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e ndërhyrjeve të huaja.	Në vijimësi	KQZ AMSHC SASPAC Organizata të shoqërisë civile Institucionet e reja të fushës
1.5.3 Fushata ndërgjegjësimi me institucionet e arsimit të lartë	Zhvillimi i veprimtarive akademike dhe studentore me objekt ndërhyrjet e huaja.	Në vijimësi	Ministria përgjegjëse për arsimin, Universitetet Institucionet e reja të fushës



OBJEKTIVI II: MBROJTJA E SIGURISË KOMBËTARE NGA NDËRHYRJET E HUAJA DHE DEZINFORMIMI			
Fusha 2.1: Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim			
2.1.1 Hartimi i një akti ligjor mbi ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin	Hartimi dhe miratimi i një akti ligjor që të parashikojë fushë veprimtarinë, përkufizime, rregullimin ligjor, sanksionet dhe institucionet përgjegjëse për çështjet e ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimin.	Shtator 2025 – qershor 2026	Kuvendi i RSH-së Këshilli i Ministrave
2.1.2 Krijimi i një strukture të dedikuar për evidentimin dhe përballjen me ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin. (Në vijim referuar si “Struktura Përgjegjëse”.)	Ligji i ri të parashikojë ngritjen e një organi rregullator dhe monitorues për ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin. Kjo strukturë të përfshijë ekspertë të lartë dhe të specializuar, dhe t'i mundësohen instrumente ligjore dhe kapacitete teknologjike në funksion të detyrave.	Shtator 2025 – qershor 2026	Kuvendi i RSH-së Këshilli i Ministrave
2.1.3 Koordinimi ndërinstitutional dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për evidentimin dhe përballjen me ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin	Ngritja e rrjetit të komunikimit, krijimi i praktikave të mirave të bashkëpunimit dhe i shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Parashikimi i trajnimeve për rritjen e ekspertizës.	Brenda marsit 2026 Në vijimësi	Struktura përgjegjëse AKSHI AKSK KQZ
2.1.4 Komision Parlamentar për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin	Të rriten burimet dhe ekspertiza parlamentare nëpërmjet koordinimit me institucionet shtetërore, akademike, shoqërinë civile, median dhe sektorin privat, si dhe të organizohen seanca dëgjimore publike e raportime periodike, me qëllim garantimin e një mbikëqyrjeje efektive, transparente dhe të përgjegjshme ndaj çdo lloji forme të FIMI-së.	Brenda tetorit 2025 Në vijimësi	Kuvendi i RSH-së
2.1.5 Raportimi periodik në Komision Parlamentar nga struktura që do të krijohet për zbulimin, analizimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse dhe dezinformimin		Periodikisht (së paku çdo katër muaj ose me kërkesë)	Struktura përgjegjëse
2.1.6 Ngritja e rrjetit të komunikimit me operatorët mediatikë (online dhe socialë) dhe bashkëpunimi me subjektet e angazhuara në verifikimin e vërtetësisë së informacionit		Në vijimësi	Struktura përgjegjëse AMA AMI Organizatave profesionale të fushës
2.1.7 Forcimi i bashkëpunimit për të promovuar bashkëregullimin dhe vetërregullimin në fushën e medias		Në vijimësi	Struktura përgjegjëse AMA Organizatave profesionale të fushës
Fusha 2.2: Ndërgjegjësimi publik mbi instrumentet e ndërhyrjeve dhe rritja e edukimit publik mbi dezinformimin			
2.2.1 Hartimi i një strategjie sektoriale për edukimin mediatik dhe/ose integrimi i edukimit mediatik në arsimin e përgjithshëm		Brenda vitit 2026	Këshilli i Ministrave Ministria përgjegjëse për arsimin AMA Struktura përgjegjëse
2.2.2 Hartimi i udhëzuesve/materialeve të informimit të gjerë publik mbi ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin	Të synohet përgatitja e teksteve dhe materialeve për një kuptim më të mirë të burimeve të dezinformimit dhe të synimeve, mjeteve dhe objektivave që qëndrojnë pas dezinformimit, por edhe të cënueshmërive/dobësive tona.	Në vijimësi	Këshilli i Ministrave AMA RTSH AMSHC Struktura përgjegjëse etj.
2.2.3 Veprimtari me qëllim edukimin publik mbi ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin	Ndërtimi i qëndrueshmërisë përfshin gjithashtu trajnime të specializuara, konferenca publike dhe debate, si dhe forma të tjera të të mësuarit të përbashkët për mediat. Ai gjithashtu përfshin fuqizimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë dhe, në veçanti, përmirësimin e edukimit mediatik të qytetarëve për të kuptuar se si të dallojnë dhe të shmangin dezinformimin.	Në vijimësi	AMA RTSH Struktura përgjegjëse Institucionet e arsimit të lartë Organizatave të profesionistëve të fushës etj.
OBJEKTIVI III: MBROJTJA E EKONOMISË KOMBËTARE DHE E SEKTORËVE TË TJERË KRITIKË			
Fusha 3.1: Forcimi i mekanizmave ligjbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonomi			
3.1.1 Miratimi i ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja	Shqipërisë i nevojitet një ligj i ri që parashikon një Mekanizëm për Shqyrtimin e Investimeve (MSHI) dhe që përfshin përkufizime të qarta të: a) sigurisë kombëtare; b) infrastrukturës kritike (energjëtika, transporti, ujë, shëndetësia, komunikimet, media, përpunimi ose ruajtja e të dhënave, infrastruktura zgjedhore ose financiare, si dhe strukturat delikate dhe investimet në blerje toke dhe pasurie të paluajtshme që janë thelbësore për përdorimin e infrastrukturave në fjalë); c) teknologjitë kritike dhe	Brenda 2026-s	Këshilli i Ministrave Kuvendi i RSH-së Struktura përgjegjëse Ministria përgjegjëse për financat Ministria përgjegjëse për ekonominë BSH AIF AKSK AKSHI



	objektet me përdorim të dyfishtë (duke përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërcjellësit, sigurinë kibernetike, kuantumin, hapësirën ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë dhe teknologjitë bërthamore, nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë); d) aksesin ose aftësinë për të kontrolluar informacionet delikate (përfshirë të dhënat personale) dhe; e) lirinë dhe pluralizmin e medias. Gjatë hartimit të legjislacionit për MSHI-në, të përfshihen grupet e interesit, si komuniteti i biznesit.		KDIMDHP
3.1.2 Zbatimi i një sistemi transparent për monitorimin e investimeve në sektorët strategjikë		Në vijimësi	Kuvendi i RSH-së KM KLSH
3.1.3 Monitorim dhe kufizimi i varësisë nga furnitorë të pasigurt		Në vijimësi	Kuvendi RSH-së/ Komisioni parlamentar përgjegjës Struktura përgjegjëse APP AKSHI AKSHE AKSK DPD
3.1.4 Krijimi i një njësie të dedikuar në rrjetin e koordinimit në nivel kombëtar për sistemin bankar dhe financiar		Në vijimësi	BSH Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar Struktura përgjegjëse
Fusha 3.2: Adresimi i kërcënimeve ndaj sektorëve strategjikë dhe sistemit financiar të ekonomisë			
3.2.1 Forcimi i ndërveprimit dhe i komunikimit të sektorit privat me institucionet publike	Zhvillimi i forumeve me pjesëmarrjen e aktorëve publikë dhe privatë për analizimin e dinamikave të tregut në raport me vulnerabilitetet e ekonomisë vendëse në raport me aktorët e huaj.	Periodik 12-mujor	BSH AMF AIF Struktura përgjegjëse Ministri përgjegjës për sipërmarrjen Këshilli Ekonomik Kombëtar Dhoma Kombëtare e Ekonomisë Organizata përfaqësuese të operatorëve ekonomikë
3.2.2 Informimi publik mbi gjendjen e ekonomisë vendëse në raport me kapitalet dhe investimet e huaja	Përgatitja mbi indikatorë dhe metodologji, si dhe publikimi i raporteve periodike që të garantojnë informacion të plotë dhe sintetik mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare në raport me kapitalet e huaja, investimet e huaja, operatorët e rinj ndërkombëtarë dhe panoramë të flukseve financiare.	Periodik 6-mujor	BSH AMF Ministria përgjegjëse për financat Ministria përgjegjëse për ekonominë AMI Struktura përgjegjëse
OBJEKTIVI IV: MBROJTJA DHE FORCIMI I LIRISË SË SHPREHJES, LIRISË SË MEDIAS, SI DHE RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E ANGAZHIMIT PUBLIK KUNDËR DEZINFORMIMIT			
Fusha 4.1: Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të pavarura për të luftuar dezinformimin			
4.1.1 Krijimi i mekanizmave të strukturuar të bashkëpunimit midis institucioneve që trajtojnë FIMI-në dhe OJF-ve, duke mundësuar analizimin dhe monitorimin e ndërhyrjes së huaj		12 muaj	Kuvendi i RSH-së Këshilli i Ministrave AMSHC Struktura përgjegjëse
4.1.2 Mbështetja me fonde publike e programeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për OJF-të për të zhvilluar ekspertizë në kërkim, analizën dhe zbulimin e FIMI-së, si edhe në advokim, rritje ndërgjegjësimi		Në vijimësi	Kuvendi i RSH-së Këshilli i Ministrave AMSHC AMA AMI
4.1.3 Promovimi i gazetarisë së verifikimit të fakteve në transmetimet e medias publike (RTSH) dhe mediat kombëtare		Në vijimësi	Kuvendi i RSH-së AMA RTSH
4.1.4 Zhvillimi i programeve trajnuese dhe i mekanizmave mbështetës për gazetarët/mediat/mbikëqyrësit publikë mbi sigurinë digjitale	Zhvillimi i trajnimeve mbi praktikën, në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës, kundër sulmeve kibernetike ose <i>spyware</i> , apo të tjera si p.sh. enkriptimi i komunikimit, përdorimi i VPN-ve etj.	Në vijimësi	Këshilli i Ministrave AMA AKSK AMSHC Departamenti i Gazetarisë/institucionet e arsimit të lartë
4.1.5 Mundësimi i lehtësirave fiskale për gazetarinë investigative, për të forcuar pluralizmin mediatik dhe për të		24 muaj	Këshilli i Ministrave Ministria përgjegjëse për financat DPT



luftuar dezinformimin e mbështetur nga aktorë të huaj.=			
Fusha 2: Promovimi i informacionit të besueshëm, rritja e ndërgjegjësimit e edukimit mediatik, si dhe fuqizimi i aftësive digjitale të qytetarëve, me qëllim forcimin e rezistencës shoqërore ndaj dezinformimit			
4.2.1 Publikimi në mënyrë të dukshme i politikave editoriale dhe standardet për moderimin e përmbajtjes në media, duke i dhënë audiencës mundësinë të kuptojë qartë proceset e përzgjedhjes së lajmeve dhe verifikimit të fakteve		12 muaj	AMA Organizatat e profesionistëve të fushës Departamenti i Gazetarisë/institucionet e arsimit të lartë
4.2.2 Përfshirja e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI), së bashku me aftësitë digjitale, në kurrikulat e shkollave parauniversitare dhe universitare	Të synohet përgatitja e teksteve dhe e materialeve për një kuptim më të mirë të burimeve të dezinformimit dhe të synimeve, mjeteve dhe objektivave që qëndrojnë pas dezinformimit, por edhe të cenueshmërive/dobësive tona.	24 muaj	Këshilli i Ministrave Ministria përgjegjëse për arsimin Struktura përgjegjëse AMA Institucionet e arsimit të lartë Qeveria e nxënësve/studentëve bordi i prindërve
4.2.3 Zbatimi i fushatave të gjera ndërgjegjësuere për publikun, të përqendruara në identifikimin e taktikave të dezinformimit dhe nxitjen e mendimit kritik te qytetarët, për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj FIMI-së	Ndërtimi i qëndrueshmërisë përfshin trajnime të specializuara, konferenca publike dhe debate, si dhe forma të tjera të të mësuarit të përbashkët për mediat. Ai, gjithashtu, përfshin fuqizimin e të gjithë sektorëve të shoqërisë dhe, në veçanti, përmirësimin e edukimit mediatik të qytetarëve për të kuptuar se si të dallojnë dhe të shmangin dezinformimin.	Në vijimësi	Këshilli i Ministrave Ministria përgjegjëse për arsimin Struktura përgjegjëse AMA Organizatat e profesionistëve të fushës Institucionet e arsimit të lartë
4.2.4 Krijimi i moduleve të detyrueshme të trajnimit mbi EMI-në dhe sigurinë digjitale në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)		24 muaj Në vijimësi	MAPA AKSK AMA Struktura përgjegjëse ASPA

DEKRET**Nr. 279, datë 28.7.2025****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 47/2025, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 52/2025****PËR MARKAT TREGTARE¹³**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky ligj përcakton:

¹³ Ky ligj përafron plotësisht:

- Rregulloren (BE) 2017/1001, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 14 qershor 2017, për markat tregtare të Bashkimit Evropian, Celex nr. 32017R1001; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 154, datë 16.6.2017 (OJ L 154, 16.6.2017, p. 1–99).

- Direktivën (BE) 2015/2436, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 dhjetor 2015, për përafrimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me markat

tregtare, Celex nr. 32015L2436; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 336, datë 23.12.2015 (OJ L 336, 23.12.2015, p. 1–26).

- Direktivën 2004/48/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 29 prill 2004, për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, Celex nr. 32004L0048R(01); Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 195, datë 2.6.2004 (OJ L 195, 2.6.2004, p. 16–25).



a) rregullat, kriteret dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare;

b) të drejtat që rrjedhin prej regjistrimit të markave tregtare;

c) rregullimin e markave tregtare si objekte të pronësisë dhe procedurat për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e markave tregtare;

ç) rregullat, kushtet dhe procedurat për shfuqizimin dhe pavlefshmërinë e markave tregtare;

d) rregullat për administrimin e sistemit dhe regjistrit të markave tregtare;

dh) mbrojtjen e të drejtave të markave tregtare në rastet e shkeljes së këtyre të drejtave.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi në mënyrë të plotë i marrëdhënieve juridike që lidhen me markat tregtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për:

a) kërkesat për regjistrimin e markave tregtare;

b) markat tregtare;

c) markat tregtare kolektive dhe certifikuese;

ç) regjistrimet ndërkombëtare të markave tregtare.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm” është autoriteti kompetent për mbikëqyrjen, monitorimin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe me çdo ligj apo akt nënligjor tjetër që përmban dispozita për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

2. “Bordi i Apelit” është organi i krijuar për shqyrtimin e ankimeve administrative, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

3. “Buletini i DPPI-së” ose “Buletini” është botimi periodik zyrtar i DPPI-së, ku botohen të gjitha të dhënat në lidhje me markat tregtare, markat

tregtare kolektive dhe certifikuese, si dhe të gjitha veprimet që lidhen me to, siç parashikohet në këtë ligj ose në aktet në zbatim të tij.

4. “DPPI” është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

5. “Dhoma e kundërshtimeve” ose “Dhoma” është një strukturë e ngritur brenda njësisë së ekzaminimit që shqyrton kundërshtimet ndaj markave tregtare, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. “Dhoma për shfuqizim dhe pavlefshmëri” ose “Dhoma” është një strukturë e ngritur brenda DPPI-së, që shqyrton kërkesat për shfuqizimin dhe deklarimin e pavlefshmërisë së markave tregtare, observimet e depozituara për shkaqe absolute kundër markave tregtare të botuara dhe ankimet kundër vendimeve për refuzimin e markës ose elementeve të markës për shkaqe absolute, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

7. “Gjykatë” është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ose Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, sipas rastit.

8. “Kërkesë për regjistrim marke tregtare” ose “Kërkesë për markë” është kërkesa për regjistrimin e një shenje si markë tregtare, që depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

9. “Klasifikimi i Nicës” është marrëveshja në lidhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve për qëllime të regjistrimit të markave, e miratuar me Marrëveshjen e Nicës më 15 qershor 1957, me të gjitha rishikimet dhe ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 9033, datë 20.3.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, për qëllimet e regjistrimit të markave”.

10. “Klasifikimi i Vjenës” është marrëveshja për krijimin e një Klasifikimi Ndërkombëtar të Elementeve Figurative të Markave, e miratuar me Marrëveshjen e Vjenës më 12 qershor 1973, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 34/2018, datë 7.6.2018, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Vjenës për Klasifikimin Ndërkombëtar të Elementeve Figurative të Markës Tregtare”.

11. “Konventa e Parisit” është Konventa për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, e miratuar në Paris më 20 mars 1883 dhe ndryshimet e saj.



12. “Konventa në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare” është konventa dhe protokollet e kësaj konvente, e nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 9899, datë 10.4.2008, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Ekspozitat Ndërkombëtare”.

13. “Licencë ekskluzive” është licenca (e përgjithshme ose e kufizuar) që autorizon personin e licencuar, duke përjashtuar çdo person tjetër, përfshirë edhe personin që e lëshon atë, për të përdorur markën tregtare në mënyrën e autorizuar nga licenca.

14. “Licencë joekskluzive” është licenca që nuk i heq të drejtën personit që ka depozituar kërkesën për markë ose pronarit të markës tregtare që ta përdorë ose ta licencojë markën tregtare te persona të tjerë.

15. “Licencim” është dhënia e licencës, nëpërmjet së cilës personi që ka depozituar kërkesën për markë ose pronari i markës tregtare autorizon dhe lejon një palë tjetër që të kryejë një ose disa veprime në lidhje me markën.

16. “Mallra të markave të falsifikuara” janë mallrat, duke përfshirë çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër të ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që mbajnë në mënyrë të paautorizuar një shenjë, e cila është identike me një markë tregtare të regjistruar rregullisht në lidhje me këto mallra, ose e cila nuk mund të dallohet në aspektet e saj thelbësore nga kjo markë tregtare dhe që shkel në këtë mënyrë të drejtat e pronarit të markës tregtare në fjalë.

17. “Markë tregtare” ose “markë” është marka tregtare e regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që ka efekt në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

18. “Markë tregtare kolektive” ose “markë kolektive” është marka tregtare që përcaktohet si e tillë në kërkesën për regjistrim të markës tregtare dhe që mundëson dallimin e mallrave dhe shërbimeve të anëtarëve të një shoqate që është pronare e markës tregtare nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve të tjera.

19. “Markë tregtare certifikuese” ose “markë certifikuese” është marka tregtare që përcaktohet si e tillë në kërkesën për regjistrim të markës tregtare dhe që mundëson dallimin e mallrave dhe

shërbimeve që janë certifikuar nga pronari i markës tregtare në lidhje me materialin, mënyrën e prodhimit të mallrave, ofrimin e shërbimeve, cilësinë, saktësinë apo karakteristika të tjera nga mallrat ose shërbimet që nuk janë certifikuar në këtë mënyrë.

20. “Markë tregtare e mirënjohur” është marka tregtare e njohur si e tillë në Republikën e Shqipërisë sipas nenit 6bis të Konventës së Parisit.

21. “Marrëveshja e Madridit” është Marrëveshja e Madridit në lidhje me Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave, e datës 14 prill 1891, me të gjitha rishikimet dhe ndryshimet e mëvonshme.

22. “Marrëveshja TRIPS” është Marrëveshja për Aspektet e Lidhura me Tregtinë e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, e nënshkruar në Marok më 15 prill 1994, si shtojcë e marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, ratifikuar me ligjin nr. 8648, datë 28.7.2000, “Për ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë.

23. “Mbajtës i së drejtave” është pronari ose mbajtësi i licencës së markës tregtare, i regjistruar në kuptim të këtij ligji, dhe çdo person ose entitet tjetër i autorizuar për të përdorur markën tregtare në rastin e markave kolektive dhe certifikuese.

24. “Mjet elektronik” është çdo mjet që mundëson dërgimin fillestar ose të mëvonshëm të informacionit dhe marrjen e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të mjeteve ose pajisjeve elektronike për procesimin, përpunimin, trajtimin dhe ruajtjen e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kablove, radiovalëve, mjeteve dhe kablove optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë dhe internetin.

25. “Observime” janë prapësimet, argumentet, dokumentet dhe provat që paraqiten nga një palë pjesëmarrëse në procedurat përpara DPPI-së.

26. “Person” është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.

27. “Përdorim real dhe efektiv i markës tregtare” është përdorimi real, i vërtetë dhe efektiv i markës tregtare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

28. “Protokolli i Madridit” është protokollin në lidhje me marrëveshjen e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave, i miratuar në Madrid, më 27 qershor 1989, me të gjitha ndryshimet e



mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 8992, datë 30.1.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave”.

29. “Regjistër” është mbledhja zyrtare e të dhënave të markave tregtare që mbahen nga DPPI-ja në përputhje me këtë ligj.

30. “Rregulloret e përdorimit” janë rregulloret e përdorimit të markave tregtare kolektive dhe certifikuese që depozitohen në DPPI në përputhje me këtë ligj.

31. “Sistemi i administrimit të pronësisë industriale” ose “SAPI” është mjeti elektronik, duke përfshirë bazën e të dhënave për administrimin e objekteve të pronësisë industriale nga DPPI-ja.

32. “Shkaqe absolute dhe relative”, sipas rastit, janë shkaqet absolute dhe relative për refuzimin e regjistrimit të markës së botuar ose deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare të regjistruar në përputhje me rregullat, kriteret dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

33. “Zyra Ndërkombëtare” është Zyra Ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

34. “OBPI” është Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, e themeluar nëpërmjet Konventës për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, e nënshkruar në Stokholm në datën 14 korrik 1967, aderuar me ligjin nr. 8993, datë 30.1.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”.

Neni 5

Karakterit dhe mënyra e fitimit të markës tregtare

1. Marka tregtare ka karakter territorial dhe gëzon mbrojtje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Marka tregtare fitohet nëpërmjet regjistrimit.

3. Ky ligj zbatohet për personat fizikë dhe juridikë shqiptarë, si dhe për personat e huaj.

PJESA II

KREU I

SHENJAT QË MUND TË PËRBËJNË MARKË TREGTARE DHE TË DREJTAT E FITUARA NGA MARKA TREGTARE

Neni 6

Shenjat që mund të përbëjnë markë tregtare

Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë, veçanërisht fjalët, duke përfshirë emrat personalë, figurat, shkronjat, numrat, ngjyrat, format e mallrave dhe paketimet e tyre dhe tingujt, me kusht që këto shenja:

a) të mundësojnë dallimin e mallrave ose shërbimeve të një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;

b) të përfaqësohen në regjistrin e DPPI-së në mënyrë të tillë që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun që të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i jepet pronarit të saj.

Neni 7

Personat që mund të jenë pronarë të një marke tregtare

1. Pronar i një marke tregtare mund të jetë çdo person fizik ose juridik.

2. Personat fizikë ose juridikë të huaj gëzojnë të njëjtat të drejta me ato që gëzojnë edhe personat fizikë dhe juridikë vendas, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 8

Shkaqet absolute për refuzim

1. Një shenjë nuk regjistrohet si markë tregtare kur:

a) nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të këtij ligji;

b) nuk ka karakter dallues;

c) përbëhet ekskluzivisht nga shenja ose tregues, që shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave ose të ofrimit të shërbimeve, ose karakteristika të tjera të mallrave apo shërbimeve;



ç) përbëhet ekskluzivisht nga shenja ose tregues, që janë bërë të zakonshëm në gjuhën e përditshme apo që janë kthyer në praktika tregtare;

d) përbëhet ekskluzivisht nga:

i. forma ose ndonjë karakteristikë tjetër, që rezulton nga vetë natyra e mallrave;

ii. forma ose ndonjë karakteristikë tjetër e mallrave, që është e nevojshme për të siguruar një rezultat teknik;

iii. forma ose ndonjë karakteristikë tjetër, që u jep mallrave një vlerë thelbësore;

dh) është në kundërshtim me interesin dhe rendin publik ose me mbrojtjen e vlerave morale;

e) është e një natyre të tillë që çorienton publikun në lidhje me natyrën, cilësinë ose origjinën gjeografike të mallrave ose shërbimeve;

ë) nuk është autorizuar për regjistrim nga autoritetet kompetente dhe refuzohet sipas nenit 6ter të Konventës së Parisit;

f) përfshin stema, simbole, emblema ose shenja të tjera zyrtare përveç atyre që mbulohen nga neni 6ter i Konventës së Parisit dhe që janë të një interesi të veçantë publik, përveçse kur është dhënë pëlqimi i autoritetit kompetent për regjistrimin e tyre;

g) përjashtohet nga regjistrimi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë;

gj) përjashtohet nga regjistrimi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e termave tradicionale për verë;

h) përjashtohet nga regjistrimi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e specialiteteve tradicionale të garantuara;

i) përbëhet ose që riprodhon në elementet e saj thelbësore një emërtim varieteti bimor të mëparshëm të regjistruar në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë ose me marrëveshjet ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të varieteteve bimore dhe që lidhen me varietete bimore të të njëjtave lloje ose të llojeve të lidhura ngushtë me to.

2. Shkaqet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, nuk zbatohen kur

marka tregtare ka fituar karakter dallues në lidhje me mallrat ose shërbimet për të cilat është kërkuar regjistrimi, si pasojë e përdorimit të saj përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim marke.

Neni 9

Shkaqet relative për refuzim

1. Mbi bazën e kundërshtimit të pronarit të markës së mëparshme, kërkesa për markë që është botuar në buletin e DPPI-së nuk regjistrohet nëse:

a) është e njëjtë me markën e mëparshme dhe mallrat ose shërbimet për të cilat është depozituar kërkesa për markë janë të njëjta me mallrat ose shërbimet për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) për shkak të njëlojshmërisë ose ngjashmërisë me markën e mëparshme, si dhe të njëlojshmërisë ose ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve që mbulohen nga markat tregtare, ekziston ose krijohet mundësia për konfuzion tek një pjesë e publikut në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën tregtare të mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me markën tregtare të mëparshme, pavarësisht nëse mallrat dhe shërbimet për të cilat është depozituar kërkesa për markë janë të njëjta, të ngjashme ose nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare e mëparshme, kur:

i. marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë; dhe

ii. përdorimi pa shkak të arsyeshëm i markës së aplikuar merr përfitim të padrejtë ose dëmton karakterin dallues apo reputacionin e markës së mëparshme.

ç) kërkesa për regjistrimin e markës është bërë në keqbesim.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, “markë tregtare e mëparshme” është:

a) secila prej markave tregtare të përcaktuara sipas kësaj pike, që ka një datë depozitimi të kërkesës për regjistrim më të hershme sesa data e depozitimit të kërkesës për regjistrim e markës që kundërshtohet, duke marrë parasysh, sipas rastit, prioritetet e pretenduara në lidhje me këto marka tregtare:

i. markat tregtare kombëtare;



ii. markat tregtare të regjistruara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë;

b) kërkesa për regjistrim të markave tregtare që përcaktohen në shkronjën “a”, të pikës 2 të këtij neni, me kusht që procedura e regjistrimit të markës të përfundojë me sukses;

c) marka tregtare që në datën e depozitimit të kërkesës për regjistrim të markës tregtare të kundërshtuar, ose, sipas rastit, në datën e prioritetit të pretenduar në kërkesën për regjistrim, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptimin që fjala “e mirënjohur” përdoret në nenin 6bis të Konventës së Parisit.

3. Mbi bazën e kundërshtimit të mbajtësit të një të drejte të mëparshme, marka tregtare e aplikuar nuk regjistrohet nëse përdorimi i saj cenon njërin prej të drejtave të mëparshme, si më poshtë:

a) të drejtën e emrit dhe mbiemrit të një individi;

b) të drejtën e pamjes së jashtme apo portretit të një individi;

c) të drejtat e autorit;

ç) të drejtat e tjera të pronësisë industriale;

d) të drejtat e një marke të paregjistruar ose të një shenje tjetër të përdorur për një kohë të gjatë në një aktivitet tregtar dhe me shtrirje të gjerë territoriale.

4. Mbi bazën e kundërshtimit të subjektit tregtar të regjistruar në entitetin përkatës të regjistrimit të subjekteve tregtare përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim të markës së kundërshtuar, duke marrë parasysh, sipas rastit, prioritetet e pretenduara në lidhje me atë markë tregtare, marka tregtare e aplikuar nuk regjistrohet nëse:

a) emri i subjektit tregtar, emri tregtar ose një pjesë thelbësore e këtyre emrave është i njëjtë ose i ngjashëm me markën tregtare; dhe

b) mallrat ose shërbimet që janë objekt i veprimtarisë tregtare të subjektit tregtar janë të njëjta ose të ngjashme me ato për të cilat është depozituar kërkesa për regjistrim marke tregtare.

5. Mbi bazën e kundërshtimit të pronarit të markës tregtare, marka tregtare nuk regjistrohet nëse përfaqësuesi i pronarit të markës tregtare depoziton kërkesën për regjistrimin e markës nën emrin e tij pa pëlqimin e pronarit, përveçse kur përfaqësuesi i justifikon veprimet e tij duke provuar se depozitimi i kërkesës ishte autorizuar drejtpërdrejt nga pronari.

6. Mbi bazën e kundërshtimit të çdo personi të autorizuar nga ligji në fuqi për të ushtruar të drejtat që rrjedhin nga një emërtim origjine ose një tregues

gjeografik, marka tregtare e aplikuar nuk regjistrohet kur, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë fuqi në Republikën e Shqipërisë për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë:

a) një kërkesë për emërtim origjine ose tregues gjeografik është depozituar përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës ose përpara datës së prioritetit të pretenduar, me kusht që procedura e regjistrimit të emërtimeve të origjinës ose treguesit të përfundojë me sukses; dhe

b) emërtimi i origjinës ose treguesi gjeografik i jep të drejtë kundërshtuesit të ndalojë përdorimin e markës tregtare të mëvonshme.

KREU II

EFEKTET E MARKËS TREGTARE

Neni 10

Të drejtat e fituara nga marka tregtare

1. Regjistrimi i markës tregtare i jep pronarit të saj të drejta ekskluzive mbi të.

2. Pa cenuar të drejtat e pronarëve, të fituara përpara datës së depozitimit ose datës së prioritetit të markës tregtare, pronari i kësaj marke tregtare ka të drejtë të ndalojë të gjithë personat e tretë që të përdorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare pa autorizimin e tij:

a) një shenjë që është e njëjtë me markën tregtare dhe që përdoret për mallra ose shërbime, të cilat janë të njëjta me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare;

b) një shenjë që është e njëjtë ose e ngjashme me markën tregtare dhe që përdoret për mallra ose shërbime, të cilat janë të njëjta ose të ngjashme me mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar marka tregtare, ku ekziston apo krijohet mundësia për konfuzion tek një pjesë e publikut në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe mundësinë e bashkëlidhjes ndërmjet shenjës dhe markës tregtare;

c) një shenjë që është e njëjtë ose e ngjashme me markën tregtare, pavarësisht nëse shenja përdoret për mallra ose shërbime të njëjta, të ngjashme ose që nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, kur marka tregtare ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe kur përdorimi pa shkak të arsyeshem i shenjës merr



përfitim të padrejtë ose dëmton karakterin dallues apo reputacionin e markës tregtare.

3. Në kuptim të pikës 2 të këtij neni, pronari i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë, gjithashtu:

a) ngjitjen ose vendosjen e shenjës te mallrat, ambalazhet ose paketimet e tyre;

b) ofrimin për shitje të mallrave, hedhjen e mallrave në treg dhe ruajtjen, mbajtjen e rezervave ose magazinimin e mallrave nën atë shenjë për këto qëllime, si dhe ofrimin e shërbimeve nën atë shenjë;

c) importimin ose eksportimin e mallrave nën atë shenjë;

ç) përdorimin e shenjës si emër tregtar, emër të shoqërisë tregtare ose si pjesë të emrit tregtar apo emrit të shoqërisë tregtare;

d) përdorimin e shenjës në dokumentet e biznesit, reklamime dhe veprimtari tregtare;

dh) përdorimin e shenjës në reklamime krahasuese në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

4. Pa cenuar të drejtat e pronarëve, të fituara përpara datës së depozitimit ose datës së prioritetit të markës tregtare, pronari i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë, gjithashtu, të gjitha palët e treta që të sjellin në Republikën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare mallra që nuk janë çliruar për qarkullim të lirë në këtë territor kur këto mallra, duke përfshirë paketimet:

a) vijnë nga vende të treta; dhe

b) mbajnë në mënyrë të paautorizuar një markë tregtare që është e njëjtë me markën tregtare të regjistruar në lidhje me këto mallra ose që nuk mund të dallohet në aspektet e saj thelbësore nga marka e regjistruar.

Kjo e drejtë e pronarit të markës tregtare shuhet nëse gjatë procedurave të filluara sipas legjislacionit doganor për pronësinë intelektuale për të përcaktuar nëse janë cenuar të drejtat e markës tregtare deklaruesi ose mbajtësi i mallrave paraqet prova se pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë vendosjen e mallrave në treg në vendin e destinacionit përfundimtar.

5. Të drejtat, që i njihen pronarit të markës tregtare të regjistruar sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 11

E drejta për të ndaluar veprimet përgatitore, në lidhje me përdorimin e paketimit ose mjeteve të tjera

1. Pronari i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë veprimet përgatitore, në lidhje me përdorimin e paketimit ose mjeteve të tjera kur:

a) ekziston rreziku se paketimi, etiketat, elementet apo pajisjet e sigurisë dhe të autenticitetit ose çdo mjet tjetër tek i cili ngjitet apo vendoset marka tregtare, mund të përdoret në lidhje me mallrat dhe shërbimet e mbrojtura nga marka tregtare; dhe

b) një përdorim i tillë përbën një shkelje të të drejtave të pronarit të markës tregtare, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 10 të këtij ligji.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, pronari i markës tregtare ka të drejtë të ndalojë veprimet e mëposhtme nëse këto veprime kryhen gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar:

a) ngjitjen apo vendosjen e një shenje të njëjtë ose të ngjashme me markën tregtare në paketimin, etiketat, elementet apo pajisjet e sigurisë dhe të autenticitetit ose në çdo mjet tjetër ku mund të ngjitet ose të vendoset marka tregtare;

b) ofrimin për shitje të mallrave, hedhjen e tyre në treg, ruajtjen, mbajtjen e rezervave apo magazinimin e tyre për këto qëllime, si dhe importimin ose eksportimin e paketimit, etiketave, elementeve apo pajisjeve të sigurisë dhe të autenticitetit ose të çdo mjeti tjetër ku mund të ngjitet ose vendoset marka tregtare.

Neni 12

Data nga e cila kanë përparësi të drejtat ndaj palëve të treta

1. Të drejtat që jepen nga marka tregtare kanë përparësi ndaj palëve të treta nga data e regjistrimit të markës.

2. Pronari i markës tregtare mund të kërkojë një shpërblim të arsyeshëm në lidhje me veprimet e kryera pas datës së botimit të kërkesës për regjistrim të markës tregtare, kur këto veprime ndalohen si pasojë e regjistrimit të markës tregtare.



Neni 13

Riprodhimi i markës tregtare në fjalor

Nëse riprodhimi i markës tregtare në një fjalor, enciklopedi ose botim të ngjashëm krijon përshtypjen se marka tregtare përbën emrin gjenerik të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ajo është regjistruar, botuesi i veprës, me kërkesë të pronarit të markës tregtare, siguron që në botimin e ardhshëm riprodhimi i markës tregtare të shoqërohet me treguesin që ajo është një markë tregtare e regjistruar.

Neni 14

Ndalimi i përdorimit të markës tregtare të regjistruar në emër të përfaqësuesit

Kur marka tregtare regjistrohet në emër të një përfaqësuesi të personit që është pronar i kësaj marke, pa autorizimin e pronarit, ky i fundit ka të drejtë të kundërshtojë përdorimin e markës së tij nga përfaqësuesi nëse ai nuk e ka autorizuar një përdorim të tillë, përveçse kur përfaqësuesi i justifikon veprimet e tij duke provuar se depozitimi i kërkesës për markë ishte autorizuar drejtpërdrejt nga pronari i markës.

Neni 15

Kufizimi i të drejtave të fituara nga marka tregtare

1. Marka tregtare nuk i jep të drejtë pronarit të saj që të ndalojë palët e treta të përdorin gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar:

a) emrin ose adresën e palës së tretë, kur pala e tretë është person fizik;

b) shenja ose tregues që nuk janë dallues ose që lidhen me llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, origjinën gjeografike, kohën e prodhimit të mallrave ose ofrimit të shërbimeve ose karakteristika të tjera të mallrave dhe shërbimeve;

c) markën tregtare për qëllime të identifikimit ose referimit në mallrat dhe shërbimet e pronarit të markës tregtare, veçanërisht kur përdorimi i kësaj marke tregtare është i nevojshëm për të treguar qëllimin që synohet për një produkt ose shërbim dhe në veçanti në rastin e aksesoreve ose pjesëve të këmbimit.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet vetëm kur përdorimi i bërë nga personi i tretë është në

përputhje me praktikat e drejta dhe të ndershme në aktivitetet industriale ose tregtare.

Neni 16

Shterimi i të drejtave të fituara nga marka tregtare

1. Pronari i markës tregtare nuk mund të ndalojë një palë të tretë që të përdorë markën tregtare për mallra të hedhura në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë nga pronari ose me pëlqimin e tij.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur ekzistojnë arsye legjitime për pronarin që të kundërshtojë tregtimin e mëtejshëm të mallrave, veçanërisht kur gjendja e mallrave ka ndryshuar ose është dëmtuar pasi ato janë hedhur në treg.

Neni 17

E drejta e pronarit të markës tregtare të regjistruar më vonë si mjet mbrojtjeje në procesin e shkeljes së të drejtave

1. Në procesin gjyqësor për shkeljen e të drejtave të markës tregtare, pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e një marke të regjistruar më vonë derisa marka e mëvonshme nuk është deklaruar e pavlefshme sipas pikave 1 dhe 5, të nenit 66, pikës 1, të nenit 67 dhe pikës 1, të nenit 68 të këtij ligji.

2. Kur pronari i markës tregtare nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e një marke të regjistruar më vonë në procesin gjyqësor për shkeljen e të drejtave të markës tregtare, sipas pikës 1 të këtij neni, as pronari i markës tregtare të regjistruar më vonë nuk ka të drejtë të ndalojë përdorimin e markës tregtare të mëparshme.

KREU III

PËRDORIMI I MARKËS TREGTARE DHE PASOJAT E MOSPËRDORIMIT

Neni 18

Përdorimi i markës tregtare

1. Pronari i markës tregtare ka të drejtë të përdorë markën tregtare në lidhje me mallrat ose shërbimet për të cilat ajo është regjistruar.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, përdorim i markës tregtare konsiderohet, gjithashtu:



a) përdorimi i markës tregtare në një formë që ndryshon në elemente, të cilat nuk e ndryshojnë karakterin dallues të markës tregtare në formën në të cilën ajo është regjistruar, pavarësisht faktit nëse marka tregtare në formën e përdorur është regjistruar ose jo në emër të pronarit;

b) ngjitja ose vendosja e markës tregtare te mallrat ose paketimet e tyre vetëm për qëllime eksporti.

3. Përdorimi i markës tregtare me pëlqimin e pronarit konsiderohet si përdorim nga ana e pronarit.

Neni 19

Pasojat e mospërdorimit të markës tregtare

Përveçse kur ka shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin, marka do t'u nënshtrohet kufizimeve dhe sanksioneve të parashikuara në nenin 20, pikat 1, 3 dhe 6, të nenit 48, pikën 4, të nenit 62, dhe pikat 1, 3 dhe 6, të nenit 67 të këtij ligji, kur:

a) pronari nuk e ka vendosur markën e tij në një përdorim real dhe efektiv në territorin e Republikës së Shqipërisë për mallrat ose shërbimet për të cilat ajo është regjistruar brenda një periudhe të pandërprerë 5-vjeçare nga data e regjistrimit të markës; ose

b) një përdorim i tillë është pezulluar për një periudhë të pandërprerë prej 5 vjetësh.

Neni 20

Mospërdorimi si mjet mbrojtjeje në procesin e shkeljes së të drejtave

1. Pronari i markës ka të drejtë të kërkojë që të ndalohet përdorimi i shenjës vetëm në masën që të drejtat e tij mbi markën, në kohën e paraqitjes së padisë për shkelje të të drejtave nuk mund të shfuqizohen sipas nenit 62 të këtij ligji.

2. Kur marka është regjistruar të paktën 5 vjet përpara datës së paraqitjes së padisë për shkelje të të drejtave dhe nëse i padituri e kërkon, pronari i markës duhet të paraqesë prova se gjatë një periudhe të pandërprerë prej 5 vjetësh përpara datës së paraqitjes së padisë:

a) marka është vendosur në përdorim real dhe efektiv në lidhje me mallrat ose shërbimet për të cilat ajo është regjistruar dhe mbi të cilat është bazuar padia; ose

b) ekzistojnë shkaqe të justifikuara për mospërdorimin e markës.

KREU IV

MARKAT TREGTARE SI OBJEKTE TË PRONËSISË

Neni 21

Transferimi i pronësisë

1. Pronësia e markës tregtare mund të transferohet në lidhje me disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar, së bashku ose në mënyrë të pavarur nga çdo transferim i pronësisë së ndërmarrjes.

2. Transferimi i gjithë pronësisë së ndërmarrjes përfshin edhe transferimin e pronësisë së markës tregtare, përveçse kur parashikohet ndryshe në marrëveshje.

3. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, transferimi i pronësisë së markës tregtare bëhet me shkrim dhe kërkon nënshkrimin e palëve në kontratë ose marrëveshje, përveçse kur ky transferim pronësie është rezultat i një vendimi gjyqësor. Në rast të kundërt, transferimi i pronësisë është i pavlefshëm.

4. Në rast se pronësia e markës transferohet në lidhje me vetëm një pjesë të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ajo është regjistruar, regjistrimi i markës ndahet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji.

Neni 22

Regjistrimi i transferimit të pronësisë në regjistër

1. Me kërkesë të pronarit të regjistruar ose pronarit të ri të markës tregtare, transferimi i pronësisë së markës tregtare regjistrohet në regjistër nëse pala kërkuese depoziton në DPPI:

a) një nga dokumentet në vijim në lidhje me transferimin e pronësisë:

i. një kopje të kontratës ose marrëveshjes së transferimit të pronësisë së markës tregtare, e cila duhet të jetë nënshkruar nga palët dhe e vërtetuar nga noteri;

ii. një kopje të vendimit gjyqësor për transferimin ose trashëgiminë e pronësisë së markës tregtare;

iii. dëshminë e trashëgimit të lëshuar nga noteri publik për kalimin me trashëgimi të pronësisë së markës tregtare;



iv. në rastet e bashkimit ose ndarjes së shoqërive tregtare, një kopje të ekstraktit tregtar ose çdo dokumenti tjetër që provon këtë ndryshim, të lëshuar nga autoriteti kompetent përkatës, ku tregohet pronari i ri i markës tregtare. Ky dokument mund të paraqitet edhe në rastin kur transferimi i pronësisë së markës tregtare ka të bëjë me ndryshimin e formës ligjore të shoqërisë;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës, të nënshkruar rregullisht.

2. Kërkesa për regjistrimin e transferimit të pronësisë së markës tregtare përmban informacionin e nevojshëm për të identifikuar markën tregtare, pronarin e ri, mallrat dhe shërbimet me të cilat lidhet transferimi i pronësisë, si dhe dokumentet për regjistrimin e transferimit të pronësisë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. DPPI-ja brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për transferim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për regjistrimin e transferimit të pronësisë, DPPI-ja i dërgon palës kërkuuese një njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa për transferimin e pronësisë së markës tregtare refuzohet.

5. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat për regjistrimin e transferimit të pronësisë, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron transferimin e pronësisë në regjistër dhe e boton atë në buletinin e saj.

6. Kërkesa për regjistrimin e transferimit të pronësisë mund të depozitohet për dy ose më shumë marka tregtare vetëm kur të dhënat e pronarit të regjistruar dhe pronarit të ri të markave tregtare janë të njëjta.

7. Procedura, përmbajtja e kërkesës për transferimin e pronësisë dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Pronari i ri i markës nuk mund të bazohet në të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës tregtare nëse transferimi i pronësisë së markës nuk është regjistruar në regjistër.

Neni 23

Transferimi i markës së regjistruar në emër të përfaqësuesit

1. Kur marka është regjistruar në mënyrë të paaautorizuar në emër të përfaqësuesit të pronarit të markës, pronari i markës ka të drejtë të kërkojë kalimin e markës në emrin e tij, përveçse kur përfaqësuesi i justifikon veprimet e tij duke provuar se depozitimi i kërkesës për regjistrimin e markës në emër të tij ishte autorizuar drejtpërdrejt nga pronari i markës.

2. Pronari i markës mund të paraqesë kërkesë për transferimin e pronësisë, sipas pikës 1 të këtij neni, në:

a) DPPI, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 66 të këtij ligji, në vend të paraqitjes së kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë;

b) gjykatë, sipas pikës 2, të nenit 66 të këtij ligji.

Neni 24

Regjistrimi i të drejtave reale në regjistër

1. Marka tregtare mund të vendoset si garanci dhe të jetë objekt i të drejtave reale në mënyrë të pavarur nga subjekti tregtar.

2. Me kërkesë të njërës prej palëve, të drejtat që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, ose transferimi i këtyre të drejtave regjistrohen në regjistër nëse pala kërkuuese depoziton në DPPI:

a) provën e ekzistencës dhe vlefshmërisë së të drejtave reale ose objektivit të të drejtave reale;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës, të nënshkruar rregullisht.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për regjistrimin e të drejtave reale është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për regjistrimin e të drejtave reale, DPPI-ja i dërgon palës kërkuuese një njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet.

5. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara në këtë nen për regjistrimin e të



drejtave reale, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron të drejtat reale në regjistër.

6. Me kërkesë të njëres nga palët, regjistrimi i kryer sipas pikës 2 të këtij neni mund të shfuqizohet ose të modifikohet.

7. Çdo regjistrim që bëhet sipas këtij neni botohet në buletin e DPPI-së.

8. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e të drejtave reale dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Regjistrimi i veprimeve përbarimore në regjistër

1. Marka tregtare mund të jetë objekt i veprimeve përbarimore nga autoritetet kompetente për procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve ose të autoritetit kompetent për procedurat e përbarimit, veprimet përbarimore regjistrohen në regjistër nëse pala kërkuese depoziton në DPPI:

a) aktin mbi bazën e të cilit kryhen veprimet përbarimore;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për regjistrimin e veprimeve përbarimore është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për regjistrimin e veprimeve përbarimore, DPPI-ja i dërgon palës kërkuese një njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet.

5. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara në këtë nen për regjistrimin e veprimeve përbarimore, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron veprimet përbarimore në regjistër.

6. Me kërkesë të njëres nga palët, regjistrimi i kryer sipas pikës 2 të këtij neni mund të shfuqizohet ose të modifikohet.

7. Çdo regjistrim që bëhet sipas këtij neni botohet në buletin e DPPI-së.

8. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e veprimeve përbarimore dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Regjistrimi i informacionit mbi fillimin e procedurës së paaftësisë paguese në regjistër

1. Informacioni për fillimin e procedurës së paaftësisë paguese të një ndërmarrjeje regjistrohet në regjistrin e DPPI-së bazuar në njoftimin e bërë nga autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin për falimentimin në fuqi në Republikën e Shqipërisë ose me kërkesë të administratorit të procedurës së paaftësisë paguese.

2. Me kërkesë të personit të interesuar, informacioni për fillimin e procedurës së paaftësisë paguese regjistrohet në regjistër nëse pala kërkuese depoziton në DPPI:

a) njoftimin ose kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për regjistrimin e informacionit të procedurës së paaftësisë paguese është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për regjistrimin e informacionit të procedurës së paaftësisë paguese, DPPI-ja i dërgon palës kërkuese një njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet.

5. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara në këtë nen për regjistrimin e informacionit të procedurës së paaftësisë paguese, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron informacionin e procedurës së paaftësisë paguese në regjistër.

6. Me kërkesë të njëres prej palëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, regjistrimi i kryer sipas pikës 2 të këtij neni mund të shfuqizohet ose të modifikohet.



7. Çdo regjistrim që bëhet sipas këtij neni botohet në buletin e DPPI-së.

8. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e informacionit të procedurës së paaftësisë paguese dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27 Licencimi

1. Marka tregtare mund të licencohet për disa ose për të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar.

2. Licenca mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive.

3. Pronari i markës tregtare bazohet tek të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës kundër të licencuarit, që vepron në kundërshtim me ndonjë prej dispozitave të marrëveshjes së licencimit në lidhje me:

- a) afatin e saj;
- b) formën sipas së cilës mund të përdoret marka;
- c) listën e mallrave dhe shërbimeve për të cilat është dhënë licenca;
- ç) territorin në të cilin mund të ngjitet ose të vendoset marka tregtare;
- d) cilësinë e mallrave të prodhuara ose të shërbimeve të ofruara nga i licencuari.

4. Pa cenuar dispozitat e marrëveshjes së licencimit, i licencuari mund të fillojë procesin ligjor kundër shkeljes së markës tregtare vetëm në rast se pronari i markës tregtare jep pëlqimin e tij. Në rastin e licencës ekskluzive, mbajtësi i licencës ekskluzive mund të fillojë këtë proces ligjor nëse pronari i markës tregtare, pasi është njoftuar me shkrim nga i licencuari ekskluziv, nuk fillon vetë procesin ligjor kundër shkeljes së markës tregtare brenda 3 muajve nga data që ka marrë njoftimin formal.

5. Për qëllime të marrjes së shpërblimit për dëmin e pësuar, i licencuari ka të drejtë të ndërhyjë në procesin kundër shkeljes së të drejtave të filluar nga pronari i markës tregtare. Për qëllime të marrjes së shpërblimit të dëmit të pësuar, pronari i markës tregtare ka të drejtë të ndërhyjë në procesin kundër shkeljes së të drejtave të filluar nga i licencuari në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

6. Marrëveshja e licencimit mund të nënlicencohet te palët e treta kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjen e licencimit ose me pëlqimin me shkrim të pronarit të markës. Kur

parashikohet në licencë, i licencuari mund të japë një nënlicencë dhe parashikimet në këtë ligj për licencuesin ose të licencuarin përfshijnë edhe nënlicencuesin ose të nënlicencuarin.

Neni 28 Regjistrimi i marrëveshjeve të licencimit në regjistër

1. Me kërkesë të njëres palë, marrëveshja e licencimit regjistrohet në regjistër nëse pala kërkuese depoziton në DPPI:

- a) një kopje të marrëveshjes së licencimit, e cila duhet të jetë nënshkruar nga palët dhe e vërtetuar nga noteri;
- b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;
- c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe
- ç) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

2. Kërkesa për regjistrimin e marrëveshjes së licencës përmban informacionin e nevojshëm për të identifikuar markën tregtare, të licencuarin, formën e licencës si ekskluzive apo joekskluzive, kohëzgjatjen, territorin, kushtet e licencës, mallrat ose shërbimet për të cilat bëhet licencimi dhe dokumentet që duhen për regjistrimin e licencës në regjistër.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për regjistrimin e licencës është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse nuk plotësohen kërkesat e caktuara më sipër për regjistrimin e marrëveshjes së licencimit, DPPI-ja i dërgon palës kërkuese njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa për regjistrimin e licencës së markës tregtare refuzohet.

5. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara për licencimin e markës, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron marrëveshjen e licencimit në regjistër dhe e boton atë në buletin.

6. Me kërkesë të njëres prej palëve, regjistrimi i kryer në përputhje me pikën 4 të këtij neni, mund të shfuqizohet ose të modifikohet.

7. Një kërkesë për regjistrimin e marrëveshjes së licencimit mund të depozitohet për dy ose më shumë marka tregtare vetëm kur pronari i regjistruar dhe i licencuari i markave tregtare janë të njëjtët.



8. Dispozitat e mësipërme në lidhje me regjistrimin e licencës zbatohen edhe për regjistrimin e marrëveshjes së nënlicencimit.

9. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e licencës dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Procedura për shfuqizimin ose modifikimin e regjistrimit të licencave dhe të drejtave të tjera në regjistër

1. Me kërkesë të personave të interesuar, regjistrimi i kryer sipas neneve 21 deri në 28 mund të shfuqizohet ose të modifikohet.

2. Kërkesa përmban numrin e regjistrimit të markës dhe të dhënat e së drejtës për të cilat kërkohet shfuqizimi ose modifikimi.

3. Regjistrimi i shfuqizimit ose modifikimit regjistrohet nëse pala kërkuese depoziton në DPPI:

a) një dokument që tregon se e drejta e regjistruar nuk ekziston më ose është modifikuar, ose kur i licencuari apo mbajtësi i një të drejte tjetër jep pëlqimin me shkrim për shfuqizimin ose modifikimin e regjistrimit;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

4. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, ekzaminon nëse kërkesa për shfuqizimin ose modifikimin e regjistrimit të licencës dhe të drejtave të tjera është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

5. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për regjistrimin e shfuqizimit ose modifikimit, DPPI-ja i dërgon palës kërkuese njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa për regjistrimin e shfuqizimit ose modifikimit refuzohet.

6. Kur paguhet tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara në këtë nen për regjistrimin e shfuqizimit ose të modifikimit, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron shfuqizimin ose modifikimin dhe e boton atë në buletin e saj.

7. Procedura, përmbajtja e kërkesës për shfuqizimin ose modifikimin e regjistrimit të

licencës dhe të drejtave të tjera dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Kërkesa për regjistrimin e markës tregtare si objekt pronësie

Nenet 21 deri në 29 të këtij ligji zbatohen edhe për kërkesat për regjistrim të markës tregtare.

Neni 31

Efektet ndaj palëve të treta

1. Transferimi i pronësisë, transferimi i të drejtave reale dhe licencimi i markës tregtare nuk sjell asnjë efekt ligjor ndaj palëve nëse nuk është regjistruar në regjistër. Megjithatë, transferimi i pronësisë, transferimi i të drejtave reale dhe licencimi sjell efekte ligjore përpara regjistrimit në regjistër vetëm ndaj palëve të treta që kanë fituar të drejta mbi markën pas datës së regjistrimit të veprimit, por që ishin në dijeni për këtë veprim në datën në të cilën ato i fituan të drejtat.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin kur personi fiton pronësinë mbi markën tregtare ose një të drejtë të lidhur me të përmes transferimit të subjektit tregtar ose trashëgimisë.

PJESA III

KËRKESA PËR REGJISTRIMIN E MARKËS TREGTARE

KREU I

DEPOZITIMI DHE KUSHTET PËR DEPOZITIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIM MARKE

Neni 32

Depozitimi i kërkesës

1. Kërkesa për regjistrimin e markës tregtare depozitohet në DPPI.

2. Kërkesa për regjistrimin e markës nuk mund të përmbajë më shumë se një shenjë për të cilën kërkohet mbrojtja e markës tregtare.

3. DPPI-ja i dërgon kërkuetit, pa vonesë, një dëshmi depozitimi, që përfshin të paktën numrin e kërkesës, përfaqësimin e markës, përshkrimin ose



identifikime të tjera të markës, llojin dhe numrin e dokumenteve, si dhe datën e marrjes së tyre.

Neni 33

Kushtet që duhet të plotësojë kërkesa

1. Kërkesa për regjistrimin e markës tregtare përmban:

- a) formularin e plotësuar të kërkesës për regjistrimin e markës tregtare;
- b) të dhënat që identifikojnë kërkuuesin;
- c) listën e mallrave dhe shërbimeve në lidhje me të cilat kërkohet regjistrimi;
- ç) përfaqësimin e markës tregtare, që përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjën “b”, të nenit 6 të këtij ligji;
- d) pagesën e tarifës së kërkesës për regjistrim marke.

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kërkesa për regjistrim marke duhet të plotësojë edhe elementet formale të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Elementet formale përfshijnë:

- a) të dhënat që identifikojnë përfaqësuesin dhe autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;
- b) dokumentin e prioritetit, kur pretendohet prioritet;
- c) rregulloren e përdorimit të markës, në rastin e markës kolektive ose certifikuese.

3. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e markës dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

Data e depozitimit të kërkesës

Data e depozitimit të kërkesës për markë tregtare është data në të cilën kërkuesi depoziton në DPPI dokumentet që përmbajnë informacionin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 33 të këtij ligji.

Neni 35

Përcaktimi dhe klasifikimi i mallrave dhe shërbimeve

1. Mallrat dhe shërbimet për të cilat depozitohet kërkesa për regjistrimin e markës tregtare

klasifikohen në përputhje me sistemin e Klasifikimit të Nicës.

2. Mallrat dhe shërbimet për të cilat kërkohet mbrojtja e markës tregtare identifikohen nga kërkuesi me qartësi dhe saktësi të mjaftueshme për të mundësuar autoritetet kompetente dhe operatorët ekonomikë, që të përcaktojnë masën e mbrojtjes së kërkuar.

3. Për qëllime të pikës 2 të këtij neni, mund të përdoren treguesit e përgjithshëm të përfshirë në titujt e klasave të Klasifikimit të Nicës ose terma të tjerë të përgjithshëm, me kusht që ato të plotësojnë standardet e kërkuara të qartësisë dhe saktësisë që përcaktohen në këtë nen.

4. Përdorimi i termave të përgjithshëm, duke përfshirë treguesit e përgjithshëm të titujve të klasave të Klasifikimit të Nicës, konsiderohet se përfshin të gjitha mallrat ose shërbimet që mbulohen në mënyrë të qartë nga kuptimi literal i treguesit ose termit.

5. Mallrat dhe shërbimet, që nuk mbulohen në mënyrë të qartë nga kuptimi literal i termave të përgjithshëm ose treguesve të titujve të klasave të Klasifikimit të Nicës, nuk konsiderohen se përfshihen në kërkesën për regjistrimin e markës tregtare, ose sipas rastit, në markën tregtare të regjistruar.

6. Kur kërkuesi kërkon regjistrimin e markës në më shumë se një klasë, kërkuesi i grupon mallrat dhe shërbimet sipas klasave të Klasifikimit të Nicës, dhe i paraqet ato sipas renditjes së klasave. Secili grup mallrash dhe shërbimesh paraprihet nga numri i klasës, të cilës i përket grupi i mallrave ose shërbimeve.

7. Mallrat dhe shërbimet nuk konsiderohen se janë të ngjashme me njëra-tjetrën për faktin se ato shfaqen në të njëjtën klasë sipas Klasifikimit të Nicës. Mallrat dhe shërbimet nuk konsiderohen se janë të ndryshme me njëra-tjetrën për faktin se ato shfaqen në klasa të ndryshme të Klasifikimit të Nicës.

8. Nëse ka mallra ose shërbime që nuk janë mjaftueshëm të qarta dhe të sakta, DPPI-ja i dërgon kërkuessit njoftim dhe i kërkon atij që të paraqesë shpjegime, specifikime ose saktësime të përshtatshme brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

9. Kur kërkuesi nuk paraqet shpjegime, specifikime ose saktësime të përshtatshme ose kur nuk i paraqet këto brenda afatit të caktuar, DPPI-ja



refuzon kërkesën në lidhje me mallrat ose shërbimet që nuk ishin mjaftueshëm të qarta dhe të sakta.

KREU II PRETENDIMI PËR PRIORITET

Neni 36

E drejta për prioritet

1. Personi, që ka depozituar rregullisht një kërkesë për regjistrim marke në ose në lidhje me një shtet palë të Konventës së Parisit ose të Marrëveshjes për Themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, ose zëvendësuesi i tij ligjor, gëzon të drejtën për prioritet, me kusht që kërkesa kombëtare për regjistrim marke në Republikën e Shqipërisë të depozitohet brenda 6 muajve nga data e depozitimit të kërkesës së parë për regjistrim marke.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, kërkesa kombëtare për regjistrimin e markës në Republikën e Shqipërisë duhet të depozitohet për të njëjtën markë, në lidhje me mallra dhe shërbime që janë të njëjta ose që përfshihen te lista e mallrave dhe shërbimeve për të cilat është depozituar kërkesa e parë për regjistrim marke.

3. Çdo kërkesë që është ekuivalente me një kërkesë kombëtare të rregullt, sipas ligjit të shtetit ku është depozituar ose sipas marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe, konsiderohet se siguron të drejtë për prioritet.

4. Me kërkesë të rregullt kombëtare kuptohet çdo kërkesë për regjistrim marke që plotëson kushtet e nevojshme për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se çfarë vendoset në lidhje me kërkesën për regjistrim marke.

5. Kur pretendohet një e drejtë prioriteti, kërkesa përmban datën, numrin dhe shtetin e kërkesës së mëparshme, si dhe mallrat ose shërbimet për të cilat pretendohet e drejta e prioritetit. Kjo e drejtë prioriteti pretendohet në momentin e depozitimit të kërkesës kombëtare për markë.

6. Kërkuesi që pretendon prioritet paraqet në DPPI një kopje të kërkesës së parë dhe përkthimin e saj në gjuhën shqipe brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës kombëtare për markë tregtare.

Neni 37

Efektet e së drejtës për prioritet

Data e prioritetit llogaritet si datë e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të përcaktohet se cilat të drejta kanë përparësi.

Neni 38

E drejta për prioritet nga ekspozitat

1. Kërkuesi i markës tregtare, që ka ekspozuar mallrat ose shërbimet me një shenjë specifike në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare ose të njohur zyrtarisht, që plotëson kriteret e Konventës në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare, gëzon të drejtën për prioritet nga data e ekspozimit të parë të mallrave dhe shërbimeve nëse ai depoziton një kërkesë për regjistrim marke në Republikën e Shqipërisë brenda 6 muajve nga kjo datë ekspozimi. Efekti i së drejtës për prioritet llogaritet siç parashikohet në nenin 37 të këtij ligji.

2. Kur pretendohet një e drejtë për prioritet nga ekspozitat, kërkesa përmban emrin dhe vendin e ekspozitës ndërkombëtare, datat e hapjes dhe të mbylljes, si dhe datën e ekspozimit të parë të mallrave ose shërbimeve, nëse kjo datë është e ndryshme nga data e hapjes së ekspozitës. Kjo e drejtë prioriteti pretendohet në momentin e depozitimit të kërkesës kombëtare për regjistrim të markës.

3. Kërkuesi, që pretendon prioritet nga ekspozitat ndërkombëtare, paraqet në DPPI një kopje të certifikatës së lëshuar nga autoriteti kompetent i ekspozitës, e cila vërteton se marka është përdorur për mallrat ose shërbimet e përfshira në kërkesën për regjistrim marke. Ky dokument dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe paraqiten në DPPI brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës kombëtare për markë tregtare.



PJESA IV
PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E
MARKËS TREGTARE

KREU I
EKZAMINIMI DHE BOTIMI I
KËRKESAVE PËR MARKË

Neni 39

Ekzaminimi i kushteve të depozitimit

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e markave sipas numrit rendor të paraqitjes së tyre.

2. Një kërkesë mund të ekzaminohet jashtë numrit rendor, kur:

a) depozitohet një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse për ekzaminim jashtë numrit rendor; ose

b) është depozituar një kërkesë për ekzaminim jashtë numrit rendor, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. DPPI-ja ekzaminon, pa vonesë, nëse kërkesa për regjistrim marke i përmbush kushtet e vendosura në këtë ligj, në lidhje me njohjen e datës së depozitimit, sipas nenit 34 të këtij ligji.

Neni 40

Ekzaminimi i elementeve formale të kërkesës

DPPI-ja, pasi konstaton se kërkesa për regjistrim marke përmbush kushtet e lidhura me njohjen e datës së depozitimit, ekzaminon nëse kjo kërkesë përmbush elementet formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 33 të këtij ligji.

Neni 41

Plotësimi i të metave dhe mangësive të kërkesës

1. Kur kërkesa nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 33 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon kërkuarit njoftim që të plotësojë të metat ose mangësitë, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse kërkuari i plotëson të metat ose mangësitë që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja, pa vonesë, cakton datën në të cilën janë plotësuar të metat ose mangësitë si datë depozitimi të kërkesës dhe i dërgon njoftim kërkuarit. Nëse

kërkuari nuk i plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja refuzon kërkesën me vendim.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga plotësimi i kushteve të depozitimit të caktuara në pikën 1, të nenit 33, të këtij ligji, ekzaminon nëse kërkesa përmbush elementet formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 33 dhe nenin 35, të këtij ligji.

4. Kur kërkesa nuk i plotëson elementet formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 33 dhe nenin 35, DPPI-ja i dërgon kërkuarit njoftim që të plotësojë të metat ose mangësitë, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Kur kërkuari i plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja, brenda 3 muajve, vijon me ekzaminimin e shkaqeve absolute të kërkesës për markë. Kur kërkuari nuk i plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit kohor, DPPI-ja refuzon kërkesën për markë me vendim.

6. Me kërkesë të kërkuarit, afati i përcaktuar në pikat 1 dhe 3, të këtij neni mund të zgjatet me 2 muaj, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

7. Mospërmbushja e kërkesave në lidhje me pretendimin për prioritet sjell humbjen e së drejtës së prioritetit.

Neni 42

Ekzaminimi i shkaqeve absolute për refuzim

1. Kur gjatë ekzaminimit konstatohet se ekziston ndonjë nga shkaqet absolute për refuzimin e regjistrimit të markës tregtare sipas pikës 1 të nenit 8 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon kërkuarit njoftim për shkaqet e refuzimit dhe e fton atë të depozitojë observime dhe prova brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Me kërkesë të kërkuarit, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të zgjatet me 2 muaj shtesë, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. DPPI-ja vendos refuzimin e kërkesës për të gjitha ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve kur:

a) kërkuari nuk i depoziton observimet dhe provat brenda afatit të caktuar; ose

b) pas depozitimit të observimeve dhe provave nga kërkuari, DPPI-ja konsideron se kërkuari nuk arrin të tejkalojë shkaqet për refuzimin e regjistrimit.

4. Vendimi për refuzimin e markës ose elementeve të markës për shkaqe absolute mund të ankimohet në Dhomën për Shfuqizim dhe



Pavlefshmëri brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit.

Ankimi në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri përmban:

a) argumentet, bazën ligjore dhe provat që lidhen me ankimin;

b) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

c) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

5. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të ankimit, ekzaminon nëse kërkuesi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

6. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara më sipër për ankimin, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri i dërgon kërkuetit njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, ankimi refuzohet.

7. Kur plotësohen kërkesat e caktuara më sipër për ankimin, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji shqyrton bazueshmërinë e ankimit dhe merr vendim mbi ankimin.

8. Kundër vendimit të Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

Neni 43

Raporti i hetimit

1. Në rast se kërkohet nga kërkuesi në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim të markës tregtare, DPPI-ja harton një raport hetimi ku citon kërkesat ose regjistrimet e markave tregtare të mëparshme që mund të shërbejnë si bazë për kundërshtimin e regjistrimit të markës, sipas nenit 9 të këtij neni.

2. Raporti i hartuar në bazë të pikës 1 të këtij neni, i dërgohet kërkuetit në rast se:

a) kërkuesi e ka kërkuar raportin e hetimit në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës tregtare; dhe

b) është paguar tarifa përkatëse për hetim.

3. Gjatë ekzaminimit të shkaqeve absolute të markës, DPPI-ja harton raportin e hetimit edhe me nismën e saj.

4. Raporti i hetimit përmban datën e depozitimit, përfaqësimin e markës tregtare, emrin e pronarit ose kërkuetit dhe klasat e mallrave e të shërbimeve, sipas Klasifikimit të Nicës.

5. DPPI-ja, pasi kërkesa për markë është botuar sipas nenit 44 të këtij ligji, u dërgon përfaqësuesve të autorizuar dhe pronarëve të kërkesave për markë ose regjistrimeve të markave tregtare të mëparshme që citohen në raportin e hetimit njoftimin për t'i informuar në lidhje me botimin e kërkesës për markë. Ky njoftim dërgohet nga DPPI-ja në adresat e regjistruara të përfaqësuesve të autorizuar dhe pronarëve të kërkesave për markë dhe regjistrimeve të markave tregtare të mëparshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht faktit nëse raporti i hetimit është kërkuar ose jo nga kërkuesi.

Neni 44

Botimi i kërkesës për markë

1. DPPI-ja bën botimin e kërkesës për markë dhe të dhënat e saj në buletin nëse:

a) plotësohen kërkesat e regjistrimit për markë; dhe

b) nuk ekziston asnjë nga shkaqet absolute për refuzimin e regjistrimit të markës tregtare, sipas nenit 8 të këtij ligji.

2. Kur regjistrimi i markës tregtare refuzohet vetëm për një pjesë të mallrave dhe shërbimeve, DPPI-ja boton të dhënat e kërkesës për pjesën tjetër të mallrave dhe shërbimeve.

3. Përmbajtja e kërkesës për markë që botohet në buletin e DPPI-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Nëse kërkesa refuzohet për shkaqe absolute, vendimi i refuzimit botohet në buletin.

5. Kur botimi i kërkesës përmban një gabim që i atribuohet DPPI-së, DPPI-ja korrigjon gabimin me nismën e saj ose me kërkesë të kërkuetit. Korrigjimi botohet rregullisht në buletin.

KREU II

OBSERVIMET NGA PALË TË TRETA DHE KUNDËRSHTIMI

Neni 45

Observimet nga palë të treta

1. Observimet me shkrim mund të depozitohen në DPPI për të shpjeguar shkaqet absolute për të



cilat marka nuk duhet të regjistrohet në lidhje me disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet nga:

a) çdo person fizik ose juridik; dhe

b) çdo grup ose entitet që përfaqëson prodhuesit, ofruesit e shërbimeve, tregtarët ose konsumatorët.

2. Personat, grupet ose entitetet që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, nuk bëhen palë në këto procedura përpara DPPI-së.

3. Observimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni depozitohen brenda 3 muajve nga data e botimit të kërkesës për regjistrimin e markës. Në rastet kur është depozituar një observim dhe një kundërshtim ndaj së njëjtës markë tregtare, Dhoma e Kundërshtimeve pezullon procedurën e kundërshtimit të markës deri në momentin që DPPI-ja merr vendim mbi observimin.

4. Observimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni i dërgohen kërkuarit që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke, i cili mund të përgjigjet dhe të depozitojë komente brenda 1 muaji nga data e marrjes së observimeve.

5. Paraqitja e observimeve që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni nuk përjashton të drejtën e DPPI-së që në çdo kohë përpara regjistrimit të markës të rihapë me nismën e saj procedurën e ekzaminimit për shkaqe absolute.

Neni 46

Depozitimi i kundërshtimit

1. Bazuar në shkaqet e refuzimit që përcaktohen në nenin 9 të këtij ligji, kundërshtimi për regjistrimin e markës mund të depozitohet në Dhomen e Kundërshtimeve, brenda 3 muajve nga data e botimit të kërkesës për regjistrimin e markës, nga:

a) pronarët e markave tregtare të mëparshme që përcaktohen në pikën 2, të nenit 9 të këtij ligji, dhe të licencuarit e autorizuar nga pronarët e këtyre markave në lidhje me shkaqet e kundërshtimit që përcaktohen në pikën 1, të nenit 9 të këtij ligji;

b) mbajtësit e të drejtave të mëparshme, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 9, të këtij ligji;

c) subjektet tregtare, në kuptim të pikës 4, të nenit 9 të këtij ligji;

ç) pronarët e markave të mëparshme, në kuptim të pikës 5, të nenit 9 të këtij ligji;

d) personat e autorizuar për të ushtruar të drejtat që përcaktohen në pikën 6, të nenit 9 të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë ose marrëveshjet ndërkombëtare që kanë

fuqi në Republikën e Shqipërisë për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë.

2. Në rastin kur kundërshtimi bazohet në shkronjën “c”, të pikave 1 dhe 2, të nenit 9 të këtij ligji, kundërshtuesi duhet të provojë se marka e mëparshme është e mirënjohur ose që ka fituar reputacion në Republikën e Shqipërisë përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim marke, ose datës së prioritetit, kur pretendohet e drejta për prioritet.

3. Nëse marka tregtare e mëparshme mbi të cilën bazohet kundërshtimi është objekt i një procedure shfuqizimi ose deklarimi pavlefshmërie, Dhoma e Kundërshtimeve vendos për pezullimin e procedurës së kundërshtimit derisa të merret vendimi për procedurën e shfuqizimit ose procedurën e deklarimit të pavlefshmërisë së markës tregtare të mëparshme.

4. Kërkesa për kundërshtim përmban:

a) argumentet, bazën ligjore dhe provat që lidhen me kundërshtimin;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

5. Afati për depozitimin e kundërshtimit që përcaktohet në pikën 1 të këtij neni nuk shtyhet.

6. Kundërshtimi mund të depozitohet në bazë të një ose më shumë të drejtave të mëparshme, me kusht që ato t'i përkasin të njëjtit person.

7. Përmbajtja e kundërshtimit dhe dokumentet bashkëlidhur tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Procedura e kundërshtimit

1. Dhoma e Kundërshtimeve shqyrton brenda 2 muajve nëse kundërshtimi është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji.

2. Nëse kundërshtimi nuk përmbush kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 46 të këtij ligji, Dhoma e Kundërshtimeve vendos për refuzimin e kundërshtimit.

3. Nëse kundërshtimi nuk është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji, Dhoma e Kundërshtimeve i dërgon njoftim kundërshtuesit që të plotësojë të metat ose



mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Nëse kundërshtuesi nuk i plotëson të metat dhe mangësitë, sipas njoftimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, Dhoma e Kundërshtimeve vendos për refuzimin e kundërshtimit.

5. Nëse kundërshtimi përmbush kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Dhoma e Kundërshtimeve, brenda 2 muajve, i dërgon kërkuarit që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke një kopje të kundërshtimit bashkë me njoftimin për kundërshtimin e markës dhe e fton atë që të depozitojë observimet kundër kundërshtimit, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse kërkuari i markës së kundërshtuar, gjatë kësaj periudhe, kërkon me shkrim paraqitjen e provave për përdorimin real dhe efektiv të markës së mëparshme nga kundërshtuesi, zbatohen procedura dhe afatet e përcaktuara në nenin 48 të këtij ligji.

6. Afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk shtyhet.

7. Nëse kërkuari nuk paraqet observimet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të caktuar në pikën 5 të këtij neni, Dhoma e Kundërshtimeve, brenda 2 muajve, vendos automatikisht për pranimin e kundërshtimit dhe refuzimin e kërkesës për regjistrimin e markës në lidhje me një pjesë ose të gjitha mallrat dhe shërbimet.

8. Nëse Dhoma e Kundërshtimeve vendos për pranimin e kundërshtimit vetëm për një pjesë të mallrave ose shërbimeve të markës së kundërshtuar, për procedurën e regjistrimit të markës në lidhje me pjesën tjetër të mbetur të mallrave dhe shërbimeve vazhdon të merret vendimi për pranimin e pjesshëm të kundërshtimit.

Neni 48

Mospërdorimi si mënyrë mbrojtjeje në procedurat e kundërshtimit

1. Nëse kërkuari i markës së kundërshtuar e kërkon me shkrim dhe kur marka e mëparshme është regjistruar të paktën 5 vjet përpara datës së depozitimit të kundërshtimit, kundërshtuesi duhet të paraqesë prova se gjatë një periudhe të pandërprerë prej 5 vjetësh përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim marke ose datës së prioritetit të markës së kundërshtuar:

a) marka e mëparshme është vendosur në përdorim real dhe efektiv në lidhje me mallrat dhe

shërbimet për të cilat ajo është regjistruar dhe mbi të cilat është bazuar kundërshtimi; ose

b) ekzistojnë shkaqe të justifikuara për mospërdorimin.

2. Dhoma e Kundërshtimeve brenda 1 muaji i dërgon njoftim pronarit të markës së mëparshme që të depozitojë observimet e tij për kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Këto observime duhet të depozitohen brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse pronari i markës tregtare të mëparshme nuk paraqet observimet e tij në lidhje me kërkesën për të provuar përdorimin real dhe efektiv ose nuk paraqet arsye të justifikuara për mospërdorimin e markës së mëparshme, Dhoma e Kundërshtimeve brenda 1 muaji vendos për refuzimin e kundërshtimit. Procedura e kërkesës për regjistrimin e markës së kundërshtuar vazhdon pasi Dhoma e Kundërshtimeve merr vendimin për refuzimin e kundërshtimit.

4. Nëse pronari i markës së mëparshme depoziton observimet e tij në lidhje me kërkesën për të provuar përdorimin real dhe efektiv të markës së mëparshme në afatin e caktuar, Dhoma e Kundërshtimeve brenda 1 muaji i dërgon kërkuarit të markës së kundërshtuar kopjen e observimeve bashkë me njoftimin përkatës dhe e fton atë që të depozitojë observimet e tij, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Me mbarimin e afatit që përcaktohet në pikën 4 të këtij neni, Dhoma e Kundërshtimeve, brenda 2 muajve, vendos për bazueshmërinë e kundërshtimit në bazë të fakteve, provave dhe observimeve të depozituara nga palët.

6. Nëse marka tregtare e mëparshme është përdorur vetëm për një pjesë të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ajo është regjistruar, ajo konsiderohet se është regjistruar vetëm për atë pjesë të mallrave dhe shërbimeve, me qëllim të shqyrtimit të kundërshtimit.

Neni 49

Pezullimi i procedurës së kundërshtimit për arritjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim

1. Kërkuari i markës së kundërshtuar dhe kundërshtuesi mund t'i kërkojnë bashkërisht Dhomës së Kundërshtimeve që të pezullojë procedurën e kundërshtimit me qëllim që të bëhen përpjekje për arritjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim.



Kërkesa duhet nënshkruar nga të dyja palët dhe të depozitohet në Dhomën e Kundërshtimeve gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit.

2. Dhoma e Kundërshtimeve brenda 1 muaji nga data e depozitimit të kërkesës së përbashkët të palëve merr vendim për pezullimin e procedurës së kundërshtimit dhe cakton një afat jo më shumë se 12 muaj që palët të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim gjatë procedurës së kundërshtimit.

3. Gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, secila palë, në çdo kohë, mund të kërkojë me shkrim ndërprerjen e pezullimit dhe vijimin e procedurës së kundërshtimit në fazën që është pezulluar.

4. Dhoma e Kundërshtimeve vendos për përfundimin e pezullimit të procedurës së kundërshtimit nëse brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni kërkuksi i markës së kundërshtuar dhe kundërshtuesi e njoftojnë me shkrim Dhomën e Kundërshtimeve që:

- a) çështja e kundërshtimit është zgjidhur; dhe
- b) kundërshtuesi tërheq kundërshtimin.

Neni 50

Vendimi për kundërshtimin

1. Dhoma e Kundërshtimeve shqyrton bazueshmërinë e kundërshtimit dhe vendos për rrëzimin e kundërshtimit nëse kundërshtimi është i pabazuar. Procedura e kërkesës për regjistrimin e markës vazhdon pasi Dhoma e Kundërshtimeve merr vendimin për rrëzimin e kundërshtimit.

2. Dhoma e Kundërshtimeve shqyrton bazueshmërinë e kundërshtimit dhe vendos për pranimin e plotë të kundërshtimit nëse kundërshtimi është i bazuar për të gjitha mallrat dhe shërbimet e përfshira në kërkesën për regjistrim marke. Vendimi për pranimin e plotë të kundërshtimit sjell si pasojë refuzimin e plotë të kërkesës për regjistrimin e markës.

3. Dhoma e Kundërshtimeve shqyrton bazueshmërinë e kundërshtimit dhe vendos për pranimin e pjesshëm të kundërshtimit nëse kundërshtimi është i bazuar vetëm për një pjesë të mallrave dhe shërbimeve të përfshira në kërkesën për regjistrim marke. Vendimi për pranimin e pjesshëm të kundërshtimit sjell si pasojë refuzimin e pjesshëm të kërkesës për regjistrimin e markës, ndërsa procedura e regjistrimit të markës për pjesën tjetër të mbetur të mallrave dhe shërbimeve

vazhdon pasi Dhoma e Kundërshtimeve merr vendimin për pranimin e pjesshëm të kundërshtimit.

4. Vendimi për refuzimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës për regjistrimin e markës botohet në buletin e DPPI-së. Vendimi i arsyetuar i Dhomës së Kundërshtimeve u komunikohet palëve brenda 2 muajve nga data e marrjes së vendimit.

5. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma e Kundërshtimeve mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, përkundërt pagesës së tarifës përkatëse.

KREU III

TËRHEQJA NGA KËRKESA PËR REGJISTRIM MARKE, KUFIZIMI I LISTËS SË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE, KORRIGJIMET DHE NDARJA E KËRKESËS

Neni 51

Tërheqja nga kërkesa për regjistrim marke dhe kufizimi i listës së mallrave dhe shërbimeve

1. Kërkuksi për regjistrimin e markës tregtare, në çdo kohë, mund të tërheqë kërkesën e tij ose të kufizojë listën e mallrave dhe shërbimeve të përfshira në kërkesë.

2. Kërkesa për kufizimin e listës së mallrave dhe shërbimeve përmban:

- a) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;
- b) pagesën e tarifës përkatëse; dhe
- c) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

3. Kur kërkesa për kufizimin e listës së mallrave dhe shërbimeve nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuksit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, DPPI-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës.

4. Në rast se kërkesa është botuar, tërheqja e kërkesës ose kufizimi i listës së mallrave dhe shërbimeve botohet në buletin e DPPI-së.

5. Në rast se kërkuksi i markës së kundërshtuar kufizon listën e mallrave dhe shërbimeve, që janë objekt i kundërshtimit, Dhoma e Kundërshtimeve brenda 2 muajve i dërgon kundërshtuesit njoftimin për kufizimin e listës së mallrave dhe shërbimeve të



markës së kundërshtuar dhe e fton atë të shprehet me shkrim nëse ai i qëndron kundërshtimit, siç është depozituar apo e tërheq atë. Kundërshtuesi duhet të shprehet me shkrim brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

6. Nëse nuk e tërheq kundërshtimin e tij, Dhoma e Kundërshtimeve vijon procedurën e kundërshtimit mbi listën e kufizuar të mallrave dhe shërbimeve nëse kundërshtuesi:

a) nuk i përgjigjet ftesës së Dhomës së Kundërshtimeve brenda afatit të caktuar në pikën 5 të këtij neni; dhe

b) nuk e tërheq kundërshtimin e tij.

Neni 52

Korrigjimi i kërkesës për regjistrim marke

1. DPPI-ja, me kërkesë të kërkuarit për markë ose me nismën e saj, bën korrigjimin e gabimeve në kërkesën për regjistrim marke vetëm në rastet kur është e nevojshme të korrigjohen:

a) emri ose adresa e kërkuarit;

b) gabimet në formulim apo në kopjim; ose

c) disa gabime të tjera të dukshme, me kusht që këto korrigjime të mos ndryshojnë në mënyrë thelbësore përfaqësimin e markës tregtare dhe të mos zgjerojnë listën e mallrave dhe shërbimeve.

2. Kërkesa për korrigjimin e gabimeve përmban:

a) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

b) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

c) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

3. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, shqyrton nëse kërkesa për korrigjimin e gabimeve është në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

4. Nëse kërkesa nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa për korrigjimin e gabimit refuzohet.

5. Nëse kërkesa plotëson kërkesat e caktuara në këtë nen, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron korrigjimin e gabimit dhe e boton atë në buletin.

6. Kërkesa për regjistrimin e markës botohet në buletin e DPPI-së në formën e ndryshuar nëse:

a) korrigjimet nuk ndikojnë në përfaqësimin e markës;

b) lista e mallrave dhe shërbimeve nuk zgjerohet; dhe

c) korrigjimet janë bërë pasi marka tregtare është botuar.

Neni 53

Ndarja e kërkesës për regjistrim marke

1. Kërkuari mund të ndajë kërkesën për regjistrim marke në një ose më shumë kërkesa të veçanta duke përcaktuar se disa prej mallrave dhe shërbimeve të përfshira në kërkesën fillestare do të jenë objekt i një ose më shumë kërkesave të ndara.

Mallrat dhe shërbimet në kërkesën e ndarë nuk duhet të jenë të njëjta me mallrat dhe shërbimet që mbeten në kërkesën fillestare ose me mallrat dhe shërbimet që janë përfshirë në kërkesat e tjera të ndara.

2. Kërkesa për ndarje depozitohet në DPPI dhe përmban:

a) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

b) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

c) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht.

3. Kërkesa për ndarje nuk pranohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse është depozituar një kundërshtim ndaj kërkesës fillestare dhe kërkesa e ndarë sjell si pasojë ndarjen e mallrave dhe shërbimeve ndaj të cilave është depozituar kundërshtimi, derisa të merret vendimi i Dhomës së Kundërshtimeve për kundërshtimin ose derisa procedurat e kundërshtimit të përfundojnë në një mënyrë tjetër me vendim;

b) përpara miratimit të datës së depozitimit nga DPPI-ja, sipas nenit 34 të këtij ligji;

c) gjatë periudhës së kundërshtimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 46 të këtij ligji.

4. Ndarja e kërkesës për regjistrim marke ka efekt nga data e regjistrimit në dosjen që DPPI-ja mban në lidhje me kërkesën fillestare.

5. Kërkesa e ndarë ruan datën e depozitimit dhe çdo datë prioriteti të kërkesës fillestare.

6. Të dhënat mbi kërkesat e ndara regjistrohen në regjister dhe botohen në buletin e DPPI-së.

7. Kur kërkesa për ndarje lidhet me një kërkesë që është botuar më përpara, në përputhje me nenin 44 të këtij ligji, kërkesa e ndarë botohet në buletin.



8. Botimi i kërkesës të ndarë në përputhje me pikën 7 të këtij neni, nuk sjell fillimin e ndonjë afati të ri për depozitimin e kundërshtimeve.

9. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për ndarje, shqyrton nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Nëse kërkesa nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

10. Nëse kërkuari nuk plotëson këto të meta ose mangësi brenda afatit të caktuar, DPPI-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës për ndarje. Nëse kërkuari plotëson këto të meta ose mangësi brenda afatit të caktuar, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron ndarjen e kërkesës për regjistrim marke në regjistër dhe vijon me botimin e saj në buletin. Vendimi për regjistrimin e ndarjes së kërkesës për markë i dërgohet kërkuarit.

11. Procedura e regjistrimit dhe botimit, përmbajtja e kërkesës për ndarje dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV REGJISTRIMI I MARKËS TREGTARE DHE CERTIFIKATA E MARKËS TREGTARE

Neni 54 Regjistrimi i markës tregtare

1. DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të paguajë tarifën për regjistrimin e markës brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit kur:

a) kërkesa për regjistrimin e markës tregtare plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe nuk është depozituar asnjë kërkesë për kundërshtim brenda afatit të caktuar në pikën 1, të nenit 46 të këtij ligji; ose

b) është depozituar një kundërshtim ndaj kërkesës për regjistrimin e markës në Dhomën e Kundërshtimeve dhe është marrë një vendim për rrëzimin e kundërshtimit, heqjen dorë ose çdo zgjidhje tjetër në lidhje me procedurën e kundërshtimit.

2. Nëse tarifa e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk paguhet brenda afatit të caktuar, DPPI-ja merr vendim për refuzimin e regjistrimit të markës.

3. Nëse tarifa e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni paguhet brenda afatit të caktuar, DPPI-ja regjistron

markën në regjistër dhe vijon me botimin e saj në buletin. Certifikata e regjistrimit të markës tregtare i dërgohet pronarit.

4. Procedura e regjistrimit të markës që botohet në buletin e DPPI-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55 Kopja e certifikatës së regjistrimit të markës tregtare

1. Me kërkesë të pronarit të markës tregtare, si dhe pas kryerjes së pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon një tjetër kopje të certifikatës së regjistrimit të markës tregtare.

2. Përmbajtja e certifikatës së markës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA V KOHËZGJATJA, RIPËRTËRITJA, MODIFIKIMI DHE NDARJA E REGJISTRIMIT TË MARKËS TREGTARE

KREU I KOHËZGJATJA

Neni 56 Kohëzgjatja e regjistrimit

1. Marka tregtare regjistrohet për një periudhë 10-vjeçare nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrim marke.

2. Regjistrimi i markës tregtare mund të ripërtërihet në mënyrë të pandërprerë për periudha të mëtejshme 10-vjeçare, në përputhje me nenin 57 të këtij ligji.

KREU II RIPËRTËRITJA

Neni 57 Ripërtëritja e regjistrimit të markës tregtare

1. Regjistrimi i markës tregtare ripërtërihet me kërkesën e pronarit të markës tregtare ose çdo personi tjetër të autorizuar sipas këtij ligji.

2. Kërkesa për ripërtëritjen e markës përmban:

a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;



b) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi; dhe

c) pagesën e tarifës përkatëse të ripërtëritjes.

3. Kërkesa për ripërtëritjen e markës depozitohet në DPPI brenda 1 viti përpara datës së mbarimit të mbrojtjes. Nëse kërkesa për ripërtëritjen e markës nuk është depozituar brenda këtij afati, pronari i markës mund ta depozitojë kërkesën për ripërtëritje edhe brenda një periudhe shtesë prej gjashtë muajsh nga data e mbarimit të afatit të regjistrimit, përkundrejt pagesës së tarifës shtesë.

4. DPPI-ja, jo më vonë se brenda 6 muajve përpara datës së mbarimit të mbrojtjes, i dërgon njoftim pronarit të markës tregtare për mbarimin e afatit 10-vjeçar të mbrojtjes. Mosdërgimi i njoftimit nuk e ngarkon DPPI-në me përgjegjësi dhe nuk ndikon në mbarimin e afatit të regjistrimit.

5. Nëse pagesa është kryer brenda afatit të caktuar në pikën 1 ose brenda afatit shtesë të caktuar në pikën 4 të këtij neni, pagesa konsiderohet si kërkesë për ripërtëritje të markës tregtare me kusht që ajo të përmbajë të gjithë treguesit e nevojshëm që përcaktojnë qëllimin e pagesës.

6. Kur kërkesa paraqitet ose tarifa paguhet vetëm në lidhje me disa prej mallrave dhe shërbimeve për të cilat është regjistruar marka tregtare, regjistrimi ripërtërihet vetëm për ato mallra dhe shërbime.

7. Kur kërkesa për ripërtëritje marke plotëson kërkesat e këtij neni, DPPI-ja regjistron ripërtëritjen e markës në regjistër dhe e boton atë në buletin. DPPI-ja, brenda 1 muaji, i dërgon kërkuesit certifikatën për ripërtëritjen e regjistrimit të markës.

8. DPPI-ja, brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për ripërtëritje, shqyrton nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Nëse kërkesa për ripërtëritje marke nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon kërkuesit njoftim për plotësimin e të metave ose mangësive, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Pa cenuar pikën 5 të këtij neni, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës nëse të metat ose mangësitë nuk plotësohen brenda afatit të caktuar.

9. Ripërtëritja e markës tregtare ose, sipas rastit, mbarimi i afatit të regjistrimit kur marka tregtare nuk ripërtërihet, hyn në fuqi nga dita në të cilën mbaron afati i regjistrimit ekzistues.

10. Përmbajtja e kërkesës për ripërtëritjen e markës tregtare dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III MODIFIKIMI

Neni 58

Modifikimi i markës tregtare

1. Marka tregtare nuk modifikohet në regjistër gjatë periudhës së regjistrimit ose ripërtëritjes së saj.

2. Përfshimisht, modifikimet e markës tregtare mund të regjistrohen me kërkesë të pronarit nëse:

a) marka tregtare përmban emrin dhe adresën e pronarit të markës; dhe

b) modifikimi i markës nuk ndikon në mënyrë thelbësore tek identiteti i markës tregtare në raport me regjistrimin fillestar.

3. Kërkesa për modifikimin e markës përmban:

a) elementin e markës, objekt modifikimi, dhe versionin e modifikuar të këtij elementi;

b) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

c) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi; dhe

ç) pagesën e tarifës përkatëse të modifikimit.

4. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për modifikimin e markës, shqyrton nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Kur kërkesa nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuesit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse kërkuesi nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të caktuar, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës. Kur kërkuesi plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron modifikimin në regjistër dhe e boton atë në buletin. Vendimi për regjistrimin e modifikimit përmban përfaqësimin e markës në versionin e modifikuar dhe i dërgohet kërkuesit.

6. Palët e treta, të drejtat e të cilave mund të preken nga modifikimi, mund ta kundërshtojnë regjistrimin e modifikimit brenda 3 muajve nga data e botimit të modifikimit.

7. Dispozitat e përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji zbatohen edhe për botimin e regjistrimit të modifikimit.



KREU IV NDRYSHIMI I EMRIT OSE ADRESËS

Neni 59

Ndryshimi i emrit ose adresës të pronarit të markës tregtare

1. Me kërkesë të pronarit të markës, DPPI-ja regjistron ndryshimin e emrit ose adresës së pronarit të markës në regjistër nëse ky ndryshim:

a) nuk është një modifikim i markës tregtare, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji; dhe

b) nuk është pasojë e një transferimi të plotë ose të pjesshëm të markës tregtare.

2. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit të emrit të pronarit të markës përmban:

a) dokumentin që vërteton ndryshimin e emrit;

b) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

c) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi; dhe

ç) pagesën e tarifës përkatëse të ndryshimit.

3. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit të adresës së pronarit të markës përmban:

a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi; dhe

c) pagesën e tarifës përkatëse të ndryshimit.

4. DPPI-ja brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për ndryshimin e emrit ose adresës së pronarit të markës tregtare shqyrton nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Kur kërkesa nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse kërkuari nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të caktuar, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës. Kur kërkuari plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja, brenda 1 muaji, regjistron ndryshimin në regjistër dhe e boton atë në buletin. Vendimi përkatës për regjistrimin e ndryshimit i dërgohet kërkuarit.

6. Dispozitat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për ndryshimin e emrit ose adresës së përfaqësuesit të autorizuar.

7. Dispozitat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për kërkesat për regjistrim të markës.

8. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit të emrit ose të adresës së pronarit të markës mund të depozitohet për dy ose më shumë marka, me kusht

që të dhënat e pronarit të regjistruar të këtyre markave të jenë të njëjta.

9. Përmbajtja e kërkesës për ndryshimin e emrit dhe adresës së pronarit të markës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V NDARJA E REGJISTRIMIT

Neni 60

Ndarja e regjistrimit të markës tregtare

1. Pronari i markës tregtare mund të ndajë regjistrimin e markës në një ose më shumë regjistrime të veçanta, duke përcaktuar se disa prej mallrave dhe shërbimeve të përfshira në regjistrimin fillestar do të jenë objekt i një ose më shumë regjistrimeve të ndara.

Mallrat dhe shërbimet në regjistrimin e ndarë nuk duhet të jenë të njëjta me mallrat dhe shërbimet që mbeten në regjistrimin fillestar ose me mallrat dhe shërbimet që janë përfshirë në regjistrimet e tjera të ndara.

2. Kërkesa për ndarjen e regjistrimit të markës depozitohet në DPPI dhe përmban:

a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi; dhe

c) pagesën e tarifës përkatëse të regjistrimit të ndarjes.

3. Kërkesa për ndarjen e regjistrimit të markës nuk pranohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse është depozituar një kërkesë për shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë ndaj regjistrimit fillestar dhe kur regjistrimi i ndarë sjell si pasojë ndarjen e mallrave dhe shërbimeve ndaj të cilave është depozituar kërkesa për shfuqizim ose deklarim pavlefshmërie, derisa të merret vendimi i Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose derisa procedurat në Dhomë të përfundojnë në një mënyrë tjetër me vendim;

b) nëse është depozituar një kundërpadi për shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë së regjistrimit fillestar në gjykatë dhe kur regjistrimi i ndarë sjell si pasojë ndarjen e mallrave dhe shërbimeve ndaj të cilave është depozituar kundërpadi, derisa të merret vendimi i gjykatës.

4. Ndarja e regjistrimit ka efekt nga data që regjistrohet në regjistër.



5. Regjistrimi i ndarë ruan datën e depozitimit dhe çdo datë prioriteti të regjistrimit fillestar.

6. Të dhënat mbi regjistrimet e ndara regjistrohen në regjistër dhe botohen në buletin të DPPI-së.

7. DPPI-ja, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për ndarje të regjistrimit të markës, ekzaminon nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Kur kërkesa nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

8. Nëse kërkuari nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të caktuar, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës. Kur kërkuari plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron ndarjen e regjistrimit në regjistër dhe vijon me botimin e tij në buletin. Vendimi për ndarjen e regjistrimit të markës i dërgohet kërkuarit.

9. Procedura për regjistrimin dhe botimin, përmbajtja e kërkesës për ndarjen e regjistrimit të markës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA VI
HEQJA DORË, SHFUQIZIMI DHE
DEKLARIMI I PAVLEFSHMËRISË SË
MARKËS TREGTARE

KREU I
HEQJA DORË

Neni 61

Heqja dorë nga marka tregtare

1. Pronari i markës mund të depozitojë një kërkesë për heqjen dorë nga marka në lidhje me disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar. Heqja dorë botohet në buletin dhe hyn në fuqi pasi regjistrohet në regjistër.

2. Kërkesa për dorëheqje përmban:

- a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;
- b) autorizimin e përfaqësimit, kur ai paraqitet nga përfaqësuesi;
- c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe
- ç) kërkesën me shkrim për heqjen dorë nga marka.

3. Nëse ndaj të njëjtës markë është depozituar një kërkesë për shfuqizim, në përputhje me nenin 62 të

këtij ligji, heqja dorë nga marka është e vlefshme nëse:

a) kërkesa për dorëheqje është depozituar në DPPI më vonë se kërkesa për shfuqizim; dhe

b) kërkesa për shfuqizim është refuzuar me vendim ose kërkuari ka hequr dorë nga kërkesa për shfuqizim.

4. Heqja dorë nga marka regjistrohet vetëm nëse pronari i markës jep pëlqimin e tij me shkrim. Nëse është regjistruar një licencë në lidhje me markën, heqja dorë nga marka regjistrohet në regjistër vetëm nëse pronari i markës tregtare provon se ka informuar të licencuarin për qëllimin e tij për të hequr dorë nga marka tregtare.

5. Heqja dorë nga marka regjistrohet në DPPI. DPPI-ja vendos për regjistrimin e heqjes dorë nga marka pas përfundimit të periudhës 3-mujore nga data në të cilën pronari siguron DPPI-në se ka informuar të licencuarin për qëllimin e tij për të hequr dorë nga marka ose përpara mbarimit të asaj periudhe, kur ai provon se i licencuari ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim.

6. DPPI-ja, brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për dorëheqje, ekzaminon nëse kjo kërkesë plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen. Kur kërkesa plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

7. Nëse kërkuari nuk plotëson këto të meta ose mangësi brenda afatit të caktuar, DPPI-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës. Kur kërkuari plotëson të metat ose mangësitë, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron dorëheqjen në regjistër dhe e boton atë në buletin. Vendimi për dorëheqjen nga marka tregtare i dërgohet kërkuarit.

8. Përmbajtja e kërkesës për heqje dorë nga marka dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

KREU II
SHFUQIZIMI I MARKËS TREGTARE

Neni 62

**Depozitimi i kërkesës dhe shkaqet për
shfuqizimin e markës tregtare**

1. Çdo person mund të kërkojë shfuqizimin e markës për disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar marka në bazë të një



kërkese drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose një padie në procesin e shkeljes të të drejtave.

2. Kërkesa për shfuqizim mund të depozitohet edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) përmes një padie sipas pikës 1 të këtij neni, nëse është duke u zhvilluar një proces për shkelje të të drejtave të markës tregtare në gjykatë; ose

b) në çdo rast tjetër kur kërkesa për shfuqizim është depozituar në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri dhe pala kërkuese ia drejton kërkesën për shfuqizim gjykatës. Kërkesa për shfuqizim të markës mund t'i drejtohet gjykatës në çdo fazë të procedurës.

3. Kërkesa për shfuqizim përmban:

a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse;

d) argumentet, bazën ligjore dhe provat vetëm në rastet kur kërkesa për shfuqizim depozitohet në bazë të pikës 5 të këtij neni.

4. Marka tregtare mund të shfuqizohet nëse nuk është vendosur në përdorim real dhe efektiv në territorin e Republikës së Shqipërisë brenda një periudhe të pandërprerë prej 5 vjetësh nga data e regjistrimit në lidhje me mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar dhe kur nuk ka shkaqe të justifikuara për mospërdorimin.

5. Marka tregtare, pas datës në të cilën ajo është regjistruar, mund të shfuqizohet edhe në rastet e mëposhtme:

a) kur marka, si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të pronarit, është bërë emër i zakonshëm në tregti për mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar;

b) kur marka, si pasojë e përdorimit të saj nga pronari i markës tregtare ose me pëlqimin e tij, mund të çorientojë publikun në lidhje me mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar, veçanërisht për sa i përket natyrës, cilësisë ose origjinës gjeografike të mallrave dhe shërbimeve.

6. Përmbajtja e kërkesës për shfuqizim dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Procedura për shfuqizimin e markës

1. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve shqyrton nëse kërkesa për shfuqizimin e markës tregtare është depozituar në përputhje me nenin 62 të këtij ligji.

2. Nëse kërkesa për shfuqizimin e markës është depozituar përpara përfundimit të periudhës 5-vjeçare nga data e regjistrimit të markës, ose nëse kërkesa nuk është depozituar për shkaqet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 62 të këtij ligji, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri merr vendim për refuzimin e kërkesës.

3. Nëse nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 62 të këtij ligji, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri i dërgon njoftim kërkuesit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Nëse kërkuesi plotëson të metat ose mangësitë brenda afati të caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri merr vendim për refuzimin e kërkesës.

5. Nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 62 të këtij ligji, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon pronarit të markës, objekt shfuqizimi, një kopje të kërkesës për shfuqizim dhe e fton atë që të depozitojë observimet dhe provat për përdorimin real dhe efektiv të markës brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Nëse pronari i markës, objekt shfuqizimi, nuk depoziton observimet dhe provat brenda afatit të caktuar, marka shfuqizohet për ato mallra ose shërbime për të cilat është depozituar kërkesa për shfuqizim.

7. Nëse pronari i markës, objekt shfuqizimi, depoziton observimet dhe provat në afatin e caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon një kopje të observimeve e të provave kërkuesit dhe e fton atë që të depozitojë observimet e tij brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

8. Nëse kërkuesi nuk depoziton observimet e tij brenda afatit të caktuar në pikën 7 të këtij neni, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve merr vendim bazuar në observimet dhe provat e depozituara më parë.

9. Nëse kërkuesi depoziton observimet e tij sipas pikës 7 të këtij neni, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon një kopje të këtyre observimeve shtesë pronarit të markës,



objekt shfuqizimi, dhe e fton atë të depozitojë observime dhe prova të tjera shtesë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

10. Nëse kërkuesi nuk depoziton observimet e tij brenda afatit të caktuar në pikën 9 të këtij neni, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve merr vendim bazuar në observimet dhe provat e depozituara më parë.

11. Përpara marrjes së vendimit, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Në seancën dëgjimore nuk paraqiten prova të reja.

Neni 64

Vendimi mbi bazueshmërinë e kërkesës për shfuqizim

1. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri shqyrton bazueshmërinë e kërkesës dhe vendos për shfuqizimin ose jo të markës.

2. Shfuqizimi i markës tregtare nuk mund të kërkohej kur përdorimi real dhe efektiv i markës ka filluar ose ka rifilluar gjatë intervalit ndërmjet mbarimit të periudhës 5-vjeçare të mospërdorimit dhe datës së depozitimit të kërkesës për shfuqizim.

Fillimi ose rifillimi i përdorimit të markës brenda një periudhe 3-mujore përpara datës së depozitimit të kërkesës për shfuqizim nuk merret parasysh nëse:

a) fillon jo më herët se mbarimi i periudhës së pandërprerë 5-vjeçare të mospërdorimit; dhe

b) përgatitjet për fillimin ose rifillimin ndodhin vetëm pasi pronari ka marrë dijeni se mund të depozitohet kërkesa për shfuqizim.

3. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për rrëzimin e kërkesës kur çmon se kërkesa për shfuqizim është e pabazuar.

4. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për shfuqizimin e markës për disa ose të gjitha mallrat ose shërbimet kur çmon se kërkesa për shfuqizimin e markës është e bazuar.

5. Kur marka tregtare shfuqizohet, ajo konsiderohet se nuk sjell efekte:

a) nga data e depozitimit të kërkesës për shfuqizim; ose

b) kur kërkohej nga njëra prej palëve, nga një datë e mëparshme që shfaqet ndonjë prej shkaqeve për shfuqizim, të përcaktuara në nenin 62 të këtij ligji.

6. DPPI-ja boton në buletin dhe regjistron në regjistër shfuqizimin e markës pasi të merret vendimi për shfuqizim. Vendimi i arsyetuar i

Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri u komunikohet palëve brenda 2 muajve nga data e marrjes së vendimit.

7. Kundër vendimit të Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

KREU III

PAVLEFSHMËRIA E MARKËS TREGTARE

Neni 65

Deklarimi i pavlefshmërisë së markës tregtare për shkaqe absolute

1. Çdo person mund të kërkojë deklarin e pavlefshmërisë së markës për shkaqe absolute për disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar marka në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, ose një padie në procesin e shkeljes së të drejtave.

2. Kërkesa për deklarin e pavlefshmërisë mund të depozitohet edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) përmes një kundërpadie nëse është duke u zhvilluar një proces për shkelje të të drejtave të markës tregtare në gjykatë; ose

b) në çdo rast tjetër kur kërkesa për deklarin e pavlefshmërisë është depozituar në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, dhe pala kërkuese ia drejton kërkesën për deklarin e pavlefshmërisë gjykatës. Kërkesa për deklarin e pavlefshmërisë të markës mund t'i drejtohet gjykatës në çdo fazë të procedurës.

3. Kërkesa për deklarin e pavlefshmërisë përmban:

a) argumentet, bazën ligjore dhe provat ku mbështetet kërkesa;

b) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

c) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi;

ç) pagesën e tarifës përkatëse.

4. Marka deklarohet e pavlefshme kur:

a) është regjistruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 8 të këtij ligji;

b) personi që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke ka vepruar në keqbesim në



momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim marke.

5. Kur marka tregtare është regjistruar në shkelje të parashikimeve të shkronjave “b”, “c”, “ç”, të pikës 1, të nenit 8 të këtij ligji, marka tregtare nuk deklarohet e pavlefshme nëse pronari i kësaj marke provon se si pasojë e përdorimit marka ka fituar karakter dallues në lidhje me mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar përpara datës së depozitimit të kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës.

6. Përmbajtja e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë për shkaqe absolute dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 66

Deklarimi i pavlefshmërisë së markës tregtare për shkaqe relative

1. Deklarimi i pavlefshmërisë së markës për shkaqe relative mund të kërkohej për disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar marka në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, ose një kundërpadie në procesin e shkeljes së të drejtave. Kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë mund të depozitohet nga:

a) pronarët e markave tregtare të mëparshme që përcaktohen në pikën 2, të nenit 9 të këtij ligji, si dhe të licencuarit e autorizuar nga pronarët e këtyre markave në lidhje me shkaqet e kundërshtimit që përcaktohen në pikën 1 të nenit 9 të këtij ligji;

b) mbajtësit e të drejtave të mëparshme, siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 9, të këtij ligji;

c) subjektet tregtare, në kuptim të pikës 4, të nenit 9, të këtij ligji;

ç) pronarët e markave tregtare, në kuptim të pikës 5, të nenit 9, të këtij ligji;

d) personat e autorizuar për të ushtruar të drejtat që përcaktohen në pikën 6, të nenit 9, të këtij ligji, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë ose me ligjin kombëtar që parashikon mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografikë.

2. Kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë mund të depozitohet edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) përmes një kundërpadie nëse është duke u zhvilluar një proces për shkelje të të drejtave të markës tregtare në gjykatë; ose

b) në çdo rast tjetër, kur kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë është depozituar në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri dhe pala kërkuese ia drejton kërkesën për deklarimin e pavlefshmërisë gjykatës. Kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë së markës mund t'i drejtohet gjykatës në çdo fazë të procedurës.

3. Kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë përmban:

a) argumentet, bazën ligjore dhe provat ku mbështetet kërkesa;

b) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;

c) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi;

ç) pagesën e tarifës përkatëse.

4. Në rastin kur deklarimi i pavlefshmërisë bazohet në një markë të mirënjohur ose një markë me reputacion, kërkuesi duhet të provojë se marka e mëparshme është e mirënjohur ose që ka fituar reputacion në Republikën e Shqipërisë përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim të markës, objekt i kërkesës për pavlefshmëri, ose datës së prioritetit, kur marka gëzon të drejta prioriteti.

5. Marka tregtare nuk deklarohet e pavlefshme nëse pronari ose mbajtësi i të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni jep pëlqimin me shkrim për regjistrimin e markës përpara datës së depozitimit të kundërpadisë ose kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë.

6. Nëse marka tregtare e mëparshme, mbi të cilën bazohet kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë, është objekt i një procedure shfuqizimi ose deklarimi pavlefshmërie, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për pezullimin e procedurës së deklarimit të pavlefshmërisë së markës së mëvonshme derisa të merret vendimi mbi shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë së markës së mëparshme.

7. Kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë së markës mund të depozitohet mbi bazën e një ose më shumë të drejtave të mëparshme. Në rast se kërkesa për pavlefshmëri depozitohet mbi bazën e disa të drejtave të mëparshme, të gjitha këto të drejta duhet t'i përkasin të njëjtit mbajtës ose pronar.

8. Përmbajtja e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë për shkaqe relative dhe dokumentet



shoqëruese të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 67

Mospërdorimi si mjet mbrojtjeje në procedurat e deklarimit të pavlefshmërisë së markës tregtare

1. Nëse pronari i markës së mëvonshme e kërkon me shkrim dhe marka është regjistruar të paktën 5 vjet përpara datës së depozitimit të kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës, pronari i markës së mëparshme duhet të depozitojë prova se gjatë një periudhe të pandërprerë prej 5 vjetësh përpara datës së depozitimit të kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë:

a) marka e mëparshme është vendosur në përdorim real dhe efektiv në lidhje me mallrat dhe shërbimet për të cilat ajo është regjistruar dhe mbi të cilat është bazuar kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë; ose

b) ekzistojnë shkaqe të justifikuara për mospërdorimin, me kusht që kjo procedurë të zbatohet kur kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare është bazuar mbi një markë tregtare të mëparshme.

2. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon njoftim pronarit të markës së mëparshme që të depozitojë observimet e tij brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Kur pronari i markës së mëparshme nuk depoziton observimet e tij për të provuar përdorimin real dhe efektiv ose nuk paraqet arsye të justifikuara për mospërdorimin e markës së mëparshme, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve merr vendim për refuzimin e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës.

4. Kur pronari i markës së mëparshme depoziton observimet e tij për të provuar përdorimin real dhe efektiv të markës së mëparshme brenda afatit të caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon një kopje të observeve kërkuarit, si dhe e fton atë që të depozitojë observimet e tij brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve vendos për

deklarimin ose jo të pavlefshmërisë së markës në bazë të fakteve, provave dhe observeve.

6. Kur marka e mëparshme është përdorur vetëm për një pjesë të mallrave ose shërbimeve për të cilat është regjistruar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë, konsideron se marka është regjistruar vetëm për atë pjesë të mallrave ose shërbimeve.

Neni 68

Pranimi në heshtje

1. Pronari i markës së mëparshme nuk ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pavlefshmërisë së markës së mëvonshme ose të kundërshtojë përdorimin e markës së mëvonshme në lidhje me mallrat ose shërbimet për të cilat kjo është përdorur, nëse ai ka pranuar në heshtje përdorimin e markës së mëvonshme për një periudhë të pandërprerë 5-vjeçare. Pranimi në heshtje nuk përfshin rastet kur kërkesa për regjistrimin e markës së mëvonshme është bërë në keqbesim.

2. Në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni pronari i markës tregtare të mëvonshme nuk ka gjithsesi të drejtë që të kundërshtojë përdorimin e markës së mëparshme.

Neni 69

Shqyrtimi i kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare

1. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri, brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare, shqyrton nëse kërkesa është depozituar në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 65 ose 66, të këtij ligji.

2. Kur kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë së markës për shkaqe relative nuk është depozituar sipas pikës 1 të nenit 66 të këtij ligji, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për refuzimin e kërkesës.

3. Kur nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në pikën 3, të nenit 65, si dhe në pikat 3 dhe 4, të nenit 66 të këtij ligji, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.



4. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për refuzimin e kërkesës.

5. Kur plotësohen kushtet për të filluar procedurën e deklarimit të pavlefshmërisë së markës, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 1 muaji i dërgon një kopje të kërkesës pronarit të markës, objekt i kërkesës për pavlefshmëri, si dhe e fton atë që të depozitojë observimet e tij brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Nëse pronari i markës, objekt i kërkesës për pavlefshmëri, nuk depoziton observimet brenda afatit të caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri brenda 2 muajve vendos për deklarimin e pavlefshmërisë së markës në lidhje me ato mallra ose shërbime për të cilat është filluar procedura për deklarimin e pavlefshmërisë.

7. Nëse pronari i markës, objekt i kërkesës për pavlefshmëri, i depoziton observimet brenda afatit të caktuar, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri shqyrton bazueshmërinë e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë.

8. Afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk shtyhet.

9. Përpara marrjes së vendimit, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Në seancën dëgjimore nuk paraqiten prova të reja.

Neni 70

Vendimi mbi bazueshmërinë e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare

1. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për refuzimin e kërkesës nëse çmon se kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë është e pabazuar.

2. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri vendos për deklarimin e pavlefshmërisë së markës tregtare në lidhje me disa ose të gjitha mallrat dhe shërbimet kur çmon se kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë është e bazuar.

3. Kur marka tregtare deklarohet e pavlefshme, ajo konsiderohet se nuk sjell efekte që nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrim të markës.

4. DPPI-ja boton në buletin dhe regjistron në regjister deklarimin e pavlefshmërisë së markës pasi të merret vendimi për deklarimin e pavlefshmërisë së markës. Vendimi i arsyetuar i Dhomës për

Shfuqizim dhe Pavlefshmëri u komunikohet palëve brenda 2 muajve nga data e marrjes së vendimit.

5. Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri nuk e deklaron të pavlefshme markën, por vendos për transferimin e pronësisë së markës në emër të pronarit të markës kur:

a) çmohet se kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë së markës së regjistruar në emër të përfaqësuesit është e bazuar; dhe

b) kërkohet që marka tregtare të transferohet në përputhje me pikën 1, të nenit 23, të këtij ligji.

Transferimi i pronësisë së markës botohet në buletin dhe regjistrohet në regjister pasi Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri merr vendimin për transferimin e pronësisë së markës në emër të pronarit të markës tregtare.

6. Kundër vendimit të Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

PJESA VII

DISPOZITA TË VEÇANTA MBI MARKAT KOLEKTIVE DHE CERTIFIKUESE

KREU I

MARKAT KOLEKTIVE

Neni 71

Markat kolektive

1. Marka kolektive është marka që përcaktohet si e tillë në kërkesën për regjistrim të markës tregtare dhe që mundëson dallimin e mallrave dhe shërbimeve të anëtarëve të shoqatës që është pronare e markës tregtare nga mallrat dhe shërbimet e ndërmarrjeve të tjera.

2. Kërkesa për regjistrim marke kolektive depozitohet nga shoqatat e prodhuesve, ofruesve të shërbimeve ose tregtarëve sipas legjislacionit në fuqi, të cilët kanë të drejtë të fitojnë të drejta e të marrin përsipër detyrime të të gjitha llojeve dhe që në emrin e tyre të lidhin kontrata, të kryejnë veprime juridike, si dhe të padisin dhe të paditen. Kërkesa për regjistrim marke kolektive depozitohet edhe nga persona juridikë që rregullohen nga e drejta publike.

3. Shenjat ose treguesit që mund të shërbejnë në tregti për të përcaktuar origjinën gjeografike të mallrave dhe shërbimeve mund të mbrohen si



markë kolektive, me përjashtim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 8, të këtij ligji.

4. Marka kolektive nuk i jep të drejtë pronarit që të ndalojë palët e treta të përdorin në treg shenjat ose treguesit që përcaktohen në pikën 3 të këtij neni, me kusht që ato t'i përdorin shenjat ose treguesit në përputhje me praktikat e drejta dhe të ndershme në fushat e industrisë e të tregtisë, sidomos ndaj palëve të treta që kanë të drejtë të përdorin një emër gjeografik.

5. Dispozitat e tjera të këtij ligji zbatohen edhe për markat kolektive, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kre të ligjit.

Neni 72

Rregullorja e përdorimit të markës kolektive

1. Kërkuesi depoziton rregulloren e përdorimit të markës kolektive në DPPI, brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për markë kolektive.

2. Rregullorja e përdorimit përcakton personat e autorizuar për përdorimin e markës, kushtet e anëtarësimit të shoqatës dhe, sipas rastit, kushtet e përdorimit të markës dhe sanksionet.

Rregullorja e përdorimit të markës kolektive, që përcaktohet në pikat 3 dhe 4, të nenit 71, të këtij ligji, lejon çdo person për t'u bërë anëtar i shoqatës që është pronare e markës, me kusht që:

a) mallrat dhe shërbimet e tij të kenë prejardhjen nga zona gjeografike përkatëse;

b) të plotësohen kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e përdorimit.

3. Nëse rregullorja e përdorimit nuk përmban informacionin e kërkuar në pikën 2, të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuesit që të plotësojë të metat ose mangësitë, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Elementet e rregullores së përdorimit dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Refuzimi i kërkesës për markë kolektive

1. Përveç shkaqeve për refuzimin e kërkesës për markë, që përcaktohen në nenet 39 dhe 42, të këtij ligji, kërkesa për markë kolektive refuzohet kur:

a) kërkesa nuk është në përputhje me parashikimet e neneve 71 dhe 72, të këtij ligji; ose

b) rregullorja e përdorimit të markës kolektive është në kundërshtim me rendin publik ose me mbrojtjen e vlerave morale.

2. Kërkesa për markë kolektive refuzohet edhe nëse ekziston mundësia që publiku të keqorientohet për karakterin ose kuptimin e markës dhe, në veçanti, kur ka mundësi të konsiderohet e ndryshme nga marka kolektive.

3. Kërkesa për markë kolektive nuk refuzohet nëse kërkuesi plotëson kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, si rezultat i ndryshimit të rregullores së përdorimit.

Neni 74

Observime nga palë të treta në lidhje me kërkesën për markë kolektive

Kur observimet me shkrim ndaj kërkesës për markë kolektive depozitohen në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, ato mund të bazohen edhe mbi shkaqet e veçanta për refuzimin e kërkesës për markë kolektive që parashikohen në nenin 73 të këtij ligji.

Neni 75

Përdorimi i markës kolektive

Përdorimi i markës kolektive nga çdo person që ka të drejtë për ta përdorur atë duhet të përmbushë edhe kërkesat e tjera në lidhje me përdorimin e markave tregtare, sipas këtij ligji.

Neni 76

Ndryshimet në rregulloren e përdorimit të markës kolektive

1. Pronari i markës kolektive depoziton në DPPI çdo ndryshim në rregulloren e përdorimit.

2. Ndryshimet në rregulloren e përdorimit nuk regjistrohen në regjistër nëse ndryshimet nuk plotësojnë kërkesat e nenit 72 të këtij ligji, ose nëse përfshijnë ndonjë prej shkaqeve për refuzim që përcaktohen në nenin 73 të këtij ligji.

3. Observimet në përputhje me nenin 74 të këtij ligji mund të depozitohen edhe ndaj ndryshimeve në rregulloren e përdorimit.

4. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, ndryshimet në rregulloren e përdorimit hyjnë në fuqi nga data e regjistrimit të ndryshimeve në regjistër.



Neni 77

Personat që kanë të drejtë të veprojnë kundër shkeljes së të drejtave

1. Dispozitat e parashikuara në pikat 4 dhe 5, të nenit 27 të këtij ligji në lidhje me të drejtat e të licencuarve zbatohen për çdo person që ka të drejtë të përdorë markën kolektive.

2. Pronari i markës kolektive ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit në emër të personave që kanë të drejtë të përdorin markën kur ato kanë pësuar dëm si pasojë e përdorimit të paautorizuar të markës kolektive.

Neni 78

Shkaqet për shfuqizimin e markës kolektive

Përveç shkaqeve për shfuqizim, të parashikuara në nenin 62 të këtij ligji, të drejtat e pronarit të markës kolektive shfuqizohen në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose një padie në procesin e shkeljes së të drejtave nëse:

a) pronari nuk merr hapa të arsyeshëm që të parandalojë përdorimin e markës kolektive në mënyrë të papajtueshme me kushtet e përdorimit të përcaktuara në rregulloren e përdorimit, përfshirë ndryshimet në rregulloren e përdorimit që janë regjistruar në DPPI;

b) mënyra në të cilën është përdorur marka nga pronari përbën shkak për keqorientimin e publikut, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 73 të këtij ligji;

c) ndryshimet në rregulloren e përdorimit të markës janë regjistruar në regjister në shkelje të parashikimeve të pikës 2, nenit 76 të këtij ligji, përveçse kur pronari i markës ndryshon rregulloren e përdorimit për t'iu përmbajtur kërkesave.

Neni 79

Shkaqet për pavlefshmërinë e markës kolektive

Përveç shkaqeve për pavlefshmëri, të parashikuara në nenet 65 dhe 66 të këtij ligji, marka kolektive e regjistruar në shkelje të parashikimeve të nenit 73 të këtij ligji, deklarohet e pavlefshme në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose një kundërpadie në procesin e shkeljes së të drejtave, përveçse kur pronari i markës

ndryshon rregulloren e përdorimit për t'iu përmbajtur kërkesave.

KREU II

MARKAT CERTIFIKUESE

Neni 80

Markat certifikuese

1. Marka certifikuese është marka që përcaktohet si e tillë në kërkesën për regjistrim të markës dhe që mundëson dallimin e mallrave dhe shërbimeve, të cilat janë të certifikuara nga pronari i markës në lidhje me materialin, mënyrën e prodhimit të mallrave ose ofrimit të shërbimeve, cilësinë, saktësinë apo karakteristika të tjera nga mallrat ose shërbimet, të cilat nuk janë certifikuara në këtë mënyrë.

2. Çdo person fizik ose juridik, duke përfshirë institucionet, autoritetet dhe organet e rregulluara nga e drejta publike, mund të depozitojë një kërkesë për regjistrimin e markës certifikuese me kusht që ky person të mos ushtrojë një aktivitet tregtar që përfshin furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të llojit të certifikuar në përputhje me pikën 1.

3. Dispozitat e tjera të këtij ligji zbatohen edhe për markat certifikuese, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë kre të ligjit.

Neni 81

Rregullorja e përdorimit e markës certifikuese

1. Rregullorja e përdorimit e markës certifikuese depozitohet në DPPI brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për markë certifikuese.

2. Rregullorja e përdorimit përcakton personat e autorizuar për përdorimin e markës, karakteristikat që certifikohen nga marka, mënyrën që organi certifikues duhet të testojë këto karakteristika dhe të mbikëqyrë përdorimin e markës, si dhe kushtet e përdorimit të markës certifikuese dhe sanksionet.

3. Nëse rregullorja e përdorimit nuk përmban informacionin e kërkuar në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuar që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Elementet e rregullores së përdorimit dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 82

Refuzimi i kërkesës për markë certifikuese

1. Përveç shkaqeve për refuzimin e kërkesës për markë që përcaktohen në nenet 39 dhe 42, të këtij ligji, kërkesa për markë certifikuese refuzohet kur:

a) nuk plotësohen kërkesat e neneve 80 dhe 81 të këtij ligji; ose

b) rregullorja e përdorimit e markës certifikuese është në kundërshtim me rendin publik ose me mbrojtjen e vlerave morale.

2. Kërkesa për markë certifikuese refuzohet edhe nëse ekziston mundësia që publiku të keqorientohet për karakterin ose kuptimin e markës dhe, në veçanti, kur ka mundësi të konsiderohet e ndryshme nga marka certifikuese.

3. Kërkesa për markë certifikuese nuk refuzohet nëse kërkuesi plotëson kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, si rezultat i ndryshimit të rregullores së përdorimit.

Neni 83

Observime nga palë të treta në lidhje me kërkesën për markë certifikuese

Kur observimet me shkrim ndaj kërkesës për markë certifikuese depozitohen në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, ato mund të bazohen edhe mbi shkaqet e veçanta për refuzimin e kërkesës për markë certifikuese që parashikohen në nenin 82 të këtij ligji.

Neni 84

Përdorimi i markës certifikuese

Përdorimi i markës certifikuese nga çdo person që ka të drejtë për ta përdorur atë duhet të përmbushë edhe kërkesat e tjera në lidhje me përdorimin e markave tregtare, sipas këtij ligji.

Neni 85

Ndryshimet e rregullores së përdorimit të markës certifikuese

1. Pronari i markës certifikuese depoziton në DPPI çdo ndryshim në rregulloren e përdorimit.

2. Ndryshimet në rregulloren e përdorimit nuk regjistrohen në regjistër nëse ndryshimet nuk plotësojnë kërkesat e nenit 81 të këtij ligji, ose nëse

përfshijnë ndonjë prej shkaqeve për refuzim që përcaktohen në nenin 82 të këtij ligji.

3. Observimet e bëra në përputhje me nenin 83 të këtij ligji mund të depozitohen edhe ndaj ndryshimeve në rregulloren e përdorimit.

4. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, ndryshimet në rregulloren e përdorimit hyjnë në fuqi nga data e regjistrimit të ndryshimeve në regjistër.

Neni 86

Transferimi i markës certifikuese

Me përjashtim të pikës 1, të nenit 21, të këtij ligji, marka certifikuese mund të transferohet tek një person që i plotëson kërkesat e parashikuara në pikën 2, të nenit 80, të këtij ligji.

Neni 87

Personat që kanë të drejtë të veprojnë kundër shkeljes së të drejtave

1. Padia kundër shkeljes së të drejtave mund të paraqitet vetëm nga pronari i markës certifikuese ose çdo person tjetër i autorizuar me shkrim nga ai për këtë qëllim.

2. Pronari i markës certifikuese ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit në emër të personave që kanë të drejtë të përdorin markën kur ato kanë pësuar dëm si pasojë e përdorimit të paautorizuar të markës certifikuese.

Neni 88

Shkaqet për shfuqizimin e markës certifikuese

Përveç shkaqeve për shfuqizim, të parashikuara në nenin 62 të këtij ligji, të drejtat e pronarit të markës certifikuese shfuqizohen në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose një padie në procesin e shkeljes së të drejtave nëse:

a) pronari nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 80, të këtij ligji;

b) pronari nuk merr hapa të arsyeshëm që të parandalojë përdorimin e markës certifikuese në mënyrë të papajtueshme me kushtet e përdorimit, të përcaktuara në rregulloren e përdorimit, përfshirë ndryshimet në rregulloren e përdorimit që janë regjistruar në DPPI;



c) mënyra në të cilën është përdorur marka nga pronari përbën shkak për keqorientimin e publikut, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 82, të këtij ligji;

ç) ndryshimet në rregulloren e përdorimit të markës janë regjistruar në regjistër në shkelje të parashikimeve të pikës 2, të nenit 85, të këtij ligji, përveçse kur pronari i markës ndryshon rregulloren e përdorimit për t'iu përmbajtur kërkesave.

Neni 89

Shkaqet për pavlefshmërinë e markës certifikuese

Përveç shkaqeve për pavlefshmëri, të parashikuara në nenet 65 dhe 66, të këtij ligji, marka certifikuese e regjistruar në shkelje të parashikimeve të nenit 82 të këtij ligji, deklarohet e pavlefshme në bazë të një kërkesë drejtuar Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose një padie në procesin e shkeljes së të drejtave, përveçse kur pronari i markës ndryshon rregulloren e përdorimit për t'iu përmbajtur kërkesave të nenit 82 të këtij ligji.

PJESA VIII

REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR I MARKËS TREGTARE SIPAS SISTEMIT TË MADRIDIT

Neni 90

Zbatimi i depozitave

Përveçse kur parashikohet ndryshe, ky ligj zbatohet për:

a) regjistrimet ndërkombëtare të markave bazuar në një kërkesë ose regjistrim marke kombëtare; dhe

b) regjistrimet ndërkombëtare të markave të regjistruara në regjistrin ndërkombëtar të mbajtur nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale që përcaktojnë Republikën e Shqipërisë në listën e shteteve për të cilat mbrohet marka.

Neni 91

Depozitimi i kërkesës për regjistrim ndërkombëtar të markës

1. Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të markës bazuar në një kërkesë ose regjistrim kombëtar të markës, sipas nenit 3 të Protokollit të Madridit, depozitohet në DPPI.

2. Përmbajtja dhe dokumentet bashkëlidhur kërkesës për regjistrim ndërkombëtar depozitohen në përputhje me Protokollin e Madridit dhe rregulloret e protokollit.

Neni 92

Ekzaminimi i saktësisë së kërkesës për regjistrim ndërkombëtar të markës

1. Nëse kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të markës plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji, DPPI-ja ia përcjell kërkesën Zyres Ndërkombëtare në OBPI.

2. Nëse kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të markës nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse kërkuari nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të caktuar, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës për regjistrim ndërkombëtar të markës.

4. Kur kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të markës është në përputhje me kërkesat e përcaktuara, DPPI-ja miraton, shënon datën e marrjes së kërkesës dhe ia përcjell kërkesën Zyres Ndërkombëtare.

Neni 93

Parregullsitë me kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të markës që plotësohen përpara Zyres Ndërkombëtare

1. DPPI-ja, sipas rastit, i përgjigjet Zyres Ndërkombëtare për çdo parregullsi të nxjerrë sipas rregullave 11 deri në 13 të rregulloreve të protokollit, brenda afatit kohor të caktuar nga Zyra Ndërkombëtare. Kur është e nevojshme, DPPI-ja konsultohet me kërkuarin.

2. Kur parregullsitë duhet të plotësohen nga Zyra e Origjinës, DPPI-ja konsultohet me kërkuarin dhe i cakton një afat kohor prej 2 muajsh që të sigurohet informacioni i kërkuar. Kur informacioni është marrë brenda afatit kohor, DPPI-ja e përcjell informacionin te Zyra Ndërkombëtare.



Neni 94

Pushimi i efekteve të kërkesës ose regjistrimit bazë

1. Kur kërkesa bazë për markë, regjistrimi që rezulton nga kjo kërkesë ose regjistrimi bazë nuk sjellin më efekte sipas nenit 6 të protokollit, DPPI-ja informon Zyrën Ndërkombëtare, siç kërkohej sipas rregullit 22 të rregulloreve të protokollit, dhe kërkon çregjistrimin e regjistrimit ndërkombëtar.

2. Kur faktet dhe vendimet e lidhura me kërkesën ose regjistrimin bazë sjellin efekte të regjistrimit ndërkombëtar vetëm në lidhje me një pjesë të mallrave dhe shërbimeve, DPPI-ja shënon:

a) mallrat dhe shërbimet për të cilat kanë ardhur efekte nga faktet dhe vendimet; ose

b) mallrat dhe shërbimet për të cilat nuk kanë ardhur efekte nga faktet dhe vendimet.

Neni 95

Depozitimi i kërkesës për shtrirje territoriale dhe regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin ndërkombëtar

1. Kërkesa për shtrirje territoriale i bërë në vijim të regjistrimit ndërkombëtar dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar mund të depozitohen në Zyrën Ndërkombëtare nëpërmjet DPPI-së, nëse DPPI-ja, bazuar në dispozitat e Protokollit të Madridit, është kompetente të përcjellë këto kërkesa në Zyrën Ndërkombëtare.

2. Përmbajtja e kërkesës për shtrirje territoriale dhe kërkesës për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar dhe dokumentet bashkëlidhur tij depozitohen në përputhje me Protokollin e Madridit dhe rregulloret e protokollit.

3. Nëse kërkesa për shtrirje territoriale ose kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar plotëson kërkesat e caktuara në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja ia përcjell kërkesën Zyres Ndërkombëtare.

4. Nëse kërkesa për shtrirje territoriale ose kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Ndërkombëtar nuk është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse këto të meta ose mangësi nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, DPPI-ja vendos për refuzimin e kërkesës.

Neni 96

Tarifat për kërkesat në lidhje me markat ndërkombëtare

1. Çdo tarifë për përcjelljen e një kërkesë të lidhur me markat ndërkombëtare në Zyrën Ndërkombëtare paguhet drejtpërdrejt për DPPI-në, në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore përkatëse.

2. Çdo tarifë e pagueshme për Zyrën Ndërkombëtare, sipas Protokollit të Madridit, paguhet drejtpërdrejt në Zyrën Ndërkombëtare.

Neni 97

Efektet e regjistrimeve ndërkombëtare që shtrihen në Republikën e Shqipërisë

1. Regjistrimi ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë sjell të njëjtat efekte si kërkesa kombëtare për markë, duke filluar nga data e regjistrimit të tij sipas paragrafit 4, të nenit 3, të Protokollit të Madridit ose nga data e shtrirjes së mëvonshme në Republikën e Shqipërisë sipas paragrafit 2, të nenit 3ter të Protokollit të Madridit.

2. Nëse DPPI-ja nuk ka njoftuar asnjë refuzim në Zyrën Ndërkombëtare, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2/“a”, të nenit 5 të Protokollit të Madridit ose nëse ndonjë refuzim i tillë është tërhequr, regjistrimi ndërkombëtar i markës sjell të njëjtat efekte si regjistrimi kombëtar i markës, duke filluar nga data e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Data e depozitimit është data e regjistrimit ndërkombëtar kur Republika e Shqipërisë është përcaktuar për mbrojtje në regjistrimin ndërkombëtar ose data e shtrirjes së mëvonshme kur Republika e Shqipërisë është përcaktuar më vonë për mbrojtje në regjistrimin ndërkombëtar.

4. Treguesi i mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në regjistrimin ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë nuk përbën detyrim për DPPI-në, në lidhje me përcaktimin e objektit të mbrojtjes së markës.



Neni 98

Ekzaminimi i shkaqeve absolute për refuzim dhe specifikimi i listës së mallrave dhe shërbimeve në regjistrimin ndërkombëtar

1. Regjistrimet ndërkombëtare që shtrihen në Republikën e Shqipërisë janë objekt ekzaminimi nga DPPI-ja për sa u përket shkaqeve absolute për refuzim dhe specifikimit të listës së mallrave dhe shërbimeve në të njëjtën mënyrë si kërkesat kombëtare për markë.

2. Nëse regjistrimi ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë konsiderohet se është i papranueshëm për mbrojtje për të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ai është regjistruar në Zyrën Ndërkombëtare, DPPI-ja, përpara përfundimit të periudhës së zbatueshme të refuzimit të përcaktuar në paragrafin 2/“a”, të nenit 5 të Protokollit të Madridit, i dërgon me nismën e saj Zyres Ndërkombëtare njoftimin për refuzim të përkohshëm, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, të nenit 5 të Protokollit të Madridit.

3. Çdo njoftim për refuzim të përkohshëm të regjistrimit ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë duhet t'i njoftohet Zyres Ndërkombëtare së bashku me një deklaratë që përmban të gjitha arsyet e lidhura me njoftimin. Ky njoftim duhet bërë përpara përfundimit të afatit kohor të zbatueshëm, i cili llogaritet duke filluar nga data në të cilën njoftimi për shtrirje i është dërguar Republikës së Shqipërisë nga Zyra Ndërkombëtare.

4. Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar mund t'i përgjigjet njoftimit për refuzim të përkohshëm duke depozituar observimet e tij mbi arsyet e refuzimit brenda 4 muajve nga data e marrjes së njoftimit të dërguar nga Zyra Ndërkombëtare. Observimet duhet të depozitohen me shkrim nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për markat tregtare që janë licencuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

5. DPPI-ja vendos për refuzimin e mbrojtjes për të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve të regjistrimit ndërkombëtar dhe e njofton vendimin përfundimtar në Zyrën Ndërkombëtare kur:

a) mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar nuk depoziton observimet e tij ndaj njoftimit për refuzim të përkohshëm brenda afatit të caktuar; ose

b) regjistrimi ndërkombëtar konsiderohet se nuk është i pranueshëm për t'u mbrojtur në Republikën e Shqipërisë.

6. DPPI-ja vendos për pranimin e mbrojtjes së regjistrimit ndërkombëtar dhe e njofton këtë vendim përfundimtar në Zyrën Ndërkombëtare kur:

a) mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar depoziton observimet e tij ndaj njoftimit për refuzim të përkohshëm brenda afatit të caktuar;

b) regjistrimi ndërkombëtar konsiderohet se është i pranueshëm për t'u mbrojtur në Republikën e Shqipërisë; dhe

c) nuk depozitohet asnjë kundërshtim ndaj regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 99

Markat tregtare kolektive dhe certifikuese të regjistrimeve ndërkombëtare

1. Kur regjistrimi ndërkombëtar bazohet në një kërkesë për markë ose regjistrim bazë që lidhet me një markë kolektive ose certifikuese, regjistrimi ndërkombëtar që përfshin Republikën e Shqipërisë trajtohet në të njëjtën mënyrë si markat kolektive ose certifikuese kombëtare.

2. Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar të markës kolektive ose certifikuese depoziton rregulloret e përdorimit të markës kolektive ose certifikuese drejtpërdrejt në DPPI. Depozitimi i rregulloreve të përdorimit u nënshtrohet rregullave të parashikuara përkatësisht në nenet 72 dhe 81, të këtij ligji.

3. Nëse rregulloret e përdorimit të markës kolektive ose certifikuese nuk janë depozituar drejtpërdrejt në DPPI, DPPI-ja lëshon me nismën e saj një njoftim për refuzim të përkohshëm.

Neni 100

Kundërshtimi i regjistrimit ndërkombëtar të markës tregtare

1. Afati kohor për depozitimin e kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar të markës tregtare është 3 muaj nga data e botimit të regjistrimit ndërkombëtar të markës në Gazetën Zyrtare të Zyres Ndërkombëtare.

2. Të dhëna të detajuara dhe dokumentet bashkëlidhur kërkesës për kundërshtim parashikohen në rregulloret e protokollit.



Neni 101

Procedura e kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar

1. Kur depozitohet një kundërshtim ndaj regjistrimit ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë, DPPI-ja, përpara përfundimit të afatit të periudhës së zbatueshme të refuzimit sipas paragrafit 2/“a”, të nenit 5 të protokollit, njofton Zyrën Ndërkombëtare mbi këtë fakt. Njoftimi i Zyrës Ndërkombëtare nga DPPI-ja dërgohet si njoftim për refuzimin e përkohshëm bazuar mbi një kundërshtim, sipas kërkesave të Protokollit të Madridit dhe rregulloreve të protokollit.

2. Çdo refuzim i përkohshëm i regjistrimit ndërkombëtar, që shtrihet në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i njoftohet Zyrës Ndërkombëtare, së bashku me një deklaratë që përmban të gjitha shkaqet e kundërshtimit. Ky njoftim duhet bërë përpara përfundimit të afatit kohor të zbatueshëm, i cili llogaritet duke filluar nga data në të cilën njoftimi për shtrirje i është dërguar Republikës së Shqipërisë nga Zyra Ndërkombëtare.

3. Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar mund t'i përgjigjet njoftimit për refuzim të përkohshëm, duke depozituar observimet e tij mbi kundërshtimin brenda 4 muajve nga data e marrjes së njoftimit të dërguar nga Zyra Ndërkombëtare. Observimet duhet të depozitohen me shkrim nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për markat tregtare që janë licencuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

4. Afatet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni nuk mund të zgjaten.

5. Kur mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikat 2 ose 3, të këtij neni, brenda afateve të caktuara, DPPI-ja vendos automatikisht për pranimin e kundërshtimit dhe refuzimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës në lidhje me një pjesë ose të gjitha mallrat dhe shërbimet.

6. Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar gëzon të njëjtat të drejta sikur marka të ishte depozituar drejtpërdrejt në DPPI. Kur mbajtësi paraqet observimet e tij brenda afateve kohore të caktuara, DPPI-ja ndjek të njëjtën procedurë kundërshtimi sikur marka të ishte depozituar drejtpërdrejt në DPPI.

Neni 102

Deklarata për dhënien e mbrojtjes ose refuzimi përfundimtar i mbrojtjes së regjistrimit ndërkombëtar të markës

1. DPPI-ja i dërgon Zyrës Ndërkombëtare njoftimin ose deklaratën që i jep mbrojtje regjistrimit ndërkombëtar të markës në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve nëse:

a) nuk ka pasur shkaqe për refuzimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës në procedurën e ekzaminimit për shkaqe absolute dhe për specifikimin e listës së mallrave ose shërbimeve;

b) nuk ka pasur shkaqe për refuzimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës në procedurën e kundërshtimit të regjistrimit ndërkombëtar të markës; ose

c) procedurat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1 të këtij neni, kanë përfunduar me vendim duke i dhënë mbrojtje markës në lidhje me të gjithë ose një pjesë të mallrave ose shërbimeve.

2. DPPI-ja i dërgon Zyrës Ndërkombëtare njoftimin ose deklaratën që refuzon mbrojtjen e regjistrimit ndërkombëtar të markës në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve nëse:

a) procedurat e ekzaminimit për shkaqet absolute dhe për specifikimin e listës së mallrave ose shërbimeve kanë përfunduar me vendim; ose

b) procedurat e kundërshtimit të regjistrimit ndërkombëtar të markës kanë përfunduar me vendim.

3. DPPI-ja i dërgon Zyrës Ndërkombëtare një njoftim ose deklaratë të mëtejshme që tregon statusin e markës në lidhje me të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve nëse:

a) njoftimi për refuzim të përkohshëm nuk është dërguar nga DPPI-ja brenda afatit kohor të zbatueshëm sipas paragrafit 2/“a”, të nenit 5 të Protokollit të Madridit; ose

b) DPPI-ja, Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri ose Bordi i Apelit ka marrë një vendim të mëtejshëm që sjell efekte të mbrojtja e markës në Republikën e Shqipërisë në vijim të dërgimit të një njoftimi ose deklarate në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Pa cenuar rregullin 19, të Protokollit, në lidhje me Marrëveshjen e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave dhe nenin 104 të këtij ligji,



DPPI-ja i dërgon Zyrës Ndërkombëtare njoftimin ose deklaratën e mëtejshme për aq sa është në dijeni të këtij vendimi.

Neni 103 **Transformimi**

1. Kërkesa për transformimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës në një kërkesë për markë kombëtare mund të depozitohet në DPPI brenda tre muajve nga data në të cilën regjistrimi ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë është çregjistruar nga Zyra e Origjinës, në përputhje me nenin 6(4) të Protokollit.

Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar mund të kërkojë transformimin për të gjithë ose një pjesë të mallrave dhe shërbimeve të listuara në regjistrimin ndërkombëtar.

Kur përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, DPPI-ja ndjek procedurat e regjistrimit të markës në të njëjtën mënyrë me procedurat e kërkesës së depozituar drejtpërdrejt në DPPI.

2. Kërkesa për transformim përmban:

a) deklaratën që kërkesa është depozituar nëpërmjet transformimit;

b) numrin ndërkombëtar të regjistrimit të markës që është çregjistruar;

c) datën e regjistrimit ndërkombëtar ose datën e shtrirjes së mëvonshme, sipas rastit;

ç) datën në të cilën është çregjistruar marka ndërkombëtare;

d) datën e çdo prioriteti të regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar, sipas rastit;

dh) pagesën e tarifës zyrtare përkatëse për transformimin;

e) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi.

3. Marka, që është objekt i regjistrimit ndërkombëtar, regjistrohet nga DPPI-ja kur:

a) marka ka fituar mbrojtjen në Republikën e Shqipërisë në ose përpara datës në të cilën është çregjistruar marka ndërkombëtare; dhe

b) janë përmbushur të gjitha kërkesat që lidhen me kërkesën për transformim.

Marka që rezulton nga transformimi, sipas rastit, mban të njëjtën datë regjistrimi me datën e regjistrimit ndërkombëtar ose datën e shtrirjes së mëvonshme të markës ndërkombëtare të çregjistruar, si dhe të drejtën për prioritet.

4. Procedurat e nisura për regjistrimin e markës ndërkombëtare në ose përpara datës së depozitimit të kërkesës për transformim konsiderohen se janë ndërmarrë për qëllime të kërkesës për regjistrim marke që rezulton nga transformimi nëse marka nuk ka fituar mbrojtjen në Republikën e Shqipërisë në ose përpara datës në të cilën është çregjistruar marka ndërkombëtare.

Data e depozitimit të kërkesës për regjistrim marke, që rezulton nga transformimi, është data e regjistrimit ndërkombëtar ose data e shtrirjes së mëvonshme, sipas rastit.

Neni 104 **Shfuqizimi dhe deklarimi i pavlefshmërisë i regjistrimit ndërkombëtar të markës**

1. Regjistrimi ndërkombëtar i markës, që shtrihet në Republikën e Shqipërisë, mund të deklarohet i pavlefshëm në përputhje me këtë ligj.

2. Kërkesa për pavlefshmërinë e regjistrimit ndërkombëtar të markës që shtrihet në Republikën e Shqipërisë u nënshtrohet të njëjtave rregulla dhe procedura, të parashikuara në lidhje me kërkesën për shfuqizim në nenet 62 deri në 64 të këtij ligji ose kërkesën për deklarim të pavlefshmërisë në nenet 65 deri në 70 të këtij ligji, sipas rastit.

3. Në procedurat lidhur me kërkesën për shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar të markës, DPPI-ja i dërgon njoftim mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar të markës për kërkesën për shfuqizim ose deklarim pavlefshmërie të markës, si dhe e fton atë që të caktojë një përfaqësues të autorizuar për markën tregtare brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Përfaqësuesi i autorizuar duhet të depozitojë prokurën ose aktin e përfaqësimit në DPPI.

4. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk shtyhet.

5. Kur plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon një kopje të kërkesës përfaqësuesit të autorizuar dhe e fton atë të paraqesë observimet e tij brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Kur mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikat 3 dhe 5, të këtij neni, brenda afateve të caktuara, DPPI-ja vendos automatikisht për pranimin e kërkesës për shfuqizim ose deklarimin e pavlefshmërisë së



regjistrimit ndërkombëtar të markës në lidhje me një pjesë ose të gjitha mallrat dhe shërbimet.

7. DPPI-ja i dërgon Zyrës Ndërkombëtare njoftimin për shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar të markës pasi ky vendim merr formë të prerë.

8. Njoftimi i mbajtësit të regjistrimit ndërkombëtar të markës lidhur me kërkesën për shfuqizim ose deklarimin e pavlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar të markës i komunikohet Zyrës Ndërkombëtare sipas rregullit 23bis të Protokollit në lidhje me Marrëveshjen e Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave.

Neni 105

Përdorimi i regjistrimit ndërkombëtar të markës

1. Data e regjistrimit ndërkombëtar të markës ose data e shtrirjes së mëvonshme të regjistrimit ndërkombëtar të markës, sipas rastit, konsiderohet si data nga e cila marka ndërkombëtare është vendosur në përdorim real dhe efektiv në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim për të provuar se regjistrimi ndërkombëtar i markës është përdorur.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet me qëllim depozitimin e provave që provojnë përdorimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës në:

- a) procedurën e kundërshtimit të markës;
- b) procedurën e shfuqizimit të markës; dhe
- c) procedurën e deklarimit të pavlefshmërisë së markës.

Neni 106

Zëvendësimi i regjistrimit kombëtar nga regjistrimi ndërkombëtar i markës

1. Mbajtësi i regjistrimit ndërkombëtar të markës mund t'i kërkojë DPPI-së që të shënojë në regjistër se regjistrimi kombëtar i markës zëvendësohet nga regjistrimi ndërkombëtar i markës nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) marka e regjistruar në Republikën e Shqipërisë është njëkohësisht objekt i një regjistrimi ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë;

b) i njëjti person është i regjistruar njëkohësisht si mbajtës i regjistrimit në Republikën e Shqipërisë dhe mbajtës i regjistrimit ndërkombëtar të markës;

c) mallrat dhe shërbimet e listuara në regjistrimin kombëtar janë të listuara edhe në regjistrimin ndërkombëtar që shtrihet në Republikën e Shqipërisë;

ç) shtrirja e regjistrimit ndërkombëtar të markës në Republikën e Shqipërisë ka ndodhur pas datës së regjistrimit kombëtar të markës.

2. Kërkesa sipas pikës 1 të këtij neni depozitohet në DPPI dhe përmban:

- a) formularin përkatës të nënshkruar rregullisht;
- b) autorizimin e përfaqësimit, kur ajo paraqitet nga përfaqësuesi;
- c) pagesën e tarifës përkatëse.

3. Zëvendësimi i regjistrimit kombëtar nga regjistrimi ndërkombëtar konsiderohet automatikisht i kryer kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 4bis të Protokollit të Madridit dhe nuk varet nga ndonjë veprim i mbajtësit të regjistrimit të markës ose DPPI-së.

Data e hyrjes në fuqi e zëvendësimit të regjistrimit kombëtar nga regjistrimi ndërkombëtar është data e regjistrimit ndërkombëtar ose data e shtrirjes së mëvonshme, sipas rastit.

4. DPPI-ja ekzaminon kërkesën nëse është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 4bis të Protokollit të Madridit.

5. DPPI-ja njofton rregullisht Zyrën Ndërkombëtare nëse regjistrimi ndërkombëtar i markës është shënuar në regjistër sipas pikës 1 të këtij neni. Njoftimi i dërguar nga DPPI-ja për Zyrën Ndërkombëtare përmban:

- a) numrin e regjistrimit ndërkombëtar të markës;
- b) mallrat dhe shërbimet me të cilat lidhet zëvendësimi i regjistrimit kombëtar nga regjistrimi ndërkombëtar;

c) datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës së markës kombëtare;

ç) datën dhe numrin e regjistrimit të markës kombëtare;

d) datën e prioritetit të markës kombëtare, nëse ka të tillë; dhe

dh) informacion në lidhje me të drejta të tjera të fituara në bazë të regjistrimit kombëtar të markës.

6. Regjistrimi kombëtar i markës nuk çregjistrohet dhe nuk sjell ndonjë efekt tjetër për shkak të zëvendësimit të tij nga regjistrimi ndërkombëtar i markës apo për shkak se DPPI-ja ka shënuar këtë zëvendësim në regjistër.

7. Kur regjistrimi ndërkombëtar nuk përfshin të gjitha mallrat dhe shërbimet e listuara në regjistrimin



kombëtar të markës, objekti i zëvendësimit kufizohet vetëm në mallrat dhe shërbimet e listuara njëkohësisht në regjistrimin kombëtar dhe regjistrimin ndërkombëtar të markës.

Neni 107

Komunikimi me Zyrën Ndërkombëtare

DPPI-ja komunikon me Zyrën Ndërkombëtare në mënyrën dhe formatin e rënë dakord ndërmjet tyre, përfshirë mjetet elektronike.

PJESA IX

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME PROCEDURAT PËRPARA DPPI-së

Neni 108

Rivendosja në afat e të drejtave

1. Personi, që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke ose pronari i markës tregtare, si dhe çdo palë tjetër në procedurat përpara DPPI-së, mund të kërkojë rivendosjen në afat të të drejtave nëse:

a) ai nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat ndaj DPPI-së për shkaqe objektive, të pavarura nga vullneti i tij; dhe

b) pengesa për respektimin e afatit ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë humbjen e të drejtave, sipas këtij ligji.

2. Kërkesa për rivendosjen në afat të të drejtave depozitohet në DPPI brenda 2 muajve nga data kur janë eliminuar pengesat për respektimin e afatit, por jo më shumë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet depozituar edhe kërkesa për të cilën pala ka humbur afatin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat të të drejtave përmban:

a) formularin e kërkesës për rivendosjen e të drejtave;

b) shkaqet, faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi.

4. DPPI-ja brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës ekzaminon nëse kërkesa

është në përputhje me kërkesat e këtij neni. Kur kërkesa nuk i përmbush elementet formale, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarës që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse kërkuarësi i plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit, DPPI-ja vijon me ekzaminimin e kërkesës dhe i dërgon njoftim kërkuarës për vendimin e marrë. Vendimi mbi kërkesën për rivendosjen në afat të të drejtave botohet në buletin.

6. Kundër vendimit për refuzimin ose rrëzimin e kërkesës për rivendosjen në afat të të drejtave mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

7. Rivendosja në afat e të drejtave nuk zbatohet për:

a) afatet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;

b) afatin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 46, të këtij ligji;

c) afatet e përcaktuara në nenin 109, të këtij ligji; dhe

ç) afatet për ankimin e vendimeve në Bordin e Apelit.

8. Kur pranohet kërkesa për rivendosjen në afat të të drejtave, personi që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke ose pronari i markës nuk mund të bazohet tek të drejtat e rivendosura përkundrajt një pale të tretë që, në mirëbesim, ka hedhur në treg mallra ose ka ofruar shërbime nën një shenjë identike ose të ngjashme me markën e tij, gjatë periudhës ndërmjet humbjes së të drejtave dhe botimit të rivendosjes të të drejtave.

9. Një palë e tretë, e cila mund të përfitojë nga parashikimet e pikës 8 të këtij neni, mund të depozitojë një ankim në Bordin e Apelit kundër vendimit për rivendosjen në afat të të drejtave të personit që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke ose pronarit të markës. Ankimi në Bordin e Apelit duhet depozituar brenda 2 muajve nga data e botimit të vendimit për rivendosjen në afat të të drejtave, përkundrajt pagesës së tarifës përkatëse.

10. Përmbajtja e kërkesës për rivendosje në afat dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 109

Rivendosja në afat për vazhdimin e procedurave

1. Personi, që ka depozituar kërkesën për regjistrim marke, ose pronari i markës tregtare, si dhe çdo palë tjetër në procedurat përpara DPPI-së mund të kërkojë rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave:

a) nëse ai nuk ka arritur të respektojë një afat ndaj DPPI-së; dhe

b) me kusht që veprimi i pakryer të kryhet në momentin e depozitimit të kërkesës për vazhdimin e procedurave.

2. Kërkesa për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave pranohet vetëm në rast se kërkesa depozitohet brenda 2 muajve nga data e përfundimit të afatit të parespektuar. Kërkesa konsiderohet se nuk është depozituar deri në pagesën e tarifës për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave pranë DPPI-së.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave përmban:

a) formularin e kërkesës për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave;

b) shkaqet, faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi.

4. DPPI-ja brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës ekzaminon nëse kërkesa është në përputhje me kërkesat e këtij neni. Kur kërkesa nuk i përmbush elementet formale, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuarit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse kërkuari i plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit, DPPI-ja vijon me ekzaminimin e kërkesës dhe i dërgon njoftim kërkuarit për vendimin e marrë. Vendimi mbi kërkesën për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave botohet në buletin.

6. Kundër vendimit për refuzimin ose rrëzimin e kërkesës për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 45 ditësh nga data e marrjes së vendimit.

7. Ky nen nuk zbatohet për afatet që parashikohen në nenin 34, pikën 1, të nenit 36, pikën 1, të nenit 38, pikën 1, të nenit 41, pikën 1, të nenit 46, pikën 3, të nenit 57, pikën 2, të nenit 108, pikën 2, të këtij neni dhe për afatet për ankimin e vendimeve në Bordin e Apelit.

8. Kur pranohet kërkesa për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave, pasojat e mosrespektimit të afatit konsiderohen se nuk kanë ardhur.

Nëse vendimi i DPPI-së është marrë në periudhën ndërmjet përfundimit të afatit që nuk është respektuar dhe datës së depozitimit të kërkesës për rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave, DPPI-ja rishikon vendimin e marrë dhe mund të marrë një vendim të ndryshuar kur veprimi i kryer është në vetvete i mjaftueshëm.

Nëse DPPI-ja, pas rishikimit të vendimit, arrin në përfundimin se vendimi fillestar nuk është i nevojshëm të ndryshohet, ajo e konfirmon këtë vendim me shkrim.

9. Përmbajtja e kërkesës për rivendosje në afat për vazhdimin e procedurave dhe dokumentet bashkëlidhur tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 110

Ndërprerja e procedurave

1. Procedurat përpara DPPI-së ndërpriten:

a) në rast të vdekjes ose mungesës së zotësisë për të vepruar të kërkuarit ose pronarit të markës;

b) në rast të vdekjes ose mungesës së zotësisë për të vepruar të personit të autorizuar për të vepruar në emër të kërkuarit ose pronarit të markës.

2. Procedurat përpara DPPI-së rifillojnë menjëherë sapo të caktohet identiteti i personit të autorizuar për të vazhduar procedurën.

3. Procedurat, përmbajtja e kërkesës për ndërprerjen dhe rifillimin e procedurave dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 111

Tarifat për kërkesat dhe veprimet e kryera pranë DPPI-së

1. Çdo kërkesë dhe veprim për markat tregtare në DPPI, me përjashtim të rasteve të veçanta, të parashikuara në këtë ligj, tarifohen.



2. Tarifat për çdo kërkesë dhe veprim për markat tregtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 112
Certifikata e prioritetit

1. Me kërkesë të kërkuarit ose pronarit të markës, si dhe pas pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon certifikatën e prioritetit të markës.

2. Përmbajtja e certifikatës së prioritetit të markës dhe procedura për lëshimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 113
Regjistri i objekteve të pronësisë industriale për markat tregtare

1. DPPI-ja në bazën e të dhënave shtetërore për Sistemin e Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI) mban dhe administron edhe të dhënat e mëposhtme në lidhje me kërkesat dhe regjistrimet e markave tregtare kombëtare:

- a) të dhënat parësore, si:
 - i. data e depozitimit të kërkesës;
 - ii. numri i kërkesës;
 - iii. data e publikimit të kërkesës;
 - iv. përfaqësimi i markës e lloji i saj dhe, sipas rastit, përshkrimi i markës;
 - v. lista e mallrave dhe shërbimeve të kërkesës;
 - vi. të dhënat e prioritetit të pretenduar sipas nenit 36 të këtij ligji;
 - vii. të dhënat e prioritetit të pretenduar nga ekspozita sipas nenit 38 të këtij ligji;
 - viii. deklarata që marka është bërë dalluese si pasojë e përdorimit të saj, sipas pikës 2, të nenit 8, të këtij ligji;
 - ix. tregues se marka është markë kolektive;
 - x. tregues se marka është markë certifikuese;
 - xi. data e regjistrimit të markës dhe numri i regjistrimit;
 - xii. të dhënat e regjistrimit ndërkombëtar të markës që shtrihet në Republikën e Shqipërisë, e cila është transformuar në një kërkesë kombëtare për markë sipas nenit 103 të këtij ligji.
- b) të dhënat dytësore, si:
 - i. emri dhe adresa e kërkuarit;
 - ii. emri dhe adresa e përfaqësuesit të kërkuarit.

2. SAPI mban dhe administron edhe shënimet e mëposhtme në lidhje me markat tregtare, së bashku me datën e tyre të regjistrimit:

- a) të dhëna parësore, si:
 - i. modifikimet dhe ndryshimet e lidhura me markën sipas neneve 58 dhe 59, të këtij ligji, si dhe korrigjimet e kërkesës për regjistrim marke sipas nenit 52 të këtij ligji;
 - ii. njoftimin e ndryshimeve të rregulloreve të përdorimit të markave kolektive ose markave certifikuese sipas neneve 76 dhe 85, të këtij ligji;
 - iii. transferimi i pronësisë sipas nenit 22 të këtij ligji;
 - iv. të drejtat reale sipas nenit 24 të këtij ligji;
 - v. veprimet përmbartimore dhe fillimi i procedurës së paaftësisë paguese, përkatësisht sipas neneve 25 dhe 26, të këtij ligji;
 - vi. regjistrimet, shfuqizimet, modifikimet, dhënia ose transferimi në lidhje me licencat, sipas neneve 28 dhe 29, të këtij ligji, dhe, sipas rastit, lloji i licencës;
 - vii. ripërtëritja e regjistrimeve të markave, sipas nenit 56 të këtij ligji, data e hyrjes në fuqi, si dhe çdo kufizim në listën e mallrave e të shërbimeve, sipas pikës 6, të nenit 57 të këtij ligji;
 - viii. të dhënat për përcaktimin e kohëzgjatjes së regjistrimeve, sipas nenit 56, të këtij ligji;
 - ix. tërheqja nga kërkesa për markë dhe kufizimi i listës së mallrave dhe shërbimeve, sipas nenit 51 të këtij ligji, heqja dorë nga marka tregtare, sipas nenit 61 të këtij ligji, si dhe data e depozitimit dhe të dhënat e kundërshtimit, kërkesa për shfuqizim, kërkesa për deklarim pavlefshmërie dhe ankimet në Bordin e Apelit sipas këtij ligji;
 - x. data dhe përmbajtja e vendimit mbi kundërshtimin, kërkesa për shfuqizim, kërkesa për deklarimin e pavlefshmërisë dhe të ankimeve në Bordin e Apelit sipas këtij ligji.
 - xi. çregjistrimi i përfaqësuesit të pronarit të markës që është regjistruar, sipas nenit 123 të këtij ligji;
 - xii. ndryshimet, modifikimet ose çregjistrimet nga SAPI që përcaktohen në nënndarjet “iv”, “v” dhe “vi”, të shkronjës “a”, të pikës 2 të këtij neni;
 - xiii. zëvendësimi i regjistrimit kombëtar nga regjistrimi ndërkombëtar i markës, sipas nenit 106 të këtij ligji;
 - xiv. data dhe numri i regjistrimit ndërkombëtar të markës bazuar në një kërkesë ose regjistrim kombëtar, sipas nenit 93 të këtij ligji;



xv. ndarja e kërkesës për markë dhe ndarja e regjistrimit të markës tregtare përkatësisht sipas neneve 53 dhe 60 të këtij ligji, së bashku me shënimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, dhe lista e mallrave ose shërbimeve të regjistrimit fillestar, siç është ndryshuar;

xvi. korrigjimi i gabimeve dhe pasaktësive të dukshme, çregjistrimi i të dhënave dhe shfuqizimi i vendimeve të DPPI-së përkatësisht, sipas neneve 116 dhe 117 të këtij ligji;

xvii. data dhe përmbajtja e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me markat tregtare kombëtare dhe markat tregtare ndërkombëtare që shtrihen në Republikën e Shqipërisë;

b) të dhënat dytësore, si:

i. ndryshimet në emër dhe adresë të përfaqësuesit të pronarit të markës;

ii. emri dhe adresa e përfaqësuesit, nëse caktohet një përfaqësues i ri për markën;

3. DPPI-ja i dërgon njoftim pronarit të markës kombëtare për çdo ndryshim në regjistër.

4. Përpunimi të dhënave në lidhje me shënimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përfshirë çdo të dhënë personale, kryhet me qëllim:

a) administrimin e kërkesave dhe regjistrimeve të markave, siç përcaktohet në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;

b) mbajtjen e regjistrit publik për inspektim, si dhe informimin e autoriteteve publike e të operatorëve ekonomikë në mënyrë që t'u mundësojë atyre të ushtrojnë të drejtat e njohura nga ky ligj dhe të informohen mbi ekzistencën e të drejtave të mëparshme që u përkasin palëve të treta; dhe

c) përpilimin e raporteve e të statistikave që i mundësojnë DPPI-së të optimizojë veprimet e saj dhe të përmirësojë funksionimin e sistemit.

5. Çdo e dhënë në lidhje me shënimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni konsiderohet se është me interes publik dhe mund të aksesohet nga çdo palë e tretë. Për arsye të sigurisë juridike, shënimet në regjistër mbahen për një periudhë kohe të pakufizuar.

Neni 114

Njohja me dokumentet

1. Dosjet e kërkesave për markë, që ende nuk janë botuar, nuk i nënshtrohen njohjes nga të tretët, pa pëlqimin me shkrim të aplikantit. Njohja me

dokumentet e dosjes për markë, që ende nuk është botuar, nuk realizohet pa pëlqimin me shkrim të aplikantit.

2. Përjashtimisht, njohja me dokumentet realizohet pa marrë pëlqimin me shkrim të aplikantit të markës nga çdo person që provon se aplikanti i markës ka deklaruar se do të përdorë të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës kundër tij, pasi marka të regjistrohet.

3. Pasi kërkesa për markë botohet, dosjet e lidhura me këtë kërkesë dhe marka që rezultojnë prej saj mund të jenë subjekt i njohjes me dokumentet nëpërmjet depozitimit të një kërkesë për njohjen me dokumentet.

4. Në rastin e njohjes me dokumentet sipas pikave 2 ose 3 të këtij neni, nuk mund të aksesohen pjesët e dosjes për të cilat pala e interesuar ka shfaqur interes për ruajtjen e konfidencialitetit përpara datës së depozitimit të kërkesës për njohjen me dokumentet, përveçse kur njohja me to justifikohet nga një interes i ligjshëm dhe mbizotërues i palës.

5. Njohja me dokumentet e kërkesave për markë dhe markave të regjistruara kryhet mbi dokumentet origjinale, fotokopjet e tyre ose mjetet teknike të arkivimit nëse dosjet janë arkivuar në këtë mënyrë.

6. Kur njohja me dokumentet kryhet siç parashikohet në pikën 7 të këtij neni, kërkesa për njohje konsiderohet se nuk është kryer deri në pagesën e tarifës përkatëse.

7. Njohja me dokumentet kryhet në mjediset e DPPI-së ose *online*. Me kërkesë të palës së interesuar, njohja me atë dosje mund të kryhet edhe nëpërmjet lëshimit të kopjes së dokumenteve të dosjes përkundrejt pagesës së një tarife shtesë, të përcaktuar nga DPPI-ja.

8. Personi i interesuar mund të aplikojë edhe për lëshim publik të akteve administrative për markat tregtare, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

9. Procedurat, përmbajtja e kërkesës për njohjen me dokumentet dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 115

Informacioni konfidencial

1. Gjatë procedurave në DPPI, palët mund të përcaktojnë se provat ose dokumentet e depozituara përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione konfidenciale. Në këtë rast, DPPI-ja mund të vendosë:



a) moskopjimin e dokumenteve ose provave që përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione konfidenciale, por vetëm mundësinë e inspektimit të tyre;

b) ndalimin e njohjes me dokumentet ose provat që përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione konfidenciale, përveçse kur njohja me dokumentet justifikohet nga një interes i ligjshëm dhe mbizotërues i palës që kërkon inspektimin; ose

c) mbylljen e dokumenteve ose provave që përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione konfidenciale në një zarf të veçantë që mund të hapet vetëm në mjediset e DPPI-së. Në këtë rast, dokumentet ose provat mbyllen përsëri në një zarf të veçantë pas njohjes me dokumentet dhe DPPI-ja shënon faktin se u krye njohja me dokumentet ose provat, datën dhe orën e kryerjes së këtij procesi dhe të dhënat e identifikimit për personin që ka kryer njohjen me dosjen.

2. Nëse dokumentet ose provat që përmbajnë sekrete tregtare dhe informacione konfidenciale vendosen në dispozicion për inspektim sipas pikës 1 të këtij neni, DPPI-ja informon paraprakisht personin që ka të drejtë të njihet me dokumentet për detyrimin e konfidencialitetit. Në këtë rast, individit duhet të nënshkruajë deklaratën për detyrimin e konfidencialitetit.

Neni 116

Korrigjimi i gabimeve dhe pasaktësive të dukshme

1. DPPI-ja, me nismën e saj ose me kërkesë të palëve, korrigjon:

a) çdo gabim gramatikor apo drejtshkrimor, gabimet në transkriptim dhe çdo pasaktësi tjetër të dukshme në aktet e saj;

b) gabimet teknike që i atribuohen DPPI-së në lidhje me botimin ose regjistrimin e markës.

2. DPPI-ja nxjerr një akt të ri për korrigjimin e gabimeve dhe pasaktësive të dukshme. Vendimi për korrigjimin e gabimeve dhe pasaktësive të dukshme u dërgohet palëve të interesuara, si dhe botohet në buletin.

3. Nëse gabimet dhe pasaktësitë e dukshme janë bërë nga vetë aplikanti ose pronari i markës, DPPI-ja i korrigjon gabimet ose pasaktësitë përkundrejt depozitimit të kërkesës dhe pagesës së tarifës përkatëse.

4. Nëse gabimet dhe pasaktësitë e dukshme janë bërë nga vetë DPPI-ja, korrigjimi kryhet pa pagesë.

5. Procedurat, përmbajtja e kërkesës për korrigjimin e gabimeve dhe pasaktësive të dukshme dhe dokumentet bashkëlidhur saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 117

Shfuqizimi i vendimeve

1. DPPI-ja çregjistron të dhënat e pasqyruara në regjistrer ose shfuqizon vendimin e marrë kur ajo ka regjistruar një të dhënë në regjistrer ose ka marrë një vendim që përmban një gabim të dukshëm që i atribuohet DPPI-së. Kur ka vetëm një palë në procedurën administrative në DPPI dhe regjistrimi i të dhënave ose vendimi sjell efekte tek të drejtat e palës, çregjistrimi ose shfuqizimi i vendimit kryhet edhe nëse gabimi nuk është i dukshëm për palën.

2. Çregjistrimi ose shfuqizimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kryhet me nismën e DPPI-së ose me kërkesë të njëres prej palëve pjesëmarrëse në procedurë. Çdo çregjistrim i të dhënave ose shfuqizim vendimi shënohet në regjistrer.

3. Ky nen nuk cenon të drejtën e palëve për të depozituar një ankim në Bordin e Apelit ose mundësinë për korrigjimin e gabimeve dhe pasaktësive të dukshme sipas nenit 116 të këtij ligji. Kur ankimi është depozituar kundër një vendimi të DPPI-së që përmban një gabim, procedurat e ankimit mbeten pa objekt pas shfuqizimit të vendimit nga DPPI-ja në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, tarifa e paguar për ankimin i rimbursohet apeluesit.

Neni 118

Hetimi

1. Me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja kryen hetime për:

a) ngjashmërinë e kërkesave për markë dhe markave të regjistruara që kanë efekt në Republikën e Shqipërisë; dhe

b) çdo të dhënë tjetër të regjistruar në regjistrer.

2. Procedurat, përmbajtja e kërkesës për hetim dhe dokumentet bashkëlidhur tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 119

Baza e të dhënave

1. Përveç detyrimit për të krijuar dhe administruar bazën e të dhënave shtetërore për SAPI sipas nenit 113 të këtij ligji, DPPI-ja mbledh dhe arkivon në një bazë të dhënash elektronike të gjitha të dhënat e siguruar nga aplikantët ose çdo palë tjetër pjesëmarrëse në procedurat pranë DPPI-së, në përputhje me këtë ligj ose akte të tjera ligjore.

2. Përveç të dhënave personale që përfshihen në SAPI, sipas nenit 113 të këtij ligji, baza e të dhënave elektronike mund të përfshijë të dhëna të tjera personale për aq sa kërkohet nga ky ligj ose akte të tjera ligjore. Mbledhja, arkivimi dhe përpunimi i të dhënave personale u shërben qëllimeve për:

a) administrimin e kërkesave dhe regjistrimeve të markave, siç përcaktohet në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;

b) aksesimin e informacionit të nevojshëm për zhvillimin më të lehtë dhe të efektshëm të procedurave përkatëse;

c) komunikimin me aplikantët dhe palët e tjera në procedurë;

ç) përpilimin e raporteve dhe statistikave që mundësojnë DPPI-në të optimizojë veprimet e saj dhe të përmirësojë funksionimin e sistemit.

3. Aksesin në të dhënat personale që përcaktohen në pikën 2 të këtij neni është i kufizuar dhe të dhënat personale nuk bëhen të disponueshme për publikun, përveçse kur pala e interesuar jep pëlqimin me shkrim.

4. Të dhënat personale përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Pavarësisht parashikimit në pikën 4 të këtij neni, pala e interesuar mund të kërkojë heqjen e të dhënave personale nga baza e të dhënave pas 18 muajve nga data e përfundimit të afatit të mbrojtjes së markës ose mbylljes së procedurave përkatëse ndërmjet palëve. Pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e të dhënave me gabime ose të pasakta në çdo kohë.

Neni 120

Afatet

1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht në këtë ligj, afati i caktuar mund të zgjatet deri në 2 muaj

shtesë me kërkesë të palës së interesuar dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. Pala e interesuar depoziton në DPPI kërkesën për zgjatje afati përpara përfundimit të afatit të caktuar së bashku me pagesën e tarifës përkatëse.

3. DPPI-ja ekzaminon, pa vonesë, kërkesën për zgjatje afati dhe miraton zgjatjen e afatit deri në 2 muaj shtesë nëse kjo kërkesë përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Vendimi për zgjatje të afatit shënohet në regjistër dhe i dërgohet kërkuarit.

Neni 121

Ankimi administrativ në Bordin e Apelit

1. Bordi i Apelit shqyrton ankimet administrative të depozituara në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duke përfshirë:

a) ankimet kundër vendimeve të Dhomës së Kundërshtimeve;

b) ankimet kundër vendimeve të Dhomës për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri;

c) ankimet kundër vendimeve të Drejtorisë së Ekzaminimit;

ç) ankimet kundër vendimeve të marra në lidhje me rivendosjen në afat të të drejtave dhe rivendosjen në afat për vazhdimin e procedurave;

d) ankimet kundër vendimeve të marra në lidhje me kërkesat e parashikuara në nenet 116 dhe 117, të këtij ligji.

2. Ankimi administrativ depozitohet në Bordin e Apelit brenda 30 ditëve nga data e njohimit të vendimit të arsyetuar dhe përmban:

a) argumentet, bazën ligjore, shkaqet dhe provat që lidhen me ankimin;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi;

c) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

ç) formularin përkatës, të nënshkruar rregullisht.

3. Sekretari i Bordit të Apelit brenda 1 muaji nga data e depozitimit të ankimit administrativ, verifikon nëse ankimi administrativ është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni.

4. Nëse nuk përmbushen kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Bordi i Apelit vendos për refuzimin e ankimit bazuar në relacionin me shkrim të Sekretarit dhe ia dërgon vendimin ankuesit.

5. Nëse ankimi administrativ nuk është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara



në pikën 2 të këtij neni, Sekretari i Bordit të Apelit i dërgon njoftim ankuesit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Nëse ankuesi nuk i plotëson të metat dhe mangësitë brenda afatit të caktuar, Bordi i Apelit vendos për refuzimin e ankimit bazuar në relacionin me shkrim të Sekretarit të Bordit të Apelit dhe i dërgon vendimin ankuesit.

7. Nëse ankimi administrativ është depozituar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, Sekretari i Bordit të Apelit i dërgon palës tjetër një kopje të ankimit dhe e fton atë të depozitojë observimet mbi ankimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

8. Afatet e përcaktuara në pikat 2, 5 dhe 7, të këtij neni nuk shtyhen.

9. Nëse pala tjetër nuk depoziton observimet e saj mbi ankimin brenda afatit të caktuar në pikën 7 të këtij neni, Sekretari i Bordit të Apelit brenda 1 muaji nga data e përfundimit të afatit, njofton me relacion me shkrim Bordin e Apelit. Bordi i Apelit brenda 2 muajve nga data e njoftimit nga Sekretari, shqyrton bazueshmërinë e ankimit dhe vendos vetëm në bazë të observimeve të depozituara nga ankuesi.

10. Nëse pala tjetër paraqet observimet e saj ndaj ankimit brenda afatit të caktuar në pikën 7 të këtij neni, Sekretari i Bordit të Apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së observimeve njofton me relacion me shkrim Bordin e Apelit. Bordi i Apelit brenda 2 muajve nga data e njoftimit nga Sekretari shqyrton bazueshmërinë e ankimit dhe vendos në bazë të observimeve të depozituara nga palët.

11. Përpara marrjes së vendimit, Bordi i Apelit mund të thërrasë palët në seancë dëgjimore. Në seancën dëgjimore nuk paraqiten prova të reja.

12. Vendimi i arsyetuar i Bordit të Apelit u komunikohet palëve përkatëse brenda 2 muajve nga data e marrjes së vendimit. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 125 i këtij ligji.

13. Ankimi administrativ i paraqitur në Bordin e Apelit pezullon ekzekutimin e aktit deri në njoftimin e vendimit të ankimit.

14. Ankimi në gjykatë i vendimit të Bordit të Apelit nuk pezullon ekzekutimin e tij.

15. Procedurat, përmbajtja e ankimit administrativ në Bordin e Apelit dhe dokumentet

shoqëruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 122

Njoftimi

1. DPPI-ja njofton palët nëpërmjet mjeteve elektronike për dërgimin e dokumenteve me postë ose njoftimin formal, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj.

2. DPPI-ja ndjek rregullat e përgjithshme të njoftimit në përputhje me legjislacionin që rregullon procedurat administrative në fuqi gjatë komunikimit me palët ose subjektet e tjera.

Neni 123

Përfaqësimi në DPPI

1. Personat, që nuk kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, mund të përfaqësohen në DPPI vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për markat tregtare, të certifikuar dhe të regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

2. Personat, që kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për markat tregtare, të certifikuar dhe të regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

3. Personat mund të autorizojnë një ose më shumë përfaqësues të autorizuar për markat tregtare për të kryer një ose të gjitha veprimet në DPPI. Tagrat e përfaqësimit për secilin përfaqësues përcaktohen në autorizimin e përfaqësimit, i cili depozitohet në DPPI për çdo rast.

4. Aplikanti ose pronari i markës tregtare mund të ndryshojë përfaqësuesin e tij në regjistrin e markave nëpërmjet depozitimit të një kërkesë, e cila përmban autorizimin e përfaqësimit për përfaqësuesin e ri dhe pagesën e tarifës përkatëse.

5. Përfaqësuesit e autorizuar për markat tregtare, që janë certifikuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja, mund të hiqen nga regjistri dhe lista e përfaqësuesve të autorizuar me kërkesë të tyre. Ndryshimet në listën e përfaqësuesve publikohen.

6. Çdo ndryshim në lidhje me statusin dhe të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar regjistrohet në regjister dhe botohet në buletin e DPPI-së.



7. Parimet e përgjithshme të përfaqësimit, procedurat dhe kushtet për certifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për markat, si dhe rregulla të tjera në lidhje me përfaqësimin në DPPI përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 124

Kërkesat në format elektronik për shërbimet që ofron DPPI-ja

1. Çdo kërkesë për shërbimet e ofruara nga DPPI-ja depozitohet elektronikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon shërbimet *online* në Republikën e Shqipërisë.

2. Çdo kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik sipas legjislacionit në fuqi.

PJESA X

ZBATIMI I TË DREJTAVE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 125

Juridiksioni gjyqësor

1. Ankimet kundër vendimeve të Bordit të Apelit të DPPI-së depozitohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka juridiksion për të gjitha çështjet e tjera, duke përfshirë:

a) të gjitha veprimet që lidhen me shkeljen e të drejtave të markës tregtare dhe veprimet që rrezikojnë shkeljen e këtyre të drejtave;

b) veprimet që lidhen me shfuqizimin dhe deklarimin e pavlefshmërisë të markës tregtare, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 126

Normat e zbatueshme

1. Mjetet, masat dhe procedurat ligjore që parashikohen në këtë ligj zbatohen në lidhje me shkeljen e të drejtave të markës tregtare, pa cenuar mjetet e tjera ligjore që janë parashikuar në legjislacionin kombëtar.

2. Ky ligj nuk përjashton zbatimin e legjislacionit penal, në lidhje me procedurat ose sanksionet penale për shkeljen e të drejtave të markës tregtare.

Neni 127

Zbatimi i masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse

Personat, që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse, janë:

a) mbajtësit e të drejtave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) çdo person i autorizuar për të përdorur këto të drejta, duke përfshirë të licencuarin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 128

Veprime që përbëjnë shkelje të të drejtave të markës tregtare

Shkelje e së drejtës është, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim ose imitim i paaautorizuar i markës tregtare dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas dispozitave të këtij ligji.

KREU II

PROVAT

Neni 129

Provat

1. Me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj dhe që ka specifikuar provat që janë nën zotërimin e palës tjetër, gjykata kompetente urdhëron që këto prova të paraqiten nga pala kundërshtare për të garantuar mbrojtjen e informacioni konfidencial.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, gjykata vlerëson çdo provë të paraqitur nga pala kërkuuese në lidhje me pretendimet e saj.

3. Me kërkesë të palës, gjykata urdhëron, sipas rastit, paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, të cilat janë në zotërim të palës kundërshtare, me qëllim që të mbrohet informacioni konfidencial.



Neni 130

Masat për sigurimin e provave

1. Me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj mbi shkeljen ose rrezikun e shkeljes së të drejtave të markës, gjykata urdhëron marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për sigurimin e provës, me qëllim që të mbrohet informacioni konfidencial.

Këto masa mund të merren edhe përpara fillimit të procedurave gjyqësore për themelin e çështjes dhe mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm të mallrave me ose pa marrjen e mostrave, konfiskimin fizik të mallrave cenuese dhe, sipas rastit, konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin dhe/ose shpërndarjen e këtyre mallrave dhe dokumenteve të lidhura me to. Gjykata vendos për marrjen ose jo të masave për sigurimin e provës brenda 5(pesë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, si dhe përcakton afatin brenda të cilit duhet të ekzekutohet masa e urdhëruar nëpërmjet këtij vendimi. Ky afat nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë (pesë) nga data e marrjes së vendimit.

2. Gjykata vendos për marrjen e masave për sigurimin e provës pa dëgjuar palën tjetër kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit të së drejtës ose kur ekziston rreziku që të asgjësohet prova.

Kur masat për sigurimin e provës vendosen pa dëgjuar palën tjetër, pala kundër së cilës është vendosur masa njoftohet menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

Kur masat për sigurimin e provës janë vendosur pa u dëgjuar pala kundër së cilës është vendosur masa, kjo e fundit ka të drejtë të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të masës.

Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave për sigurimin e provës brenda një afati të arsyeshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

3. Gjykata vendos që marrja e masave për sigurimin e provës të kushtëzohet me depozitim nga kërkuesi të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barasvlershëm, me qëllim që të garantohet ose sigurohet shpërblimi i çdo dëmi

që mund t'i shkaktohet të paditurit sipas pikës 5 të këtij neni.

4. Me kërkesë të të paditurit, masat për sigurimin e provës shfuqizohen ose hiqen, pa cenuar të drejtën për dëmshpërblim që mund të pretendohet, nëse kërkuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga gjykata në vendimin e saj për marrjen e masave. Ky afat i arsyeshëm nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike, cilito që është afati më i gjatë, nga data e ekzekutimit të masës për sigurimin e provës.

5. Nëse masat e sigurimit të provës shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të kërkuesit, ose nëse është konstatuar më pas se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të markës tregtare, gjykata urdhëron kërkuesin, me kërkesën e të paditurit, që t'i sigurojë këtij të fundit një shpërblim të përshtatshëm për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa.

6. Gjykata merr masa për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve të përfshirë në procedurën për sigurimin e provave.

Neni 131

E drejta për informim

1. Me kërkesë të arsyetuar dhe proporcionale të paditësit, gjykata urdhëron gjatë shqyrtimit të shkeljes së të drejtave të markës tregtare që informacioni mbi origjinën dhe rrjetet e shpërndarjes së mallrave ose shërbimeve, që cenojnë të drejtat e markës tregtare, të sigurohet nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër që:

a) konstatohet se zotëron mallra cenuese në shkallë tregtare;

b) konstatohet se përdor shërbime që cenojnë të drejtën në shkallë tregtare;

c) konstatohet se ofron shërbime që cenojnë të drejtën në shkallë tregtare; ose

ç) identifikohet nga një prej personave të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” ose “c”, të kësaj pike, se është përfshirë në prodhimin, përpunimin ose shpërndarjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve që cenojnë të drejtën.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përfshin:

a) emrat dhe adresat e prodhuesve, përpunuesve, shpërndarësve, furnizuesve, mbajtësve të tjerë të



mëparshëm të mallrave ose shërbimeve, si dhe të tregtarëve me shumicë dhe pakicë;

b) informacionin mbi sasi të prodhuara, të përpunuara, të shpërndara, të marra ose të porositura, si edhe çmimet e marra për mallrat ose shërbimet në fjalë.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen pa cenuar dispozitat e tjera ligjore në fuqi, të cilat:

a) i njohin të drejtën mbajtësit të së drejtës që të marrë informacion më të plotë;

b) rregullojnë përdorimin e informacionit të siguruar në përputhje me këtë nen në procedura civile ose penale;

c) parashikojnë përgjegjësi për keqpërdorimin i të drejtës për informim;

ç) japin mundësi për refuzimin e dhënies së informacionit kur ky informacion detyron personin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni që të pranojë pjesëmarrjen e tij ose të të familjarëve të tij në shkeljen e të drejtave të markës tregtare;

d) rregullojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit ose përpunimin e të dhënave personale.

KREU III

MASAT E PËRKOHSHME

Neni 132

Masat e përkohshme

1. Me kërkesën e personit të interesuar, gjykata vendos:

a) marrjen e masave të përkohshme kundër shkelësit të pretenduar për të parandaluar një shkelje të pritshme të të drejtave të markës tregtare ose për të ndaluar në mënyrë të përkohshme vazhdimin e shkeljes së pretenduar të të drejtave;

b) konfiskimin ose vendosjen nën kontroll të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e markës tregtare, me qëllim që të parandalojë hyrjen ose qarkullimin e tyre në kanalet e tregtisë.

Gjykata vendos për marrjen ose jo të masave të përkohshme brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës

2. Masat e përkohshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të vendosen edhe kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e markës tregtare.

3. Gjykata mund të vendosë konfiskimin e përkohshëm të pasurive të luajshme ose të

paluajtshme të shkelësit të pretenduar, duke përfshirë bllokimin e llogarive të tij bankare dhe asetëve të tjera, kur pala e dëmtuar demonstroi rrethana të tilla që mund të rrezikojnë rikuperimin e dëmeve. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera të përshtatshme për marrjen e informacionit përkatës.

4. Gjykata mund t'i kërkojë kërkuesit prova në lidhje me masat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, me qëllim për të vërtetuar se ai është mbajtës i së drejtës dhe se të drejtat e tij janë shkelur ose që pritet të shkelen.

5. Gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për mbajtësin e së drejtës. Në një rast të tillë, palët informohen menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

6. Kur masat e përkohshme janë vendosur pa i dhënë mundësi palës kundër së cilës është vendosur masa të dëgjohet, kjo e fundit mund të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njofimit të masës së përkohshme.

Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve që të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave të përkohshme brenda një afati të arsyeshëm që nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

7. Me kërkesë të të paditurit, gjykata vendos shfuqizimin ose heqjen e masave të përkohshme nëse kërkuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda afatit të caktuar nga gjykata në vendimin për marrjen e masave të përkohshme. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 20 (njëzet) ditë pune ose 31 (tridhjetë e një) ditë kalendarike nga data e ekzekutimit të masës, sipas afatit që është më i gjatë.

8. Gjykata vendos që marrja e masave të kushtëzohet me depozitimin nga kërkuesi të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barasvlershëm, me qëllim që të garantohet ose sigurohet shpërblimi i çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të paditurit sipas pikës 9 të këtij neni.

9. Nëse masat e përkohshme shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të një veprimi ose mosveprimi të kërkuesit, ose nëse pas vendosjes



së saj është konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të markës tregtare, gjykata urdhëron kërkuesin, me kërkesën e të paditurit, që t'i sigurojë këtij të fundit shpërblimin për çdo dëm të shkaktuar nga zbatimi i masës.

KREU IV PROCEDURAT DHE MASAT KUNDËR SHKELJES SË TË DREJTAVE

Neni 133

Procedurat dhe masat kundër shkeljes së të drejtave

1. Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse, sipas këtij ligji, mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar:

a) ndalimin e tregtimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve që shkelin të drejtat e markës tregtare;

b) heqjen nga qarkullimi tregtar dhe/ose konfiskimin e mallrave që cenojnë të drejtën, dhe, sipas rastit, të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve;

c) ndalimin e futjes në treg të mallrave të markave të falsifikuara vetëm me heqjen ose shpëputjen e markës së ngjitur në këto mallra.

ç) shkatërrimin e mallrave që cenojnë të drejtën, si dhe/ose të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve;

d) botimin e pjesshëm ose të plotë të vendimit të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

dh) shpërblimin e dëmit të pësuar nga shkelja e të drejtave të markës tregtare;

2. Gjkata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveçse kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e këtyre masave, gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat legjitime të palëve të treta.

3. Masa e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni mund të merret edhe ndaj ndërmjetësit, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e markës tregtare.

Neni 134

Shpërblimi i dëmit

1. Me kërkesë të palës së dëmtuar, gjykata urdhëron personin që është përfshirë në veprimtari shkelëse që të paguajë shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljes së të drejtave të markës tregtare.

2. Në përlogaritjen e masës së shpërblimit të dëmit, gjykata mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, të pësuar nga pala e dëmtuar duke përfshirë:

a) fitimin e munguar të palës së dëmtuar;

b) çdo përfitim të padrejtë të realizuar nga shkelësi; dhe

c) dëmin moral që i është shkaktuar palës së dëmtuar nga shkelja, cenimin e emrit dhe reputacionit tregtar.

3. Gjkata, sipas rastit, vendos shpërblimin e menjëhershëm të dëmit nëpërmjet caktimit të një shume monetare për t'u paguar nga shkelësi në favor të palës së dëmtuar. Vendimi i gjykatës bazohet në elemente të tillë si: fitimet, të ardhurat dhe/ose tarifat që do të siguroheshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizimin për përdorimin e të drejtave të markës tregtare në fjalë.

4. Kur shkelësi nuk ka vepruar me qëllim ose nuk ka pasur arsye të arsyeshme për ta ditur se veprimtaria e tij përbënte shkelje të së drejtës, gjykata urdhëron rikuperimin e fitimeve të realizuara nga shkelja ose pagesën e dëmeve, të cilat mund të jenë të paracaktuara sipas parashikimeve të nenit 13, pika 2, të këtij ligji.

Neni 135

Masat në doganë

Kushtet dhe procedurat lidhur me veprimet që ndërmerren nga autoritetet doganore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e markës tregtare nga mallra, të cilat janë ose duhet të ishin objekt i mbikëqyrjes doganore apo kontrollit doganor, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, rregullohen nga legjislacioni doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 136

Masat në tregun e brendshëm

1. Mbajtësi i të drejtave, në kuptim të këtij ligji, mund të paraqesë një kërkesë-ankesë për inspektim



tek autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm për fillimin e procedurave dhe marrjen e masave përkatëse të inspektimit, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelen të drejtat e markës tregtare nga mallra dhe shërbime që janë vendosur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Procedurat për veprimet që ndërmerr autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen nga legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe nga çdo ligj apo akt nënligjor tjetër që përmban dispozita për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

PJESA XI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 137

Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale me qëllim zbatimin e këtij ligji bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 138

Dispozita tranzitore dhe përfundimtare

Proceset për shkeljen e të drejtave dhe procedurat administrative, që kanë filluar ose janë pezull përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen dhe vendosen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 315, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për markat”, i ndryshuar.

Neni 139

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 7, të nenit 22; të pikës 8, të nenit 24; të pikës 8, të nenit 25; të pikës 8, të nenit 26; të pikës 9, të nenit 28; të pikës 7, të nenit 29; të pikës 3, të nenit 33; të pikës 3, të nenit 44; të pikës 7, të nenit 46; të pikës 11, të nenit

53; të pikës 4, të nenit 54; të pikës 2, të nenit 55; të pikës 10, të nenit 57; të pikës 9, të nenit 59; të pikës 9, të nenit 60; të pikës 8, të nenit 61; të pikës 6, të nenit 62; të pikës 6, të nenit 65; të pikës 8, të nenit 66; të pikës 4, të nenit 72; të pikës 4, të nenit 81; të pikës 1, të nenit 96; të pikës 10, të nenit 108; të pikës 9, të nenit 109; të pikës 3, të nenit 110; të pikës 2, të nenit 111; të pikës 2, të nenit 112; të pikës 9, të nenit 114; të pikës 5, të nenit 116; të pikës 2, të nenit 118; të pikës 15, të nenit 121 dhe të pikës 7, të nenit 123.

Neni 140 Shfuqizime

1. Nenet 1, 2, 3, 4, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 150/“a”, 151, 151/“a”, 151/“b”, 151/“c”, 152, 153, 153/“a”, 154, 155, 156, 156/“a”, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 163/“a”, 163/“b”, 164, 165, 166, 172, 173, 174, 175, 175/“a”, 184, 184/“a”, 184/“b”, 184/“c”, 184/“ç”, 185, 185/“a”, 186, 187, 188, 192, 195, 201, 202, 203 dhe 204, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, shfuqizohen, për aq sa parashikohet në lidhje me markat tregtare, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore ekzistuese në fushën e pronësisë industriale mbeten në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj.

Neni 141 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 280, datë 29.7.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 280, datë 29.7.2025****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 52/2025, “Për markat tregtare”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 53/2025****PËR PATENTAT, MODELET E
PËRDORIMIT DHE CERTIFIKATAT
E MBROJTJES SHITESË¹⁴**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky ligj ka për objekt:

a) caktimin e rregullave, kriterëve dhe procedurave për regjistrimin e patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë;

b) përcaktimin e të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë;

c) caktimin e rregullave për administrimin e sistemit dhe regjistrat e patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është:

a) t'u sigurojë mbrojtjen e duhur shpikjeve të bëra nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) të përcaktojë dhe të rregullojë mbrojtjen e të drejtave të patentave për shpikje, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

**Neni 3
Zbatimi i ligjit**

Ky ligj zbatohet:

1. Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që përfshin hapësirën tokësore, tërësinë e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësirën ajrore, që shtrihet mbi hapësirën tokësore, dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër, ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, mjetet ajrore të aviacionit ushtarak ose civil, kudo që ndodhen;

¹⁴ Ky ligj është përfshirë plotësisht me aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian për sa i përket pjesës së fushës së zbatimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësive Industriale:

1. Direktiva 98/44/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 6 korrik 1998, për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike (OJ L 213, 30.7.1998).

2. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 29 prill 2004, për zbatimin e të drejtave të pronësive intelektuale (OJ L 157, 30.4.2004).

3. Rregullorja (KE) nr. 816/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 17 maj 2006, për licencimin detyrues të patentave në lidhje me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vende me probleme të shëndetit publik OJ L 157, 9.6.2006 – në vijim: Rregullorja (KE) nr. 816/2006).

4. Rregullorja (KE) nr. 469/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 6 maj 2009, në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte mjekësore (OJ L 152, 16.6.2009).

5. Rregullorja (KE) nr. 2019/933 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 20 maj 2019, që amendon rregulloren (KE) nr. 469/2009 në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte mjekësore (OJ L 153, 11.6.2019).

6. Rregullorja (KE) nr. 1610/96 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 23 korrik 1996, në lidhje me krijimin e certifikatës së mbrojtjes shtesë për produktet e mbrojtjes së bimëve (OJ L 198, 8.8.1996).

7. Rregullorja (KE) nr. 1901/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 12 dhjetor 2006, për produktet mjekësore për përdorim pediatrik dhe ndryshon rregulloren (EEC) nr. 1768/92, direktivën 2001/20/EC, direktivën 2001/83/EC dhe rregulloren (KE) nr. 726/2004.



2. Për shpikjet e krijuara ose të përdorura jashtë, në hapësirë, të cilat janë nën juridiksionin e kontrollin e autoriteteve të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

3. Për personat fizikë dhe juridikë me shtetësi shqiptare, si dhe për personat e huaj, që vijnë nga:

a) vendet dhe territoret, palë kontraktuese të konventave dhe traktateve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) vendet dhe territoret, anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë;

c) vendet dhe territoret me të cilat zbatohet parimi i reciprocitetit në fushën e pronësisë industriale.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kërkesë ndërkombëtare” është një kërkesë që depozitohet sipas procedurave të parashikuara në TBP;

2. “Kërkesë për patentë evropiane” është kërkesa për patentë evropiane, që depozitohet në përputhje me KPE-në;

3. “Kërkesë për patentë kombëtare” është kërkesa për patentë që depozitohet në DPPI, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

4. “Bordi i Apelit” është organi që shqyrton ankimet administrative në përputhje me këtë ligj;

5. “Buletini i DPPI-së” ose “buletini” është botimi periodik zyrtar i DPPI-së, ku botohen të gjitha të dhënat në lidhje me patentat për shpikje, modelet e përdorimit, certifikatat e mbrojtjes shtesë, si dhe të gjitha veprimet që lidhen me to, siç parashikohen në këtë ligj dhe/ose në aktet në zbatim të tij;

6. “DPPI” është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, e cila është autoriteti përgjegjës për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, si dhe për administrimin e regjistrave të tyre;

7. “Gjykatë” është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ose Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, sipas rastit;

8. “Individ” është çdo subjekt që nuk është as person fizik, as person juridik, siç përkufizohet në pikën 25 të këtij neni;

9. “Konventa e Patentave Evropiane” aderuar me ligjin nr. 10 179, datë 29.10.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Evropiane”, të ndryshuar, si dhe rregullorja për zbatimin e saj (në vijim, KPE);

10. “Konventa e Parisit” është Konventa për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, e miratuar në Paris më 20 mars 1883, me ndryshimet e mëvonshme, në të cilën ka aderuar Republika e Shqipërisë;

11. “Konventa në lidhje me ekspozitat ndërkombëtare” është Konventa për Ekspozitat Ndërkombëtare dhe protokollet e kësaj konvente, e nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 9899, datë 10.4.2008;

12. “Licencë ekskluzive” është licenca që aplikanti ose pronari i një patente ose pronari i një modeli përdorimi (licencuesi) i jep ekskluzivisht vetëm një palë tjetër (i licencuari) të drejtën për ta përdorur atë në mënyrën e autorizuar në licencë;

13. “Licencë joekskluzive” është licenca që nuk i heq të drejtën aplikantit ose pronarit të një patente ose modeli përdorimi (licencuesi), që ta përdorë ose ta licencojë patentën ose modelin e përdorimit edhe te personat e tjerë (të licencuarve);

14. “Licencim” është një marrëveshje nëpërmjet së cilës aplikanti ose pronari i patentës apo i modelit të përdorimit (licencuesi) autorizon një palë tjetër (të licencuarin) të kryejë çdo akt apo veprim në lidhje me kërkesën për patentë, model përdorimi, ose në lidhje me vetë patentën ose modelin e përdorimit, në bazë të këtij ligji;

15. “Licencë e detyruar” është licenca që jepet nga autoriteti shtetëror kompetent në kushtet e një situatë emergjente, me anën e së cilës një ent apo person lejohet të prodhojë ose të përdorë një produkt ose proces të patentuar pa pëlqimin e pronarit të patentës;

16. “Marrëveshja TRIPS” është Marrëveshja për Aspektet e Lidhura me Tregtinë e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, e nënshkruar në Marok më 15 prill 1994, si shtojcë e marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë dhe “Deklarata e Doha-s” e marrëveshjes TRIPS, e miratuar nga Konferenca Ministrore e OBT-së në Doha më 14 nëntor 2001, aderuar me ligjin nr. 9950, datë 10.7.2008, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e marrëveshjes së TRIPS”;



17. “Material biologjik” është çdo material, që përmban informacion gjenetik e që është i aftë të riprodhojë veten ose që mund të jetë i riprodhueshëm nga një sistem biologjik;

18. “Mbajtës i të drejtave” është pronari ose mbajtësi i licencës së patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë;

19. “Mjet elektronik” është çdo mjet që mundëson dërgimin fillestar ose të mëvonshëm të informacionit dhe marrjen e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të mjeteve ose pajisjeve elektronike për procesimin, përpunimin, trajtimin dhe ruajtjen e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kabllave, radiovalëve, mjeteve dhe kabllave optikë ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë dhe internetin;

20. “*Mutatis mutandis*” do të thotë “në të njëjtën mënyrë” ose “njëlloj”;

21. “OBT” është Organizata Botërore e Tregtisë;

22. “OKB” është Organizata e Kombeve të Bashkuara;

23. “Patentë evropiane” është patenta evropiane që jepet nga ZEP-i për një kërkesë për patentë evropiane, sipas procedurës së parashikuar në KPE;

24. “Patentë kombëtare” është patenta që jepet nga DPPI-ja për një kërkesë për patentë kombëtare, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj;

25. “Person” është çdo person fizik ose juridik, në kuptim të Kodit Civil dhe legjislacionit tjetër kombëtar;

26. Përkufizimet, në kuptim të këtij ligji, për licencat detyruese, që lidhen me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vende me probleme të shëndetit publik, do të kenë të njëjtin kuptim me përkufizimet e bëra në rregulloren nr. 816/2006 të Bashkimit Evropian.

27. “Proces mikrobiologjik” është çdo proces, që përfshin apo realizohet nga një material mikrobiologjik ose që rezulton në një material mikrobiologjik;

28. “Proces thelbësisht biologjik për prodhimin e bimëve ose kafshëve” është një proces, që është tërësisht fenomen natyror, siç është kryqëzimi ose seleksionimi;

29. “Regjistër” është libri ku regjistrohen e mblidhen zyrtarisht të dhënat e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, që mbahet nga DPPI-ja, në

përputhje me këtë ligj;

30. “Rregullore” është rregullorja e patentave, modeleve të përdorimit dhe e certifikatave të mbrojtjes shtesë, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

31. “Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale, SAPI” është mjeti elektronik, duke përfshirë edhe bazën e të dhënave për administrimin e pronësisë industriale nga DPPI-ja;

32. Shprehjet e përdorura në këtë ligj në një gjini do të përfshijnë në mënyrë të njëjtë gjininë mashkullore ose atë femërore;

33. “Shpikje bioteknologjike” është shpikja lidhur me një produkt, i cili ka në përmbajtje material biologjik ose një proces, nëpërmjet të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik.

34. “TLP” është Traktati i Ligjit për Patentat, miratuar në Gjenevë, datë 1 qershor 2000, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm të tij, si dhe rregullorja për zbatimin e TLP-së, në të cilin ka aderuar Republika e Shqipërisë;

35. “Traktati i Bashkëpunimit për Patentat” (në vijim TBP) është traktati i miratuar në Uashington më 19 qershor 1970, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm të tij, si dhe rregullorja për zbatimin e saj, në të cilin ka aderuar Republika e Shqipërisë;

36. “Traktati i Budapestit” është traktati për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllime të procedurës së patentave të datës 28 prill 1977, me gjithë rishikimet e tij, aderuar me ligjin nr. 9031, datë 20.3.2003, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave.”;

37. “Unioni i Parisit” është tërësia e shteteve kontraktuese, që janë anëtarë të Konventës së Parisit;

38. “Varietet bimor” është çdo grupim bimor brenda një klasifikimi botanik të vetëm të shkallës më të ulët të klasifikimit, grupim që mund:

a) të jetë i përcaktuar nga shfaqja e karakteristikave që rezultojnë nga një gjenotip i dhënë ose kombinim gjenotipesh;

b) të jetë i dallueshëm nga një grupim tjetër bimor nga shfaqja e të paktën të njëjës prej karakteristikave të sipërpërmendura; si dhe që mund;

c) të konsiderohet si grupim për shkak të mundësisë së tij për t'u shumuar në mënyrë të



pandryshueshme, sipas ligjit përkatës për materialin bimor mbjellës e shumëzues;

39. “ZEP” është Zyra Evropiane e Patentave;

40. “Zyrë e caktuar” është zyra kombëtare e një shteti, që caktohet nga një aplikant sipas procedurave të parashikuara në TBP;

41. “Zyrë e zgjedhur” është zyra kombëtare e një shteti që zgjidhet nga një aplikant sipas procedurave të parashikuara në TBP;

42. “Zyrë pritëse” është DPPI-ja, ZEP-i ose Zyra Ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, në varësi të zgjedhjes së aplikantit, sipas procedurave të parashikuara në TBP.

PJESA II OBJEKTI I MBROJTJES SË SHPIKJES

Neni 5

Shpikjet e patentueshme

1. Patenta jepet për një shpikje, për të gjitha fushat e teknologjisë, kur shpikja plotëson të gjitha kushtet në vijim:

- a) përbën risi;
- b) përmban hap shpikës; dhe
- c) është e zbatueshme në industri.

2. Nuk përbëjnë shpikje për qëllime të këtij ligji:

- a) zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore;
- b) krijimet estetike;
- c) rregullat, udhëzimet dhe metodat për kryerjen e veprimeve mendore, për luajtjen e lojërave ose për bërjen e biznesit;

ç) paraqitja e informacionit; dhe

d) programet kompjuterike.

3. Objektet e pikës 2 të këtij neni përjashtohen nga patentueshmëria në masën që kërkesa për patentë ose patenta lidhet me vetë këto objekte.

4. Objekti i një shpikjeje që mbrohet me patentë mund të jetë një produkt ose një proces.

Neni 6

Shpikjet bioteknologjike

1. Një shpikje bioteknologjike është gjithashtu e patentueshme nëse përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji dhe nëse ajo lidhet me:

a) një produkt që përbëhet ose përmban material biologjik;

b) një proces me anën e të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik;

c) një material biologjik të izoluar nga mjedisi i tij natyror ose të prodhuar nëpërmjet një procesi teknik, edhe kur ky proces ka ndodhur më parë në natyrë; ose

ç) një proces mikrobiologjik ose proces tjetër teknik apo një produkt i përfutur nëpërmjet një procesi të tillë, me përjashtim të rastit kur përftohet një varietet bimor apo shtazor.

2. Një shpikje që lidhet me bimët ose kafshët konsiderohet e patentueshme, nëse mundësia teknike e shpikjes nuk kufizohet në një varietet të veçuar bimor apo shtazor.

3. Një element i marrë apo i izoluar nga trupi i njeriut ose i prodhuar ndryshe nëpërmjet një procesi teknik, që përfshin një sekuençë apo një sekuençë të pjesshme të një gjeni, mund të përbëjë shpikje të patentueshme, edhe kur struktura e tij është identike me strukturën e elementit natyror. Zbatimi industrial i sekuençës ose i sekuençës së pjesshme të gjenit duhet të tregohet në kërkesën për patentë.

Neni 7

Përjashtimet nga patentueshmëria

Objektet e renditura më poshtë nuk mbrohen me patentë:

1. Varietetet bimore dhe racat e kafshëve.

2. Proceset thelbësisht biologjike për prodhimin e bimëve ose të kafshëve, si dhe bimët ose kafshët e përfutura në mënyrë ekskluzive nga këto procese, me përjashtim të shpikjeve që lidhen me proceset mikrobiologjike, me procese të tjera teknike ose me produktet që rezultojnë nga procese të tilla.

3. Shpikjet që lidhen me metodat diagnostikuese ose kirurgjikale, ose me metodat e trajtimit, që praktikohen drejtpërdrejt në trupin e njeriut ose të kafshës, me përjashtim të produkteve, veçanërisht substancat ose përbërësit që përdoren në këto metoda.

4. Shpikjet, shfrytëzimi tregtar i të cilave do të vinte në kundërshtim me rendin ose moralin publik, shëndetin publik ose jetën e njerëzve, veçanërisht:

a) proceset për klonimin e qenies njerëzore;

b) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të linjës embrionale të qenies njerëzore;

c) përdorimi i embrionit njerëzor për qëllime industriale apo tregtare;



ç) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve, që mund t'u shkaktojnë kafshëve vuajtje, pa ndonjë përfitim mjekësor thelbësor te njeriu apo kafsha, si edhe kafshët, që rezultojnë nga procese të tilla.

Neni 8

Trupi i njeriut dhe elementet e tij

1. Shpikjet që lidhen me trupin e njeriut në fazat e ndryshme të formimit dhe të zhvillimit të tij, si dhe thjesht zbulimi i njërit prej elementeve të tij, duke përfshirë një sekuençë ose një sekuençë të pjesshme të një gjeni, nuk janë të patentueshme.

2. Shpikja, që lidhet me një element të izoluar nga trupi i njeriut ose që prodhohet ndryshe nëpërmjet një procesi teknik, duke përfshirë një sekuençë ose një sekuençë të pjesshme të një gjeni, mund të përbëjë shpikje të patentueshme, edhe kur struktura e elementit të izoluar është identike me atë të elementit natyror.

3. Zbatueshmëria në industri e një sekuece ose e një sekuece të pjesshme të një gjeni tregohet në kërkesën për patentë.

Neni 9

Risia

1. Një shpikje përbën risi kur ajo nuk është pjesë e një arritjeje të mëparshme.

2. Arritja e mëparshme përfshin gjithçka që është bërë e njohur për publikun kudo në botë, nëpërmjet një përshkrimi, me gojë ose me shkrim, nëpërmjet përdorimit ose në çdo mënyrë tjetër, para datës së depozitimit të kërkesës për patentë.

3. Arritja e mëparshme përfshin edhe përmbajtjen e të gjitha kërkesave për patentë, të depozituara ose të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, data e depozitimit e të cilave është më e hershme se data e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, dhe që janë bërë publike vetëm në datën e depozitimit të kërkesës për patentë ose pas kësaj date.

4. Parashikimet e bëra në pikat 2 dhe 3 të këtij neni nuk përjashtojnë mundësinë për mbrojtjen me patentë të një substance ose përbërjeje, të përfshirë në arritjen e mëparshme, për përdorim në metodat e parashikuara në pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji, me kusht që përdorimi i saj për një metodë të tillë të mos jetë përfshirë në arritjen e mëparshme.

5. Parashikimet e bëra në pikat 2 dhe 3 të këtij neni nuk përjashtojnë mundësinë për mbrojtjen me patentë të një substance ose përbërjeje, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, për çdo përdorim specifik në metodat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të këtij ligji, me kusht që ky përdorim të mos jetë përfshirë në arritjen e mëparshme.

Neni 10

Moscenimi i shpikjes nga bërja publike e saj

1. Një shpikje konsiderohet se është e re, në kuptim të nenit 9 të këtij ligji, nëse shpikja bëhet publike, si pjesë e arritjes së mëparshme, jo më parë se 6 (gjashtë) muaj para datës së depozitimit të kërkesës për patentë kur bërja publike e shpikjes bëhet:

a) si pasojë e një abuzimi të dukshëm nga një individ ose person ndaj aplikantit të patentës ose paraardhësit të tij ligjor; ose

b) për shkak të ekspozimit të saj nga aplikanti i patentës ose nga paraardhësi i tij ligjor në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare ose të njohur zyrtarisht sipas Konventës për Ekspozitat Ndërkombëtare, me kusht që në kërkesën për patentë të tregohet, në kohën e depozitimit të saj, se shpikja është ekspozuar, duke depozituar një certifikatë për këtë ekspozim jo më vonë se 4 (katër) muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Certifikata e përcaktuar në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni përmban të dhëna për personin që ekspozoi shpikjen, titullin e shpikjes, datën e hapjes së ekspozitës, nëse shpikja është bërë publike pas kësaj date, datën e bërjes publike për herë të parë të shpikjes dhe verifikimin vërtetues nga një autoritet përgjegjës.

Neni 11

Hapi shpikës

1. Një shpikje përmban hap shpikës kur, edhe nëse do të mbahej parasysh arritja e mëparshme, shpikja nuk do të ishte lehtësisht e kuptueshme për një person të kualifikuar në fushën e asaj arritjeje.

2. Kur shqyrtohet për të vendosur se shpikja përmban hap shpikës, nuk merret në konsideratë përmbajtja e kërkesave, që përcaktohen në pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji.



Neni 12

Zbatueshmëria në industri

Shpikja është e zbatueshme në industri kur objekti i saj mund të prodhohet ose përdoret në çdo lloj industrie, duke përfshirë edhe bujqësinë.

PJESA III

E DREJTA PËR MBROJTJEN E SHPIKJES

Neni 13

Personat që kanë të drejtë të sigurojnë mbrojtje

1. E drejta për patentë i përket shpikësit ose zëvendësuesit të tij ligjor.

2. Nëse shpikja është bërë bashkërisht nga dy ose më shumë shpikës, e drejta për patentë u përket shpikësve bashkërisht ose zëvendësuesve të tyre ligjorë. Aplikantët e përbashkët kanë të drejta të barabarta ndërmjet tyre, përveç rasteve kur, me marrëveshje, ata bien dakord ndryshe.

3. Personat e huaj gëzojnë të njëjtat të drejta që përcaktohen në këtë ligj për personat me shtetësi shqiptare, kur një gjë e tillë rezultojnë nga traktatet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, ose nga zbatimi i parimit të reciprocitetit.

4. Personat që pretendojnë reciprocitet duhet të paraqesin dokumente ose prova në lidhje me të.

Neni 14

Shpikësi

1. Shpikës është individ që ka bërë një shpikje gjatë punës së tij krijuese.

2. Personi që ka kontribuar për bërjen e një shpikjeje, duke dhënë vetëm ndihmë teknike, nuk konsiderohet se është shpikës.

3. Shpikësi ka të drejtë që emri i tij të shënohet në kërkesën për patentë në të gjitha dokumentet që lëshohen ose botohen nga DPPI-ja në lidhje me to, si dhe në regjistrat përkatës.

4. Zëvendësues ligjor i shpikësit është çdo individ ose person, që ka të drejtë të fitojë një patentë në bazë të ligjit, të një kontrate të ligjshme ose të trashëgimisë.

Neni 15

Shpikjet e bëra gjatë marrëdhënies së punës

1. Shpikja që bëhet gjatë marrëdhënies së punës i përket punëdhënësit, i cili fiton të drejtën mbi patentën, përveçse kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje ndërmjet tij dhe punëmarrësit.

2. Shpikja konsiderohet se është bërë gjatë marrëdhënies së punës, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, kur ajo rezultojnë nga puna e bërë nga punëmarrësi gjatë ushtrimit të detyrave të tij normale, ose nga aktiviteti shpikës i kryer, sipas udhëzimeve të punëdhënësit, si dhe duke përdorur burimet e punëdhënësit.

3. Nëse kontrata e punës ndërmjet punëdhënësit dhe shpikësit nuk parashikon ndonjë shpërblim specifik për shpikjet e bëra gjatë marrëdhënies së punës, shpikësi ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të arsyeshëm.

4. Me shpërblim të drejtë dhe të arsyeshëm, sipas pikës 3 të këtij neni, kuptohet një shpërblim financiar ose ekuivalenti i tij në natyrë, shuma dhe forma e të cilit vendoset ndërmjet palëve, duke mbajtur parasysh:

a) përpjekjet dhe aftësitë që punëmarrësi i ka kushtuar krijimit të shpikjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në pjesën e kontributit të punëmarrësit në shpikje në raport me shpikësit e tjerë, nëse shpikja është krijuar bashkërisht nga dy ose më shumë shpikës;

b) burimet që punëdhënësi i ka kushtuar ose pritjet t'i kushtojë zhvillimit, patentimit dhe shfrytëzimit të shpikjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në sigurimin e objekteve, materialeve dhe aftësive tregtare ose drejtuese; dhe

c) vlerën ekonomike të shpikjes, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në përfitimet ekonomike, që rrjedhin ose pritjet të rrjedhin për punëdhënësin nga shfrytëzimi i shpikjes.

5. Në rast konflikti ose mosmarrëveshjeje ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit për shumën ose formën e shpërblimit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, secila palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Përfaqësimi në DPPI

1. Personat që nuk kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë



përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë mund të përfaqësohen në DPPI vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për patentat, modelet e përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë të certifikuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

2. Personat që kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për patentat, modelet e përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë të certifikuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

3. Personat mund të autorizojnë një ose më shumë përfaqësues të autorizuar për patentat, modelet e përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë për të kryer një ose të gjitha veprimet në DPPI. Tagrat e përfaqësimit për secilin përfaqësues përcaktohen në autorizimin e përfaqësimit, i cili depozitohet në DPPI për çdo rast.

4. Aplikanti ose pronari i patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë mund të ndryshojë përfaqësuesin e tij në regjistër nëpërmjet depozitimit të një kërkesë, e cila përmban autorizimin e përfaqësimit për përfaqësuesin e ri dhe pagesën e tarifës përkatëse.

5. Përfaqësuesit e autorizuar për patentat, modelet e përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë të certifikuar dhe regjistruar si të tillë nga DPPI-ja mund të hiqen nga regjistri dhe lista e përfaqësuesve të autorizuar me kërkesë të tyre ose me nismën e DPPI-së kur ata nuk mund të ushtrtojnë më këtë veprimtari.

6. Çdo ndryshim në lidhje me statusin dhe të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar regjistrohet në regjistër dhe botohet në buletin e DPPI-së.

7. Një shpikje për proceset ose produktet, që janë objekt licencimi sipas ligjit nr. 87/2024 “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake” është e patentueshme kur përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

8. Për shpikjet e përcaktuara në pikën 7 të këtij neni, përpara regjistrimit, kërkohet miratimi nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për të siguruar që nuk cenohet siguria kombëtare.

9. Parimet e përgjithshme të përfaqësimit, procedurat dhe kushtet për certifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për patentat, modelet e përdorimit, si dhe rregulla të tjera në lidhje me

përfaqësimin në DPPI përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar.

PJESA IV PROCEDURA PËR MBROJTJEN E SHPIKJES

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PROCEDURALE

Neni 17 Autoriteti përgjegjës

DPPI-ja është autoriteti përgjegjës për dhënien, regjistrimin e patentës për shpikje, modelit të përdorimit dhe të certifikatës së mbrojtjes shtesë, administrimit dhe mirëmbajtjes së regjistrave të tyre.

Neni 18 Tarifat

Procedurat që kryhen sipas këtij ligji nga DPPI-ja janë objekt i pagesës së tarifave të caktuara, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19 Regjistri i objekteve të pronësisë industriale për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë

1. DPPI-ja, në bazën e të dhënave shtetërore për sistemin e administrimit të pronësisë industriale mban dhe administron regjistrin e objekteve të pronësisë industriale për patentat, modelet e përdorimit, si dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

2. Regjistri i objekteve të pronësisë industriale për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë është publik. Çdo person ka të drejtë të njihet me dosjen për përmbajtjen e të dhënave, që janë shënuar në këtë regjistër, sipas kushteve të parashikuara në nenet 24 e 25 të këtij ligji.

3. Me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon ekstraktin e kërkuar nga regjistri përkatës.

4. Përmbajtja e të dhënave të regjistrit të objekteve të pronësisë industriale dhe procedura e lëshimit të ekstraktit të kërkuar nga ky regjistër përcaktohet në rregulloren për lëshimin e patentave



për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas bashkërendimit me Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes, përcaktohen rregulla dhe procedura të posaçme për proceset e produktet, që janë objekt licencimi, sipas ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

Neni 20

Regjistri i pronësisë industriale i patentave

1. Kërkesat për patentë bëhen publike pas publikimit të tyre. Regjistri i patentave përmban të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat parësore:

i. numrin e kërkesës;

ii. datën e depozitimit të kërkesës;

iii. titullin e shpikjes;

iv. treguesin e klasës sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Patentave (KNP);

v. informacionin që shpikësi nuk dëshiron të përmendet në kërkesë;

vi. informacionin për të drejtën e prioritetit të përcaktuar në nenin 43 të këtij ligji (numri dhe data e depozitimit të kërkesës së parë dhe shteti ose organizata ndërkombëtare ose ndërqeveritare në të cilin ose për të cilën kërkesa është depozituar);

vii. informacionin për ekspozimin në një ekspozitë/panair ndërkombëtar, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji, nëse shpikja është ekspozuar;

viii. numrin dhe datën e kërkesës fillestare, si dhe numrat e të gjitha kërkesave të ndara kur ndahet kërkesa për patentë;

ix. informacionin për një kërkesë ndërkombëtare, nëse depozitohet: numri dhe data e depozitimit të një kërkesë ndërkombëtare, si dhe numri dhe data e një botimi ndërkombëtar;

x. numrin dhe datën e kërkesës për patentë evropiane, kur është rasti i konvertimit të parashikuar në nenin 138 të këtij ligji;

xi. datën e botimit të kërkesës dhe numrit të buletinit;

xii. datën e botimit të mëvonshëm të një raport hetimi dhe numrin e buletinit, kur është rasti;

xiii. statusin faktik të patentës;

xiv. numrin e patentës;

xv. datën dhe numrin e buletinit, ku shënohet botimi i dhënies së patentës;

xvi. numrin dhe datën e vendimit për dhënien e patentës;

xvii. informacionin për patentën evropiane, numrin dhe datën e kërkesës për vlefshmëri të patentës evropiane, numrin dhe datën ndërkombëtare të publikimit të patentës evropiane dhe numrin, datën dhe gjuhën e publikimit të patentës evropiane;

xviii. informacionin për kryerjen e pagesës së tarifës për ripërtëritjen e patentës;

xix. informacionin për pushimin e efekteve të të drejtave nga një kërkesë për patentë ose një patentë: baza ligjore dhe data e pushimit dhe masa e pushimit, në rast të një pushimi të pjesshëm për heqje dorë ose konflikt administrativ;

xx. informacionin lidhur me një kërkesë për deklarimin e pavlefshëm të një patente;

xxi. informacionin për ndryshimet në lidhje me transferimin e të drejtave, licencës, të drejtave reale (*in rem*), ekzekutimin, falimentimin dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për statusin ligjor të një kërkesë/patente; dhe

xxii. informacionin për certifikatën e mbrojtjes shtesë: numri i kërkesës, data e depozitimit, mbajtësi i certifikatës, numri i certifikatës.

b) të dhënat dytësore:

i. emrin dhe adresën e aplikantit ose të mbajtësit të patentës;

ii. emrin dhe adresën e shpikësit;

iii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

iv. informacionin për ndryshimet në lidhje me aplikantin ose mbajtësin e patentës, si: ndryshimi i emrit, i adresës, i përfaqësuesit etj.

2. Mënyra e mbajtjes dhe e administrimit të të dhënave parësore dhe dytësore në lidhje me patentat do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Regjistri i pronësisë industriale i modeleve të përdorimit

1. Kërkesat për modele përdorimi bëhen publike pas botimit të tyre. Regjistri i modeleve të përdorimit përmban të dhënat që vijojnë:



a) të dhënat parësore:

i. numrin e kërkesës;

ii. datën e depozitimit të kërkesës;

iii. titullin e shpikjes;

iv. treguesin e klasifikimit sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Patentave (KNP);

v. informacionin që shpikësi nuk dëshiron të përmendet në kërkesë;

vi. informacionin për të drejtën e prioritetit përcaktuar në nenin 43 të këtij ligji (numri dhe data e depozitimit të kërkesës së parë dhe shteti ose organizata ndërkombëtare ose ndërqeveritare, në të cilën ose për të cilën kërkesa është depozituar);

vii. numrin dhe datën e kërkesës fillestare, si dhe numrat e të gjitha kërkesave të ndara në rast ndarjeje të një kërkesë për patentë;

viii. informacionin për ekspozimin në një ekspozitë/panair ndërkombëtar, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit, nëse shpikja është ekspozuar;

ix. informacionin për një kërkesë ndërkombëtare, nëse depozitohet: numri dhe data e depozitimit të një kërkesë ndërkombëtare dhe numri dhe data e një botimi ndërkombëtar;

x. numrin dhe datën e një kërkesë për patentë evropiane, kur është rasti i një konvertimi, përcaktuar në nenin 138 të këtij ligji;

xi. statusin faktik të modelit të përdorimit;

xii. numrin e modelit të përdorimit;

xiii. datën e botimit të kërkesës dhe numrin e buletinit të DPPI-së, ku jepen të dhënat për kërkesën;

xiv. numrin dhe datën e vendimit për regjistrimin e një modeli përdorimi;

xv. informacionin për kryerjen e pagesës për ripërtëritjen e modelit të përdorimit;

xvi. informacionin për pushimin e efekteve të një modeli përdorimi: baza ligjore, data e pushimit dhe masa e pushimit;

xvii. informacionin në lidhje me një kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë: data e depozitimit, aplikanti, lloji dhe data e vendimit; dhe

xviii. informacionin për ndryshimet në lidhje me transferimin e të drejtave, licencës, të drejtave reale (*in rem*), ekzekutimin, falimentimin dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për statusin ligjor të një kërkesë për patentë ose model përdorimi.

b) të dhënat dytësore:

i. emrin dhe adresën e aplikantit ose të mbajtësit të modelit të përdorimit;

ii. emrin dhe adresën e shpikësit;

iii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

iv. informacionin për ndryshimet në lidhje me aplikantin ose mbajtësin e modelit të përdorimit (ndryshimi i emrit, i adresës, i përfaqësuesit etj.)

2. Mënyra e mbajtjes dhe e administrimit të të dhënave parësore dhe dytësore në lidhje me modelet e përdorimit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Regjistri i pronësisë industriale i certifikatave të mbrojtjes shtesë

1. Regjistri i pronësisë industriale i certifikatave të mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe për produktet e mbrojtjes së bimëve përmban të dhënat si më poshtë:

a) të dhënat parësore:

i. numrin e kërkesës për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

ii. datën e depozitimit të kërkesës për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

iii. emrin e produktit për të cilin është aplikuar dhënia e certifikatës së mbrojtjes shtesë (emri kimik ose generik);

iv. numrin dhe datën e depozitimit të kërkesës për patentën bazë dhe titullin e shpikjes;

v. numrin dhe datën e autorizimit për të vendosur produktin në treg dhe emrin e produktit të identifikuar në atë autorizim, siç përshkruhet në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji;

vi. informacionin për zgjatjen e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

vii. numrin e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

viii. datën e marrjes së vendimit për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë dhe, kur aplikohet, të vendimit për zgjatjen e afatit së certifikatës së mbrojtjes shtesë;

ix. kohëzgjatjen e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

x. informacionin për kryerjen e pagesës për ripërtëritjen e certifikatës së mbrojtjes shtesë;

xi. statusin faktik të certifikatës së mbrojtjes shtesë;

xii. informacionin për procedurën në lidhje me kërkesën për deklarimin e pavlefshmërisë së certifikatës së mbrojtjes shtesë: data e depozitimit, aplikanti, lloji dhe data e vendimit.



xiii. informacionin për ndryshimet në lidhje me transferimin e të drejtave, licencës, të drejtave reale (*in rem*), ekzekutimin, falimentimin dhe të dhëna të tjera të rëndësishme në lidhje me statusin ligjor të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

b) të dhënat dytësore:

i. emrin dhe adresën e aplikantit;

ii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit;

iii. emrin dhe adresën e mbajtësit të certifikatës së mbrojtjes shtesë;

iv. informacionin për ndryshimet në lidhje me aplikantin ose mbajtësin e certifikatës së mbrojtjes shtesë (ndryshimi i emrit, adresës, përfaqësuesit etj.).

2. Mënyra e mbajtjes dhe e administrimit të të dhënave parësore dhe dytësore në lidhje me certifikatat e mbrojtjes shtesë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Botimi i informacionit në buletin

1. Të dhënat dhe informacioni i përcaktuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe të dhëna dhe informacione të tjera zyrtare botohen në buletin.

2. Në rastet kur informacioni i klasifikuar është objekt i proceseve që rregullohen nga ky ligj, patenta trajtohet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

3. Buletini botohet elektronikisht në faqen zyrtare të DPPI-së.

Neni 24

Njohja dhe informimi për dosjet

1. Çdo person ka të drejtë të njihet me dosjet dhe dokumentet e tyre, që lidhen me patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

2. Njohja me dosjet për kërkesa ende të pabotuara në buletin nuk bëhet pa pëlqimin me shkrim të aplikantit.

3. Për një kërkesë të pabotuar në buletin, çdo person ka të drejtë t'i kërkojë DPPI-së të informohet vetëm për:

a) numrin e kërkesës;

b) datën e depozitimit të kërkesës;

c) numrin, datën dhe shtetin ose autoritetin në të cilin është depozituar kërkesa e parë, kur është pretenduar për prioritet;

ç) të dhëna mbi aplikantin; dhe

d) titullin e shpikjes.

4. Kur një person gjatë ndjekjes së procedurave para DPPI-së, paraqet dokumente që përmbajnë sekret tregtar dhe informacion konfidencial, me kërkesë të personit, DPPI-ja merr masa për mbrojtjen e tyre.

5. DPPI-ja, përpara se sa të ofrojë njohje me dosjet ose dokumentet, që përmbajnë sekrete tregtare dhe informacion konfidencial, paralajmëron personat që kanë kërkuar të njihen me dosjet për detyrimin që ata kanë për të mbajtur e ruajtur konfidencialitetin e sekreteve tregtare dhe të informacionit konfidencial, si dhe u kërkon këtyre për këtë qëllim të nënshkruajnë një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit.

Neni 25

Shërbime informuese

1. Me kërkesë të çdo individi ose personi, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon kopje të kërkesave të botuara për patentë, të patentave, modeleve të përdorimit dhe të certifikatave për mbrojtjen shtesë.

2. Mbi bazën e kërkesave dhe përkundrejt pagesës përkatëse, DPPI-ja jep dhe ofron shërbime informuese për të dhënat që zotëron, siç parashikohet në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Procedura dhe mënyra e ofrimit të kopjeve të dokumenteve dhe shërbimeve informuese përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Korrigjimet e gabimeve dhe të pasaktësive të dukshme

1. Me kërkesë të aplikantit, mbajtësit të së drejtës ose me iniciativën e vetë DPPI-së (*ex officio*), DPPI-ja bën korrigjimin e gabimeve dhe të pasaktësive të dukshme në dokumentet, regjistrat ose buletinin e saj.

2. Kërkesa për korrigjimin e një gabimi ose pasaktësie, sipas pikës 1 të këtij neni, paraqitet nëpërmjet një formulari, që përmban:



a) numrin e kërkesës ose të së drejtës, që i referohet kërkesa;

b) emrin e aplikantit;

c) gabimin ose pasaktësinë, që duhet të korrigjohet ose të saktësohet;

ç) të dhënën e saktësuar ose të korrigjuar;

d) përfaqësuesin dhe autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa është depozituar nga përfaqësuesi;

dh) vërtetimin e kryerjes së pagesës.

3. Korrigjimi ose saktësimi regjistrohet në regjister dhe botohet në bulletin.

4. Kur gabimi ose pasaktësia është bërë nga DPPI-ja, korrigjimi ose saktësimi regjistrohet pa pagesë.

5. Të dhëna të detajuara për kërkesën për korrigjim dhe për botimin e korrigjimeve ose të pasaktësive përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Rivendosja në afat

1. Kur, me gjithë kujdesin e treguar, aplikanti ose mbajtësi i së drejtës nuk arrin të kryejë një veprim gjatë ndjekjes së procedurës në DPPI brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj dhe kur moskryerja e këtij veprimi sjell si pasojë të drejtpërdrejtë humbjen e të drejtave në lidhje me një kërkesë ose me një të drejtë të dhënë ose të regjistruar, DPPI-ja e rivendos në afat vetëm nëse aplikanti ose mbajtësi i së drejtës plotëson kushtet si më poshtë:

a) depoziton një kërkesë për rivendosjen në afat dhe kryen të gjitha veprimet që nuk kishte kryer brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni;

b) paraqet dhe tregon faktet që e penguan atë të mos kryente veprimin brenda afatit të caktuar; dhe

c) paguan tarifën përkatëse.

2. Kërkesa për rivendosjen në afat depozitohet brenda afatit, që mbaron më herët nga afatet e mëposhtme:

a) 2 (dy) muaj nga data e eliminimit të shkakut, që ka penguar kryerjen e veprimit; ose

b) 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit, që nuk është respektuar.

3. Nëse kërkesa lidhet me mospagimin e tarifës së ripërtëritjes së patentës, afati është në çdo rast 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të

periudhës shtesë për ripërtëritjen e patentës, sipas pikës 5 të nenit 89 të këtij ligji.

4. Kur pranohet një kërkesë për rivendosje në afat, DPPI-ja merr vendimin për rivendosjen në afat, kthimin e procedurës në gjendjen që ishte para moskryerjes së veprimit, si dhe revokon pasojat e ardhura për shkak të humbjes së afatit.

5. Rivendosja në afat nuk lejohet për:

a) depozitimin e një kërkesë për t'u rivendosur në afat në lidhje me mundësinë për të bërë kërkesë, sipas pikës 1 të këtij neni;

b) depozitimin e një kërkesë për shtyrjen ose zgjatjen e një afati;

c) depozitimin e kërkesës për dhënien, rivendosjen, korrigjimin ose shtimin e të drejtës së prioritetit;

ç) depozitimin e kërkesës për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë ose zgjatjen e afatit të saj;

d) depozitimin e kërkesës për shqyrtim të mëtejshëm;

dh) depozitimin e kërkesës për regjistrimin e patentës evropiane në regjistrin e patentave dhe dërgimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 134 të këtij ligji; ose

e) të gjitha veprimet e kryera dhe të drejtat e ushtruara gjatë ndjekjes së procedurave para DPPI-së.

6. Çdo person, i cili ka shfrytëzuar ose përdorur në mirëbesim shpikjen apo ka bërë përgatitje efektive e serioze për shfrytëzimin ose përdorimin e shpikjes, që është objekt i një kërkesë për patentë të botuar, ka të drejtë, në periudhën ndërmjet humbjes së së drejtës të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe botimit në bulletin të vendimit për pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, të vazhdojë këtë shfrytëzim ose përdorim, pa të drejtë kompensimi për dëmet, vetëm për qëllime të biznesit të tij dhe nevojave që lidhen me të.

7. Të dhëna dhe procedura të detajuara në lidhje me kërkesën për rivendosjen në afat përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 28

Shqyrtimi i mëtejshëm

1. Nëse aplikanti ose mbajtësi i të drejtave nuk kryen një veprim gjatë ndjekjes së procedurës përpara DPPI-së brenda afatit të caktuar dhe, si pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj, aplikanti ose mbajtësi i të drejtave humbet të drejtat, DPPI-ja e lejon shqyrtimin e mëtejshëm vetëm kur aplikanti ose mbajtësi i të drejtave:

a) depoziton një kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm dhe kryen veprimin e pakryer brenda afatit të caktuar në pikën 2 të këtij neni; si dhe

b) paguan tarifën përkatëse.

2. Kërkesa për shqyrtim të mëtejshëm mund të depozitohet nga aplikanti ose mbajtësi i të drejtave brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit nga DPPI-ja për humbjen e afatit për kryerjen e veprimit dhe pasojat ligjore, që vijnë prej saj.

3. Kur veprimi i pakryer nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja e refuzon kërkesën për shqyrtim të mëtejshëm me vendim.

4. Në rast se kërkesa dhe kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni përmbushen nga aplikanti ose mbajtësi i të drejtave, pasojat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni konsiderohen se nuk kanë sjellë efekte.

5. Ndalohet të depozitohet kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm, kur moskryerja lidhet me afatin që caktohet:

a) për depozitimin e kërkesës për ushtrimin e kërkesës të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, pasi është humbur e drejta për të bërë kërkesë sipas kësaj pike;

b) për depozitimin e kërkesës për dhënien, rivendosjen, korrigjimin ose shtimin e së drejtës së prioritetit;

c) për depozitimin e kërkesës për rivendosjen në afat për ushtrimin e të drejtave;

ç) për pagesën e tarifave për mbajtjen e të drejtave të vlefshme;

d) për depozitimin e kërkesës për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë ose zgjatjes së afatit të saj; ose

dh) për të gjitha veprimet e kryera dhe të drejtat e ushtruara gjatë ndjekjes së procedurave para DPPI-së.

6. Çdo person, që në mirëbesim ka shfrytëzuar ose ka bërë përgatitje të vërteta, reale dhe serioze

(*genuine*) për shfrytëzimin e shpikjes, që është objekt i një kërkesë të botuar, në periudhën ndërmjet humbjes të së drejtës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe botimit të informacionit për aprovimin e kërkesës për shqyrtim të mëtejshëm, ka të drejtë ta vazhdojë këtë shfrytëzim, pa të drejtë kompensimi për dëmet, vetëm për qëllime të biznesit të tij dhe të nevojave që lidhen me këtë biznes.

7. Përmbajta e informacionit për shqyrtim të mëtejshëm për t'u botuar në buletin e DPPI-së përcaktohet në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Ndryshimi i emrit dhe i adresës

1. Regjistrimi i ndryshimeve të emrit ose të adresës bëhet me vendim të DPPI-së, kur aplikanti ose mbajtësi i patentës plotëson këto kushte:

a) depoziton kërkesën për ndryshimin e emrit ose të adresës;

b) depoziton dokumentin, që provon ndryshimin e kërkuar;

c) depoziton autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga një përfaqësues;

ç) depoziton dokumentin, që tregon se është kryer pagesa e tarifës përkatëse.

2. Regjistrimi në një kërkesë të vetme i disa kërkesave për ndryshime emri ose adrese, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me vendim të DPPI-së vetëm kur aplikanti ose mbajtësi i të drejtave tregon në kërkesën e vetme numrat e të gjitha kërkesave për ndryshim emri ose adrese dhe paguan tarifën përkatëse për secilën prej kërkesave.

3. Kur aplikanti ose mbajtësi i të drejtave nuk plotëson kushtet për regjistrimin e një ndryshimi emri ose adrese sipas këtij neni, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Me kërkesë të aplikantit ose të mbajtësit të së drejtës, afati i caktuar në pikën 3 të këtij neni zgjatet nga DPPI-ja deri në 1 (një) muaj.

5. Nëse e meta ose mangësia nuk plotësohet brenda afatit të caktuar, DPPI-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës.

6. Kur kushtet e parashikuara në këtë nen plotësohen, DPPI-ja regjistron ndryshimin e kërkuar në regjister dhe e boton atë në buletin.



7. Dispozitat e këtij neni zbatohen njëloj edhe për ndryshimin e emrit dhe të adresës të përfaqësuesit dhe për çdo ndryshim, që ka lidhje me adresën për korrespondencën.

8. Forma, përmbajtja dhe struktura e kërkesës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe informacioni për t'u botuar në buletin përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II PROCEDURA PËR MBROJTJEN E SHPIKJES

Neni 30

Depozitimi i kërkesës për patentë

1. Procedura për mbrojtjen e shpikjes fillon me depozitimin e kërkesës për patentë në DPPI.

2. Detajet për mënyrën dhe kërkesat teknike për depozitimin e një kërkesë për patentë përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Uniteti i shpikjes

1. Për çdo shpikje depozitohet një kërkesë e vetme për patentë.

2. Lejohet të paraqitet një kërkesë e vetme për një patentë për disa shpikje vetëm kur këto shpikje lidhen në një mënyrë të tillë, që formojnë një koncept shpikës të vetëm.

Neni 32

Përmbajtja e kërkesës për patentë

1. Kërkesa për patentë përmban:

- a) kërkesën për dhënien e patentës;
- b) përshkrimin e shpikjes;
- c) një ose më shumë pretendime;
- ç) çdo vizatim, që referohet në përshkrimin e shpikjes ose në pretendime, kur është e nevojshme;
- d) abstraktin e shpikjes.

2. Përmbajtja dhe mënyra e përgatitjes së secilit element të kërkesës, si dhe dokumentet e

nevojshme, që i bashkëlidhen kërkesës, përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 33

Kërkesa për dhënien e patentës

1. Kërkesa për dhënien e patentës përmban:

- a) një tregues të qartë se pse kërkohet dhënia e patentës;
- b) titullin e shpikjes, që tregon qartë dhe në mënyrë koncize thelbin e shpikjes;
- c) të dhëna në lidhje me aplikantin;
- ç) të dhëna në lidhje me shpikësin; ose
- d) një deklaratë të shpikësit, kur ky nuk dëshiron që emri i tij të përmendet në kërkesë.

2. Deklarata me shkrim e shpikësit se nuk dëshiron që emri i tij të përmendet në kërkesë depozitohet në DPPI brenda 3 (tre) muajve nga data e depozitimit të kërkesës.

3. DPPI-ja nuk verifikon autenticitetin e të dhënave, që jepen në kërkesën për dhënien e patentës.

Neni 34

Përshkrimi i shpikjes

1. Përshkrimi i shpikjes duhet të jetë mjaftueshëm i qartë dhe i saktë, si dhe të zbulojë e të tregojë informacionin e nevojshëm që të mundësojë realizimin e shpikjes nga një person i kualifikuar në fushën e arritjes.

2. Përshkrimi i shpikjes përmban veçanërisht:

- a) fushën teknike me të cilën lidhet shpikja;
- b) problemin teknik, zgjidhja e të cilit kërkohet të mbrohet me patentë;
- c) arritjen e mëparshme;
- ç) bërjen publike të shpikjes;
- d) një paraqitje, përshkrim të shkurtër të vizatimeve, nëse ka të tilla;
- dh) një përshkrim të detajuar të paktën të një mënyre të realizimit të shpikjes; dhe
- e) mënyrën në të cilën shpikja është e zbatueshme në industri.

3. Nëse shpikja përfshin përdorimin e një materiali të mundshëm biologjik ose lidhet me një material të tillë, që nuk është i disponueshëm për publikun dhe që nuk ka mundësi të bëhet publik në



kërkesë sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shpikja konsiderohet se është bërë publike në mënyrë të qartë dhe të saktë, kur plotësohen këto kushte:

a) një mostër e këtij materiali të jetë depozituar në institucionin përgjegjës për depozitimin e mikroorganizmave jo më vonë se në datën e depozitimit të kërkesës për patentë;

b) kërkesa për patentë të përmbajë të gjithë informacionin e njohur për aplikantin mbi materialin e mundshëm biologjik të depozituar; dhe

c) kërkesa për patentë të përmbajë emrin e një institucioni të autorizuar për depozitimin e mikroorganizmave dhe numrin e regjistrimit të materialit biologjik.

4. Informacioni i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni depozitohet brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve nga data e depozitimit të kërkesës për patentë ose nga data e prioritetit më të hershëm, nëse është pretenduar për prioritet, por jo jashtë afatit brenda të cilit ishin bërë përgatitjet teknike për të botuar kërkesën në buletin.

5. Nëse kërkesa për patentë përmban bërjen publike të një ose disa sekuencave nukleotidesh ose aminoacidesh, përshkrimi i kërkesave përmban listën e këtyre sekuencave.

6. Lista e sekuencave të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, që depozitohet pas datës së depozitimit të kërkesës për patentë, nuk bëhet pjesë e përshkrimit të shpikjes.

Neni 35 Vizatimet

1. Vizatimet janë një tërësi figurash, që përfaqësojnë një shtesë plotësuese të përshkrimit teknik të shpikjes, me qëllimin për të bërë të qartë dhe të kuptueshme paraqitjen e të gjitha elementeve teknike të shpikjes, të cilat janë thelbësore për realizimin e saj.

2. Vizatimet nuk janë të detyrueshme.

Neni 36 Pretendimet

1. Pretendimet përcaktojnë objektin për të cilin kërkohet mbrojtja e shpikjes.

2. Pretendimet duhet të jenë të qarta, të përmbledhura saktë dhe të mbështetura plotësisht nga përshkrimi i shpikjes.

3. Pretendimet janë të pavarura dhe të varura.

4. Pretendimet e pavarura përmbajnë karakteristikat e reja dhe thelbësore të shpikjes, ndërsa pretendimet e varura përmbajnë karakteristikat specifike të shpikjes, siç përcaktohet në një pretendim të pavarur ose në një pretendim tjetër të varur.

5. Rregulla më të detajuara për paraqitjen e pretendimeve parashikohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 37 Abstrakti

1. Abstrakti është një përmbledhje e shkurtër e thelbit të shpikjes, që përbën një mjet efikas për kërkime në fushën teknike përkatëse.

2. Abstrakti nuk shërben për qëllime të tjera dhe veçanërisht as për qëllime të interpretimit të objektit të mbrojtjes së kërkuar, si dhe as për qëllime të zbatimit të parashikimeve, që përcaktohen në pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji.

3. DPPI-ja, kur e konsideron të domosdoshme, i kërkon aplikantit të ndryshojë abstraktin.

Neni 38 Disponueshmëria e materialit biologjik organik

1. Mostra e depozituar e materialit biologjik, sipas pikës 3 të nenit 34 të këtij ligji, vihet në dispozicion me kërkesë:

a) të çdo personi, që ka marrë miratimin e aplikantit për këtë qëllim deri në botimin e kërkesës për patentë, si dhe të çdo personi, që paraqet një kërkesë të tillë pa miratimin e aplikantit, me kusht që kërkuesi të sjellë prova se aplikanti ka vepruar kundër tij;

b) të çdo personi që paraqitet ndërmjet datës së botimit të kërkesës dhe datës së dhënies së patentës; dhe

c) të çdo personi, pasi patentë të jetë dhënë, pavarësisht nëse ajo është deklaruar e pavlefshme ose është shfuqizuar.

2. Mostra jepet vetëm nëse personi që e kërkon atë merr përsipër që deri në përfundimin e procedurës së dhënies së patentës ose gjatë



periudhës që patenta është e vlefshme të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të mos e vërë mostrën ose ndonjë material që rrjedh prej saj në dispozicion të palëve të treta;

b) të mos e përdorë mostrën apo ndonjë material që rrjedh prej saj, veçse për qëllime eksperimentale ose kërkimore, përveçse kur aplikanti ose mbajtësi i patentës, sipas rastit, heq dorë shprehimisht nga detyrimi i kërkesës, me anën e të cilës detyrimi për të përdorur një mostër ose ndonjë material të rrjedhur prej tij vetëm për qëllime eksperimentale ose kërkimore nuk do të zbatohet për një aplikant që e përdor atë mostër ose material sipas një licence të detyrueshme.

3. Derisa të plotësohen kërkesat teknike për botimin e një kërkesë për patentë, aplikanti ka të drejtë të depozitojë një kërkesë për të lejuar disponueshmërinë e materialit të depozituar vetëm nëpërmjet dhënies së një mostre një eksperti të pavarur të caktuar nga vetë aplikanti:

a) deri në botimin e dhënies së patentës; ose

b) brenda një afati prej 20 (njëzet) vjetësh nga data e depozitimit, përveç kur kërkesa refuzohet, shfuqizohet ose procedura pezullohet me kërkesë, raste në të cilat zbatohet pika 2 e këtij neni.

4. Kur materiali biologjik i depozituar në përputhje me këtë nen nuk është më i disponueshëm në një institucion për depozitim mikroorganizmash, pranohet një depozitim i ri i materialit në një institucion të ri me të njëjtat kushte me ato të përcaktuara në Traktatin e Budapestit.

5. Ndërprerja e disponueshmërisë së materialit nuk sjell pasojë ligjore nëse certifikata e depozitimit e lëshuar nga institucion i ri i autorizuar për depozitim mikroorganizmash, që vërteton se materiali i ri i depozituar është i njëjtë me atë të depozituar fillimisht, paraqitet në DPPI brenda 4 (katër) muajve nga data e depozitimit të ri.

Neni 39

Përmbajtjet që ndalohen të përfshihen në kërkesë

1. Kërkesa nuk duhet të përmbajë:

a) tregues ose përmbajtje të tjera, që janë në kundërshtim me ligjin ose moralin;

b) tregues ose shënime, që diskreditojnë produkte ose veprime të një personi të tretë, cilësinë ose kuptimin e një kërkesë ose patente të këtij

personi. Krahassimi me ish-arritjen e mëparshme, në vetvete, nuk është diskreditues; ose

c) tregues ose përmbajtje të tjera, që dukshëm nuk janë as thelbësore, as të nevojshme.

2. Kur kërkesa përmban tregues ose përmbajtje të tjera nga ato që parashikohen në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja ka të drejtë t'i heqë dhe të mos i botojë ato dhe shënon ose tregon vendin dhe numrin e fjalëve e të vizatimeve të hequra.

Neni 40

Përmbajtja e kërkesës për patentë e domosdoshme për dhënien e datës së depozitimit

1. DPPI-ja i jep një kërkesë datë depozitimi, kur kërkesa përmban:

a) një tregues për të cilin kërkohet dhënia e patentës;

b) të dhëna për aplikantin ose të dhëna që mundësojnë kontaktin me aplikantin; dhe

c) pjesën që duket me shikim të parë si përshkrim i shpikjes ose një referencë të kërkesës e depozituar më parë.

2. Referenca të kërkesës e depozituar më parë, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e depozitimit dhe numrin e asaj kërkesë, të dhënat e zyrës, ku është depozituar kjo kërkesë, dhe një tregues që kërkesa e mëparshme zëvendëson përshkrimin dhe vizatimet.

3. Kur kërkesa përmban referencën e përmendur në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni, brenda 2 (dy) muajve nga data e depozitimit të kërkesës së mëparshme, një kopje e kësaj kërkesë depozitohet në DPPI, në të cilën përmbahet vërtetimi i zyrës së përmendur në pikën 2 të këtij neni, si dhe përkthimi në shqip i kërkesës, nëse ky është depozituar në gjuhë të huaj.

KREU III

E DREJTA PËR PRIORITET

Neni 41

Prioriteti nga një kërkesë e mëparshme

1. Nëse e njëjta shpikje është krijuar nga dy ose më shumë shpikës në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, prioriteti në lidhje me të drejtën për patentë i përket aplikantit, kërkesa për patentë e të cilit ka datë



depozitimi më të hershme, me kusht që kjo kërkesë të jetë botuar sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Prioriteti bëhet efektiv nga data e depozitimit të kërkesës në DPPI, përveçse kur zbatohen kërkesat për dhënien e së drejtës së prioritetit, të parashikuara në nenet 42 e 43 të këtij ligji.

Neni 42

E drejta për prioritet ndërkombëtar

1. Çdo person që ka paraqitur një kërkesë të rregullt për patentë në një shtet anëtar të Unionit të Parisit ose në një shtet anëtar të OBT-së gëzon të drejtën e prioritetit në Republikën e Shqipërisë për një afat 12-mujor nga data e depozitimit të kërkesës në njërin prej këtyre shteteve anëtare.

2. Kërkesa e rregullt për patentë në Republikën e Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, merr për datë depozitimi datën e depozitimit që i është dhënë kërkesës në shtetin anëtar përkatës të Unionit të Parisit ose të OBT-së, në përputhje me legjislacionin kombëtar të atij shteti, ose në përputhje me një traktat ndërkombëtar të lidhur ndërmjet shteteve, pavarësisht rezultatit të mëpasshëm ligjor të kërkesës së parë.

3. Një kërkesë për patentë e mëvonshme për të njëjtën shpikje me atë të kërkesës së parë ndalohet të depozitohet në të njëjtin shtet ose për të njëjtin shtet, ku gjendet e regjistruar kërkesa e parë, përveçse kur kërkesa e parë është refuzuar ose tërhequr pa u bërë i mundshëm dhe i disponueshëm për publikun, si dhe pa sjellë asnjë pasojë juridike.

4. Në rast se bëhet një kërkesë e mëvonshme për të njëjtën shpikje me një kërkesë të parë në të njëjtin shtet ose për të njëjtin shtet, në kundërshtim me kushtet e caktuara në pikën 3 të këtij neni, kërkesa e mëvonshme është e pavlefshme, si dhe nuk shërben si bazë për të pretenduar prioritet.

Neni 43

E drejta për prioritet

1. Aplikanti që pretendon prioritet për një kërkesë për patentë sipas nenit 42 të këtij ligji, depoziton në DPPI një kërkesë për prioritet, e cila përmban numrin e kërkesës së parë, datën e depozitimit dhe shtetin ose organizatën ndërkombëtare, në të cilën ose për të cilën është depozituar kërkesa e parë.

2. Pretendimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund të depozitohet në DPPI bashkë me kërkesën për patentë, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

3. Aplikanti i kërkesës për patentë ka të drejtë të pretendojë disa prioritate bazuar në disa kërkesa të mëparshme në disa shtete të ndryshme, anëtare të Unionit të Parisit ose të OBT-së. Afati për të depozituar kërkesën për prioritet, sipas këtij ligji, për të gjitha pretendimet e mëparshme fillon të llogaritet nga data e kërkesës, që mban datën më të hershme të prioritetit midis kërkesave të mëparshme në ato shtete.

4. Aplikanti i një kërkesë për patentë, që pretendon të drejtë ose datë prioriteti, është i detyruar të depozitojë në DPPI një kopje të kërkesës së parë ose me datë më të hershme kërkesë, kur ka bërë disa kërkesa, të vërtetuar nga autoriteti kompetent i shtetit ose i shteteve anëtare të Unionit të Parisit ose OBT-së, në të cilin ose për të cilin është ose janë depozituar, por, në çdo rast, jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj nga data e prioritetit më të hershëm të pretenduar.

5. Kur kërkesa që pretendon prioritet nuk është në gjuhën shqipe dhe bazueshmëria e tij është e rëndësishme për të përcaktuar patentueshmërinë e shpikjes, DPPI-ja ka të drejtë t'i kërkojë aplikantit të depozitojë një përkthim të asaj kërkesë në gjuhën shqipe brenda 2 (dy) muajve nga marrja e njoftimit.

Neni 44

Efekti i së drejtës së prioritetit

Data e prioritetit konsiderohet si data e depozitimit të kërkesës për patentë në DPPI, në kuptim të pikave 2 dhe 3 të nenit 9 dhe të pikës 1 të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 45

Korrigjimi ose shtimi i pretendimit për prioritet

1. Aplikanti ka të drejtë të depozitojë një kërkesë për korrigjimin ose shtimin e pretendimit për prioritet brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve nga data më e hershme e prioritetit ose kur korrigjimi apo shtesa shkakton ndryshimin e datës më të hershme të prioritetit, kërkesa depozitohet brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve nga data e prioritetit



të ndryshuar, nga të cilët do të zbatohet ai afat 16-mujor, që mbaron më parë, me kusht që:

a) të depozitohet kërkesa për korrigjim ose shtim brenda 4 (katër) muajve nga data e depozitimit të kërkesës për patentë; dhe

b) të jetë paguar tarifa përkatëse.

2. Ndalohej të depozitohet kërkesë për korrigjimin ose shtimin e një pretendimi për prioritet nëse aplikanti ka depozituar një kërkesë për botim të parakohshëm, sipas pikës 3 të nenit 57 të këtij ligji, përveçse kur kërkesa për botim është tërhequr para botimit.

3. Nëse data e prioritetit ndryshon për shkak të korrigjimit ose shtimit të pretendimit për prioritet, afatet llogariten nga data e prioritetit të ndryshuar.

4. Korrigjimi ose shtimi i kërkesës për pretendim për prioritet përfshin korrigjimin ose shtimin e çdo të dhëne, që parashikohet në pikën 1 të nenit 43 të këtij ligji.

5. Kërkesa për korrigjim ose shtimin e pretendimit për prioritet refuzohet kur nuk paguhet tarifa përkatëse e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 46

Kërkesa për rivendosjen në afat për të drejtën e prioritetit

1. Kur aplikanti nuk e ka depozituar kërkesën për prioritet brenda afatit 12-mujor ose e ka paraqitur kërkesën jashtë afatit 12-mujor, siç kërkohet në pikën 1 të nenit 42 të këtij ligji, aplikanti ka të drejtë të depozitojë një kërkesë për rivendosjen në afat për të drejtën e prioritetit, me kusht që:

a) kërkesa për rivendosjen në afat për të drejtën për prioritet të depozitohet në DPPI brenda 2 (dy) muajve nga data e mbarimit të periudhës së prioritetit;

b) të tregohen arsyet dhe të paraqiten shpjegimet ose provat që vërtetojnë se aplikanti nuk mundi të depozitojë kërkesën për prioritet brenda afatit për shkak të pavarura nga vullneti i tij; dhe

c) të paguhet tarifa përkatëse.

2. Kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës për prioritet refuzohet me vendim, nëse ajo nuk plotëson të gjitha kushtet e pikës 1 të këtij neni.

3. Nuk mund të depozitohet një kërkesë për rivendosjen në afat kur aplikanti ka depozituar një kërkesë për botim të kërkesës, në përputhje me pikën 3 të nenit 57 të këtij ligji, përveçse kur kjo

kërkesë për botim është tërhequr nga aplikanti para botimit.

Neni 47

Karakteristikat e shpikjes, objekt i pretendimit për prioritet

1. Pretendimi për prioritet lidhet vetëm me ato karakteristika të shpikjes, që përmbahen në kërkesën e parë ose në kërkesat, për të cilat kërkohet prioritet.

2. Nëse disa karakteristika të shpikjes për të cilat kërkohet prioritet nuk shfaqen nëpërmjet pretendimeve të formuluar në kërkesën e parë ose në kërkesat e tjera, e drejta për prioritet jepet vetëm kur elementet e kërkesës së marrë në tërësi bëjnë të njohur specifikisht të gjitha këto karakteristika.

KREU IV

EKZAMINIMI I KËRKESËS

Neni 48

Dhënia e datës së depozitimit

1. Pas depozitimit të një kërkesë për patentë, DPPI-ja shqyrton nëse kërkesa është në përputhje me kërkesat për dhënien e datës së depozitimit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 40 të këtij ligji.

2. Nëse kërkesa nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 40 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon aplikantit një njoftim për të plotësuar të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga marrja e njoftimit.

3. Kur aplikanti i plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, data e njoftimit të DPPI-së dërguar aplikantit se janë plotësuar të metat ose mangësitë konsiderohet si data e depozitimit të kërkesës për patentë.

4. Me kërkesë të aplikantit, DPPI-ja ka të drejtë të zgjasë afatin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni me një afat shtesë prej një muaji.

5. Kur aplikanti nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të parashikuar në pikat 2 ose 4 të këtij neni, sipas rastit, DPPI-ja e refuzon kërkesën me vendim.

Neni 49

Pjesë që mungojnë në përshkrimin ose në vizatimet

1. Kur gjatë ekzaminimit të kërkesës për patentë për dhënien e datës së depozitimit, DPPI-ja



konstaton se një pjesë e përshkrimit ose e vizatimeve të shpikjes të përcaktuar në kërkesë mungon, ose kërkesa përmban të meta ose mangësi, që lidhen me nenin 40 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon njoftim aplikantit për të paraqitur pjesët që mungojnë, sipas kësaj pike, ose për të plotësuar të metat ose mangësitë, sipas nenit 40, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Kur aplikanti e depoziton mungesën ose plotëson të metat dhe mangësitë brenda afatit 2-mujor, kërkesa merr si datë depozitimi datën që aplikanti i plotëson dhe i depoziton këto të meta ose mangësi. Kur depozitimet e mungesave ose të plotësimeve bëhen në kohë të ndryshme, kërkesa merr si datë depozitimi datën që është bërë depozitimi i fundit i mangësive ose i plotësimeve.

3. Kur pjesa që mungon e përshkrimit ose e vizatimeve të shpikjes depozitohet brenda afatit dymujor, si dhe kur për kërkesën pretendohet prioritet i mëparshëm, data e depozitimit konsiderohet data kur plotësohen të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 40 të këtij ligji, me kusht që pjesa që mungon e përshkrimit ose e vizatimeve të përfshihen plotësisht në kërkesën e mëparshme.

4. Kur pjesa e përshkrimit ose e vizatimeve nuk depozitohet, konsiderohet se aplikanti nuk u referohet më atyre pjesëve.

5. Me kërkesë të aplikantit, DPPI-ja ka të drejtë të zgjasë afatin e caktuar në pikën 1 të këtij neni me një afat shtesë prej një muaji.

Neni 50

Regjistrimi i kërkesës në regjistër

Pasi merr datë depozitimi, kërkesa për patentë regjistrohet në regjistrin përkatës dhe ky regjistrim i njoftohet me shkrim aplikantit nga DPPI-ja.

Neni 51

Certifikata e prioritetit

1. Me kërkesë të aplikantit dhe pasi është bërë pagesa e tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon certifikatën e së drejtës së prioritetit.

2. Përmbajtja e certifikatës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përcaktohet në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Ndarja e kërkesës për patentë

1. Aplikanti, me kërkesë të tij ose të DPPI-së, e ndan objektin e kërkesës fillestare për patentë në dy ose në më shumë kërkesa të ndara. Në një rast të tillë, aplikanti ndjek procedura më vete për secilën kërkesë të ndarë.

2. Objekti i çdo kërkesë të ndarë për patentë nuk shtrihet përtej përmbajtjes së kërkesës fillestare.

3. Ndarja e kërkesës fillestare për patentë lejohet të bëhet derisa nuk është marrë vendimi për dhënien e patentës për shpikjen për të cilën është bërë kërkesë fillestare.

4. Kërkesa e ndarë mban si datë depozitimi atë të kërkesës fillestare dhe, kur ka prioritet, mban datën e prioritetit.

5. Dokumentet e prioritetit dhe të gjitha përkthimet e tjera që janë paraqitur në DPPI për kërkesën fillestare janë të vlefshme për çdo kërkesë të ndarë.

Neni 53

Ekzaminimi i formaliteteve të kërkesës

1. Pasi kërkesa për patentë merr datë depozitimi, DPPI-ja ekzaminon nëse aplikanti ka plotësuar kushtet si më poshtë:

a) të ketë paguar tarifën për depozitimin e kërkesës;

b) të jetë depozituar përkthimi i kërkesës në gjuhën shqipe, kur kërkesa është hartuar në gjuhë të huaj;

c) të jetë paraqitur autorizimi i përfaqësimit, kur kërkesa depozitohet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar, ose kur aplikanti përfshihet në rrethin e personave, që parashikohen në pikën 1 të nenit 16 të këtij ligji;

ç) të jetë caktuar shpikësi ose, kur shpikësi nuk dëshiron të përmendet në kërkesë, të jetë depozituar deklarata e tij që nuk dëshiron të përmendet;

d) të jenë depozituar të gjithë zërat ose elementet e caktuara në nenin 32 të këtij ligji dhe dokumentet bashkëlidhur tyre; dhe

dh) të jetë depozituar pretendimi për prioritet, në rast se pretendohet për prioritet.

2. Kur gjatë ekzaminimit rezulton se nuk janë përmbushur një ose disa kushte, që kërkohen në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja njofton aplikantit për



të plotësuar të metat ose mangësitë brenda dy muajve nga marrja e njoftimit.

3. Me kërkesë të arsyetuar të aplikantit, DPPI-ja ka të drejtë të zgjasë afatin dymujor edhe me një afat shtesë prej dy muajsh.

4. Kur DPPI-ja konstaton një të metë në lidhje me pretendimin për prioritet, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, dhe, me gjithë njoftimin e marrë, aplikanti nuk e plotëson këtë të metë brenda afatit ose afatit shtesë, sipas rastit, të caktuar në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja e refuzon pretendimin për prioritet. Megjithatë, aplikanti ka të drejtë të kërkojë të rivendoset në afat, kur janë kushtet e nenit 46 të këtij ligji.

Neni 54

Ndryshime në kërkesën për patentë

1. Aplikanti nuk ka të drejtë të ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe vizatimet pas dërgimit të kërkesës për hartimin e raportit të hetimit, sipas nenit 56 të këtij ligji.

2. Kërkesa për patentë, të cilës i është dhënë një datë depozitimi, nuk ndryshohet më pas në ndonjë mënyrë, që ndryshimi të kalojë ose të shtrihet tej objektit të shpikjes për të cilën është kërkuar mbrojtja me anën e kërkesës për patentë.

Neni 55

Vazhdimi i ekzaminimit të kërkesës për patentë

1. Gjatë procedurës së ekzaminimit të mëtejshëm të kërkesës për patentë, pasi ka përfunduar ekzaminimi për formalitete, sipas nenit 53 të këtij ligji, DPPI-ja ekzaminon nëse kërkesa u përmbahet kushteve të mëposhtme:

a) nëse kërkesa është hartuar siç kërkohet nga nenet 31, 32, 34, 35, 36, 37, 38 dhe 39 të këtij ligji; dhe

b) nëse objekti i mbrojtjes është një shpikje, që nuk përjashtohet nga mbrojtja, në kuptim të neneve 5, pikat 2 dhe 3, 6, 7, 8 dhe 12 të këtij ligji.

2. Kur gjatë ndjekjes së procedurës së ekzaminimit, DPPI-ja konstaton se kërkesa përmban të meta ose mangësi për sa i përket përmbushjes së kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ajo i dërgon aplikantit njoftim për të plotësuar të metat ose mangësitë brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Pas marrjes së njoftimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, aplikanti ka të drejtë të ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe vizatimet, me kusht që ndryshimi të depozitohet së bashku me një përgjigje ndaj rezultatit të ekzaminimit dhe kërkesa për botim të parakohshëm të kërkesës për patentë të mos jetë depozituar më parë në DPPI.

4. Me kërkesë të arsyetuar të aplikantit, si dhe pas kryerjes së pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja ka të drejtë të shtyjë afatin kohor të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni me një muaj shtesë.

Neni 56

Kërkesa për raport hetimi

1. Aplikanti ka të drejtë të paraqesë kërkesë në DPPI për të kryer një hetim për arritjen e mëparshme, që përbën objektin e kërkesës për patentë, nga një autoritet i huaj ndërkombëtar me të cilin DPPI-ja ka lidhur marrëveshje ose tek një autoritet hetimi ndërkombëtar, sipas nenit 15(5)(b) të TBP-së.

2. Kërkesa për hetim bëhet brenda 13 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për patentë ose, kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit.

3. Kërkesa për hetim shoqërohet me pagimin e tarifës përkatëse. Aplikanti ka të drejtë t'i kërkojë DPPI-së zgjatjen e afatit për pagimin e tarifës deri në pesë muaj, kërkesë e cila nuk refuzohet nga DPPI-ja. DPPI-ja nuk e kryen hetimin nëse nuk është paguar tarifa caktuar.

4. Kur aplikanti nuk arrin të depozitojë një kërkesë për hetim brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni ose nuk e paguan tarifën e caktuar në pikën 3 të këtij neni, kërkesa për patentë konsiderohet se është tërhequr.

5. Në rast se kërkesa konsiderohet si e tërhequr, sipas pikës 4 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon njoftim aplikantit, ku e njofton atë për të drejtat që ka, sipas neneve 27 dhe 28 të këtij ligji.

6. Kur aplikanti i përmbush kërkesat e caktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, DPPI-ja përcjell kërkesën për hetim tek autoriteti i huaj ndërkombëtar të caktuar nga aplikanti, sipas pikës 1 të këtij neni.



KREU V BOTIMI I KËRKESËS PËR PATENTË

Neni 57

Mënyra dhe përmbajtja e botimit të kërkesës për patentë

1. DPPI-ja e boton kërkesën për patentë në buletin e saj menjëherë pas përfundimit të afatit prej 18 muajsh nga data e depozitimit të kërkesës ose, kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit.

2. DPPI-ja nuk e boton kërkesën për patentë nëse kërkesa është tërhequr ose është refuzuar përpara mbarimit të afatit 18-mujor, siç caktohet në pikën 1 të këtij neni.

3. Me kërkesë të aplikantit, e shoqëruar me pagesën e tarifës së caktuar, DPPI-ja e boton kërkesën për patentë përpara mbarimit të afatit 18-mujor, por jo më parë se tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës për botim të parakohshëm në DPPI. Botimi i parakohshëm bëhet në buletin e radhës.

4. DPPI-ja, menjëherë pas vendimit për dhënien e patentës, e boton atë së bashku me specifikimet, sipas rregullores për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. DPPI-ja boton në buletin të gjitha ndryshimet, që lidhen me patentën ose statusin e saj ligjor.

6. Botimet sipas këtij neni mund të kufizohen për shpikje të caktuara, rast pas rasti, për arsye të mbrojtjes kombëtare dhe sekretit shtetëror, në zbatim të kërkesave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

7. DPPI-ja zbaton të gjitha masat mbrojtëse për informacionin e klasifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Ndalohet publikimi, riprodhimi ose shpërndarja e informacionit të klasifikuar lidhur me patentat dhe markat tregtare për armatimin dhe teknologjitë ushtarake.

8. Të dhënat e detajuara dhe procedurat në lidhje me botimin e kërkesës për patentë përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI EKZAMINIMI I KUSHTEVE PËR DHËNIEN E PATENTËS

Neni 58

Vendimi për refuzimin e patentës

Nëse kërkesa për patentë nuk përmbush kushtet që parashikohen në nenet 53 dhe 55 të këtij ligji, DPPI-ja e refuzon kërkesën për patentë me vendim.

Neni 59

Vendimi për dhënien e patentës

1. Kur kërkesa për patentë përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenet 53, 55 dhe 56 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim për të paguar tarifën përkatëse për dhënien e patentës brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse aplikanti paguan tarifën brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja merr vendim për regjistrimin e patentës.

3. Nëse aplikanti nuk paguan tarifën përkatëse brenda afatit sipas pikës 1 të këtij neni, DPPI-ja refuzon kërkesën për patentë me vendim.

4. DPPI-ja i lëshon patentat pa kryer ekzaminimin thelbësor për patentueshmërinë e shpikjeve. Vlera e çdo shpikjeje ose e saktësisë së dokumenteve shoqëruese të saj është tërësisht në përgjegjësinë e vetë aplikantit.

Neni 60

Regjistrimi i të drejtave të dhëna

Të dhënat në lidhje me një patentë apo model përdorimi të lëshuar nga DPPI-ja regjistrohen në regjistrat përkatës.

Neni 61

Certifikata për patentë

1. Kur merr vendim për dhënien e patentës, DPPI-ja i jep pronarit të saj certifikatën për patentë.

2. Përmbajtja dhe forma e certifikatës për patentë përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 62

Specifikimet e patentës

1. Specifikimet e patentës i jepen pronarit të saj brenda një muaji nga data e vendimit për dhënien e patentës.

2. Përmbajtja dhe forma e specifikimeve të patentës përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Botimi i vendimit për dhënien e patentës

1. Vendimi për dhënien e patentës botohet në buletin e DPPI-së.

2. Të dhënat që botohen në buletin e DPPI-së përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA V

MODELET E PËRDORIMIT

Neni 64

Kushtet dhe objekti i mbrojtjes

1. Një shpikje mund të regjistrohet si model përdorimi në rast se ajo është e re dhe e zbatueshme në industri.

2. Pikat 2 dhe 3 të nenit 5, neni 7 dhe pika 1 e nenit 8 të këtij ligji zbatohen njëjloj (*mutatis mutandis*) edhe për modelet e përdorimit.

3. Një model përdorimi nuk regjistrohet për:

- a) shpikjet në fushën e bioteknologjisë;
- b) substancat kimike ose farmaceutike; dhe
- c) proceset.

4. Nenet 9, 10 dhe 12 të këtij ligji në lidhje me risinë dhe zbatueshmërinë në industri zbatohen njëjloj (*mutatis mutandis*) edhe për modelet e përdorimit.

5. Nenet 93, 96, 98, 100, 101 dhe 102 të këtij ligji në lidhje me të drejtat e fituara, përjashtimet dhe kufizimet zbatohen njëjloj edhe për modelet e përdorimit.

6. Neni 103 i këtij ligji në lidhje me licencat detyruese zbatohet njëjloj (*mutatis mutandis*) për modelet e përdorimit.

7. Pjesa X e këtij ligji në lidhje me transferimin e të drejtave, licencimin, të drejtat reale (*in rem*) dhe çështjet e lidhura me to zbatohet njëjloj edhe për modelet e përdorimit.

8. Pjesa XI e këtij ligji në lidhje me pavlefshmërinë zbatohet njëjloj (*mutatis mutandis*) edhe për modelet e përdorimit.

Neni 65

E drejta e prioritetit kombëtar

1. Çdo person që ka depozituar një kërkesë për patentë gëzon prioritet nga data e depozitimit të asaj kërkesë për qëllime të kërkesës për një model përdorimi ose të konvertimit të kërkesës për patentë në kërkesë për model përdorimi, me kusht që kërkesa për model përdorimi për të njëjtën shpikje të jetë depozituar brenda 12 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për patentë, si dhe të mos jetë pretenduar prioritet për kërkesën për patentë.

2. Aplikanti për modelin e përdorimit depoziton kërkesën për prioritet sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se dy muaj nga data e depozitimit të kërkesës për patentë.

3. Nenet 42 dhe 43 të këtij ligji në lidhje me prioritetin ndërkombëtar zbatohen edhe për prioritetin kombëtar.

4. Nenet 42 dhe 43 të këtij ligji në lidhje me të drejtën e prioritetit ndërkombëtar zbatohen njëjloj (*mutatis mutandis*) edhe për modelet e përdorimit.

Neni 66

Kërkesa për model përdorimi

1. Procedura për regjistrimin e një modeli përdorimi fillon me depozitimin në DPPI të kërkesës për modelin e përdorimit, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse.

2. Kërkesa për model përdorimi përmban:

- a) kërkesën për regjistrimin e modelit të përdorimit;
- b) përshkrimin e shpikjes;
- c) një ose më shumë pretendime, që përcaktojnë objektin e shpikjes;
- ç) vizatimet që përmenden në përshkrimin e shpikjes dhe pretendimet, kur është e nevojshme; dhe
- d) abstraktin e shpikjes.

3. Kërkesa për model përdorimi nuk mund të përmbajë më shumë se dhjetë pretendime.



4. Pikat 1 dhe 2 të nenit 34, nenet 35, 36, 37, 39 dhe 40 të këtij ligji në lidhje me përmbajtjet e kërkesës zbatohen njëloj edhe për modelet e përdorimit. Nenet 31 dhe 48 të këtij ligji, respektivisht në lidhje me unitetin e shpikjes dhe me datën e depozitimit, zbatohen njëloj edhe për modelet e përdorimit.

Neni 67

Ekzaminimi i kërkesës për model përdorimi

1. Pas dhënies së datës së depozitimit, DPPI-ja ekzaminon nëse kërkesa për një model përdorimi i përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 53 të këtij ligji, si dhe nëse kërkesa për model përdorimi:

a) është në përputhje me nenin 66 të këtij ligji; dhe

b) vjen në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 64 të këtij ligji.

2. Kriteret për risinë dhe zbatueshmërinë në industri, sipas pikës 1 të nenit 64 të këtij ligji, në lidhje me modelet e përdorimit nuk ekzaminohen nga DPPI-ja.

3. Nëse gjatë procedurës së ekzaminimit, DPPI-ja konstaton se kërkesa nuk është në përputhje me të gjitha kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ajo i dërgon aplikantit njoftim që të korrigjojë të metat ose mangësitë brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Njoftimi, sipas pikës 3 të këtij neni, përmban rezultatin e ekzaminimit me shpjegimet përkatëse.

5. Pas marrjes së njoftimit, sipas pikës 3 të këtij neni, aplikanti ka të drejtë të ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe vizatimet, me kusht që ndryshimi të depozitohet së bashku me një përgjigje për rezultatin e ekzaminimit.

6. Me kërkesë të arsyetuar të aplikantit, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, DPPI-ja ka të drejtë të shtyjë afatin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni me një muaj tjetër shtesë.

7. Kërkesa për model përdorimi nuk botohet.

Neni 68

Vendimi për refuzimin e modelit të përdorimit

Regjistrimi i modelit të përdorimit refuzohet me vendim, kur, pas ekzaminimit të kryer nga DPPI-ja,

sipas nenit 67 të këtij ligji, kërkesa për model përdorimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara për regjistrim.

Neni 69

Vendimi për regjistrimin e modelit të përdorimit

1. Kur kërkesa për model përdorimi përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 67 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon njoftim aplikantit të paguajë tarifën përkatëse për regjistrimin e modelit të përdorimit brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse aplikanti e paguan tarifën brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja e regjistron modelin e përdorimit me vendim.

3. Nëse aplikanti nuk paguan tarifën përkatëse brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja e refuzon kërkesën për model përdorimi me vendim.

4. Të dhënat e regjistrimit të modelit të përdorimit regjistrohen në regjistrin përkatës.

Neni 70

Konvertimi i kërkesës

1. Aplikanti ka të drejtë të depozitojë një kërkesë në DPPI për konvertimin e një kërkesë për patentë në kërkesë për model përdorimi, e cila, pasi e ekzaminon, merr vendimin përkatës.

2. Kërkesa për konvertimin e kërkesës për patentë në kërkesë për model përdorimi depozitohet vetëm nëse nuk është marrë vendimi sipas nenit 68 ose nenit 69 të këtij ligji, kërkesë e cila shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

3. Kërkesa për konvertim mban datën e depozitimit të kërkesës për patentë.

PJESA VI

CERTIFIKATA E MBROJTJES SHITESË

Neni 71

Përkufizime për produkte mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve

1. Produkte mjekësore, në kuptim të këtij ligji, janë si më poshtë:

a) “produkt mjekësor” është çdo substancë ose kombinim substancash, që krijohen për trajtimin ose



parandalimin e sëmundjes në qeniet njerëzore ose tek kafshët, si dhe çdo substancë ose kombinim substancash, që mund të përdoren te qeniet njerëzore ose kafshët me synimin për përcaktimin e një diagnoze mjekësore ose për rivendosjen, rregullimin ose modifikimin e funksioneve fiziologjike te njerëzit ose te kafshët;

b) “produkt” është një përbërës aktiv ose kombinim përbërësish aktivë të një produkti mjekësor;

c) “patentë bazë” është një patentë që mbron një produkt si të tillë, një proces për të përfutur një produkt ose një kërkesë për një produkt, që projektohet nga mbajtësi i saj për ndjekjen e procedurës për marrjen e një certifikate mbrojtjeje shtesë;

ç) “certifikatë” është certifikatë e mbrojtjes shtesë, e cila është një mënyrë mbrojtjeje e pronësisë industriale, duke zgatur mbrojtjen e një shpikjeje të patentuar, veçanërisht për produktet farmaceutike dhe bimore, përtej afatit standard të një patente, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 88 të këtij ligji;

d) “kërkesa për zgjatje afati” është një kërkesë për zgjatjen e afatit të certifikatës, sipas pikës 3 të nenit 82 të këtij ligji;

dh) “prodhues” është një person, që ushtron aktivitetin ose është krijuar në Republikën e Shqipërisë, për llogari të të cilit bëhet një produkt ose një produkt mjekësor, që përmban atë produkt, për qëllime eksporti në vende të tjera ose për qëllime magazinimi.

2. Përkufizime për produktet e mbrojtjes së bimëve janë si më poshtë:

a) “produkte të mbrojtjes së bimëve” janë substanca dhe preparate aktive, që përmbajnë një ose më shumë substanca aktive të bëra në formën që i jepen përdoruesit dhe që synojnë:

i. të mbrojnë bimët ose produktet bimore kundër të gjithë organizmave të dëmshëm ose të parandalojnë veprimin e këtyre organizmave, për aq sa këto substanca ose preparate nuk përkufizohen ndryshe më poshtë;

ii. të ndikojnë në proceset jetësore të bimëve, përveç asaj të një ushqimi (p.sh. rregulloret për rritjen e bimëve);

iii. të ruajnë produktet bimore, për aq sa këto substanca ose produkte nuk janë objekt i dispozitave të veçanta për mbrojtjen;

iv. të shkatërrojnë bimët e padëshiruara; ose

v. të shkatërrojnë pjesë të bimëve, të kontrollojnë ose të parandalojnë rritjen e padëshiruar të bimëve.

b) “substanca” janë elemente kimike dhe përbërësit e tyre, siç krijohen ose ndodhin në mënyrë të natyrshme ose përmes prodhimit, duke përfshirë çdo papastërti të paevitueshme, që rezulton nga procesi i prodhimit;

c) “substanca aktive” janë substanca ose mikroorganizma duke përfshirë viruset, që kanë veprim të përgjithshëm ose specifik:

i. kundër organizmave të dëmshëm; ose

ii. për bimët, pjesë të bimëve ose produktet bimore.

ç) “preparate” janë përzierje ose solucione të përbëra nga dy ose më shumë substanca, nga të cilat njëra është një substancë aktive, që synohet të përdoren si produkt për mbrojtjen e bimëve;

d) “bimë” është bimë ose pjesë bimësh në fazën e mbirjes ose të rritjes, duke përfshirë frutat e farat e freskëta;

dh) “produkte bimore” janë produktet në gjendje të papërpunuar apo që i janë nënshtruar vetëm përgatitjes së thjeshtë, si: bluarjes, tharjes ose shtrydhjes, të prejardhura nga bimët, por duke përjashtuar vetë bimët;

e) “organizma të dëmshëm” janë insekte të bimëve ose të produkteve të bimëve, që u përkasin bashkësisë së kafshëve ose të bimëve, si dhe viruset, bakteret dhe mykoplazmat dhe patogjenet e tjera;

ë) “produkt” është një substancë aktive, siç përkufizohet në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, ose kombinim substancash aktive të një produkti të mbrojtjes së bimës;

f) “patenta bazë” është një patentë që mbron një produkt, siç përkufizohet në shkronjën “ë” të kësaj pike, një preparat, siç përkufizohet në shkronjën “ç” të kësaj pike, një proces për të përfutur një produkt ose një kërkesë për një produkt, dhe që caktohet nga mbajtësi i saj për qëllime të ndjekjes së procedurës për marrjen e një certifikate.

Neni 72

Objekti i certifikatës

Çdo produkt, që mbrohet nga një patentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i është nënshtruar një procedure administrative autorizimi, përpara futjes në treg si një produkt mjekësor ose si produkt për mbrojtjen e bimëve, mund të jetë objekt i një



certifikate, në përputhje me kriteret e kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 73

Kushtet për marrjen e certifikatës

1. Certifikata e mbrojtjes shtesë për një produkt mjekësor ose për një produkt për mbrojtjen e bimëve jepet nga DPPI-ja mbi bazën e një kërkesë, si dhe kur, në datën e paraqitjes së kërkesës:

a) produkti mbrohet nga një patentë bazë në fuqi në territorin e Shqipërisë;

b) është dhënë një autorizim i vlefshëm për hedhjen e produktit në treg, si produkt mjekësor ose si produkt për mbrojtjen e bimëve, sipas nenit 72 të këtij ligji;

c) të mos ketë qenë lëshuar më parë ndonjë certifikatë për produktin;

ç) autorizimi i përmendur në shkronjën “b” të kësaj pike të jetë autorizimi i parë për hedhjen e produktit në treg.

2. Mbajtësit të më shumë se një patente për të njëjtin produkt për mbrojtjen e bimëve nuk i jepet më shumë sesa një certifikatë për produktin. Megjithatë, kur janë në shqyrtim e sipër, dy ose më shumë kërkesa, që lidhen me të njëjtin produkt dhe që burojnë nga dy ose më shumë mbajtës të patentave të ndryshme, secili mbajtës ka të drejtë të pajiset me një certifikatë për këtë produkt.

Neni 74

Objekti i mbrojtjes

Brenda kufijve të mbrojtjes që jepet nga patentat bazë, mbrojtja që sigurohet me një certifikatë shtrihet vetëm te produkti, që mbulohet nga autorizimi për hedhjen në treg të produktit, që i korrespondon produktit mjekësor ose produktit për mbrojtjen e bimëve, si dhe kjo mbrojtje është e vlefshme për çdo përdorim të produktit, si produkt mjekësor apo produkt për mbrojtjen e bimëve, që është autorizuar para mbarimit të certifikatës.

Neni 75

Pasojat e certifikatës së mbrojtjes shtesë

1. Certifikata jep të njëjtat të drejta me ato që jepen edhe nga patentat bazë dhe u nënshtrohet po atyre kufizimeve dhe detyrimeve që u nënshtrohet edhe patentat bazë.

2. Si përjashtim nga pika 1 e këtij neni, certifikata e mbrojtjes shtesë nuk ofron mbrojtje kundër disa veprimeve, që do të kërkonin pëlqimin e mbajtësit të certifikatës, kur plotësohen kushtet si më poshtë:

a) Veprimet përfshijnë:

i. prodhimin ose bërjen e një produkti ose të një produkti mjekësor që përmban produktin, për qëllime eksporti te vende të tjera;

ii. çdo veprim lidhur me prodhimin që është rreptësisht i domosdoshëm për prodhimin në Republikën e Shqipërisë sipas nënndarjes “i” të shkronjës “a” të kësaj pike ose për eksport;

iii. prodhimin, jo më herët se gjashtë muaj para mbarimit të certifikatës, të një produkti ose të një produkti mjekësor që e përmban atë produkt, me qëllim magazinimin e tij në territorin e vendit të prodhimit, që më pas të hedhë produktin ose produktin mjekësor që përmban produktin, në tregun e vendeve të tjera pas mbarimit të certifikatës korresponduese; ose

iv. çdo veprim lidhur me prodhimin që është rreptësisht i domosdoshëm në Republikën e Shqipërisë sipas nënndarjes “iii” të kësaj pike ose për magazinimin faktik, me kusht që ky veprim të kryhet jo më herët se gjashtë muaj para mbarimit të certifikatës.

b) Prodhuesi i dërgon DPPI-së njoftim përmes mjeteve të duhura dhe të dokumentuara se ku do të bëhet prodhimi, si dhe informon mbajtësin e certifikatës për të dhënat e renditura në pikën 5 të këtij neni jo më vonë se tre muaj para fillimit të prodhimit në vend ose jo më vonë se tre muaj para veprimit të parë të lidhur para këtij prodhimi, që përndryshe do t'i ndalohej mbrojtja që ofrohet nga një certifikatë, cilado prej këtyre të jetë më e hershme;

c) Nëse të dhënat e renditura në pikën 5 të këtij neni ndryshojnë, prodhuesi njofton DPPI-në, si dhe mbajtësin e certifikatës përpara se sa të bëhen këto ndryshime;

ç) Në rastin e produkteve ose të produkteve mjekësore që përmbajnë këto produkte, të prodhuara për qëllime eksporti në vende të treta, prodhuesi siguron që një logo, sipas formës së dhënë në rregulloren përkatëse për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, t'i ngjitet paketimit të jashtëm të produktit ose produktit mjekësor që përmban produktin, siç parashikohet në nënndarjen “i” të



shkronjës “a” të kësaj pike dhe, kur është e mundur, te paketimi i parë që i bëhet menjëherë produktit;

d) Prodhuesi duhet të zbatojë përcaktimet e pikës 9 të këtij neni dhe të pikës 1 të nenit 82 të këtij ligji.

3. Përfshirja e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohet ndaj çdo veprimi ose aktiviteti që kryhet për importimin e produktit ose të produktit mjekësor që përmban këtë produkt, thjesht për qëllime ripaketimi, rieksporimi ose depozitimi.

4. Të dhënat, që i jepen mbajtësit të certifikatës në zbatim të shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, përdoren vetëm me qëllimin për të verifikuar nëse janë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe, kur është rasti, për të filluar procedurat ligjore ndaj shkeljeve të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

5. Në zbatim të shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, prodhuesi është i detyruar të japë të dhënat si më poshtë:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;

b) specifikimin nëse prodhimi është për qëllime eksporti, për qëllime magazinimi ose për qëllime eksporti e depozitimi së bashku;

c) shtetin ku do të bëhet prodhimi dhe, kur është rasti, depozitimi, si dhe shtetin ku do të kryhet veprimi i parë i lidhur me prodhimin, nëse kryhet, para fillimit të prodhimit;

ç) numrin e certifikatës së dhënë në shtetin e prodhimit dhe numrin e certifikatës së dhënë në shtetin ku do të kryhet veprimi i parë lidhur me prodhimin, nëse kryhet, përpara prodhimit; dhe

d) për produktet mjekësore që janë për eksport te shtete të tjera, numrin e referencës së autorizimit të hedhjes në treg ose ekuivalentin e një autorizimi të tillë në secilin shtet tjetër ku do të bëhet eksporti, menjëherë sapo të bëhet publikisht e mundur.

6. Në lidhje me njoftimin që dërgohet te DPPI-ja, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, prodhuesi përdor formën standard dhe të dhënat që do të jepen në rregulloren përkatëse.

7. Mosrespektimi i shkronjës “c” të pikës 5 të këtij neni në lidhje me shtetin ndikon drejtpërdrejt për eksportet në atë shtet dhe, për pasojë, këto eksporte nuk përfitojnë nga përjashtimi.

8. Prodhuesi siguron që produktet mjekësore të bëra sipas nënndarjes “i” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni të mos mbajnë një identifikues aktiv unik sipas përcaktimit në rregulloren përkatëse për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e

përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Prodhuesi siguron me anën e mjeteve të duhura dhe të dokumentuara që çdo person në një marrëdhënie kontraktore me prodhuesin, që kryen veprime sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, të jetë plotësisht i informuar dhe i ndërgjegjshëm për të dhënat si më poshtë:

a) këto veprime përfshihen në pikën 2, të këtij neni;

b) hedhja në treg, importimi ose riimportimi i produktit ose i produktit mjekësor që përmban produktin, përcaktuar në nënndarjen “i” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, ose hedhja në treg e produktit ose e produktit mjekësor që përmban produktin, përcaktuar në nënndarjen “iii” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, mund të cenojë certifikatën e përcaktuar sipas kësaj pike kur dhe për sa kohë ajo përdoret.

Neni 76

E drejta për certifikatë

Certifikata e mbrojtjes shtesë i jepet pronarit të patentës bazë ose zëvendësuesit të tij ligjor.

Neni 77

Kërkesa për certifikatë

1. Kërkesa për certifikatë paraqitet brenda gjashtë muajve nga data e dhënies së autorizimit për hedhjen e produktit në treg si produkt mjekësor ose si produkt për mbrojtjen e bimëve.

2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, kur autorizimi për hedhjen e produktit në treg është dhënë para se sa të jepet patentë bazë, kërkesa për certifikatë duhet të paraqitet brenda gjashtë muajve nga data e dhënies së patentës.

3. Kërkesa për një zgjatje afati mund të bëhet kur paraqitet kërkesa për certifikatë ose kur kërkesa për certifikatë është në shqyrtim, si dhe kur plotësohen përkatësisht kërkesat e shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 78 ose të pikës 4 të nenit 78 të këtij ligji.

4. Kërkesa për zgjatje afati të një certifikate të dhënë paraqitet jo më vonë se dy vjet para mbarimit të afatit të certifikatës.



Neni 78

Përmbajtja e kërkesës për certifikatë

1. Kërkesa për certifikatë përmban:

a) kërkesën për dhënien e certifikatës, ku shënohen veçanërisht:

i. emri dhe adresa e aplikantit;

ii. nëse ai ka caktuar një përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;

iii. numri i patentës bazë;

iv. titulli i shpikjes; dhe

v. numri dhe data e autorizimit të parë për hedhjen e produktit në treg;

b) një kopje të autorizimit të parë për hedhjen e produktit në treg, siç përcaktohet në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 73, ku shënohen veçanërisht produkti, numri, data e autorizimit dhe një përmbledhje e karakteristikave të produktit;

c) kur autorizimi i përmendur në shkronjën “b” të kësaj pike nuk është autorizimi i parë për hedhjen e produktit në treg, si një produkt mjekësor ose produkt për mbrojtjen e bimëve, paraqiten të dhëna për produktin për të cilin është lëshuar një autorizim i tillë, baza ligjore ku është mbështetur procedura e lëshimit të autorizimit, së bashku me një kopje të njoftimit të publikimit zyrtar të autorizimit ose, kur kjo është e pamundur, çdo dokument tjetër, që provon se autorizimi është lëshuar në datën e lëshimit të tij, si dhe produktin për të cilin është lëshuar ai;

ç) kur kërkesa për certifikatë përmban një kërkesë për zgjatje afati, një kopje të deklaratës që tregon se kërkesa i përmbahet planit të hetimit të plotë pediatrik, i cili përfundon me dhënien e një autorizimi të një treguesi pediatrik. Kjo pikë do të zbatohet edhe kur përfundimi i planit të hetimit pediatrik nuk çon në marrjen e autorizimit të një treguesi pediatrik, por rezultatet e studimeve të bëra reflektohen në përmbledhjen e karakteristikave të produktit dhe, kur është rasti, në udhëzuesin ku shënohet produkti mjekësor përkatës.

2. Në rastin e produkteve mjekësore të autorizuar, që mbrohen nga një certifikatë mbrojtjeje shtesë ose nga një patentë e cila kualifikohet për dhënien e certifikatës së mbrojtjes shtesë, kërkesat e mëposhtme sipas shkronjave “a”, “b”, “c” e “ç” do të zbatohen në kërkesat për autorizim për treguesit e rinj, duke përfshirë treguesit pediatrikë, format e reja farmaceutike dhe mënyrat e reja të administrimit:

a) rezultatet e të gjitha studimeve të kryera dhe detajet e të gjitha informacioneve të mbledhura në përputhje me planin e hetimit të plotë pediatrik;

b) vendimi i autoritetit përkatës për përjashtimin e një produkti mjekësor specifik;

c) vendimi i autoritetit përkatës për përjashtimin e një klase produktesh mjekësore specifike;

ç) vendimi i autoritetit përkatës për shtyrjen e fillimit ose të përfundimit të disa ose të të gjitha masave të përcaktuara në planin e hetimit;

Për qëllime të shkronjës “a” të kësaj pike, në kërkesë përfshihet vendimi i autoritetit përkatës që ka rënë dakord për planin e hetimit pediatrik përkatës.

3. Dokumentet e depozituara sipas shkronjave “a”, “b”, “c” e “ç” të pikës 2 të këtij neni do të mbulojnë së bashku të gjitha nënndarjet e popullsisë pediatrike, si dhe treguesit ekzistues dhe të rinj, format farmaceutike dhe mënyrat e administrimit.

4. Kur kërkesa për certifikatë është në proces shqyrtimi, kërkesa për zgjatjen e afatit të certifikatës sipas pikës 3 të nenit 77, përmban të dhënat e përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, dhe referimin të kërkesa për certifikatë që është depozituar.

5. Kërkesa për zgjatjen e afatit të një certifikate të dhënë përmban të dhënat e përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni dhe një kopje të certifikatës së dhënë.

6. Kërkesa për certifikatë ose për zgjatje afati shoqërohet me kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse.

7. Përmbajtja dhe forma e paraqitjes së kërkesës për certifikatë të mbrojtjes shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 79

Depozitimi i kërkesës për certifikatë

1. Kërkesa për certifikatë ose për zgjatjen e afatit të certifikatës paraqitet në DPPI.

2. Njoftimi i kërkesës për certifikatë botohet nga DPPI-ja, i cili përmban:

a) emrin dhe adresën e aplikantit;

b) numrin e patentës bazë;

c) titullin e shpikjes;



ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg dhe produktin e specifikuar në këtë autorizim;

d) kur është rasti, shënimin se kërkesa përfshin një kërkesë për zgjatje afati.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet edhe për njoftimin e kërkesës për zgjatje afati të një certifikatë të dhënë ose kur kërkesa për certifikatë është në shqyrtim. Njoftimi më tej përmban shënimin se është bërë kërkesë për zgjatje afati të certifikatës.

4. Data e depozitimit për një kërkesë për certifikatë të mbrojtjes shtesë është data kur kërkesa plotëson të paktën kushtet e shkronjës “a” të pikës 1 dhe të pikës 6 të nenit 78 të këtij ligji.

5. Kur kërkesa për certifikatë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 dhe pikën 6 të nenit 78 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim të plotësojë të metat, mangësitë ose të kryejë pagesën e tarifës brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Nëse aplikanti vepron sipas njoftimit brenda afatit të caktuar në pikën 5 të këtij neni, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim ku e informon se data e paraqitjes së plotësimit të të metave ose mangësive ose e kryerjes së pagesës së tarifës është data e depozitimit të kërkesës për certifikatë.

7. Me kërkesë të arsyetuar të aplikantit, DPPI-ja ka të drejtë të zgjasë afatin e përcaktuar në pikën 5 të këtij neni për një periudhë jo më shumë se dy muaj.

8. Nëse e meta ose mangësia nuk plotësohet ose pagesa nuk kryhet sipas pikës 5 të këtij neni, DPPI-ja e refuzon kërkesën.

9. Kur një kërkesë për certifikatë ka marrë datë depozitimi, DPPI-ja e regjistron kërkesën në regjistrin përkatës, të parashikuar në nenin 22 të këtij ligji, si dhe e boton kërkesën në Buletin.

10. Të dhënat, që publikohen sipas pikës 9 të këtij neni, do të përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 80

Dhënia e certifikatës ose refuzimi i kërkesës për certifikatë

1. Kur kërkesa për certifikatë dhe produkti me të cilin lidhet kërkesa plotësojnë kushtet e përcaktuara

në këtë krye, DPPI-ja jep certifikatën përkatëse dhe përcakton kohëzgjatjen e saj.

2. Kur kërkesa për certifikatë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë krye, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim të plotësojë të metat ose mangësitë apo të paguajë tarifën përkatëse brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse aplikanti nuk plotëson të metat ose mangësitë apo nuk paguan tarifën brenda afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja e refuzon kërkesën me vendim.

4. Pikat nga 1 deri 3 të këtij neni do të zbatohen njëjloj (*mutatis mutandis*) edhe për kërkesën për zgjatje afati.

5. Nëse kërkesa për zgjatje të afatit të certifikatës së mbrojtjes shtesë është depozituar njëkohësisht me kërkesën për këtë certifikatë ose gjatë procedurës së ekzaminimit të kërkesës për dhënie të certifikatës, DPPI-ja vendos për kërkesën për zgjatje afati me të njëjtin vendim që lidhet me kërkesën për certifikatë të mbrojtjes shtesë.

6. Nëse depozitohet kërkesë për zgjatje afati të një certifikate të dhënë, si dhe kur ndërkohë ka filluar një procedurë për pavlefshmërinë ose mbarimin e saj, DPPI-ja e pezullon procedurën për zgjatjen e afatit derisa vendimi për pavlefshmërinë ose për mbarimin e certifikatës të bëhet përfundimtar.

7. Kërkesa për zgjatjen e afatit, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji, nuk do të aplikohet për produktet mjekësore, të përcaktuara si produkte mjekësore për diagnoza të rralla (*orphan medicinal products*) sipas ligjit përkatës.

8. Kërkesa për zgjatjen e afatit sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji, nuk aplikohet nëse aplikanti ka kërkuar dhe ka marrë një vit zgjatje afati për periudhën e vlefshmërisë për mbrojtjen e tregtimit, të dhënë sipas akteve ligjore përkatëse, me arsyetimin se produkti i ri mjekësor sjell përfitime të rëndësishme krahasuar me terapitë ekzistuese.

Neni 81

Botimi i certifikatës

1. Kur jepet certifikata, DPPI-ja boton njoftimin e dhënies së certifikatës, i cili përmban të paktën:

- a) emrin dhe adresën e mbajtësit të certifikatës;
- b) numrin e patentës bazë;
- c) titullin e shpikjes;



ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg dhe identifikimin e produktit që specifikohet në autorizim;

d) kohëzgjatjen e certifikatës.

2. Kur kërkesa për certifikatë refuzohet, DPPI-ja publikon njoftimin e refuzimit të kërkesës për certifikatë, që përmban të paktën të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 79 të këtij ligji.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe për njoftimin nëse është dhënë zgjatje afati një certifikate ose nëse është refuzuar kërkesa për zgjatje.

4. DPPI-ja boton sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se një muaj, të dhënat e listuara në pikën 5 të nenit 75 të këtij ligji, së bashku me datën e njoftimit të të dhënave. DPPI-ja gjithashtu boton sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa brenda një muaji, çdo ndryshim të të dhënave të njoftuara sipas shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 75 të këtij ligji.

Neni 82

Kohëzgjatja e certifikatës së mbrojtjes shtesë

1. Mbajtja në fuqi e certifikatës së mbrojtjes shtesë kushtëzohet nga kryerja e pagesës së tarifës vjetore të ripërtëritjes.

2. Certifikata e mbrojtjes shtesë hyn në fuqi në fund të kohëzgjatjes të përcaktuar me ligj të patentës bazë për një periudhë të njëjtë me periudhën që ka kaluar ndërmjet datës në të cilën është depozituar kërkesa për një patentë bazë dhe datës së autorizimit të parë për hedhjen e produktit në treg, duke e shkurtuar me një periudhë prej pesë vjetësh.

3. Kohëzgjatja e certifikatës së mbrojtjes shtesë nuk jepet më shumë se pesë vjet nga data në të cilën ajo hyn në fuqi.

4. Afati i përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni zgjatet me 6 muaj për certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore për përdorim pediatrik. Zgjatja e afatit prej 6 muajsh bëhet vetëm një herë.

5. Për qëllime të përlogaritjes së kohëzgjatjes së certifikatës për mbrojtjen e bimëve mbahet parasysh edhe lëshimi i një autorizimi provizor për hedhjen e parë në treg të produktit, por vetëm nëse ai ndiqet menjëherë nga një autorizim përfundimtar, i lëshuar për të njëjtin produkt.

Neni 83

Mbarimi i certifikatës

1. Certifikata e mbrojtjes shtesë mbaron:

a) në fund të periudhës së përcaktuar në nenin 82 të këtij ligji;

b) kur mbajtësi i certifikatës heq dorë prej saj;

c) kur tarifa vjetore e caktuar nuk paguhet në afat;

ç) kur dhe për sa kohë produkti, që mbulohet nga certifikata, nuk mund të hidhet më në treg, në vijim të tërheqjes së autorizimit përkatës për hedhjen në treg.

2. Mbarimi i afatit të certifikatës mund të vendoset nga DPPI-ja me nismën e vet ose me kërkesën e çdo personi.

Neni 84

Pavlefshmëria e certifikatës

1. Certifikata është e pavlefshme kur:

a) është dhënë në kundërshtim me nenin 73 të këtij ligji;

b) patentës bazë i ka mbaruar afati para se t'i mbaronte afati i përcaktuar në ligj;

c) patenta bazë është shfuqizuar apo kufizuar në masën që produkti për të cilin është dhënë certifikata nuk mbrohet më nga pretendimet e patentës bazë ose, pasi ka mbaruar patenta bazë, ekzistojnë shkaqe që justifikojnë këtë shfuqizim ose kufizim.

2. Çdo individ, person ose DPPI-ja me nismën e vet ka të drejtë të kërkojë me padi në gjykatë deklarimin e pavlefshmërisë së një certifikate.

3. Kur certifikata deklarohet e pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë, DPPI-ja, me kërkesën e personit të interesuar ose edhe me iniciativën e vet (*ex officio*), regjistron vendimin gjyqësor në regjistër.

4. Të dhëna më të detajuara për kërkesën për pavlefshmëri për regjistrimin e vendimit gjyqësor, si dhe për botimin e këtij, përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 85

Shfuqizimi i zgjatjes së afatit

1. Zgjatja e afatit të certifikatës mund të shfuqizohet nëse zgjatja ishte dhënë në kundërshtim



me nenin 77 të këtij ligji dhe nuk plotëson kërkesat e pikës 5 të nenit 79 të këtij ligji.

2. Bazuar në pikën 1 të këtij neni, çdo individ ose person mund të paraqesë një kërkesë në DPPI për shfuqizimin e një zgjatjeje afati.

3. Të dhëna të detajuara për kërkesën për shfuqizimin e zgjatjes së afatit, shqyrtimin dhe botimin e saj përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 86

Njoftimi i mbarimit ose i pavlefshmërisë

1. Kur certifikata mbaron, shfuqizohet ose deklarohet e pavlefshme, DPPI-ja boton njoftimin përkatës në buletin.

2. Nëse zgjatja e afatit shfuqizohet sipas nenit 85 të këtij ligji, njoftimi i saj botohet nga DPPI-ja në buletin.

Neni 87

Ankimet

Vendimet e marra nga DPPI-ja mund të ankimohen te Bordi i Apelit në përputhje me nenin 159 të këtij ligji, përveç rasteve që parashikohen ndryshe në këtë ligj.

PJESA VII

KOHËZGJATJA, MBAJTJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I EFEKTTIT TË NJË PATENTE

KREU I

KOHËZGJATJA DHE MBAJTJA NË FUQI E NJË PATENTE

Neni 88

Afati i një patente

1. Afati i një patente është 20 vjet nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Afati i një modeli përdorimi është 10 vjet nga data e depozitimit të kërkesës.

Neni 89

Mbajtja në fuqi e patentës dhe modelit të përdorimit

1. Mbajtja në fuqi e patentës dhe modelit të përdorimit kushtëzohet nga kryerja e pagesës së tarifës vjetore të ripërtëritjes.

2. Tarifa vjetore e ripërtëritjes, sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet nga çdo individ ose person.

3. Tarifa vjetore e ripërtëritjes, sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet për vitin e tretë dhe çdo vit tjetër pasues, duke e filluar llogaritjen nga data e depozitimit të kërkesës.

4. Tarifa vjetore e ripërtëritjes për kërkesën fillestare që është për t'u bërë në datën e depozitimit të kërkesës për ndarje të aplikimit për patentë është e pagueshme edhe për kërkesën e ndarë në datën e depozitimit të kërkesës për ndarje.

5. Nëse tarifa vjetore e ripërtëritjes nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar në pikat 3 ose 4 të këtij neni, ajo mund të paguhet brenda gjashtë muajve të tjerë shtesë përkundrejt pagesës së një tarife shtesë, të barabartë me 50% të vlerës së tarifës vjetore përkatëse. Nëse tarifa vjetore nuk paguhet as brenda kësaj periudhe shtesë gjashtëmuajore, ajo mund të paguhet brenda një periudhe të dytë shtesë prej dy muajsh në vijim të periudhës së parë shtesë, përkundrejt pagesës së një tarife shtesë, të barabartë me 100% të vlerës së tarifës vjetore përkatëse.

6. DPPI-ja njofton aplikantin, mbajtësin e patentës apo mbajtësin e modelit të përdorimit për mospagesën e tarifës vjetore të ripërtëritjes dhe pasojave që vijnë prej saj, si dhe mundësinë për të kryer pagesën sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 90

Ripërtëritja e certifikatës së mbrojtjes shtesë

1. Tarifa vjetore për ripërtëritjen e certifikatës së mbrojtjes shtesë paguhet në DPPI për çdo vit të kohëzgjatjes së saj.

2. Tarifa vjetore e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mbulon periudhën 12-mujore, duke filluar nga data e mbarimit të patentës bazë dhe paguhet për çdo vit më vete.

3. Nëse viti i fundit i kohëzgjatjes së certifikatës është më i shkurtër se 12 muaj, tarifa vjetore e ripërtëritjes së këtij viti do të parapaguhet në shumën që është në përpjesëtim me kohëzgjatjen e



certifikatës, së bashku me pagesën e shumës totale të tarifës vjetore të vitit të plotë para vitit të fundit.

4. Nëse tarifa vjetore nuk paguhet sipas pikave 2 ose 3 të këtij neni, ajo mund të paguhet brenda gjashtë muajve të tjerë shtesë përkundrejt pagesës së një tarife shtesë, të barabartë me 50% të vlerës së tarifës vjetore përkatëse. Nëse tarifa vjetore nuk paguhet as brenda kësaj periudhe shtesë gjashtëmuajore, ajo mund të paguhet brenda një periudhe të dytë shtesë prej dy muajsh në vijim të periudhës së parë shtesë, përkundrejt pagesës së një tarife shtesë, të barabartë me 100% të vlerës së tarifës vjetore përkatëse.

5. Tarifa vjetore e ripërtëritjes, sipas këtij neni, mund të paguhet nga çdo person që plotëson kushtet sipas nenit 16 të këtij ligji.

6. DPPI-ja njofton mbajtësin e certifikatës së mbrojtjes shtesë për mospagesën e tarifës vjetore të ripërtëritjes për pasojat e mospagesës së tarifës dhe për mundësinë që ka ai për të paguar tarifën e ripërtëritjes sipas pikës 4 të këtij neni.

KREU II MBARIMI I PATENTËS

Neni 91

Mbarimi i patentës dhe modelit të përdorimit për mospagesë të tarifës së ripërtëritjes

1. Në rast se aplikanti i patentës, mbajtësi i patentës ose mbajtësi i modelit të përdorimit nuk paguan tarifën vjetore të ripërtëritjes, patenta ose modeli i përdorimit mbaron në datën që pason datën në të cilën mbaron afati i fundit për pagesën e tarifës vjetore të ripërtëritjes, sipas pikave 3 dhe 5 të nenit 89 të këtij ligji.

2. Mbarimi i patentës ose modelit të përdorimit botohet në buletin.

Neni 92

Mbarimi i patentës me dorëheqje

1. Mbajtësi i patentës ose modelit të përdorimit mund të heqë dorë pjesërisht ose plotësisht nga patenta ose modeli i përdorimit nëpërmjet depozitimit të një kërkesë për këtë qëllim në DPPI.

2. Efekti i dorëheqjes fillon nga data e depozitimit në DPPI të kërkesës për dorëheqje.

3. Në rast se janë regjistruar të drejta të personave të tretë në regjistrat përkatës, mbajtësi i patentës ose modelit të përdorimit depoziton edhe pëlqimin me shkrim të këtyre personave për dorëheqjen, së bashku me kërkesën për dorëheqje.

4. DPPI-ja regjistron dorëheqjen në regjistrin përkatës dhe e boton atë në buletin.

PJESA VIII

KREU I EFEKTET E PATENTËS

Neni 93

Të drejtat ekskluzive që fitohen nga patenta

1. Mbajtësi i një patente fiton të drejta ekskluzive nga patenta në datën e botimit të dhënies së saj.

2. Çdo person, që nuk ka pëlqimin e mbajtësit të patentës, ndalohet:

a) të prodhojë, të ofrojë për shitje, të shesë ose të përdorë, të importojë ose të magazinohet për qëllime të tilla produktin, që është objekt i patentës;

b) të përdorë ose të ofrojë për përdorim procesin që është objekt i patentës, nëse personi tjetër ishte ose duhet të ishte i njohur me faktin se procesi ndalohet të zbatohet pa pëlqimin e mbajtësit të patentës; ose

c) të ofrojë për shitje, të shesë, të përdorë, të importojë ose të magazinohet për qëllime të tilla produktin që është përfituar drejtpërdrejt nga një proces që është objekt i patentës.

3. Çdo person tjetër, që nuk ka pëlqimin e mbajtësit të patentës, ndalohet gjithashtu të ofrojë ose të furnizojë produktin që përbën një element thelbësor të shpikjes të persona që nuk kanë të drejtë të shfrytëzojnë shpikjen në fjalë, nëse ofruesi ose furnizuesi e di ose duhet ta dinte nga rrethanat faktike se ai produkt synon të vendosë në funksionim shpikjen, patenta e së cilës i përket një personi tjetër.

4. Pika 3 e këtij neni nuk zbatohet nëse produkti i ofruar ose i furnizuar është një produkt që ofrohet ose furnizohet në treg për qëllime të ndryshme tregtare, përveçse kur ofruesi ose furnizuesi nxit ose shtyn persona të tjerë të kryejnë veprime që parashikohen në pikën 2 të këtij neni.



Neni 94

Të drejtat ekskluzive që lidhen me patenta në fushën biologjike dhe gjenetike

1. Kur materiali biologjik me karakteristika specifike si rezultat i shpikjes mbrohet me patentë, të drejtat ekskluzive, të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 93 të këtij ligji, shtrihen mbi çdo material tjetër biologjik që rrjedh nga ai material biologjik nëpërmjet riprodhimit apo shumëfishimit në formë të njëjtë ose të ndryshme dhe që zotëron po të njëjtat karakteristika.

2. Nëse procesi, që mundëson prodhimin e materialit biologjik me karakteristika specifike si rezultat i shpikjes, mbrohet me patentë, të drejtat ekskluzive, që përcaktohen në pikat 2 dhe 3 të nenit 93 të këtij ligji, shtrihen edhe mbi materialin biologjik që përfitohet drejtpërdrejt nga ky proces dhe mbi çdo material tjetër biologjik që rrjedh nga materiali biologjik, i përfituar drejtpërdrejt nëpërmjet riprodhimit apo shumëfishimit në formë të njëjtë ose të ndryshme dhe që zotëron po të njëjtat karakteristika.

3. Kur produkti, që përmban ose përbëhet nga një informacion gjenetik, mbrohet me patentë, të drejtat ekskluzive, të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 93 të këtij ligji, shtrihen mbi të gjithë materialin, me përjashtim të materialit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji, duke përfshirë produktin dhe materialin në të cilin informacioni gjenetik përmbahet dhe kryen funksionin e tij.

Neni 95

Të drejtat që sigurohen nga kërkesa për patentë

1. Me botimin e kërkesës për patentë, aplikanti fiton të drejta të perkohshme në bazë të të cilave ka të drejtë të pretendojë dhe të kërkojë kompensimin e dëmeve nga çdo person i tretë që ka shfrytëzuar shpikjen, në kundërshtim me nenet 93 dhe 94 të këtij ligji, brenda periudhës ndërmjet datës së botimit të kërkesës për patentë dhe datës së botimit të dhënies së patentës.

2. Kërkesa për patentë nuk i ka efektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kur ajo pezullohet, rrëzohet ose refuzohet.

Neni 96

Objekti i të drejtave ekskluzive

1. Objekti i të drejtave ekskluzive të mbajtësit të patentës përcaktohet nga pretendimet që janë pranuar përfundimisht në procedurën e dhënies së patentës, ndërsa përshkrimi dhe vizatimet shërbejnë për të interpretuar pretendimet.

2. Kur objekti i patentës është një proces, të drejtat që sigurohen nga kjo patentë shtrihen gjithashtu edhe mbi produktin që përfitohet drejtpërdrejt nga procesi.

3. Kushtet e pretendimeve nuk kufizohen ngurtësisht në kuptimin literal të fjalëve. Po kështu, as përshkrimi apo vizatimet nuk mund të konsiderohen vetëm me qëllimin e sqarimit të paqartësive në pretendimet e patentës. Pretendimet nuk mund të merren as si orientime për të treguar se objekti i të drejtave ekskluzive mund të shtrihet edhe në ndonjë materie që mund të konsiderohet nga një person i kualifikuar në fushën e arritjes si objekt i synuar i mbrojtjes mbi bazën e përshkrimit dhe vizatimeve.

Neni 97

Shkalla e mbrojtjes nga një kërkesë e botuar

1. Në periudhën nga kërkesa për patentë deri në dhënien e patentës, shkalla e mbrojtjes përcaktohet nga pretendimet e kërkesës së botuar.

2. Të drejtat sipas pikës 1 të këtij neni përcaktohen në mënyrë prapavepruese nga pretendimet e dhëna me patentë ose të ndryshuara në procedurën e shfuqizimit, me kusht që shkalla e mbrojtjes të mos jetë zgjeruar.

KREU II

KUFIZIMI I EFEKTEVE TË PATENTËS

Neni 98

Përjashtimet nga të drejtat ekskluzive

Të drejtat ekskluzive të mbajtësit të patentës për shfrytëzimin e shpikjes nuk shtrihen mbi:

a) veprimet me anën e të cilave shpikja shfrytëzohet për qëllime private dhe jotregtare;

b) veprimet e kryera për qëllime kërkimore dhe zhvillimore, si dhe për qëllime eksperimentale në lidhje me objektin e një patente ose të një certifikate mbrojtjeje shtesë, duke përfshirë veprimet që janë të



domosdoshme për marrjen e autorizimit për hedhjen në treg të një produkti që përmban një ilaç i destinuar për njerëzit ose kafshët; ose

c) përgatitjen e drejtpërdrejtë dhe individuale të një ilaçi në një farmaci mbi bazën e një recete mjekësore individuale, si dhe mbi veprimet që lidhen me ilačin që përgatitet në këtë mënyrë.

Neni 99

Kufizimi i efekteve të patentave në fushën biologjike

1. Të drejtat ekskluzive, që rrjedhin nga neni 94 i këtij ligji, nuk shtrihen mbi materialin biologjik të përftuar nga riprodhimi ose shumëfishimi i materialit biologjik të vendosur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e tij, kur shumëfishimi ose riprodhimi rezulton domosdoshmërisht nga kërkesa për të cilin është tregtuar materiali biologjik, me kusht që materiali i përftuar të mos përdoret më pas për riprodhime dhe shumëfishime të tjera.

2. Si përjashtim nga neni 94 i këtij ligji, shitja ose çdo formë tjetër tregtimi e bimës, që riprodhon materialin të një fermer për përdorim bujqësor nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e këtij nënkupton se fermeri është i autorizuar të përdorë produktin e të korrave të tij për riprodhim ose shumëfishim në fermën e tij.

3. Si përjashtim nga neni 94 i këtij ligji, shitja ose çdo formë tjetër e tregtimit të bagëtive për mbarëshim ose çdo materiali tjetër për riprodhim kafshësh të një fermer nga mbajtësi i patentës ose që bëhet me pëlqimin e këtij nënkupton se fermeri është i autorizuar të përdorë kafshët për qëllime bujqësore, duke përfshirë mundësimin e kafshës ose të materialit tjetër për riprodhim kafshësh për ndjekjen e aktivitetit të tij bujqësor në kuadrin ose për qëllime të një aktiviteti riprodhues tregtar.

Neni 100

Të drejtat e datës së mëhershme

1. Të drejtat që sigurohen nga patenta nuk sjellin asnjë pasojë ndaj një personi që ka përdorur ose ka prodhuar një produkt që është objekt i një shpikjeje, ose që ka bërë në mirëbesim përgatitje serioze dhe efektive për shfrytëzimin e kësaj shpikjeje, në kuadër të aktiviteteve të tij ekonomike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përpara datës së

depozitimit të kërkesës për patentë ose përpara datës së dhënies së prioritetit.

2. Personi, që përmendet në pikën 1 të këtij neni, ka të drejtë të vazhdojë shfrytëzimin e shpikjes brenda objektit që ai ka shfrytëzuar ose ka përgatitur për shfrytëzimin e saj deri në datën e kërkesës të patentës për këtë shpikje.

3. E drejta e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni mund të transferohet ose të trashëgohet vetëm me procesin e punës dhe në një vend prodhimi ku është përgatitur ose ka filluar shfrytëzimi i shpikjes.

Neni 101

Kufizimi i të drejtave për trafik të qetë ndërkombëtar

1. Përdorimi i produkteve të bëra sipas një shpikjeje të mbrojtur në një anije, që i përket një vendi anëtar të Unionit të Parisit ose të OBT-së, si trupi i anijes, makineri, pajisje, mjete ose aksesore të tjerë, nuk konsiderohet shkelje e patentës, kur kjo anije gjendet, përkohësisht ose aksidentalisht, në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto produkte të përdoren ekskluzivisht për nevoja të kësaj anijeje.

2. Përdorimi i produkteve të bëra sipas një shpikjeje të mbrojtur në ndërtimin ose funksionimin e një avioni, të një automjeti tokësor ose mjeti tjetër transporti, që i përket një vendi anëtar të Unionit të Parisit ose OBT-së, nuk konsiderohet shkelje e patentës, kur mjete të tilla transporti gjenden, përkohësisht ose aksidentalisht, në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto produkte për ndërtim ose funksionim të përdoren ekskluzivisht për nevoja të këtyre mjeteve të transportit.

Neni 102

Shterimi i të drejtave ekskluzive të mbajtësit të patentës

1. Të drejtat ekskluzive të siguruara nga patenta nuk shtrihen mbi një produkt, që është objekt i patentës, pasi ky produkt të jetë hedhur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e tij.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet nëse ka baza të mbështetura në ligj ose në rregullore për mbajtësin e patentës të ndalojë tregtimin e mëtejshëm të produktit.



3. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për të drejtat ekskluzive të fituara nga certifikata e mbrojtjes shtesë.

PJESA IX LICENCAT DETYRUESE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 103 Licencat detyruese

1. Me kërkesë të një personi të interesuar, autoriteti kompetent, në situata emergjente, ka të drejtë t'i japë personit licencë detyruese, kur provon se ka aftësi për të shfrytëzuar shpikjen, që është objekt i patentës së dhënë në Republikën e Shqipërisë, si dhe kur plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikateve të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me kusht që:

a) të kenë kaluar katër vjet nga depozitimi i kërkesës për patentë ose tre vjet nga dhënia e patentës;

b) pronari i patentës të mos e ketë përdorur patentën për një periudhë kohe të arsyeshme ose të mos ketë bërë përgatitje serioze dhe efektive për shfrytëzimin e saj, përveçse kur paraqet arsye të ligjshme për mosveprim;

c) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për të marrë autorizimin nga pronari i patentës, në kushte dhe afate të arsyeshme, si dhe këto përpjekje të mos kenë rezultuar të suksesshme, brenda një afati të arsyeshëm.

2. Licenca detyruese nuk mund të jepet nëse mbajtësi i një patente paraqet arsye të legjitimuara në ligj ose rregullore për mosshfrytëzimin ose shfrytëzimin e pamjaftueshëm të patentës.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, autoriteti kompetent mund të japë licencë detyruese nëse shfrytëzimi i objektit të patentës apo aplikimit për patentë bëhet i domosdoshëm në situata ekstremisht urgjente në nivel kombëtar, veçanërisht për sigurinë kombëtare, mbrojtjen e interesit publik në fushën e shëndetësisë, furnizimin ushqimor, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, interesin komercial specifik ose kur është e nevojshme të rregullohet një praktikë

antikonkurruese, e vendosur me vendim gjyqësor ose administrativ, si e tillë.

4. Lloji i përdorimit, që mbulohet nga licenca detyruese, si dhe kushtet, që duhet të plotësohen, specifikohen nga autoriteti kompetent, i cili merr parasysh që:

a) fusha dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të kufizohen brenda qëllimit për të cilin është dhënë licenca:

b) shfrytëzimi të jetë joekskluziv;

c) shfrytëzimi të jetë i patransferueshëm.

5. Shfrytëzimi i një licence detyruese autorizohet veçanërisht për të furnizuar tregun e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rastit të përcaktuar në kreun II të kësaj pjese.

6. Licenca detyruese është e vlefshme deri në mbarimin e afatit të caktuar nga autoriteti kompetent ose deri në mbarimin e afatit të patentës. Me kërkesë të arsyetuar, autoriteti kompetent mund të anulojë autorizimin, për shkak të mbrojtjes së interesave të legjitimuara të personave të autorizuar, nëse dhe kur rrethanat që çuan në dhënien e autorizimit kanë pushuar së ekzistuari dhe nuk ka gjasa të përsëriten.

7. Licencat detyruese regjistrohen nga DPPI-ja në regjistrin përkatës.

8. Pronari i patentës ka të drejtë të marrë një kompensim të përshtatshëm për çdo licencë detyruese, duke mbajtur parasysh vlerat ekonomike të licencës. Kur palët nuk bien dakord, vlera e kompensimit vendoset nga autoriteti kompetent.

9. Mbajtësi i një licence detyruese mund të heqë dorë prej saj në çdo kohë.

10. Në rast se mbajtësi i licencës detyruese nuk e fillon shfrytëzimin e saj brenda një viti nga data e dhënies së licencës, pronari i patentës mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e licencës detyruese tek autoriteti kompetent.

KREU II LICENCAT DETYRUESE PËR PRODUKTET FARMACEUTIKE

Neni 104 Objekti

Ky krye përcakton procedurën për dhënien e licencave detyruese në lidhje me patentat dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë për prodhimin dhe shitjen e produkteve farmaceutike, kur këto



produkte destinohen për eksport në vendet importuese në nevojë, të autorizuar për produkte të tilla, për të trajtuar problemet e shëndetit publik.

Neni 105

Përkufizime në zbatim të këtij kreu

Për qëllime të këtij kreu, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Produkt farmaceutik” është çdo produkt i sektorit farmaceutik, duke përfshirë produktet mjekësore;

b) “Mbajtës të drejtash” është mbajtësi i çdo patente ose certifikate të mbrojtjes shtesë në lidhje me një licencë detyruese, të cilat janë kërkuar sipas këtij ligji;

c) “Vend importues” është vendi ku do të eksportohet produkti farmaceutik.

Neni 106

Autoriteti kompetent

Autoriteti kompetent, siç përcaktohet në nenin 103 të këtij kreu dhe në nenin 122 të këtij ligji, është ministria përgjegjëse që mbulon fushën ku zbatohet patentat përkatëse. DPPI-ja regjistron licencën detyruese që lëshohet.

Neni 107

Vendet importuese të autorizuar

Vendet importuese të autorizuar janë si më poshtë:

a) çdo vend pak i zhvilluar që rezulton si i tillë në listën e OKB-së;

b) çdo anëtar i OBT-së, përveç atyre vendeve anëtare më pak të zhvilluara, të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni, që ka bërë një njoftim te Këshilli i TRIPS-it për qëllimin e tij për të përdorur sistemin si sistem importues, duke përfshirë edhe rastin kur e përdor sistemin plotësisht apo në mënyrë të kufizuar;

c) çdo vend që nuk është anëtar i OBT-së, por bën pjesë në listën e Komitetit të Asistencës së Zhvillimit të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH) të vendeve me një produkt kombëtar bruto për frymë më pak se 745 USD dhe që i ka dërguar një njoftim këtij Komiteti për qëllimin e tij për të përdorur sistemin si importues, duke përfshirë edhe rastin nëse e

përdor sistemin plotësisht ose në mënyrë të kufizuar.

Megjithatë, çdo anëtar i OBT-së, që ka depozituar një deklaratë në OBT se nuk do ta përdorë sistemin si anëtar importues i OBT-së, nuk kualifikohet si vend importues.

Neni 108

Shtrirja në vendet pak të zhvilluara dhe në zhvillim që nuk janë anëtarë të OBT-së

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për vendet importuese të autorizuar sipas nenit 107 që nuk janë anëtare të OBT-së:

a) vendi importues e bën njoftimin drejtpërdrejt te Këshilli i TRIPS-it;

b) vendi importues, në njoftimin e përmendur në pikën 1 të nenit 111 të këtij ligji, deklaron se do ta përdorë sistemin për problemet e shëndetit publik dhe jo si instrument për të ndjekur objektiva politike industriale ose tregtare, si dhe do të miratojë masat e përcaktuara në pikën 4 të vendimit për zbatimin e paragrafit 6 të Deklaratës së Doha-s;

c) me kërkesë të mbajtësit të së drejtës, autoriteti kompetent mund të përfundojë licencën detyruese të dhënë në bazë të këtij neni, nëse vendi importues nuk ka përmbushur detyrimet e tij të përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni. Përpara përfundimit të një licence detyruese, autoriteti kompetent merr parasysh çdo pikëpamje të shprehur nga organet e përmendura në shkronjën “dh” të pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji.

Neni 109

Kërkesa për licencë detyruese

1. Çdo person mund të paraqesë tek autoriteti kompetent një kërkesë për licencë detyruese, sipas këtij ligji.

2. Kur personi, që aplikon për licencë detyruese, ka depozituar kërkesa tek autoritetet e më shumë se një vendi për të njëjtin produkt, ai e shënon këtë fakt në çdo kërkesë, së bashku me detajet për sasitë dhe vendet përkatëse importuese.

3. Kërkesa sipas pikës 1 të këtij neni përmban:

a) emrin dhe detajet e kontaktit të aplikantit dhe të agentit ose përfaqësuesit të cilin aplikanti e ka caktuar të veprojë në emër të tij para autoritetit kompetent;



b) emrin pa pronësi të produktit farmaceutik ose produkteve që aplikanti synon të prodhojë dhe të shesë për eksport, sipas licencës detyruese;

c) sasinë e produktit farmaceutik që aplikanti kërkon të prodhojë sipas licencës detyruese;

ç) vendin ose vendet importuese;

d) sipas rastit, dokumente dhe të dhëna për negociatat e mëparshme me mbajtësin e të drejtave sipas nenit 112 të këtij ligji;

dh) dokumentin provues të një kërkesë specifike nga:

i. përfaqësuesi i autorizuar i vendit ose vendeve importuese; ose

ii. një organizatë joqeveritare që vepron me autorizim formal të një ose më shumë vendeve importuese; ose

iii. organet e OKB-së ose organizatat ndërkombëtare të shëndetit që veprojnë me autorizim formal të një ose më shumë vendeve importuese, duke treguar sasinë e produktit të kërkuar.

4. Kërkesa formale ose administrative e nevojshme për përpunimin efikas të saj përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kërkesa të tilla nuk duhet të shtojnë në mënyrë të panevojshme kostot ose barrën e vendosur mbi aplikantën dhe në asnjë rast nuk duhet ta bëjnë procedurën për dhënien e licencave të detyrueshme sipas këtij ligji më të rëndë sesa procedura për dhënien e licencave të tjera të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi për licencat.

Neni 110

Të drejtat e mbajtësve të të drejtave

1. Autoriteti kompetent e njofton mbajtësin e të drejtave pa vonesë për kërkesën për licencë detyruese.

2. Përpara dhënies së licencës detyruese, autoriteti kompetent i jep mundësi mbajtësit të së drejtës të komentojë mbi kërkesën, si dhe t'i sigurojë autoritetit kompetent çdo informacion të nevojshëm për kërkesën.

Neni 111

Verifikimi

1. Autoriteti kompetent verifikon se:

a) çdo vend importues, i cituar në kërkesë, që është anëtar i OBT-së, ka bërë njoftim në OBT, sipas vendimit, bazuar në Deklaratën e Doha-s; ose

b) çdo vend importues, i cituar në kërkesë, që nuk është anëtar i OBT-së, i ka bërë njoftim Këshillit të TRIPS-it për çdo produkt që përfshihet në kërkesë ku:

i. specifikon emrat dhe sasitë e pritshme të produktit ose produkteve që nevojiten;

ii. përveç rastit, kur vendi importues është vend pak i zhvilluar, konfirmon se vendi ka treguar se ka kapacitete të pamjaftueshme ose nuk ka fare kapacitete prodhuese në sektorin farmaceutik në lidhje me një produkt ose produkte të veçanta në një nga mënyrat e përcaktuara në aneksin e vendimit për zbatimin e paragrafit 6 të Deklaratës së Doha-s, përcaktuar në shkronjën "b" të nenit 108 të këtij ligji;

iii. konfirmon se kur është patentuar një produkt farmaceutik në territorin e vendit importues, vendi importues ka dhënë ose synon të japë një licencë detyruese për importimin e produktit përkatës, në përputhje me nenin 31 të Marrëveshjes TRIPS dhe dispozitat e vendimit për zbatimin e paragrafit 6 të Deklaratës së Doha-s.

Pika 1 e këtij neni nuk cenon fleksibilitetin që vendet pak të zhvilluara duhet të kenë sipas vendimit të Këshillit të TRIPS-it të datës 27 qershor 2002.

2. Autoriteti kompetent verifikon nëse sasia e produktit të cituar në kërkesë nuk e kalon sasinë e njoftuar në OBT nga një vend importues, i cili është anëtar i OBT-së, ose te Këshilli i TRIPS-it nga vendi importues që nuk është anëtar i OBT-së, si dhe, duke marrë parasysh licencat e tjera detyruese të dhëna në ndonjë vend tjetër, sasia totale e produktit të autorizuar për t'u prodhuar për çdo vend importues nuk e tejkalon në mënyrë të ndjeshme shumën e njoftuar nga ai vend tek OBT-ja, në rastin kur vendet importuese janë anëtare të OBT-së, ose te Këshilli i TRIPS-it, në rastin kur vendet importuese nuk janë anëtare të OBT-së.

Neni 112

Negociimi i mëparshëm

1. Aplikanti paraqet prova për të bindur autoritetin kompetent se ka bërë përpjekje për të marrë autorizimin nga mbajtësi i të drejtave dhe se këto përpjekje nuk kishin qenë të suksesshme brenda një periudhe prej 30 ditësh para depozitimit të kërkesës.



2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në situatat e emergjencës kombëtare, në rrethana të tjera të urgjencës ekstreme ose në rastet e përdorimit publik jotregtar, sipas nenit 31(b) të marrëveshjes TRIPS.

Neni 113

Kushtet e licencave detyruese

1. Licenca detyruese e dhënë është e patransferueshme, përveç asaj pjese që lidhet me vlerën e licencës, si dhe joekskluzive. Ajo duhet të përmbajë kushtet specifike të përcaktuara në pikat 2 deri 9 të këtij neni, që duhet të përmbushen nga i licencuari.

2. Sasia e produktit ose produkteve të prodhuara sipas licencës nuk duhet të kalojë atë që nevojitet për të përmbushur nevojat e vendit ose vendeve importuese të cituara në kërkesë, duke mbajtur parasysh sasinë e produktit ose produkteve të prodhuara, sipas licencave të tjera detyruese të dhëna në vende të tjera.

3. Kohëzgjatja e licencës duhet të shënohet.

4. Licenca kufizohet rreptësisht të gjitha veprimet që nevojiten për prodhimin e produktit ose produkteve për eksport dhe shpërndarje në vendin ose vendet e cituara në kërkesë. Asnjë produkt i prodhuar apo i importuar sipas licencës detyruese nuk do të ofrohet për shitje apo të hidhet në treg në ndonjë vend tjetër, përveç atij të cituar në kërkesë, përveç kur një vend importues i ofron vetes mundësinë sipas nënparagrafit 6(i) të vendimit që rrjedh nga Deklarata e Doha-s për të eksportuar te vendet anëtare të një marrëveshjeje tregtare rajonale që ndajnë problemin shëndetësor në fjalë.

5. Produktet e bëra sipas licencës duhet të identifikohen qartë nëpërmjet etiketimit ose shënimit specifik, si të prodhuara në bazë të rregullave të përcaktuara për këtë qëllim. Produktet duhet të dallohen nga ato të bëra nga mbajtësit e të drejtave nëpërmjet paketimit, ngjyrosjes, formës së veçantë, me kusht që një dallim i tillë të jetë i mundshëm, por të mos ketë ndikim të rëndësishëm në çmim. Paketimi dhe çdo udhëzim ose instruksion shoqërues duhet të ketë një tregues që produkti i nënshtrohet një licencë detyruese, duke dhënë emrin e autoritetit kompetent dhe çdo numër identifikues reference, si dhe duke specifikuar qartë se produkti është ekskluzivisht për eksport dhe shpërndarje në vendin ose vendet importuese përkatëse. Detajet e

karakteristikave të produktit u vihen në dispozicion autoriteteve doganore të vendeve përkatëse.

6. Përpara dërgesës në vendin ose vendet importuese, të cituara në kërkesë, i licencuari poston në një faqe zyrtare interneti informacionet e mëposhtme:

a) sasitë që do të furnizohen sipas licencës dhe vendet importuese ku ato do të furnizohen;

b) karakteristikat dalluese të produktit ose produkteve përkatëse.

Adresa e internetit i komunikohet autoritetit kompetent.

7. Nëse produkti ose produktet që përfshihen në licencën detyruese janë të patentuara në vendet importuese të përmendura në kërkesë, produkti ose produktet do të eksportohen vetëm nëse ato vende kanë lëshuar një licencë detyruese për importimin, shitjen ose shpërndarjen e produkteve.

8. Me kërkesë të mbajtësit të së drejtës ose me iniciativën e vet autoritetit kompetent, autoriteti kompetent mund të kërkojë të verifikojë dhe të inspektojë librat dhe regjistrat e mbajtur nga i licencuari, vetëm për të kontrolluar nëse janë plotësuar kushtet e licencës, veçanërisht ato që lidhen me destinacionin përfundimtar të produkteve. Librat dhe regjistrat duhet të përfshijnë dokumentin e eksportit të produktit, nëpërmjet një deklarate eksporti, të vërtetuar nga autoriteti doganor përkatës, dhe dokumentin e importit nga një prej organeve të përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji.

9. I licencuari është përgjegjës për pagimin e shpërblimit të drejtë të mbajtësit të të drejtave, duke mbajtur parasysh sa më poshtë:

a) në rastet e përmendura në pikën 2 të nenit 112 të këtij ligji shpërblimi është jo më shumë se 4% i çmimit total, shumë e cila do të paguhet nga vendi importues ose në emër të tij;

b) në të gjitha rastet e tjera shpërblimi caktohet duke marrë parasysh vlerën ekonomike të përdorimit të autorizuar, sipas licencës në vendin ose vendet importuese përkatëse, si dhe rrethanat humanitare ose jotregtare në lidhje me çështjen e licencës.

10. Kushtet e licencës nuk lidhen me mënyrën e shpërndarjes së produkteve në vendin ose vendet importuese. Shpërndarja mund të kryhet edhe nga ndonjë prej organeve ose organizatave të listuara në shkronjën “dh” të pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji, si



dhe në kushte tregtare ose jotregtare, duke përfshirë edhe mënyrën krejtësisht pa pagesë.

Neni 114 Refuzimi i kërkesës

1. Autoriteti kompetent refuzon kërkesën kur nuk plotësohet ndonjë prej kushteve të parashikuara në nenet 109 deri në 112 ose kur kërkesa nuk përmban elementet e nevojshme për të lejuar autoritetin kompetent të japë licencën, në përputhje me nenin 113 të këtij ligji.

2. Përpara refuzimit të kërkesës, autoriteti kompetent i jep një mundësi kërkuarit të korrigjojë situatën dhe të dëgjohet.

Neni 115 Njoftimi

Kur është dhënë një licencë detyruese, vendi i interesuar njofton Këshillin e TRIPS-it për dhënien e licencës dhe për kushtet specifike që bashkëlidhen me të.

Njoftimi përmban të dhënat e mëposhtme të licencës:

- a) emrin dhe adresën e të licencuarit;
- b) produktin ose produktet përkatëse;
- c) sasinë që do të furnizohet;
- ç) vendin ose vendet ku do të eksportohen produkti ose produktet;
- d) kohëzgjatjen e licencës;
- dh) adresën e faqes së internetit, të përcaktuar në pikën 6 të nenit 113 të këtij ligji.

Neni 116 Ndalimi i importimit

1. Ndalohet importimi në territorin e Republikës së Shqipërisë i produkteve të prodhuara sipas një licence detyruese të dhënë në përputhje me vendimin, të bazuar në Deklaratën e Doha-s ose me këtë ligj për qëllime të çlirimit për qarkullim të lirë, të rieksporimit, të vendosjes në procedura pezulluese ose të vendosjes në një zonë të lirë.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e rieksporimit në vendin importues, të cituar në kërkesë dhe të identifikuar në paketimin dhe dokumentacionin shoqërues të produktit, ose në rastin e vendosjes në një procedurë transiti ose

regjimi doganor magazinimi apo në një zonë të lirë me qëllim rieksporimit po në vendin importues.

Neni 117 Veprimet nga autoritetet doganore

1. Nëse ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar se produktet e prodhuara sipas licencës detyruese të dhënë në bazë të vendimit, bazuar në Deklaratën e Doha-s ose këtij ligji, janë duke u importuar në Republikën e Shqipërisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 116 të këtij ligji, autoritetet doganore pezullojnë çlirimin e produkteve ose bllokojnë produktet për një kohë që nevojitet për marrjen e një vendimi nga autoriteti kompetent për karakterin e produktit. Periudha e pezullimit ose bllokimit nuk është më e gjatë se 10 ditë pune, përveçse kur ka rrethana të veçanta, rast në të cilin periudha mund të zgjatet edhe me 10 ditë pune të tjera. Pas mbarimit të kësaj periudhe, produktet do të çlirohen vetëm pasi të kryhen të gjitha formalitetet doganore.

2. Autoriteti kompetent, mbajtësi i të drejtave dhe prodhuesi ose eksportuesi i produkteve përkatëse informohen pa vonesë për pezullimin e çlirimit ose bllokimin e produkteve dhe u jepet i gjithë informacioni që disponohet në lidhje me produktet përkatëse. Gjatë ndjekjes së këtyre procedurave, të gjithë personat e ngarkuar me trajtimin e produkteve janë të detyruar të mbrojnë konfidencialitetin e të dhënave personale dhe të sekretit tregtar dhe industrial, si dhe konfidencialitetin profesional e atë administrativ. Importuesit dhe, kur është rasti, eksportuesit do t'u krijohet mundësia e mjaftueshme të pajisin autoritetin kompetent me informacionin që ky e gjykon të përshtatshëm për produktet.

3. Kur konfirmohet se produktet e pezulluara ose të bllokuara nga autoritetet doganore destinoheshin për import në Republikën e Shqipërisë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 116 të këtij ligji, autoriteti kompetent siguron që produktet të ndalohen dhe të disponohen në përputhje me këtë ligj.

4. Procedura e pezullimit, bllokimit ose e ndalimit të produkteve do të kryhet me shpenzimet e importuesit. Nëse nuk është e mundur që këto shpenzime të mbulohen nga importuesi, ato mund të rikuperohen, në përputhje me këtë ligj, nga çdo person tjetër përgjegjës për importimin e paligjshëm.



5. Kur konstatohet më pas se produktet e pezulluara ose të bllokuara nga autoritetet doganore nuk e shkelin pikën 1 të nenit 116 të këtij ligji, autoritetet doganore i çlirojnë produktet të marrësi vetëm pasi të jenë kryer të gjitha formalitetet dhe procedurat doganore.

6. Autoriteti kompetent informon organin përkatës sipas Deklaratës së Doha-s për çdo vendim për ndalimin ose shkatërrimin e produkteve, të marrë në përputhje me këtë ligj.

Neni 118

Përfundimi i bagazheve personale

Nenet 116 dhe 117 të këtij ligji nuk zbatohen për mallrat e natyrës jotregtare që përmbahen në bagazhet personale të udhëtarëve për qëllime personale, brenda kufizimeve të përcaktuara për çlirimin nga detyrimi doganor.

Neni 119

Përfundimi ose rishikimi i licencës

1. Në varësi të mbrojtjes së përshtatshme të interesave të të licencuarit, të mbështetura në ligj ose në rregullore, licenca detyruese e dhënë në bazë të këtij ligji mund të përfundojë me vendim të autoritetit kompetent ose të një organi që parashikohet në nenin 120 të këtij ligji, kur kushtet e licencës nuk respektohen nga i licencuari. Me kërkesë të arsyetuar të mbajtësit të të drejtave ose të të licencuarit, autoriteti kompetent ka të drejtë të rishqyrtojë licencën detyruese nëse janë respektuar kushtet e saj. Ky rishikim do të bazohet në vlerësimin që bëhet në vendin importues kur është e përshtatshme.

2. Mbarimi i licencës së dhënë sipas këtij ligji i njoftohet Këshillit të TRIPS-it, sipas dispozitave të Deklaratës së Doha-s.

3. Pas mbarimit të licencës, autoriteti kompetent ka të drejtë të vendosë një afat të arsyeshëm brenda së cilës i licencuari të organizojë dhe të marrë masat që të dërgojë, me shpenzimet e tij, çdo produkt në posedim, ruajtje, zotërim ose kontroll, në vendet në nevojë, siç parashikohet në nenin 107 të këtij ligji, ose ndryshe të shkatërrojë ato, siç do përcaktohet nga autoriteti kompetent në konsultim me mbajtësit e të drejtave.

4. Kur vendi importues njofton se sasia e produktit farmaceutik është bërë e pamjaftueshme

për të përmbushur nevojat e tij, autoriteti kompetent ka të drejtë, me kërkesë të të licencuarit, të modifikojë kushtet e licencës me qëllim që të lejohet prodhimi dhe eksporti i sasive shtesë të produktit në masën e nevojshme për të përmbushur nevojat e vendit importues. Kërkesa e të licencuarit në raste të tilla do të trajtohet sipas një procedurë të thjeshtë dhe të përsheptuar, ku informacioni i parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 109 të këtij ligji nuk do të kërkohej, vetëm pasi të identifikohet licenca detyruese origjinale nga i licencuari. Në situatat kur zbatohet pika 1 e nenit 112 të këtij ligji, por nuk zbatohet përjashtimi i pikës 2 të këtij neni, nuk do të kërkohej prova të mëtijshme për negociatat me mbajtësin e të drejtave, me kusht që shuma shtesë e kërkuar e produkteve të mos kalojë 25% të shumës së dhënë, sipas licencës detyruese origjinale. Në situatat kur zbatohet pika 2 e nenit 112 të këtij ligji, nuk do të kërkohej asnjë provë negociimi me mbajtësin e të drejtave.

Neni 120

Ankimet

Ankimet kundër çdo vendimi të autoritetit kompetent për licencat detyruese dhe mosmarrëveshjet në lidhje me pajtueshmërinë me kushtet e tyre do të shqyrtohen nga gjykata kompetente.

Neni 121

Siguria dhe efikasiteti i produkteve mjekësore

Kur kërkesa për licencë detyruese ka lidhje me një produkt mjekësor, kërkuesi mund t'i bashkëngjisë kërkesës një opinion shkencor ose certifikatë eksporti, të dhënë sipas procedurës së parashikuar në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, për produkte eksporti të destinuara ekskluzivisht për tregjet jashtë Republikës së Shqipërisë.



KREU III
LICENCA DETYRUESE PËR PATENTAT
E SHPIKJEVE BIOTEKNOLOGJIKE

Neni 122

**Licenca detyruese për patentat e shpikjeve
bioteknologjike**

1. Me kërkesë drejtuar autoritetit kompetent për të përdorur në mënyrë joekskluzive një shpikje të mbrojtur me një patentë të mëparshme ose një të drejtë mbi një varietet bimor të mëparshëm, autoriteti kompetent mund t'i japë licencë detyruese për patentën e mëparshme pronarit të një patente të mëvonshme ose mbajtësit të një të drejte mbi një varietet bimor të mëvonshëm, i cili nuk mund të përdorë patentën ose të drejtën e mëvonshme, pa cenuar patentën ose të drejtën e mëparshme mbi variatetin bimor, përkundrajt një pagese të caktuar nga eksperti i zgjedhur nga autoriteti kompetent, me kusht që:

a) shpikja e patentës ose e së drejtës së mëvonshme të jetë një përparim teknik me rëndësi ekonomike të konsiderueshme, krahasuar me shpikjen e patentës ose të drejtën e mëparshme;

b) mbajtësi i patentës ose i së drejtës së mëvonshme t'i ketë kërkuar zotëruesit të patentës ose të së drejtës të mëparshme të përdorin atë mbi bazën e një licence dhe të mos u jetë dhënë kjo me të gjitha përpjekjet e bëra.

2. Autoriteti kompetent verifikon nëse palët janë para një situatë të tillë, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, përpara se sa të vendosë për dhënien e licencës detyruese për një përdorim joekskluziv të patentës ose të drejtës së mëparshme.

3. Për rastin e licencës detyruese, të dhënë sipas pikës 1 të këtij neni, pronari i patentës ose mbajtësi i së drejtës së mëparshme ka të drejtë të marrë një licencë të ndërsjellë me kushte të arsyeshme për të përdorur patentën ose të drejtën e mëvonshme.

4. Në rastin e një licence detyruese, të dhënë sipas këtij neni, përdorimi ose shfrytëzimi i autorizuar i patentës ose i së drejtës së mëparshme është i transferueshëm vetëm kur transferohet patentat ose e drejta e mëvonshme.

PJESA X
TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

Neni 123

Transferimi i pronësisë së patentës

1. Pronësia mbi një patentë transferohet plotësisht ose pjesërisht.

2. Kontrata për transferimin e pronësisë së patentës bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët para noterit, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.

3. Me kërkesë të pronarit ose përfituesit të patentës ose, sipas rastit, me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me akt noterial në rastin e kalimit të pronësisë me trashëgimi, transferimi i pronësisë së patentës regjistrohet nga DPPI-ja në regjistrin përkatës, kur depozitohen:

a) një nga dokumentet në vijim në lidhje me transferimin e pronësisë:

i. një kopje e kontratës ose marrëveshjes së transferimit të pronësisë së patentës;

ii. një kopje e vendimit gjyqësor të formës së prerë për transferimin e pronësisë;

iii. një kopje e aktit noterial kur pronësia e patentës kalon me trashëgimi; ose

iv. një kopje e ekstraktit tregtar, në rastet e bashkimit ose të ndarjes së shoqërive tregtare, të lëshuar nga autoriteti kompetent përkatës, ku tregohet pronari i ri i patentës. Ky dokument mund të paraqitet edhe në rastin kur transferimi i pronësisë së patentës lidhet me ndryshimin e formës ligjore të shoqërisë;

b) autorizimi i përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga një përfaqësues;

c) pagesa e tarifës përkatëse; dhe

ç) formulari përkatës i nënshkruar rregullisht.

4. Kërkesa për regjistrimin e transferimit të pronësisë së patentës përmban informacionin e nevojshëm për të identifikuar patentën, pronarin e ri, si dhe dokumentet që duhen për regjistrimin e transferimit të pronësisë, sipas pikës 3, të këtij neni.

5. Brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës, DPPI-ja shqyrton nëse kërkesa është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Kur kërkesa për transferimin e pronësisë përmban të meta ose mangësi, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim të plotësorë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Në



rast se të metat ose mangësitë nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, kërkesa për transferimin e pronësisë së patentës refuzohet me vendim.

7. Kur kërkesa për transferimin e pronësisë është depozituar në përputhje me kërkesat sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni, ose kur plotësohen të metat ose mangësitë brenda afatit dymujor dhe është paguar tarifa përkatëse dhe plotësohen kërkesat e caktuara në këtë nen për regjistrimin e transferimit të pronësisë, DPPI-ja brenda 1 muaji regjistron transferimin e pronësisë në regjistrin përkatës dhe e boton atë në buletin e saj.

8. Transferimi i pronësisë së patentës regjistrohet në regjistrin e patentave, pasi kryhet pagesa e tarifës përkatëse, nëse nuk është paguar më parë.

9. Ky nen do të zbatohet njëloj (*mutatis muntandis*) edhe për ndryshimet e pronësisë së kërkesës për patentë, modelin e përdorimit dhe certifikatën e mbrojtjes shtesë.

10. Patentat e regjistruara për armatimin ushtarak dhe teknologji ushtarake nuk mund të transferohen apo shiten te subjekte të huaja ose entitete private pa miratimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

11. Të dhëna të detajuara për përmbajtjen e kërkesës dhe procedurën për regjistrimin e transferimit të pronësisë përcaktohen në rregulloret për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 124 Licencimi

1. E drejta për të shfrytëzuar shpikjen që mbrohet me patentë mund t'i jepet një personi tjetër me kontratë licencimi.

2. Licenca është ekskluzive ose joekskluzive.

3. Kontrata e licencimit bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

4. Lidhja e kontratës së licencimit për një patentë që zotërohet bashkërisht nga disa mbajtës të patentës bëhet me pëlqimin dhe nënshkrimin e të gjithë mbajtësve të patentës.

5. Ky nen zbatohet njëloj edhe për kërkesën për patentë, modelin e përdorimit dhe certifikatën e mbrojtjes shtesë.

6. Kontrata e licencimit sjell efekte për palët dhe personat e tretë nga data që ajo regjistrohet në regjistrin.

7. Transferimi i pronësisë përpara regjistrimit sjell efekte ndaj palëve të tjera që i kanë fituar të drejtat mbi patentën pas datës së këtij transferimi, edhe pse ishin në dijeni se transferimi ende nuk ishte regjistruar në datën në të cilën këto palë i fituan të drejtat.

8. Patentat e regjistruara për armatimin ushtarak dhe teknologji ushtarake nuk mund të licencohen apo shiten te subjekte të huaja ose entitete private, pa miratimin e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes.

Neni 125

Regjistrimi i transferimit të të drejtave dhe i kontratës së licencimit

1. Me kërkesë të mbajtësit të patentës ose të një personi që ka fituar një patentë, ose të secilës prej palëve, DPPI-ja pasqyron ndryshimet e patentës në lidhje me transferimin e të drejtave dhe licencës së parashikuar në nenet 123 dhe 124 të këtij ligji, në regjistrin përkatës, me kusht që:

a) të paguhet tarifa përkatëse;

b) të depozitohet kontrata ose marrëveshja që provon transferimin ose licencimin dhe, kur kontrata ose marrëveshja nuk është në gjuhën shqipe, të depozitohet një kopje e përkthyer në gjuhën shqipe;

c) të depozitohet autorizimi i përfaqësimit, nëse regjistrimi kërkohet përmes një përfaqësuesi.

2. Kontrata ose marrëveshja origjinale ose e njësuar me origjinalin depozitohet e plotë ose e pjesshme me kusht që të tregohet qartë ndryshimi i bërë.

3. Nëse regjistrimi i transferimit të të drejtave kërkon ndryshimin e të dhënave për mbajtësin e patentës, i cili përfaqësohet nga një përfaqësues në kuptim të pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, depozitohet një autorizim përfaqësimi për mbajtësin e ri të patentës.

4. Nëse kërkesa për regjistrimin e ndryshimit në patentë, sipas këtij neni, përmban të meta ose mangësi, DPPI-ja i dërgon aplikantit njoftim të plotësojë të metat ose mangësitë brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse të metat ose mangësitë nuk plotësohen brenda afatit dymujor, DPPI-ja e rrëzon kërkesën me vendim.

6. Kur kërkesa paraqitet e rregullt ose kur të metat ose mangësitë plotësohen brenda afatit të parashikuar dymujor, DPPI-ja e regjistron



ndryshimin e kërkuar në regjistrin përkatës dhe e boton atë në buletin.

7. Mënyra e depozitimit dhe detajet e përmbajtjes së kërkesës përcaktohen në rregullore për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

Neni 126

Regjistrimi i të drejtave reale

1. Patenta mund të jetë objekt i një kontrate garancie, pengu ose i të drejtave të tjera reale.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, si dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, kontrata e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni regjistrohet në regjistrin e patentave dhe botohet në buletin e DPPI-së.

3. Kontrata e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni prodhon efekte ndaj palëve të treta pasi regjistrohet në regjistrin e patentave.

4. Përcaktimet e këtij neni zbatohen njëloj edhe për kërkesën për patentë, modelin e përdorimit dhe certifikatën e mbrojtjes shtesë.

Neni 127

Regjistrimi i procedurave të falimentimit dhe të parafalimentimit

Kur një kërkesë për patentë, një patentë, model përdorimi ose certifikatë e mbrojtjes shtesë është pjesë e një pasurie falimentimi, të dhënat për gjendjen e falimentimit ose procedurat parafalimentimit regjistrohen në regjistrin përkatës mbi bazën e njoftimeve nga një autoritet kompetent, një likuidator ose administrues i pasurisë së falimentimit, si dhe në forma të tjera të parashikuara në ligjin e posaçëm.

PJESA XI PAVLEFSHMËRIA

Neni 128

Pavlefshmëria e patentës

1. Çdo person ose DPPI-ja, me iniciativën e vet, ka të drejtë të kërkojë deklarimin plotësisht ose pjesërisht të pavlefshëm të një patente, kur patenta është dhënë:

a) për një objekt që nuk mund të mbrohet nga një patentë, në kuptim të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të këtij ligji;

b) për një shpikje, që nuk ishte risi në kuptim të nenit 9 të këtij ligji, ose që nuk përbënte hap shpikës në kuptim të nenit 11 të këtij ligji, ose për një shpikje që nuk ishte e aplikueshme në industri, në kuptim të nenit 12 të këtij ligji, në datën e depozitimit të kërkesës për patentë ose në datën e prioritetit, kur ka prioritet;

c) për një shpikje që nuk është bërë e njohur në mënyrë të mjaftueshme e qartë dhe e detajuar aq sa të mund të zbatohet nga një person i kualifikuar në fushën e arritjes;

ç) për objektin e patentës ose atë pjesë të objektit të saj, që shtrihet përtej përmbajtjes së kërkesës për patentë, ashtu siç është depozituar, ose, nëse patenta është dhënë në bazë të një kërkesë të ndarë, përtej përmbajtjes së kërkesës fillestare, ashtu siç është depozituar; dhe

d) në emër të një personi që nuk ka të drejtë të mbrojë shpikjen me patentë.

2. Kërkesa, sipas pikës 1 të këtij neni, shqyrtohet dhe vendoset në gjykatë.

3. Nëse vlefshmëria e patentës kundërshtohet në një proces gjyqësor, të filluar nga mbajtësi i licencës ekskluzive kundrejt një pale të tretë, proces në të cilin nuk merr pjesë pronari i patentës si palë ndërgjyqëse, vendimi i gjykatës është i detyrueshëm vetëm për palët në gjykim.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për pavlefshmëri të patentës, gjykata i jep pronarit të patentës mundësinë me njoftim të paraqesë argumentet e tij brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit, si dhe mund t'i kërkojë pronarit të patentës të depozitojë për qëllime provueshmërie botime dhe dokumente që tregojnë arritjet e mëparshme ku referohet kërkesa për patentë ose mbi bazën e të cilës është dhënë patenta nga zyra të tjera ekzaminuese.

5. Përcaktimet e këtij neni në lidhje me pavlefshmërinë e patentës zbatohen njëloj edhe për modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

Neni 129

Pasojat e pavlefshmërisë së patentës

1. Çdo patentë, pretendim ose pjesë e pretendimit që deklarohet i pavlefshëm konsiderohet se nuk ka sjellë pasoja që nga fillimi.

2. Nëse shkaqet për deklarimin e pavlefshmërisë ndikojnë vetëm pjesërisht mbi patentën, pavlefshmëria shtrihet vetëm mbi atë pjesë të patentës që deklarohet e pavlefshme. Deklarimi i pjesshëm i pavlefshmërisë ose kufizimi mund të zbatohet, të shënohet ose të regjistrohet në formën e një ndryshimi në pretendimet e patentës.

Neni 130

Botimi dhe nxjerrja e specifikimeve të ndryshuara të patentës

1. DPPI-ja regjistron deklarimin e pavlefshmërisë së patentës në regjistrin përkatës dhe e boton atë në buletin.

2. Kur një patentë mbahet në fuqi e ndryshuar, DPPI-ja boton në buletin specifikimet e reja të patentës.

3. Rregulla më të hollësishme për përmbajtjen e të dhënave që botohen përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

PJESA XII

**KËRKESA PËR PATENTË EVROPIANE
DHE PATENTA EVROPIANE**

Neni 131

Depozitimi i kërkesës për patentë evropiane

1. Kërkesa për patentë evropiane depozitohet në:
a) ZEP; ose
b) DPPI.

2. Kërkesa për patentë evropiane depozitohet drejtpërdrejt nëpërmjet postës ose në mënyrë elektronike në një kopje, në secilën prej gjuhëve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 14 të KPE-s, në përputhje me përcaktimet e KPE-së dhe rregulloreve në zbatim të saj.

3. Kërkesa për ndarje patente evropiane, sipas nenit 76 të KPE-së, dhe kërkesa e re për patentë evropiane, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 61 të KPE-së, depozitohen drejtpërdrejt në ZEP.

4. Kur një shpikje është me interes për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, aplikanti me vendbanim ose vendqëndrim në Shqipëri e depoziton kërkesën për patentë evropiane vetëm në DPPI.

5. Kërkesa për patentë evropiane, e depozituar në DPPI në një datë të caktuar, ka të njëjtin efekt sikur të ishte depozituar në ZEP në po atë datë, me kusht që DPPI-ja t’ia ketë transmetuar atë ZEP-it, në përputhje me dispozitat e KPE-së.

6. Kërkesa për patentë evropiane, që depozitohet në DPPI, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, mund të depozitohet në çdo gjuhë të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 14 të KPE-së.

7. Kur nga kërkesa, që depozitohet në DPPI, nuk del i qartë fakti që aplikanti aplikon për një patentë evropiane, me njoftim të DPPI-së, aplikanti depoziton një shkresë sqaruese në gjuhën shqipe apo angleze, ku bëhet e qartë se aplikohet për një patentë evropiane.

Neni 132

Tarifat dhe pagesat procedurale për kërkesat për patentë evropiane

Tarifat dhe pagesat procedurale për kërkesat për patentë evropiane i paguhen ZEP-it në përputhje me përcaktimet e KPE-së dhe rregulloreve në zbatim të saj.

Neni 133

Pasojat e kërkesës për patentë evropiane

1. Kërkesa për patentë evropiane, që kërkon të shtrijë mbrojtjen e një shpikjeje në Republikën e Shqipërisë si vend i caktuar, kërkesë të cilës i është dhënë një datë depozitimi, do të jetë e njëjtë me një kërkesë për patentë kombëtare, me datë prioriteti datën e depozitimit të kërkesës për patentë evropiane, pavarësisht rezultatit të kërkesës gjatë ndjekjes së procedurave.

2. Kërkesa e botuar për patentë evropiane, e depozituar për mbrojtjen e një shpikjeje në Republikën e Shqipërisë si vend i caktuar, i siguron aplikantit të njëjtën mbrojtje që siguron edhe një kërkesë e botuar për patentë kombëtare, sipas nenit 95 të këtij ligji, duke filluar nga data në të cilën aplikanti i ka komunikuar përkthimin në shqip të pretendimeve të kërkesës së botuar për patentë evropiane personit që përdor shpikjen në Shqipëri.



ose nga data që pretendimet e përkthyer në shqip botohen nga DPPI-ja.

3. Kërkesa për patentë evropiane konsiderohet se nuk ka sjellë pasoja që nga fillimi, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, nëse kërkesa është tërhequr, konsiderohet se është tërhequr, është refuzuar përfundimisht ose nëse caktimi i Republikës së Shqipërisë është tërhequr apo konsiderohet se është tërhequr.

Neni 134

Pasojat e patentës evropiane

1. Patenta evropiane, që cakton Republikën e Shqipërisë si vend për mbrojtjen e një shpikjeje, sipas kërkesave të këtij neni, siguron po ato të drejta me ato që siguron një patentë kombëtare, sipas këtij ligji, që nga data e botimit të dhënies së patentës evropiane nga ZEP-i.

2. Pas dërgimit të njoftimit përkatës, DPPI-ja e regjistron patentën evropiane me vendim në regjistrin e patentave, pasi pronari i patentës evropiane të paguajë brenda tre muajve nga data e botimit të dhënies së patentës tarifën përkatëse për regjistrimin dhe pagesat e tjera për botimin e përkthimit të pretendimeve evropiane në shqip. Me qëllim që të regjistrojë patentën evropiane, aplikanti depoziton në DPPI:

- a) një kërkesë për regjistrimin e patentës evropiane në regjistrin e patentave;
- b) specifikimin e patentës evropiane në anglisht ose përkthimin e këtij specifikimi në anglisht, përveçse kur specifikimet ishin në anglisht;
- c) përkthimin e pretendimeve në shqip; dhe
- ç) vërtetimin e pagesës së tarifës së regjistrimit.

3. Në rast se si rezultat i një kundërshtimi të depozituar në ZEP, patenta evropiane mbahet në fuqi me pretendime të ndryshuara ose kufizohet pas ndryshimit të pretendimeve, si rezultat i një kërkesë për kufizim, pronari i patentës evropiane, brenda tre muajve nga data e botimit të vendimit përkatës të ZEP-it për mbajtjen në fuqi ose kufizimin, duhet t'i paraqesë DPPI-së përkthimin e pretendimeve të ndryshuara në gjuhën shqipe dhe të paguajë tarifën e përcaktuar.

4. Kur pretendimi përmban shenja reference të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

5. DPPI-ja boton sa më parë çdo përkthim të depozituar rregullisht, sipas pikave 2 ose 3 të këtij neni.

6. Nëse përkthimi, i përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, nuk depozitohet në kohën e duhur ose tarifa përkatëse nuk paguhet në kohën e duhur, patenta evropiane konsiderohet e pavlefshme që nga fillimi për Republikën e Shqipërisë. Kërkesa për patentë evropiane dhe patenta e dhënë do të konsiderohen se nuk kanë sjellë që nga fillimi pasojat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, dhe në nenin 131 të këtij ligji, në rastin kur patenta evropiane është shfuqizuar ose kufizuar me procedurë kundërshtimi, kufizimi apo shfuqizimi para ZEP-it.

7. Afati i përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, mund të zgjatet me një muaj nëse aplikanti paraqet një kërkesë për zgjatje afati dhe paguan tarifën përkatëse për këtë qëllim.

8. Detaje më të hollësishme në lidhje me kërkesën për regjistrimin e patentës evropiane dhe për përmbajtjen e botimit përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

Neni 135

Teksti autentik i kërkesës për patentë evropiane ose i patentës evropiane

1. Teksti i një kërkesë për patentë evropiane ose i një patente evropiane i bërë në gjuhën e kërkesës në procedurat përpara ZEP-it shërben si tekst autentik për të gjitha procedurat në Republikën e Shqipërisë.

2. Kur përkthimi i përcaktuar në pikën 2 të nenit 133 dhe pikat 2 dhe 3 të nenit 134 të këtij ligji, siguron një mbrojtje më të kufizuar nga mbrojtja që siguron kërkesa për patentë evropiane ose patenta evropiane, ky përkthim do të konsiderohet autentik. Kjo nuk zbatohet ndaj procedurave që lidhen me deklarin e një patente si të pavlefshme.

3. Aplikanti ose pronari i patentës mund të depozitojë një përkthim të korrigjuar në çdo kohë.

4. Përkthimi i korrigjuar i pretendimeve të një patente evropiane, të botuar sipas nenit 134 të këtij ligji, nuk ka efekte ligjore në Republikën e Shqipërisë derisa ky përkthim t'i jetë komunikuar personit që përdor shpikjen në Republikën e Shqipërisë.

5. Përkthimi i korrigjuar i pretendimeve të përcaktuara sipas këtij ligji nuk sjell pasoja ligjore në



Republikën e Shqipërisë si vend i caktuar derisa DPPI-ja të botojë korrigjimin e përmendur sapo të jetë paguar tarifa përkatëse për botimin, sipas pikës 5 të nenit 134 të këtij ligji.

6. Çdo person, që përdor në mirëbesim ose ka bërë përgatitje efektive dhe serioze për të përdorur një shpikje, përdorimi i së cilës nuk përbën cenim të një kërkesë për patentë evropiane ose të një patente evropiane në përkthimin origjinal, mund ta vazhdojë këtë përdorim gjatë zhvillimit të biznesit të vet ose për nevoja të ndryshme, pasi përkthimi i korrigjuar të bëhet i vlefshëm, pa kryer ndonjë pagesë për këtë.

Neni 136

Të drejtat që burojnë nga data më e hershme

1. Kërkesa për patentë evropiane ose patenta evropiane, që caktohet për t'u shtrirë në Republikën e Shqipërisë, ka të njëjtin efekt që ka edhe kërkesa për patentë kombëtare ose patenta kombëtare në lidhje me arritjen e mëparshme.

2. Kërkesa për patentë kombëtare ose patenta kombëtare ka të njëjtin efekt që ka edhe kërkesa për patente evropiane ose patenta evropiane që caktohet për t'u shtrirë në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me arritjen e mëparshme.

Neni 137

Mbrojtja e njëkohshme

Kur patenta evropiane, që caktohet për t'u shtrirë në Republikën e Shqipërisë, dhe një patentë kombëtare, që ka të njëjtën datë depozitimi ose, kur kërkohet prioritet, të njëjtën datë prioriteti, i është dhënë të njëjtit person ose zëvendësuesit të tij ligjor, patenta kombëtare, për aq sa ajo lidhet me të njëjtën shpikje me atë të patentës evropiane nuk do të ketë më efekt:

a) nga data kur ka përfunduar afati për depozitimin e kundërshtimit ndaj patentës evropiane, nëse nuk është depozituar kundërshtimi; ose

b) nëse është depozituar kundërshtimi, nga data kur procedura e kundërshtimit ka përfunduar me vendim të formës së prerë për lënien në fuqi të patentës evropiane.

Neni 138

Konvertimi në kërkesë për patentë kombëtare

1. Me kërkesë të aplikantit të një patente evropiane, DPPI-ja fillon procedurën për konvertimin e patentës evropiane në patentë kombëtare në rastet e mëposhtme:

a) kur kërkesa për patentë evropiane është tërhequr sipas pikës 3 të nenit 77 të KPE-së; ose

b) kur përkthimi i një kërkesë për patentë evropiane sipas pikës 2 të nenit 14 të KPE-së nuk është depozituar brenda afatit sipas pikës 3 të nenit 90 të KPE-së.

2. Në rastin e përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, kërkesa për konvertimin e një kërkesë për patentë evropiane në kërkesë për patentë kombëtare depozitohet në DPPI, kur kërkesa për patentë evropiane për të cilën kërkohet konvertimi është depozituar në DPPI. DPPI-ja, në varësi të dispozitave ligjore për sigurinë kombëtare, ia përcjell kërkesën zyrove qendrore të pronësisë industriale të shteteve kontraktore të KPE-së, që specifikohen në kërkesë.

3. Në rastin e shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, kërkesa për konvertimin e një kërkesë për patentë evropiane në kërkesë për patentë kombëtare depozitohet në ZEP, e cila ia përcjell kërkesën DPPI-së, nëse Republika e Shqipërisë caktohet në të si vend shtrirës.

4. Kërkesa për konvertimin e një kërkesë për patentë evropiane në një kërkesë për patentë kombëtare depozitohet brenda afatit të përcaktuar nga neni 115(1) i KPE-së dhe efektet e kësaj kërkesë për patentë evropiane, siç parashikohen në nenin 131 të këtij ligji, mbarojnë nëse kërkesa për konvertim nuk depozitohet brenda afatit.

5. Brenda dy muajve nga data e depozitimit në DPPI të kërkesës për konvertimin e një kërkesë për patentë evropiane në një kërkesë për patentë kombëtare, aplikanti bën pagesën e tarifës përkatëse për depozitimin e kërkesës, si dhe depozition përkthimin në shqip të tekstit origjinal të kërkesës për patentë evropiane.

6. Kur nuk paguhet tarifa brenda afatit ose nuk depozitohet përkthimi në shqip i tekstit origjinal të kërkesës për patentë brenda afatit, kërkesa për konvertim konsiderohet se nuk është depozituar, për të cilën DPPI-ja nxjerr vendimin përkatës.

7. Konvertimi botohet në buletinin e DPPI-së.



8. Të dhëna të detajuara në lidhje me konvertimin dhe për përmbajtjen e botimit parashikohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 139

Tarifat e mbajtjes në fuqi

Tarifat e ripërtëritjes së patentave evropiane i paguhen DPPI-së për vitet në vijim të vitit në të cilin dhënia e patentës evropiane botohet sipas rregullores së dalë në zbatim të pikës 2 të nenit 141 të KPE-së.

Neni 140

Deklarimi i pavlefshëm i patentës evropiane

1. Patenta evropiane mund të deklarohet e pavlefshme nga gjykata, me efekt në Republikën e Shqipërisë, në bazë të nenit 138 të Konventës së Patentave Evropiane, si dhe të nenit 128 të këtij ligji.

2. Kur gjatë ndjekjes së procedurës për deklarimin e pavlefshmërisë së një patente evropiane në DPPI, pronari i patentës mund të kufizojë patentën duke ndryshuar pretendimet, rast në të cilin procedura për deklarimin e pavlefshmërisë së patentës evropiane vazhdon të bëhet në bazë të patentës së kufizuar, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 138(3) të KPE-së.

3. Nëse kërkesa për pavlefshmërinë e patentës evropiane depozitohet në DPPI pas fillimit të procedurës së kundërshtimit në ZEP, sipas nenit 99 të KPE-së, ose pas fillimit të procedurës në lidhje me një kërkesë kufizimi ose shfuqizimi të patentës, sipas nenit 105/a të KPE-së, DPPI-ja pezullon procedurën në lidhje me kërkesën për deklarimin e pavlefshmërisë deri në përfundimin e procedurës nga ZEP-i.

Neni 141

Ligji i zbatueshëm

1. Ky ligj do të zbatohet për kërkesat për patentë evropiane dhe për patentat evropiane, të cilat, në përputhje me dispozitat e KPE-së dhe të këtij ligji i shtrijnë efektet në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur KPE-ja parashikon ndryshe.

2. Në rast konflikti midis dispozitave të KPE-së dhe dispozitave të këtij ligji, kanë përparësi dhe zbatohen dispozitat e KPE-së.

PJESA XIII

KËRKESA NDËRKOMBËTARE SIPAS TBP-së

Neni 142

Kërkesa ndërkombëtare

Dispozitat e TBP-së, ky ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji do të zbatohen për kërkesat ndërkombëtare të depozituara në DPPI si zyrë pritëse ose ku Republika e Shqipërisë shënohet si zyrë e caktuar ose e zgjedhur.

Neni 143

Kërkesa ndërkombëtare e depozituar në DPPI si zyrë pritëse

1. Kërkesa ndërkombëtare depozitohet në DPPI, si zyrë pritëse, kur aplikanti është shtetas shqiptar ose ka vendbanimin ose vendin kryesor të biznesit të tij në Republikën e Shqipërisë.

2. Depozitimi i kërkesës ndërkombëtare, sipas pikës 1 të këtij neni, shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse për dërgimin e kërkesës në Byronë Ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, pagesë e cila duhet të kryhet brenda një muaji pas datës së depozitimit të kërkesës ndërkombëtare në DPPI.

Neni 144

Mënyra e depozitimit të kërkesës ndërkombëtare në DPPI si zyrë pritëse

1. Kërkesa ndërkombëtare depozitohet në DPPI, si zyrë pritëse, në mënyrë elektronike ose në ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar në ligjin nr. 10 180, datë 29.10.2009, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”, në gjuhën angleze ose shqipe.

2. Nëse kërkesa ndërkombëtare është depozituar në gjuhën shqipe, aplikanti depoziton një përkthim të kërkesës ndërkombëtare në gjuhën angleze brenda 1 muaji pas depozitimit të kërkesës në DPPI.

3. Tarifat e përcaktuara në rregulloren e nxjerrë në zbatim të TBP-së dhe tarifat e përcaktuara në



marrëveshjen ndërmjet ZEP-it dhe Byrosë Ndërkombëtare paguhen brenda një muaji nga data e depozitimit të kërkesës ndërkombëtare.

4. Hetimi ndërkombëtar dhe ekzaminimi paraprak ndërkombëtar i kërkesave ndërkombëtare të depozituara në DPPI, si zyrë pritëse, do të kryhen nga ZEP-i.

5. Kërkesat teknike për depozitimin e kërkesës, mënyra e pagesës së tarifave, llogaritë ku do të bëhen pagesat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen në rregulloren për lëshimin e patentave për shpikje, modelet e përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.

Neni 145

Kërkesa ndërkombëtare e depozituar në DPPI si zyrë e caktuar ose zyrë e përzgjedhur

1. Kërkesa ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë caktohet ose zgjidhet për të dhënë patentën kombëtare, sipas dispozitave të TBP-së, depozitohet në DPPI në gjuhën shqipe brenda një afati prej 31 muajsh nga data e depozitimit të kërkesës ndërkombëtare ose nga data e prioritetit, kur e drejta e prioritetit është pretenduar në kërkesën ndërkombëtare, sipas nenit 8 të TBP-së. Kërkesa ndërkombëtare shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

2. Nëse pretendimet ndryshohen, në përputhje me nenin 19 të TBP-së, kërkesa ndërkombëtare, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë pretendimet e ndryshuara dhe një përkthim të deklaratës së përcaktuar në nenin 19 të TBP-së.

3. Nëse kërkesa ndërkombëtare ndryshohet, në përputhje me nenin 34 të TBP-së, dhe nëse raporti i ekzaminimit paraprak ndërkombëtar përmban shtojca për ndryshimet e bëra, kërkesa ndërkombëtare, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me shtojcat e raportit të ekzaminimit paraprak ndërkombëtar.

4. Dispozitat e këtij ligji, që referojnë në procedurën e dhënies së patentës të filluar sipas një kërkesë të rregullt kombëtare për patentë, zbatohen njëjloj edhe për kërkesën ndërkombëtare, të përmendur në pikën 1 të këtij neni.

5. Kërkesa ndërkombëtare, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, botohet në buletin e DPPI-së, jo më vonë se 6 muaj nga data e depozitimit.

6. Të drejtat e përkohshme, të parashikuara në nenin 95 të këtij ligji për kërkesën ndërkombëtare, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, hyjnë në fuqi nga data e botimit të përkthimit në gjuhën shqipe.

7. Kërkesa ndërkombëtare, e botuar sipas nenit 21 të TBP-së, nuk konsiderohet arritje e mëparshme, sipas pikës 3 të nenit 9 të këtij ligji, nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

PJESA XIV ZBATIMI I TË DREJTAVE

KREU I

Neni 146

Juridiksioni gjyqësor

1. Ankimet kundër vendimeve të Bordit të Apelit të DPPI-së depozitohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditësh nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka juridiksion për të gjitha çështjet e tjera, duke përfshirë:

a) të gjitha veprimet që lidhen me shkeljen e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë, si dhe veprimet që rrezikojnë shkeljen e këtyre të drejtave;

b) veprimet që lidhen me deklarimin e pavlefshmërisë së patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj;

c) dhënien e licencave detyruese, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) çdo mosmarrëveshje tjetër ndërmjet personave në lidhje me të drejtat e patentës, modelit të përdorimit dhe certifikatës së mbrojtjes shtesë, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 147

Normat e zbatueshme

1. Mjetet, masat dhe procedurat ligjore që parashikohen në këtë ligj zbatohen në lidhje me shkeljen e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë, pa cenuar mjetet e tjera ligjore që parashikohen në legjislationin kombëtar.



2. Ky ligj nuk përjashton zbatimin e legjislacionit penal në lidhje me procedurat ose sanksionet penale për shkeljen e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë.

Neni 148

Zbatimi i masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse

1. Personat, që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse janë:

a) mbajtësit e të drejtave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) çdo person i autorizuar për të përdorur këto të drejta, duke përfshirë të licencuarin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar, i licencuari ka të drejtë të marrë pjesë si person i tretë në procesin gjyqësor kundër shkeljes së të drejtave të filluar nga pronari i patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë.

Neni 149

Veprime që përbëjnë shkelje të të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë

Përbën shkelje të të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë, sipas rastit, çdo përdorim i paautorizuar i të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë, sipas dispozitave të këtij ligji.

KREU II PROVAT

Neni 150

Provat

1. Me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme në mbështetje të pretendimeve të saj se pala kundërshtare zotëron një ose më shumë prova, që kanë lidhje dhe rëndësi për çështjen në gjykim, gjykata kompetente mund të urdhërojë palën kundërshtare të paraqesë provat që ka në zotërim, me kushtin që të mbrohet informacioni konfidencial.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, gjykata vlerëson çdo provë të paraqitur nga pala kërkuuese në lidhje me pretendimet e saj.

3. Me kërkesë të palës, gjykata urdhëron, sipas rastit, paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare që janë në zotërim të palës kundërshtare, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial.

Neni 151

Masat për sigurimin e provave

1. Me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj mbi shkeljen ose rrezikun e shkeljes së të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë, gjykata urdhëron marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për sigurimin e provës, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial.

Këto masa mund të merren edhe përpara fillimit të procedurave gjyqësore për themelin e çështjes dhe mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm me ose pa marrjen e mostrave, konfiskimin fizik të mallrave cenuese dhe, sipas rastit, të materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin dhe/ose shpërndarjen e këtyre mallrave dhe dokumenteve të lidhura me to.

Gjykata vendos për marrjen ose jo të masave për sigurimin e provës brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, si dhe përcakton afatin kohor brenda të cilit duhet të zbatohet masa e urdhëruar nëpërmjet këtij vendimi.

Ky afat kohor nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

2. Gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit të së drejtës ose kur ka rrezik që të shkatërrohet prova.

Kur masat për sigurimin e provës vendosen pa dëgjuar palën tjetër, pala kundër së cilës është vendosur masa, njoftohet menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

Kur masat për sigurimin e provës janë vendosur pa i dhënë mundësi të dëgjohet palës kundër së cilës është vendosur masa, kjo e fundit mund të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të masës.

Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve që të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose



shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave për sigurimin e provës brenda një afati kohor të arsyeshëm që nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

3. Gjykata vendos që marrja e masave për sigurimin e provës të kushtëzohet me depozitimin nga kërkuuesi të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barasvlershme, me qëllim që të garantohet ose sigurohet shpërblimi i çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të paditurit sipas pikës 5 të këtij neni.

4. Me kërkesë të të paditurit, masat për sigurimin e provës shfuqizohen ose hiqen, pa cenuar të drejtën për dëmshpërblim që mund të pretendohet, nëse kërkuuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga gjykata në vendimin e saj për marrjen e masave.

Ky afat i arsyeshëm nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike, cildo që është afati më i gjatë, nga data e ekzekutimit të masës për sigurimin e provës.

5. Me kërkesën e të paditurit, gjykata urdhëron kërkuuesin që ai t'i sigurojë të paditurit një shpërblim të përshtatshëm për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa nëse:

a) masat e sigurimit të provës shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të një veprimi ose mosveprimi të kërkuuesit; ose

b) është konstatuar më vonë se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

6. Gjykata merr masa për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve.

Neni 152

E drejta për informim

1. Me kërkesë të arsyetuar dhe proporcionale të paditësit, gjykata urdhëron gjatë shqyrtimit të shkeljes së të drejtave të patentës, modelit të përdorimit dhe certifikatës së mbrojtjes shtesë që informacioni mbi origjinën dhe rrjetet e shpërndarjes së mallrave dhe shërbimeve që cenojnë të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë të sigurohet nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër që:

a) konstatohet se zotëron mallra cenuese në shkallë tregtare;

b) konstatohet se përdor shërbime cenuese në shkallë tregtare;

c) konstatohet se ofron shërbime që përdoren në veprimtari cenuese në shkallë tregtare; ose

ç) identifikohet nga personi i përcaktuar në shkronjat “a”, “b” ose “c” të kësaj pike se është përfshirë në prodhimin, përpunimin ose shpërndarjen e mallrave apo ofrimin e shërbimeve.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përfshin:

a) emrat dhe adresat e prodhuesve, përpunuesve, shpërndarësve, furnizuesve, mbajtësve të tjerë të mëparshëm të mallrave ose shërbimeve, si dhe të tregtarëve me shumicë dhe pakicë;

b) informacionin mbi sasitë e prodhuara, të përpunuara, të shpërndara, të marra ose të porositura, si edhe çmimet e marra për mallrat ose shërbimet në fjalë.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen pa cenuar dispozitat e tjera ligjore, të cilat:

a) i japin të drejta mbajtësit të së drejtës që të marrë informacion më të plotë;

b) rregullojnë përdorimin e informacionit të komunikuar në përputhje me këtë nen në proceset civile ose penale;

c) rregullojnë përgjegjësinë nga keqpërdorimi i të drejtës për informim;

ç) japin mundësi për refuzimin e dhënies së informacionit kur ky informacion detyron personin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni që të pranojë pjesëmarrjen e tij ose të familjarëve të tij në shkeljen e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë;

d) rregullojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit ose përpunimin e të dhënave personale.

KREU III

MASAT E PËRKOHSHME

Neni 153

Masat e përkohshme

1. Me kërkesën e personit të interesuar, gjykata vendos:

a) marrjen e masave të përkohshme kundër shkelësit të pretenduar për të parandaluar një shkelje të pritshme të së drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë ose për të ndaluar në mënyrë të përkohshme vazhdimin e shkeljes së pretenduar të së drejtave;



b) konfiskimin ose vendosjen nën kontroll të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë në mënyrë që të parandalojë hyrjen ose qarkullimin e tyre në treg.

Gjykata vendos për marrjen ose jo të masave të përkohshme brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Masat e përkohshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni mund të vendosen gjithashtu kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

3. Gjykata mund të vendosë konfiskimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, duke përfshirë bllokimin e llogarive të tij bankare dhe aseteve të tjera, kur pala e dëmtuar demonstroi rrethana të tilla që mund të rrezikojnë rikuperimin e dëmeve.

Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera të përshtatshme për marrjen e informacionit përkatës.

4. Gjykata mund t'i kërkojë kërkuarit prova në lidhje me masat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni për të vërtetuar nëse ai është mbajtës i së drejtës dhe nëse të drejtat e tij janë shkelur ose pritet të shkelen.

5. Gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për mbajtësin e së drejtës. Në një rast të tillë, kërkuari duhet të paraqesë padinë brenda 15 ditëve.

Në një rast të tillë, pala tjetër informohet menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

6. Kur masat e përkohshme janë vendosur pa i dhënë mundësi të dëgjohet palës tjetër kundër së cilës është vendosur masa, kjo e fundit mund të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të masës së përkohshme.

Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve të dëgjohen dhe në përfundim konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave të përkohshme brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

7. Me kërkesë të paditurit, gjykata vendos shfuqizimin ose heqjen e masave nëse kërkuari nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda një afati që nuk tejkalon 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike, sipas afatit më të gjatë.

8. Gjykata vendos që marrja e masave të kushtëzohet me depozitimin nga kërkuari të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barazvlefshëm, me qëllim që të garantohet ose sigurohet shpërblimi i çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të paditurit sipas pikës 9 të këtij neni.

9. Me kërkesën e të paditurit, gjykata urdhëron kërkuarin e masave që ai t'i sigurojë të paditurit një shpërblim të përshtatshëm për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa nëse:

a) masat e përkohshme shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të një veprimi ose mosveprimi të kërkuarit; ose

b) është konstatuar më vonë se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

KREU IV

PROCEDURAT DHE MASAT KUNDËR SHKELJES SË TË DREJTAVE

Neni 154

Procedurat dhe masat kundër shkeljes së të drejtave

1. Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse, sipas këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar:

a) ndalimin e tregtimit të mallrave dhe ofrimit të shërbimeve që shkelin të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë;

b) heqjen nga kanalet tregtare dhe/ose konfiskimin e mallrave cenuese dhe, sipas rastit, të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve;

c) shkatërrimin e mallrave cenuese, si dhe/ose të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve;

ç) botimin e pjesshëm ose të plotë të vendimit të gjykatës në medien publike me shpenzimet e



personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

d) shpërblimin e dëmit të pësuar nga shkelja e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë;

2. Gjkata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni me shpenzimet e shkelësit, përveçse kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e këtyre masave, gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta.

3. Masa e parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni mund të merret edhe ndaj ndërmjetësit kur nga përdorimi i shërbimeve të të cilit nga një palë e tretë cenohen të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

Neni 155 Shpërblimi i dëmit

1. Me kërkesë të palës së dëmtuar, gjykata urdhëron personin që është përfshirë në veprimtari shkelëse që të bëjë shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljes së të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë.

2. Në përllogaritjen e masës së shpërblimit të dëmit, gjykata mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, duke përfshirë:

- a) fitimin e munguar të palës së dëmtuar;
- b) çdo përfitim të padrejtë të realizuar nga shkelësi; dhe
- c) dëmin moral që i është shkaktuar palës së dëmtuar nga shkelja, cenimin e emrit dhe reputacionit tregtar.

3. Gjkata, sipas rastit, mund të vendosë shpërblimin e menjëhershëm të dëmit nëpërmjet caktimit të një shume monetare për t’u paguar nga shkelësi në favor të palës së dëmtuar. Vendimi i gjykatës bazohet në elemente të tilla si: fitimet, të ardhurat dhe/ose tarifat që do të siguroheshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizimin për përdorimin e të drejtave të patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë në fjalë.

4. Kur shkelësi nuk është përfshirë në aktivitet shkelës me vetëdije ose me arsye të arsyeshme për të qenë në dijeni të shkeljes, gjykata urdhëron

rikuperimin e fitimeve ose pagesën e dëmeve, të cilat mund të jenë të paracaktuara.

Neni 156 Masat në doganë

Kushtet dhe procedurat lidhur me veprimet që ndërmerren nga autoritetet doganore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e patentës, modelit të përdorimit dhe certifikatës së mbrojtjes shtesë nga mallra, të cilat janë ose duhet të ishin objekt i mbikëqyrjes doganore apo kontrollit doganor, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, rregullohen nga legjislacioni doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 157 Masat në tregun e brendshëm

1. Mbajtësi i të drejtave, sipas këtij ligji, mund të paraqesë një kërkesë-ankesë për inspektim tek autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm, duke kërkuar fillimin e procedurave dhe marrjen e masave përkatëse të inspektimit, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelen të drejtat e patentës, modelit të përdorimit ose të certifikatës së mbrojtjes shtesë nga mallra dhe shërbime që janë vendosur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit të tyre nga autoritetet doganore dhe kalimin në tregun e brendshëm.

2. Procedurat që zbaton autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, rregullohen nga legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe nga çdo ligj apo akt nënligjor tjetër që përmban dispozita për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

PJESA XV DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 158 Ankimi administrativ në Bordin e Apelit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vendimet e marra nga DPPI-ja, që kanë ndikim negativ mbi fitimin, ushtrimin ose mbajtjen në fuqi të të drejtave ose titujve të pronësisë sipas këtij ligji, duke përfshirë, në veçanti, çdo vendim që refuzon



dhënien ose regjistrimin e patentës, modelit të përdorimit ose certifikatës së mbrojtjes shtesë, mund të ankimohen administrativisht në Bordin e Apelit.

2. Kundër një vendimi të DPPI-së, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të bëjë ankim administrativ vetëm aplikanti ose mbajtësi i të drejtave që preken nga vendimi brenda 2 muajve nga data në të cilën është njoftuar vendimi.

3. Ankimi administrativ specifikon në mënyrë të qartë vendimin kundrejt të cilit është paraqitur ankimi, si dhe përmban elementet e mëposhtme:

a) argumentet, bazën ligjore, shkaqet dhe provat që lidhen me ankimin;

b) rivendosjen në afat për një të drejtë që kërkohet nëpërmjet ankimit;

c) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi;

ç) pagesën e tarifës përkatëse; dhe

d) formularin e kërkesës përkatëse të nënshkruar në mënyrë të rregullt.

4. Ankimi administrativ shqyrtohet nga Bordi i Apelit në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, duke marrë në konsideratë faktet, provat dhe argumentet e disponueshme për të. Procedurat në Bordin e Apelit nuk janë të hapura për ndërhyrjen e palëve të treta.

5. Në vijim të shqyrtimit të ankimit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, Bordi i Apelit mund të lërë në fuqi, të rishikojë ose të shfuqizojë vendimin e kontestuar të DPPI-së.

6. Ankimi administrativ i paraqitur në Bordin e Apelit pezullon ekzekutimin e aktit deri në njoftimin e vendimit të ankimit. Ankimi në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Bordit të Apelit.

7. Përbërja dhe procedurat, që lidhen me ankimin administrativ në Bordin e Apelit përcaktohen në rregulloren përkatëse për lëshimin e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 159

Afatet

1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht në këtë ligj, çdo afat i caktuar në këtë ligj mund të zgjatet deri në 2 muaj me kërkesë të palës së interesuar dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. Pala e interesuar depoziton në DPPI kërkesën për zgjatje afati përpara mbarimit të afatit të caktuar së bashku me pagesën e tarifës përkatëse.

3. DPPI-ja shqyrton pa vonesë kërkesën për zgjatje afati dhe, kur konstaton se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë nen, miraton zgjatjen e afatit deri në 2 muaj shtesë me vendim.

Neni 160

Kërkesat elektronike për shërbimet që ofron DPPI-ja

1. Çdo kërkesë për shërbimet, që ofrohen nga DPPI-ja, depozitohet elektronikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon shërbimet *on-line* në Republikën e Shqipërisë.

2. Çdo kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 161

Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllim të zbatimit të këtij ligji bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 162

Dispozita kalimtare

1. Proceset për shkëljen e të drejtave dhe procedurat administrative, që kanë filluar ose janë pezulluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen dhe do të vendosen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 1707, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, i ndryshuar.

2. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e pronësisë industriale do të mbeten në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj, deri në miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

3. Ky ligj, rregulloret dhe akte të tjera nënligjore, të miratuara në bazë të këtij ligji do të interpretohen dhe do të zbatohen në përputhje me TLP-në.



Neni 163
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda nëntë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të miratojë me vendim:

a) rregulloren e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë sipas pikës 9 të nenit 16; nenit 18; pikave 4 e 5 të nenit 19; pikës 2 të nenit 21; pikës 2 të nenit 22; pikës 3 të nenit 25; pikës 5 të nenit 26; pikës 7 të nenit 27; pikës 7 të nenit 28; pikës 8 të nenit 29; pikës 2 të nenit 30; pikës 2 të nenit 32; pikës 5 të nenit 36; pikës 2 të nenit 51; pikës 8 të nenit 57; pikës 2 të nenit 61; pikës 2 të nenit 62; pikës 2 të nenit 63; pikave 6 e 8 të nenit 75; pikës 7 të nenit 78; pikës 10 të nenit 79; pikës 4 të nenit 84; pikës 3 të nenit 85; pikës 1 të nenit 103; pikës 4 të nenit 109; pikës 11 të nenit 123; pikës 7 të nenit 125; pikës 3 të nenit 130; pikës 8 të nenit 134; pikës 8 të nenit 138; pikës 5 të nenit 144 dhe pikës 7 të nenit 158 të këtij ligji;

b) rregulloren për përfaqësuesit e autorizuar në zbatim të pikës 9 të nenit 16 të këtij ligji;

c) tarifat për shërbimet e ofruara nga DPPI-ja në lidhje me objektet e pronësisë industriale, në zbatim të nenit 18 të këtij ligji.

Neni 164
Shfuqizime

1. Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 të nenit 4 dhe nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 36/a, 36/b, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 87/a, 87/b, 87/c, 87/ç, 87/d, 87/dh, 87/e, 87/ë, 87/f, 87/g, 87/gj, 88, 89, 90, 91, 92, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 188/a të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Nenet 184/a, 184/b, 184/c, 184/ç, 185, 185/a, 186, 187, 188 të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji, për aq sa parashikohet në lidhje me patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë dhe jo për objektet e tjera të pronësisë industriale.

Neni 165
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr. 281, datë 29.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 281, datë 29.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 53/2025, “Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 55/2025

**PËR ADMINISTRIMIN E
BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESA**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt:



a) rregullimin e marrëdhënieve juridike në fushën e administrimit dhe mirëmbajtjes së bashkëpronësisë në ndërtesa, të truallit, objekteve dhe mjediseve ndihmëse, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme;

b) përcaktimin e subjekteve, marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe me të tretët, të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella;

c) rolin e bashkisë në zbatimin e këtij ligji;

ç) sanksionet përkatëse në rast mospërbushjeje të këtyre detyrimeve.

Neni 2 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e një sistemi të drejtë, të qëndrueshëm, transparent, llogaridhënës dhe eficient të administrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve në bashkëpronësi të detyrueshme në ndërtesa, duke siguruar një balancë të drejtë midis respektimit të së drejtës të pronës të çdo bashkëpronari dhe përbushjes së interesit publik për zhvillimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, si dhe paqes e harmonisë sociale.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrator” është personi fizik, regjistruar në librin e bashkëpronësisë, të mbajtur nga bashkia, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. “Akti i bashkëpronësisë” është dokumenti që përmban të gjitha objektet në bashkëpronësi, sipas përcaktimeve të pikës 9 të këtij neni, që hartohet nga krijuesi i pronës si pjesë përbërëse e kontratës së shitblerjes, kontratës së dhurimit apo kontratës së këmbimit të truallit me njësitë e banimit dhe është në përputhje me projektin ndërtimor të miratuar nga organi kompetent në zbatim të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe që regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

3. “Asambleja e bashkëpronarëve” është tërësia e bashkëpronarëve të secilit kat ose njësie të ndarë të çdo kati, në ato raste kur ndërtesa është e ndarë me kate, ose secilës njësi ose pjesëve të njësisë, në rastet

e komplekseve të ndërtimit, të cilët kanë në bashkëpronësi objektet e përbashkëta të ndërtesës.

4. “Bashkëpronarë” janë personat, të cilët kanë në pronësi të paktën një njësi të veçantë në një ndërtesë të caktuar dhe për këtë shkak kanë në bashkëpronësi të detyrueshme objektet e pandashme të ndërtesës.

5. “Inspektorati vendor” është inspektorati ndërtimor dhe urbanistik i bashkisë, që funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisjen vendore dhe inspektimet.

6. “Krijuesi i pronës” është një institucion shtetëror, person juridik, person ose grup personash fizikë që veprojnë së bashku, të cilët investojnë për krijimin e pronës sipas legjislacionit në fuqi, në emër të të cilëve regjistrohet për herë të parë pronësia, që ofrojnë për herë të parë për shitje ose për çdo lloj kalimi tjetër në pronësi individuale njësitë brenda bashkëpronësisë.

7. “Kryesia” përbëhet nga tre apo më shumë pronarë të njësisë individuale, që veprojnë në emër dhe për llogari të asamblesë për të gjitha veprimet e nevojshme, sipas Kodit Civil dhe këtij ligji.

8. “Kuotë e pjesëmarrjes në bashkëpronësi” është pjesa e pronësisë së pandashme në pronën e përbashkët, e cila shërben për përcaktimin e masës së pjesëmarrjes në shpenzimet e përbashkëta dhe në votim për pronarët e çdo njësie. Kuota e pjesëmarrjes në bashkëpronësi për çdo njësi përcaktohet në bazë të raportit të sipërfaqes së njësisë individuale (në m²) me shumën e sipërfaqes së të gjitha njësive. Kuota e pjesëmarrjes në pronën e përbashkët dhe njësia nuk mund të tjetërsohen të ndara nga njëra-tjetra.

9. “Objekte në bashkëpronësi të detyrueshme” janë objektet e parashikuara shprehimisht në aktin e bashkëpronësisë dhe aktin e pronësisë të secilit bashkëpronar në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit në ato raste kur ndërtesa është e ndarë me kate ose me vleftën e njësisë ose të pjesëve të njësisë në rastet e komplekseve të ndërtimit dhe, deri në plotësimin e këtij akti, ato që janë përcaktuar në nenin 209 të Kodit Civil, si dhe në këtë ligj.

10. “Ndërtesë” konsiderohet:

a) ndërtesa me hyrje të pavarur, e ndarë me kate, me dy ose më shumë njësi individuale të parashikuara për banim apo për përdorim të përzier si njësi shërbimi, tregtare, administrative, që ndodhen në të njëjtin objekt, të cilat kanë në pronësi të përbashkët truallin, objektet, mjediset ndihmëse,



infrastrukturën apo impiantet/sistemet në funksion dhe në përdorim ekskluzivisht të pronarëve të njësive;

b) tërësia e ndërtesave që përbëjnë një kompleks ndërtimi multifunksional, komplekse rezidenciale apo turistike, resorte apo klasifikime të ngjashme sipas legjislacionit për planifikimin e territorit, ndërtuar nga i njëjti investitor dhe që përfshihen brenda së njëjtës leje zhvillimi apo shtese të saj, të cilat kanë në pronësi të përbashkët truallin, mjediset ndihmëse, infrastrukturën apo impiantet/sistemet në funksion dhe në përdorim ekskluzivisht të pronarëve të njësive, që përbëjnë një kompleks.

11. “Njësi” është një pjesë e ndërtesës, e destinuar për njësi banimi ose përdorim të përzier si njësi shërbimi, tregtare, administrative ose që është në pronësi individuale, e cila së bashku me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi përbën një pjesë të veçantë pasurie të paluajtshme. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në aktin e bashkëpronësisë, kjo pasuri e paluajtshme trajtohet me po ato të drejta, që i njihen çdo pasurie tjetër të paluajtshme.

12. “Pronar i njësisë” është një ose janë më shumë persona fizikë apo juridikë, që ka ose kanë në pronësi një njësi individuale.

13. “Shoqëri administruese” është personi juridik privat, regjistruar në regjistrin përkatës të mbajtur nga bashkia për të ushtruar veprimtarinë në fushën e administrimit të ndërtesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

14. “Tarifa e administrimit” është detyrimi mujor në para i secilit bashkëpronar për përballimin e shpenzimeve për administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet për të gjitha ndërtesat me dy ose më shumë pronarë, që shërbejnë për banim ose për përdorim të përzier si njësi shërbimi, tregtare, administrative, që kanë në pronësi të përbashkët truallin, objekte, mjedisin ndihmës, në funksion dhe në përdorim ekskluzivisht të pronarëve të njësive në ndërtesë.

Neni 5

Pronësia individuale

1. Përveç rasteve kur në aktin e bashkëpronësisë ose në projektin e ndërtesës nuk specifikohet ndryshe, kufiri i pronësisë individuale të njësisë përcaktohet nga sipërfaqja e brendshme perimetrike e mureve ndarëse të njësisë me njësitë e tjera individuale, tavanet e dyshemeja dhe përfshin çdo element, që ndodhet brenda këtij perimetri, si: dritaret, dyert, shkallët e brendshme, të cilat i shërbejnë vetëm njësisë individuale, me përjashtim të mureve mbajtëse dhe pjesëve të tjera, që janë të domosdoshme për ekzistencën, funksionimin e qëndrueshmërinë.

2. Ndryshimi i destinacionit të njësisë pronë individuale kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Objekte në pronësi të përbashkët

1. Objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët është e pandashme dhe është në pronësinë e përbashkët të pronarëve të njësive individuale, në përputhje me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi.

2. Prona e përbashkët, përveç kur në aktin e pronësisë është caktuar ndryshe, përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, sipas legjislacionit në fuqi, si: trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimi, themelet, muret mbajtëse, çatia, tarraca, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, pusët, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat, si dhe muret rrethuese, rrugët e brendshme të kompleksit, lulishtet, parqet, ambientet sportive, shtyllat e ndriçimit e çdo hapësirë e pajisje tjetër, në funksion të kompleksit.

3. Prona e përbashkët përfshin, gjithashtu, pjesë të ndërtesës për përdorim të përbashkët, të cilat janë vendosur gjatë ndërtimit ose më vonë, si: kanalizime, kolona shkarkimi, oxhakë, sisteme elektrike, rrjete interneti, hidraulike, gazi ose ngrohjeje, që mund të kalojnë nëpër pronën e përbashkët deri në pikat e shpërndarjes në njësitë individuale dhe në komplekse, depot e ujit, kabinat



elektrike dhe ato të vendosjes së pajisjeve të shërbimit internet bashkë me rrjetet përkatëse, sistemet e vaditjes, kullimit, mbledhjes ose përpunimit të plehrave, sistemet për mbledhjen dhe përpunimin e ujërave të zeza, si dhe çdo sistem tjetër për përdorim të përbashkët.

4. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pasqyron në hartën kadastrale kufijtë gjeografikë të pasurive të krijuara me aktin e fitimit të pronësisë për çdo pjesë të pronës. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me kufirin e pronës, zbatohet legjislacioni për kadastrën.

Neni 7

Bashkëpronësia e njëjse

Në njësitë ku ka dy ose më shumë pronarë marrëdhëniet e bashkëpronësisë ndërmjet pronarëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit Civil, të këtij ligji dhe të rregullores së administrimit të banesave e të ndërtesave.

KREU II

REGJISTRIMI I AKTIT TË BASHKËPRONËSISË

Neni 8

Përmbajtja e aktit të bashkëpronësisë

1. Akti i bashkëpronësisë, që regjistrohet në kadastrë, duhet të përmbajë:

a) dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për kadastrën;

b) përshkrimin fizik dhe statusin ligjor të truallit;

c) përshkrimin fizik të ndërtesës, destinacionin e përdorimit të çdo njësie individuale, përfshirë objektet në bashkëpronësi të detyrueshme;

ç) planimetritë ose vizatimet e mjaftueshme për identifikimin e vendndodhjes dhe të përcaktimit të sipërfaqes së çdo njësie brenda strukturës ndërtimore, duke përfshirë kufirin ndarës gjeografik të pasurive në raport me njëra-tjetrën;

d) kuotat e pjesëmarrjes në bashkëpronësi për çdo njësi;

dh) përshkrimin e pronës së përbashkët;

e) procedurat e ndryshimit të aktit të bashkëpronësisë, si dhe çdo ndryshim në të dhënat sipas këtij neni.

2. Format i aktit të bashkëpronësisë, procedurat dhe afatet për deklarimin e të dhënave,

sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe përditësimet e të dhënave në aktet ekzistuese në kadastrë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Regjistrimi

1. Regjistrimi i aktit të bashkëpronësisë për të gjitha ndërtesat bëhet në drejtorinë vendore të kadastrës, nën juridiksionin e së cilës ndodhet ndërtesa, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën. Akti i bashkëpronësisë regjistrohet në emër të bashkëpronarëve të ndërtesës.

2. Në kohën kur regjistrohet ndërtesa, çdo njësi individuale së bashku me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi regjistrohen më vete dhe përbëjnë një pjesë të veçantë pasurie të paluajtshme. Për rastet kur prona e çdo njësie kalon nga krijuesi tek pronari individual, si dhe për çdo ndryshim tjetër të mëvonshëm të pronësisë së njësisë, në regjister shënohen data e ndryshimit të pronësisë, emri i pronarit të ri dhe çdo informacion shtesë, i nevojshëm për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

3. Bashkia, sipas rastit, mbështet bashkëpronarët me të ardhura të pakta, që përfitojnë ndihmë ekonomike sipas ligjit nëpërmjet skemave mbështetëse me financime ose duke vënë në dispozicion personel teknik që i ndihmon në përmbytjen e detyrimeve që rrjedhin nga administrimi i objekteve në bashkëpronësi.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRONARËVE E TË PËRDORUESVE TË NJËSIVE

Neni 10

Të drejtat e pronarit të njësisë

Pronari i njësisë ka të drejtë:

a) të kërkojë nga bashkëpronarët e tjerë në bashkëpronësinë e detyrueshme, ku bën pjesë, apo dhe nga përdoruesit e këtyre njëjseve të veçanta të mos e cenojnë përdorimin e gëzimit të objekteve të pandashme, si dhe të kërkojë dëmshpërblim apo ndreqje të dëmit, kur dëmi është shkaktuar nga veprimet e tyre;

b) të marrë pjesë në vendimmarrje, sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe të këtij ligji;



c) të informohet nga asambleja ose administratori/shoqëria e administrimit për vendimet e marra në mungesë të tij;

ç) të informohet rregullisht nga administratori dhe nga kryesia për përdorimin e tarifës së administrimit;

d) të informohet nga administratori/shoqëria e administrimit për mospagesën e tarifës së administrimit nga pronarët e tjerë;

dh) t'i parashtojë asamblesë propozime për administrimin e ndërtesës.

Neni 11

Detyrimet e pronarit të njësisë

1. Pronari i njësisë ka detyrimet e mëposhtme:

a) të respektojë normat e etikës e të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të banesave e të ndërtesave;

b) të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë në gëzimin e objekteve, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme;

c) të paguajë tarifën e administrimit edhe në rastet kur nuk banon apo e ka dhënë njësinë me qira;

ç) të lejojë kryerjen e inspektimeve dhe të riparimeve të pronës së përbashkët brenda njësisë në pronësi të tij, sipas legjislacionit në fuqi;

d) të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij në lidhje me administrimin e objekteve në bashkëpronësi.

2. Në rast të moszbatimit të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 52 të këtij ligji.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet e krijuesit si pronar i njësisë

Për sa kohë që një apo disa njësi apo objekte në pronësi të përbashkët nuk janë tjetërsuar ose mbeten në pronësi të krijuesit të pronës, ky i fundit mbetet pronar i një kuote pjesëmarrjeje në bashkëpronësi, në përputhje me kuotën përkatëse të njërive të patjetërsuara, si dhe ka të drejtat e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, përfshirë detyrimin për të kontribuar në shpenzimet e përbashkëta, sipas kuotës që i është përcaktuar.

Neni 13

Detyrimet dhe të drejtat e qiramarrësve

1. Personat, që banojnë si qiramarrës në njësinë e pronarit, duhet të zbatojnë rregullat e caktuara nga asambleja për të gjithë banorët e bashkëpronësisë. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë, por pa të drejtë vote, përveç rasteve kur pronari i njësisë ka autorizuar me prokurë qiramarrësin të marrë pjesë dhe të votojë për çështjen në rend të ditës së mbledhjes.

2. Në rast se nuk parashikohet ndryshe në kontratën e qirasë, shpenzimet që burojnë nga administrimi i objekteve në bashkëpronësi janë detyrim i pronarit të njësisë. Pronari i njësisë njofton me shkrim administratorin/shoqërinë administruese kur, sipas parashikimeve kontraktore, shpenzimet mbulohen nga qiramarrësi.

3. Pronari i njësisë përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve nga administrimi i objekteve në bashkëpronësi, nëse ka marrë dënim me shkrim nga administratori se qiramarrësi nuk i ka përmbushur ato, pavarësisht parashikimeve kontraktore.

Neni 14

Detyrimet e pronarëve të njërive që nuk përdoren

1. Pronari i njësisë që nuk përdoret është i detyruar të kontribojë për administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës në bashkëpronësi njëllor si bashkëpronarët e tjerë, përveçse kur vendoset ndryshe nga asambleja e bashkëpronarëve.

2. Për mbajtjen e kontakteve me kryesinë ose administratorin dhe për kryerjen e pagesave mujore, pronari detyrohet të njoftojë me njëren nga mënyrat e mëposhtme:

a) të njoftojë për adresën ku dëshiron t'i dërgohen njoftimet;

b) të autorizojë një person për të mbajtur kontaktet;

c) të derdhë në llogarinë bankare të përcaktuar për administrimin tarifën, ose të autorizojë një person, që do të kryejë pagesën e tarifës në emër të tij.

3. Në rast se për riparimin e objekteve në bashkëpronësi është urgjente dhe e nevojshme të ndërhyhet në njësinë që nuk përdoret, pronari i njësisë njoftohet 10 ditë përpara, në mënyrë që ta hapë njësinë vetë ose me personin e autorizuar prej



tij. Nëse për shkak të natyrës së situatës urgjente nuk mund të pritët përmbushja e afatit dhe ndërhyrja me qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të banorëve të tjerë duhet të kryhet pa vonesë, me kërkesë të kryesisë, drejtuar inspektoratit vendor, bëhet hapja e njësisë, në prani të kryesisë dhe të inspektorit vendor. Inspektorati vendor mban procesverbal në lidhje me hapjen e njësisë. Në rast se nga kryesia nuk mund të jenë prezent të paktën 2 anëtarë, në procesin e hapjes thirren të paktën tre bashkëpronarë. Riparimi i objekteve në bashkëpronësi është në ngarkim të të gjithë bashkëpronarëve, sipas kuotës së pjesëmarrjes. Riparimi i dëmeve, shkaktuar në njësi individuale nga hapja me forcë, është në ngarkim të bashkëpronarëve, nëse nuk vërtetohet se pronari i njësisë ka qenë në dijeni dhe nuk është paraqitur me dashje.

KREU IV ASAMBLEJA E BASHKËPRONARËVE

Neni 15 **Konstituimi i asamblesë së bashkëpronarëve**

1. Mbledhja për konstituimin e asamblesë thirret nga krijuesi i ndërtesës brenda 30 ditëve nga data kur pronarët, që përbëjnë të paktën 1/3 e kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi, kanë fituar pronësinë mbi pjesët individuale. Anëtarësia në asamble përbëhet nga pronarët e të gjitha njësive, përfshirë krijuesin e ndërtesës, për sa kohë që ka në pronësi një apo më shumë njësi.

2. Kur asambleja nuk është mbledhur asnjëherë, secili nga bashkëpronarët ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e saj dhe, nëse bashkëpronarët refuzojnë të organizojnë asamblenë e tyre, secili bashkëpronar i drejtohet me kërkesë të arsyetuar administratorit të njësisë administrative të bashkisë për të thirrur mbledhjen organizuese. Kërkesa për mbledhjen e asamblesë pasqyron përpjekjet për të rënë dakord mbi zhvillimin e mbledhjes dhe arsyet e moszhvillimit. Brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës, përfaqësuesi i caktuar nga administratori i bashkisë realizon mbledhjen e asamblesë së bashkëpronarëve.

3. Në mbledhjen e parë asambleja zgjedh kryesinë, vendos formën e administrimit dhe masën e tarifës së administrimit. Një kopje e vendimit për

zgjedhjen e kryesisë depozitohet për regjistrim në bashki dhe reflektohet në librin e bashkëpronësisë.

4. Asambleja autorizon kryesinë të hapë llogari bankare në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve në një nga bankat e nivelit të dytë me qëllim depozitimin e të gjitha tarifave të administrimit apo fondit rezervë sipas këtij ligji dhe përdorimin e tyre sipas tagrave të përcaktuar në këtë ligj dhe në rregulloren e administrimit të banesave e të ndërtesave.

Neni 16 **Rregullorja e administrimit të banesave dhe ndërtesave**

1. Asambleja e bashkëpronarëve miraton rregulloren e administrimit të banesave dhe ndërtesave, që hartohet sipas rregullores tip, të miratuar me vendim nga Këshilli i Ministrave, sipas pikës 2 të këtij neni, dhe që përfshin, por pa u kufizuar vetëm në:

a) procedurat e krijimit të asamblesë dhe të kryesisë, të organizimit dhe funksionimit të tyre, të ndërveprimit me administratorin/shoqërinë administruese, të organizimit të mbledhjeve, marrjes së vendimeve dhe mënyrës së kryerjes së njoftimeve;

b) procedurat e administrimit të buxhetit të bashkëpronësisë, duke përfshirë fondin rezervë dhe tagrat e kryesisë e të administratorit apo shoqërisë administruese për përdorimin e llogarisë bankare të çelur sipas nenit 15 të këtij ligji;

c) rregullat e përgjithshme të administrimit e të mirëmbajtjes së pronës;

ç) procedurat për verifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e shkakut të dëmit, shkaktuar nga përdorimi i pakujdesshëm sipas këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore, miraton rregulloren tip për administrimin e banesave e të ndërtesave, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij neni.

Neni 17 **Kompetencat e veçanta të asamblesë së bashkëpronarëve**

Përveç kompetencave të përgjithshme, që përcaktohen në nenin 214 të Kodit Civil, asambleja e bashkëpronarëve ka edhe këto kompetenca:



a) miraton kriteret dhe kostot e administrimit, tarifën e administrimit, si dhe mënyrën e kohën e pagesës së saj për secilin bashkëpronar;

b) miraton paketën e administrimit për çdo vit;

c) merr vendim për formën e administrimit të bashkëpronësisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

ç) autorizon kryesinë të lidhë kontratë me njërin nga administratorët/shoqëritë administrative, bazuar në ofertën që e ka vlerësuar më të leverdishme, si dhe miraton, në parim, kontratën që do të nënshkruajë;

d) miraton planin financiar, të paraqitur nga administratori/shoqëria e administrimit;

dh) miraton lejimin e shfrytëzimit apo të përdorimit të hapësirave të përbashkëta për aktivitete tregtare në dobi të të gjithë bashkëpronarëve, si dhe përdorimin e të ardhurave që gjenerohen;

e) miraton çeljen e një llogarie bankare pranë një banke të nivelit të dytë, ku do të transferohen apo do të depozitohen tarifat e administrimit, dhe të një llogarie të posaçme bankare për fondin rezervë në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve, duke autorizuar kryesinë për përdorim dhe, sipas rastit, duke përcaktuar kufizime të përdorimit të këtyre llogarive nga administratori apo shoqëria e administrimit;

ë) miraton fondin rezervë dhe përcakton kriteret e përdorimit të tij, duke autorizuar kryesinë për këtë qëllim;

f) miraton lejimin e vendosjes së paneleve diellore për rritjen e eficiencës energjetike, të instalimeve për përdorimin e ujit apo grumbullimin e mbetjeve në ambientet e objekteve në bashkëpronësi, nëse vendosja nuk cenon njësi në pronësi individuale apo objektet në bashkëpronësi të detyrueshme;

g) miraton kërkesat për ndryshimin e pamjes së objekteve në bashkëpronësi ose pamjen e jashtme të njësisë individuale, pjesë e një kompleksi ndërtimi, dhe kërkesat për ndërtime mbi katin e fundit të njësisë individuale, pjesë e një kompleksi ndërtimi, sipas nenit 40 të këtij ligji;

gj) miraton, nëse e konsideron të nevojshme, kryerjen e një auditimi financiar mbi administrimin e fondeve, shpenzimeve të mirëmbajtjes, si dhe aspekte të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme.

Neni 18

Mbledhjet e asamblesë së bashkëpronarëve

1. Njoftimi për mbledhjen e radhës së asamblesë afishohet nga kryesia në një vend të dukshëm në ndërtesë, të paktën 10 ditë para mbledhjes, ku shënohen: vendi, ora dhe rendi i ditës. Mbledhja e asamblesë mund të zhvillohet me prezencë fizike apo *online* nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit. Në raste të jashtëzakonshme, mbledhja mund të bëhet brenda ditës dhe, si mënyrë njoftimi, përveç afishimit, përdoret edhe njoftimi me postë elektronike me telefon apo njoftimi verbal pranë vendqëndrimit të bashkëpronarit.

2. Në rast se me njoftimin e parë nuk janë të pranishëm personalisht apo të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, të cilët përfaqësojnë 2/3 e tërësisë së kuotave të pjesëmarrjes në bashkëpronësi, njoftimi përsëritet për një mbledhje tjetër brenda 3 (tri) ditëve nga data kur do të zhvillohej mbledhja e parë. Në këtë mbledhje duhet të jenë të pranishëm personalisht apo të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, që përfaqësojnë të paktën shumicën e zakonshme të kuotave të pjesëmarrjes në bashkëpronësi.

3. Mbledhja e asamblesë së bashkëpronarëve drejtohet nga kryetari i zgjedhur nga bashkëpronarët e pranishëm. Kryetari verifikon që formalitetet për thirrjen e asamblesë janë kryer rregullisht dhe të gjithë anëtarët kanë marrë dijeni, si dhe që kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje është arritur. Vendimet e asamblesë së bashkëpronarëve, procesverbali dhe lista e të pranishmëve përgatiten nga kryesia dhe firmosen nga kryetari e pronari i njësisë, që është më i vjetri në moshë nga bashkëpronarët e tjerë, pjesëmarrës në mbledhje.

Neni 19

Vlefshmëria e vendimeve

1. Vendimet e asamblesë së bashkëpronarëve janë të vlefshme kur ato merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të asamblesë, përveç rasteve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, sipas këtij ligji dhe dispozitave të Kodit Civil.

2. Vendimet e asamblesë u njoftohen të gjithë bashkëpronarëve ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar, si dhe shpallen në një vend të dukshëm në ndërtesë.



3. Kundër vendimeve të asamblesë, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, bëhet ankimim në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në territorin ku ndodhet ndërtesa, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.

Neni 20

Zgjedhja e kryesisë

1. Kryesia zgjidhet nga radhët e anëtarëve të asamblesë së bashkëpronarëve dhe vepron në emër e për llogari të saj.

2. Kryesia përbëhet nga të paktën 3 (tre) anëtarë, por, në të gjitha rastet, jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.

3. Anëtarët e kryesisë zgjidhen për një mandat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Mandati i anëtarit të kryesisë përfundon kur mbaron mandati, vdes, jep dorëheqjen apo shkarkohet nga asambleja. Ndryshimet në anëtarësinë e kryesisë pasqyrohen nga administratori në librin e bashkëpronësisë.

Neni 21

Mbledhja e kryesisë

1. Njoftimi për mbledhjen e kryesisë afishohet nga administratori në një vend të dukshëm në ndërtesë, të paktën 5 (pesë) ditë para mbledhjes, ku shënohen: vendi, ora, rendi i ditës dhe, sipas rastit, dokumentacioni përkatës. Mbledhja e kryesisë mund të zhvillohet me prezencë fizike apo *online* nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit. Në raste të jashtëzakonshme mbledhja mund të bëhet brenda ditës dhe si mënyrë njoftimi, përveç afishimit, përdoret edhe njoftimi me mjete elektronike, me telefon apo njoftimi verbal pranë vendqëndrimit të bashkëpronarit.

2. Në rast se kryesia përbëhet nga më shumë se 3 (tre) anëtarë, kur me njoftimin e parë nuk janë të pranishëm personalisht apo të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, të cilët përfaqësojnë 2/3 e anëtarëve të kryesisë, njoftimi përsëritet për një mbledhje tjetër brenda 3 (tri) ditëve nga data kur do të zhvillohej mbledhja e parë. Në këtë mbledhje duhet të jenë të pranishëm personalisht apo të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, që përfaqësojnë të paktën shumicën e zakonshme të anëtarëve.

3. Mbledhja e kryesisë drejtohet nga kryetari i zgjedhur nga anëtarët e pranishëm. Kryetari

verifikon që formalitetet për thirrjen e kryesisë janë kryer rregullisht dhe të gjithë anëtarët kanë marrë dijeni, si dhe që kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje është arritur. Vendimet e kryesisë, procesverbali dhe lista e të pranishmëve përgatiten nga kryetari ose një anëtar i përcaktuar prej tij dhe firmosen nga të gjithë anëtarët, pjesëmarrës në mbledhje.

Neni 22

Kompetencat e veçanta të kryesisë

1. Përveç kompetencave të tjera, të përcaktuara në këtë ligj, kryesia ka edhe këto kompetenca:

a) miraton vendimin për vlerësimin e dëmit dhe ndreqjen e tij me kërkesë të një bashkëpronari, të cilit i është shkaktuar dëm nga përdorimi i pakujdesshëm i një bashkëpronari tjetër, duke e detyruar atë të rivendosë në gjendjen e mëparshme njësinë e bashkëpronarit të dëmtuar. Vlerësimi i dëmit kryhet, sipas rastit, nga personat e specializuar, që ofrojnë ndreqjen dhe riparimin, apo eksperti i licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse dëmtuesi nuk ndërmerr masat e nevojshme për të rivendosur në gjendjen e mëparshme bashkëpronarin e dëmtuar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit, vendimi i kryesisë së bashkëpronarëve për ndreqjen e dëmit përbën titull ekzekutiv, në kuptim të shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ekzekutohet nga shërbimi përmbarrimor sipas ligjit. Nëse pronari që ka shkaktuar dëmin nuk është dakord me vlerën e dëmit të caktuar nga kryesia, ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet civile. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e titullit ekzekutiv;

b) autorizon administratorin ose shoqërinë administruese për të kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas pikës 3 të nenit 33 të këtij ligji, si dhe ndjekjen deri në fund të ekzekutimit për mospagesën e tarifës së administrimit nga bashkëpronari;

c) përdor/prek fondin rezervë ose autorizon administratorin të përdorë/prekë fondin rezervë, sipas kriteve të përdorimit, të përcaktuara nga asambleja e bashkëpronarëve;

ç) përfaqëson asamblenë e bashkëpronarëve në raport me të tretët për kryerjen e veprimeve juridike, me qëllim administrimin e objekteve në bashkëpronësi;



d) miraton planin dhe modalitetet për shfrytëzimin apo përdorimin e hapësirës së përbashkët për aktivitete tregtare në dobi të të gjithë bashkëpronarëve dhe autorizon administratorin në lidhje me nënshkrimin e kontratës përkatëse;

dh) shkarkon administratorin ose shoqërinë administruese, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore;

e) çdo detyrë tjetër të caktuar nga asambleja e bashkëpronësisë.

2. Kryesia mund të autorizojë administratorin/shoqërinë administruese për të njoftuar ndryshimet në të dhënat e librit të bashkëpronësisë dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës në bashki.

Neni 23

Vlefshmëria e vendimeve

1. Në rastin kur kryesia përbëhet nga më shumë se 3 (tre) anëtarë, vendimet e kryesisë janë të vlefshme kur ato merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve, përveç rasteve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, sipas këtij ligji.

2. Vendimet e kryesisë u njoftohen të gjithë bashkëpronarëve ose përfaqësuesve të tyre të autorizuar, si dhe shpallen në një vend të dukshëm në ndërtesë.

KREU V

ADMINISTRIMI I BASHKËPRONËSISË

Neni 24

Format e administrimit të bashkëpronësisë

1. Kryesia, në emër dhe për llogari të asamblesë, mund të lidhë kontratë për administrimin e bashkëpronësisë me:

a) një shoqëri administrimi;

b) një administrator, person fizik, i cili mund të jetë njëri prej bashkëpronarëve ose një person i jashtëm.

2. Në rastin kur administrimi i bashkëpronësisë kryhet nga një shoqëri administrimi, për çdo ndërtesë caktohet një administrator i regjistruar në regjistrin e administruesve, pjesë e librit të bashkëpronësisë.

3. Në rastin kur administrimi i bashkëpronësisë kryhet me administrator, ai regjistrohet pranë administratës tatimore për t'u pajisur me numër identifikimi unik (NUIS) të gjeneruar nga sistemi, që

shërben si numër i identifikimit tatimor, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për procedurat tatimore. Ky rregull zbatohet edhe në rastin kur administrimi i bashkëpronësisë kryhet nga një administrator i caktuar nga shoqëria e administrimit.

4. Kontrata me administratorin/shoqërinë administruese lidhet për të paktën një afat 3-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje, nëse kryesia vlerëson që shërbimet janë kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratën e lidhur me të.

Neni 25

Regjistrimi dhe certifikimi i administratorëve dhe shoqërive të administrimit

1. Çdo person, fizik apo juridik, privat, që ka për objekt veprimtarie administrimin e ndërtesave, regjistrohet në librin e bashkëpronësisë pranë bashkisë, në juridiksionin e së cilës do ta ushtrojë këtë veprimtari dhe do të certifikohet prej saj.

2. Trajnimi profesional i personave për kryerjen e veprimtarisë së administrimit kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave miraton vendimin për procedurat që duhet të ndjekin bashkitë, kriteret për regjistrimin, programin e trajnimit dhe certifikimin e administratorëve e të shoqërive të administrimit, mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet për heqjen nga regjistri nga ana e bashkisë.

Neni 26

Përgjegjësitë e administratorit/shoqërisë administruese

1. Administratori/shoqëria administruese kryen detyrat e përcaktuara në kontratë ose në marrëveshjen me kryesinë, në varësi të formës së zgjedhur të administrimit. Përgjegjësitë e administrimit përfshijnë, ndër të tjera, edhe:

a) zbatimin e vendimeve të marra nga asambleja e bashkëpronarëve ose kryesia;

b) ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për mirëmbajtjen e bashkëpronësisë sipas ligjit, përfshirë edhe kontraktimin e subjekteve të treta, kur një gjë e tillë është miratuar nga kryesia;

c) ndërmarrjen e masave për përputhshmërinë me standardet e administrimit, duke përfshirë mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e



zakonshme, si dhe kontrollet periodike, teknike e higjieno-shëndetësore për gjendjen e pronës e të objekteve në bashkëpronësi, si sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit, sistemi i ngrohjes qendrore, ashensorëve, tarracave, sistemi i ndriçimit, infrastrukturës së brendshme për rrjetin e komunikimeve elektronike, pranisë së insekteve e të parazitëve dhe të veprimeve për të zhdukur dëmtimet e pronës apo pranisë së faktorëve, që mund të përbëjnë rrezik për epidemi sëmundjeje;

ç) mbledhjen, faturimin ose kontrollin për derdhjen në llogari bankare të tarifave mujore, si dhe përditësimin periodik pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në lidhje me kufizimet në pasurinë e paluajtshme të bashkëpronarëve debitorë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

d) mbajtjen e buxhetit për mirëmbajtje dhe riparime, në zëra të veçantë, në emër të asamblesë;

dh) kontrollin e kostove e të pagesave të të gjitha faturave në emër të asamblesë apo kryesisë;

e) mbajtjen e librit të llogarive të asamblesë dhe të atyre bankare;

ë) përgatitjen e raportit për gjendjen financiare, katërmujor e vjetor, dhe raportimin në mbledhjen vjetore të asamblesë;

f) përgatitjen e planit të veprimeve vjetore të buxhetit përkatës, masës dhe kohës së kryerjes së pagesës së tarifave mujore dhe paraqitjen e tyre në mbledhjen vjetore të asamblesë për vendimmarje;

g) kontrollin e zbatimit të rregullave të bashkëjetesës sipas këtij ligji;

gj) regjistrimin e ashensorit pranë strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut në ato raste kur nuk është kryer ende;

h) këshillimin nga asambleja ose kryesia, kur është e nevojshme;

i) depozitimin e çdo të dhëne apo ndryshimi në librin e bashkëpronësisë;

j) krijimin, përditësimin dhe ruajtjen e të gjitha akteve, procesverbaleve apo dokumenteve, që lidhen me administrimin e bashkëpronësisë;

k) sigurimin dhe marrjen e ofertave për shërbime që lidhen me administrimin e bashkëpronësisë nga subjekte të specializuara, duke u bazuar në kriteret ligjore dhe standardet e miratuara nga institucionet kompetente dhe paraqitjen e tyre për miratim nga kryesia;

l) sigurimin e aksesit çdo operatori në infrastrukturën e ndërtesës, me qëllim ofrimin e

rrjetit me shpejtësi të lartë të komunikimeve elektronike;

ll) sigurimin e kryerjes së shërbimeve të miratuara në përputhje me specifikimet dhe afatet e përcaktuara në kontratat përkatëse.

2. Administratori mbikëqyrret nga kryesia. Pas përfundimit të kontratës, administratori/shoqëria administruese ka detyrimin t'i kthejë kryesisë, pa vonesë, të gjithë shumën, pjesë e fondit rezervë në para, nëse disponon të tillë, si dhe dokumentacionin e administrimit të mbajtur gjatë administrimit të ndërtesës.

3. Format i kontratës tip, që lidh asambleja me administratorin, që përmban përgjegjësitë e detajuara të administratorit/shoqërisë administruese, miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

Neni 27

Shoqëritë administruese

1. Shoqëritë administruese, përveç shërbimit të administrimit, mund të mbulojnë me veprimtarinë e tyre edhe shërbimet e mirëmbajtjes, nëse kanë personelin me kualifikimin e nevojshëm për veprimtari specifike të mirëmbajtjes sipas ligjit, si: mirëmbajtja e ashensorëve, restaurimi apo rikonstruksioni i fasadave apo mjediseve të brendshme, si dhe çdo lloj veprimtarie tjetër, që kërkon kualifikim të posaçëm, në një fushë të caktuar sipas ligjit.

2. Nëse administratorët apo shoqëritë administruese, gjatë përmbushjes së veprimtarisë në lidhje me përmbushjen e standardeve të administrimit, kryejnë veprime në kundërshtim me këtë ligj, bashkia, kryesisht apo me kërkesë të çdo të interesuari, i heq ata nga lista e subjekteve të regjistruara dhe të certifikuara. Në aktin e heqjes nga kjo listë parashikohen edhe detyrimet e këtij subjekti ndaj asamblesë së bashkëpronarëve të kontraktuar.

Neni 28

Kontraktimi i një subjekti administrues

1. Lista e administratorëve dhe e shoqërive administruese, të regjistruara brenda juridiksionit të bashkisë, shpallet në vendin e njoftimeve të institucionit ose në faqen zyrtare të bashkisë.

2. Administratori mund të ushtrojë aktivitet, që lidhet me administrimin e objekteve në



bashkëpronësi pas përfundimit të trajnimit dhe certifikimit sipas ligjit.

3. Administratorët apo shoqëritë administruese paraqesin llojin e shërbimeve që ofrojnë, kohën e realizimit dhe cilësinë e shërbimit me çmimet përkatëse. Kryesia vendos për subjektin që dëshiron të kontrakttojë, bazuar në shqyrtimin e ofertave, në sasinë e shërbimeve që ofrohen, cilësinë, kohën dhe vlerën e ofertës.

Neni 29

Moskontraktimi i një subjekti administrues

1. Kryetari i bashkisë, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, ka të drejtë të kontrakttojë administratorin ose shoqërinë administruese nga lista e administratorëve apo shoqërive administruese të regjistruar në bashki, nëse:

a) një asamble bashkëpronarësh nuk konstituohet;

b) një asamble nuk merr vendim për formën e administrimit brenda afatit të parashikuar në nenin 15 të këtij ligji.

Kryetari i bashkisë informohet nga administratori i njësisë mbi moskontraktimin e subjektit administrues.

2. Përzgjedhja e listës së administratorëve apo e shoqërive administruese kryhet bazuar në një proces transparent dhe mbi kritere objektive të miratuara me udhëzim të ministrit, që mbulon fushën e pushtetit vendor.

3. Kryetari i bashkisë ka të drejtë ta ushtrojë këtë kompetencë për 3 (tre) muaj, me të drejtë rizgjatjeje, derisa asambleja të konstituohet ose kryesia të kontrakttojë një administrator apo një shoqëri administruese. Kryetari i bashkisë, sipas rastit, mund të delegojë kryerjen e veprimeve të përmendura në këtë nen tek administratori i njësisë.

4. Akti i lëshuar nga bashkia, që përcakton shpenzimin e kryer nga të ardhurat e saj për këtë procedurë të jashtëzakonshme, përbën titull ekzekutiv në kuptimin e shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarrimit, në ngarkim të bashkëpronarëve, që nuk kanë shlyer vullnetarisht detyrimin. Asambleja e bashkëpronarëve mund të kundërshtojë masën e shpenzimeve në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e titullit ekzekutiv.

Neni 30

Standardet e administrimit

1. Në standardet e administrimit të ndërtesës përfshihet zbatimi i normave detyruese të mirëmbajtjes së zakonshme në ndërtesa, si standarde minimale dhe të domosdoshme për t'u respektuar nga bashkëpronësia, për:

a) ruajtjen e higjienës e të shëndetit publik;

b) mbrojtjen kundër zjarrit;

c) mirëmbajtjen fizike të mjediseve të brendshme, të fasadave, mjediseve rrethuese, që janë pjesë e aktit të bashkëpronësisë, si dhe të sjelljes qytetare në këto mjedise;

ç) regjistrimin dhe mirëmbajtjen e ashensorëve;

d) ruajtjen e sistemeve të ujit, ngrohjes, ftohjes ose ventilimit;

dh) ndërtimin, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe administrimin e pikës së aksesit në godina.

2. Mbikëqyrja për realizimin e standardeve të administrimit bëhet nga bashkia.

3. Në rast se konstatohet nga bashkia se standardet e administrimit, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohen brenda afateve të parashikuara, bashkia urdhëron kryerjen e tyre nga një subjekt tjetër i përzgjedhur nga lista e subjekteve që kryejnë këto shërbime. Bashkia krijon dhe përditëson një listë me subjekte që ofrojnë dhe kryejnë shërbimet e renditura në pikën 1 të këtij neni.

4. Shpenzimet për realizimin e shërbimeve hartohen mbi bazën e një metodologjie për përlogaritjen e tyre, sipas specifikave përkatëse, të miratuar nga këshilli bashkiak, që siguron transparencë dhe që çmimet e shërbimeve të mos jenë mbi çmimet e tregut.

5. Akti i lëshuar nga bashkia, që përmban shpenzimet për realizimin e shërbimeve nga ana e subjekteve, sipas procedurës së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, përbën titull ekzekutiv në kuptimin e shkronjës “e”, të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarrimit, në ngarkim të bashkëpronarëve, që nuk kanë përmbushur vullnetarisht detyrimin.



Neni 31

Paketat e administrimit

1. Paketa e administrimit është tërësia e shërbimeve për administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës së përbashkët në ndërtesën e banimit dhe miratohet brenda janarit të çdo viti nga asambleja, si pjesë e buxhetit vjetor.

2. Asambleja e bashkëpronarëve përcakton me vendim paketën e administrimit, duke përcaktuar hollësisht shërbimet e domosdoshme, me çmimet përkatëse, apo përqindjen nga tarifa e administrimit për secilin shërbim.

3. Në paketën e administrimit përfshihen, në mënyrë të detyrueshme, pagesat për:

a) shërbimet e pastrimit e të higjienizimit të shkallëve të brendshme, si dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të kompleksit, lulishteve, parqeve, ambienteve sportive e pishinave;

b) shërbimin e mirëmbajtjes së ashensorëve;

c) zbatimin e standardeve të administrimit sipas nenit 30 të këtij ligji;

ç) shoqërinë administruese/administratorin.

KREU VI

**ADMINISTRIMI I BUXHETIT TË
BASHKËPRONËSISË**

Neni 32

Përcaktimi i tarifës

1. Tarifa e administrimit për secilin bashkëpronar është e njëjtë për të gjithë bashkëpronarët dhe, si rregull, përcaktohet bazuar në shpenzimet e administrimit dhe në kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi të pronarëve të njëjësive. Përfshihet, për pronarët e njëjësive, të cilët i shfrytëzojnë vetë apo përmes të tretëve këto njësi për qëllime tregtare, tarifa që aplikohet duhet të jetë më e lartë se ajo që aplikohet për pronarët e njëjësive familjare, duke marrë parasysh qëllimin e përdorimit të njësisë, amortizimin e pronës së përbashkët, ashensorëve, shpenzimet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta dhe frekuentueshmërinë e saj.

2. Në rast se asambleja e bashkëpronarëve nuk gjen dakordësinë, për përcaktimin e tarifës zbatohet tarifa e referencës, e miratuar nga këshilli bashkiak përkatës, e ndarë sipas zonave dhe tipologjisë së

ndërtesës, që bazohet në udhëzuesin për llogaritjen e tarifës së administrimit.

3. Ministri, që mbulon fushën e çështjeve vendore, miraton udhëzuesin për parimet dhe metodologjinë e llogaritjes së tarifës së administrimit.

Neni 33

**Pagesa e tarifës së administrimit dhe
ekzekutimi i detyrimeve monetare**

1. Mënyra dhe koha e pagesës së tarifës së administrimit përcaktohen nga asambleja e bashkëpronarëve. Nëse një bashkëpronar nuk e paguan tarifën e administrimit në kohën e caktuar, për çdo muaj vonesë, ai paguan një kamatë, të barabartë me 30 për qind të tarifës. Kamata nuk zbatohet për pronarët që gëzojnë status dhe mbrojtje të veçantë ligjore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Nëse bashkëpronari nuk e ka shlyer pagesën e tarifave të prapambetura as në muajin e tretë, bashkë me kamatat përkatëse, administratori ose shoqëria e administrimit informon me shkrim kryesinë dhe asamblenë e bashkëpronarëve, si dhe afishon në ambientet e ndërtesës listën e bashkëpronarëve që nuk kanë paguar dhe vlerën që detyrohen të paguajnë. Kryesia verifikon dhe përcakton vlerën e detyrimit për pagimin e tarifave të prapambetura dhe kamatëvonesave përkatëse.

3. Vendimi i kryesisë, që përcakton detyrime monetare në ngarkim të bashkëpronarëve, si rrjedhojë e mospagesës së tarifës së administrimit, dëshmipërblymimit apo çfarëdo lloji detyrimi tjetër të përcaktuar në këtë ligj, përbën titull ekzekutiv në kuptim të shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 34

Masa e sigurimit të detyrimit

1. Administratori ose shoqëria administruese ka të drejtë të kërkojë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës regjistrimin e një kufizimi mbi pasurinë e paluajtshme të bashkëpronarit të një njësie, që nuk ka shlyer detyrimin për tarifën e administrimit dhe të mirëmbajtjes për një periudhë jo më pak se 12 muaj ose kur detyrimi i papaguar arrin jo më pak se 0.5% të vlerës së njësisë në pronësi të tij.



2. Vendimi për të vendosur kufizim mbi pasurinë e bashkëpronarit merret nga kryesia, me shumicë të cilësuar të anëtarëve të saj, pas njoftimit me shkrim të tij. Bashkëpronari njoftohet me shkrim 10 (dhjetë) ditë para marrjes së vendimit mbi vendosjen e kufizimit mbi pasurinë e tij. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin lidhur me identifikimin e pronarit, detyrimin e papaguar, pasurinë, objekt kufizimi, si dhe kompetencën e kryesisë për të marrë vendimin dhe për të autorizuar administratorin ose shoqërinë administruese për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e kufizimit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

3. Vendimi i kryesisë, që përcakton vendosjen e kufizimit në ngarkim të bashkëpronarëve, si rrjedhojë e mospagesës së tarifës së administrimit dhe mirëmbajtjes të përcaktuar në këtë ligj, regjistrohet nga drejtoria përgjegjëse e kadastrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, dokumentacionit dhe kryerjes së pagesës së tarifave kadastrale.

4. Kërkesa për regjistrimin e kufizimit përmban:

a) vendimin e kryesisë, që autorizon vendosjen e kufizimit sipas këtij ligji;

b) dokumentacionin që vërteton vlerën e detyrimit të papaguar;

c) vërtetimin e identitetit të administratorit ose të shoqërisë administruese.

5. Kufizimi hiqet me kërkesë të pronarit të njësisë kur vërtetohet shlyerja e detyrimeve të akumuluar me anë të vërtetimit bankar, pa qenë e nevojshme nxjerrja e vendimit të kryesisë. Agjencia Shtetërore e Kadastrës heq kufizimin në kartelë brenda 5 (pesë) ditësh nga data e depozitimit të vërtetimit të shlyerjes së detyrimit nga pronari i njësisë.

6. Pasuria e paluajtshme, në kartelën e së cilës është vendosur kufizimi, nuk mund të tjetërsohet, të kalohet, të jepet në përdorim, të ngarkohet me barrë apo çdo të drejtë tjetër reale sipas ligjit, pa u vërtetuar shlyerja e detyrimeve sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 35

Fondi rezervë

1. Fondi rezervë krijohet në një llogari bankare, në emër të asamblesë së bashkëpronarëve, nga pagesa e tarifave mujore ose nëpërmjet pagesave vjetore, sipas vendimit të asamblesë, dhe preket në përputhje me parashikimet e këtij ligji, si dhe për çdo veprimtari tjetër, që miratohet nga asambleja e

bashkëpronarëve në çastin e krijimit të fondit rezervë.

2. Fondi rezervë, i krijuar sipas parashikimeve të këtij ligji, përbëhet nga këta zëra:

a) “Fondi i emergjencës”, që preket vetëm në kushtet e riparimeve apo mirëmbajtjes, sipas këtij ligji, ku mosveprimi në kohë mund shkaktojë dëme të konsiderueshme dhe të pariparueshme në bashkëpronësi;

b) “Fondi i mirëmbajtjes/përmirësimeve të zakonshme, të mëdha dhe rinesimeve cilësore”, që preket në rastet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 39 të këtij ligji;

c) “Fondi në para”, që preket vetëm në rastet e mospagimit të tarifës së administrimit nga bashkëpronarët apo të faturave të lëshuara nga administratori/shoqëria administruese për shërbimet e kryera në bazë të kontratës. Në çastin që bashkëpronari shlyen tarifën e prapambetur të administrimit, derdhja bëhet në fondin rezervë, në llogarinë rrjedhëse, në një bankë të nivelit të dytë të asamblesë së bashkëpronarëve.

3. Rregullat e hollësishme të përdorimit të këtij fondi përcaktohen në rregulloren e administrimit të banesës dhe ndërtesës sipas këtij ligji.

4. Në rast se njësia shitet apo tjetërsohet në çdo formë tjetër sipas ligjit, pjesa takuese e fondit, e depozituar nga pronari i njësisë, kalon tek blerësi apo personi që e përfiton dhe bëhet pronari i njësisë. Në këtë rast, shitësi apo personi që tjetërson pronën nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së depozituar në fondin rezervë.

Neni 36

Njësitë specifike

1. Pronarët e njësive të veçanta, që janë pjesë përbërëse e një ndërtese, por që kanë në pronësinë e tyre vetëm ashensorin, shkallën hyrëse apo kanë hyrje drejt nga rruga, si dyqanet, detyrohen ta zbatojnë këtë ligj për sa u takon bashkëpronësisë së detyrueshme në objektet e tjera, të pandashme të ndërtesës, si: themelet, kanalizimet, ndriçimi, instalimet, tarracat, siç përcaktohet në aktin e bashkëpronësisë.

2. Këto subjekte detyrohen të marrin pjesë në atë asamble bashkëpronarësh, me të cilën ndajnë më shumë objekte të përbashkëta.

3. Rregullat e përgjithshme të marrëdhënieve ndërmjet bashkëpronarëve përcaktohen në



rregulloren e administrimit të banesave dhe ndërtesave.

Neni 37

Kreditimi për bashkëpronësitë

1. Asambleja e bashkëpronarëve, kundrejt një projekti për restaurimin, rikonstruksionin, për ndërtimet shtesë apo përshtatjet e hyrjeve, të ashensorëve dhe mjediseve rrethuese, e për riparimin e tarracës, ka të drejtë të marrë kredi nga bankat kundrejt hipotekimit në zyrën e kadastrës të objekteve në bashkëpronësi, që janë përfshirë në aktin e bashkëpronësisë, në favor të kredituesit, nëse pronarët e njësisë, që përbëjnë 90 për qind të kuotave të pjesëmarrjes në bashkëpronësi, votojnë pro hipotekimit të aktit të bashkëpronësisë.

2. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim mënyrën e hipotekimit të objekteve në bashkëpronësi dhe procedurat e tjera që lidhen me zbatimin e këtij neni.

KREU VII

MIRËMBAJTJA, RIPARIMI DHE PËRMIRËSIMI I PRONËS

Neni 38

Mirëmbajtja e bashkëpronësisë dhe e njësisë individuale

1. Mirëmbajtja e bashkëpronësisë sipas standardeve kryhet nga shoqëritë tregtare, që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë, ose nga shoqëria e administrimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Të gjithë bashkëpronarët kontribuojnë financiarisht për mirëmbajtjen e bashkëpronësisë, në përpjesëtim me kuotën e pjesëmarrjes në këtë bashkëpronësi.

2. Pronari i njësisë është i detyruar ta mirëmbajë njësinë me shpenzimet e veta. Me mirëmbajtjen e njësisë individuale, asnjë pronar nuk duhet të cenojë, të dëmtojë ose të rrezikojë pronën e përbashkët apo pronën e një pronari tjetër.

3. Kur elemente të pronës së përbashkët ose individuale dëmtohen për shkak të mosfunksionimit, keqpërdorimit apo dëmtimeve, të shkaktuara nga çdo bashkëpronar apo persona të tjerë, çdo pronar i një njësie fqinje ose të mbivendosur detyrohet të lejojë inspektimin, konstatimin, riparimin dhe zëvendësimin e

elementeve të pronës së dëmtuar, nëse më parë është bërë njoftimi me shkrim.

4. Kur nga pronari i njësisë individuale, ku duhet të kryhet inspektimi, konstatimi, riparimi ose zëvendësimi, refuzohet leja, kryesia, me vendim, u drejtohet policisë bashkiake dhe inspektoratit vendor, që mundësojnë kryerjen e veprimeve të nevojshme për riparimin e dëmit.

5. Pronari i njësisë ka të drejtë ankimi në gjykatë kundër vendimit të kryesisë. Ankimi në gjykatë nuk e pezullon kryerjen e inspektimit e të riparimit.

Neni 39

Rinesimi dhe përmirësimi i pasurisë së përbashkët

1. Përmirësimet e zakonshme në komoditetin dhe mirëfunksionimin e bashkëpronësisë ndërmerren nga asambleja, me miratimin e shumicës së kuotave pjesëmarrëse.

2. Përmirësimet e mëdha ose rinesimet e pronës së përbashkët, siç janë lyerja, mirëmbajtja e fasadës, mirëmbajtja e çatisë, vendosja e sistemeve për ujë të ngrohtë, e sistemeve të ngrohjes apo ftohjes qendrore, e depozitave të ujit, gjeneratorëve, ashensorëve dhe përmirësime të tjera të kësaj natyre, ndërmerren nga asambleja vetëm nëse miratohen nga të paktën 75 për qind e kuotave pjesëmarrëse.

3. Rinesimet cilësore apo punime të tjera, që lidhen me strukturën dhe qëndrueshmërinë fizike të ndërtesës, të tilla si: riparime strukturore të kornizës së ndërtesës apo ndërhyrje të tjera, që lidhen me pasojat e fatkeqësive natyrore, kryhen në përputhje me standardet ligjore të miratuara me ligje të veçanta ose me akte nënligjore. Vendimi i asamblesë miratohet nga të paktën 75 për qind e kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi.

4. Instituti i Ndërtimit harton dhe miraton standardet për kryerjen e rinesimeve cilësore apo të punimeve, që lidhen me strukturën dhe qëndrueshmërinë e ndërtesës, periodicitetin e tyre dhe procedurën për zbatimin e tyre.

5. Përmirësimet e zakonshme, rinesimet cilësore apo punime të tjera, që mund të ndryshojnë pamjen, ose elemente të veçanta të objekteve të banimit në bashkëpronësi, të shpallura monument kulture, bëhen sipas kërkesave dhe procedurave të legjislacionit për trashëgiminë kulturore.



Neni 40

Ndryshimi i njësive nga pronarët

1. Pronari i njësisë mund të bëjë çdo lloj përmirësimi ose ndryshimi në njësinë individuale, që nuk cenon qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe integritetin struktural, rrjetin inxhinierik dhe njësitë e tjera individuale.

2. Pronari i njësisë mund ta ndryshojë pamjen e pronës së përbashkët ose pamjen e jashtme të njësisë individuale, pjesë e një kompleksi, duke përfshirë këtu arkitekturën, si: fasadën, veshjet, kornizat, dyert, hyrjet, tjegullat, oxhaqet, dritaret, grilat, ngjyrën, stilin, vetëm pasi ka marrë më parë miratimin me shkrim të shumicës së thjeshtë të votave nga asambleja, si dhe është në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit. Pronari i njësisë mund të bëjë ndërtim në katin e fundit të një ndërtese apo ndërtime mbi katin e fundit të njësisë individuale, pjesë e një kompleksi, vetëm pasi ka marrë më parë miratimin me shkrim të shumicës së cilësuar të votave prej tre të katërtat nga asambleja.

3. Çdo ndryshim në pamjen ose përdorimin e pjesës së përbashkët apo përmirësim ose ndryshim i njësisë individuale duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 41

Dëmtime të pronës së përbashkët ose të njësive individuale të tjera

Kur pronari i njësisë ose një person tjetër, që vepron në emër të tij, shkakton dëm në një pjesë të pronës së përbashkët apo të një njësie tjetër individuale të bashkëpronarëve, pronari, që ka shkaktuar dëmin, duhet ta riparojë atë ose të paguajë shpenzimet e riparimit.

Neni 42

Sigurimi i objekteve në bashkëpronësi të detyrueshme

1. Pronari i njësisë përgjigjet për sigurimin e pronës së vet, ndërsa asambleja e bashkëpronarëve përgjigjet për sigurimin e detyrueshëm të objekteve në bashkëpronësi.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë e llogaritjes së tarifës për sigurimin e detyrueshëm, si dhe kushtet e kriteret ligjore për përfitimin e masave

mbështetëse në lidhje me këtë detyrim për shtresat në nevojë.

KREU VIII

**ROLI I INSTITUCIONEVE VENDORE
DHE QENDRORE**

Neni 43

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e administrimit të bashkëpronësisë

1. Bashkia është përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

- a) mbarëvajtjen e administrimit dhe mirëmbajtjen e ndërtesave;
- b) nxitjen e zbatimit të përputhshmërisë me standardet e administrimit;
- c) funksioneve monitoruese;
- ç) funksioneve inspektuese.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës është përgjegjëse për regjistrimin e aktit të bashkëpronësisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, ruajtjen dhe përditësimin e regjistrit kadastral të objekteve në bashkëpronësi, të detyrueshme për ndërtesën, si dhe të ligjit në fuqi për kadastrën.

Neni 44

Libri i bashkëpronësisë

1. Libri i bashkëpronësisë për të gjitha ndërtesat brenda territorit të bashkisë krijohet, ruhet, administrohet dhe përditësohet nga bashkia.

2. Libri i bashkëpronësisë përmban të dhënat e mëposhtme, për:

- a) aktin e bashkëpronësisë,
- b) ndërtesën, duke përfshirë vitin e ndërtimit apo të dhëna të tjera, që lidhen me tipologjinë, numrin e njësive;
- c) formën e administrimit të bashkëpronësisë dhe tarifën e administrimit;
- ç) përbërjen dhe mandatin e kryesisë;
- d) përputhshmërinë me standardet e administrimit dhe të mirëmbajtjes;
- dh) të gjitha ndryshimet përkatëse në këto të dhëna, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Çdo e dhënë e regjistruar dhe e publikuar në librin e bashkëpronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, vlerësohet e njohur dhe mund t'u kundërjohet të tretëve nga data e regjistrimit. Të gjitha të dhënat



e librit të bashkëpronësisë dhe dokumentet shoqëruese, pavarësisht nëse janë paraqitur në formë shkresore apo elektronike sipas këtij ligji, regjistrohen e ruhen në formë elektronike.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara për mënyrën e krijimit dhe të administrimit të librit të bashkëpronësisë, dokumentet që paraqiten dhe formën e tyre, të dhënat që regjistrohen, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, duke përfshirë Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, si dhe për nivelin e aksesimit elektronik për subjektet e interesuara.

Neni 45

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për administrimin e bashkëpronësisë

1. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pronarëve, krijuesit apo përdoruesit të njësisë në lidhje me të drejtat dhe përmbushjen e detyrimeve sipas këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, krijohet Komiteti për Ndërmjetësimin dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, që funksion pranë çdo bashkie.

2. Komiteti për Ndërmjetësim dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, përkatësisht:

a) një punonjës i bashkisë, i caktuar nga kryetari i bashkisë, që ushtron funksione në lidhje me administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa;

b) administratori i njësisë administrative, ku ndodhet ndërtesa për të cilën ka lindur mosmarrëveshja;

c) një përfaqësues nga inspektorati vendor në fushën e ndërtimit, që ushtron funksione si jurist, caktuar nga titullari i inspektoratit vendor.

3. Komiteti për Ndërmjetësim dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve vendos në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, në funksion të sigurimit të harmonisë sociale, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil dhe të këtij ligji.

4. Vendimi i Komitetit përbën titull ekzekutiv në kuptim të shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulla të detajuara në lidhje me organizimin, funksionimin, si dhe procedurat e vendimarrjes së Komitetit.

Neni 46

Inspektimet në fushën e administrimit të objekteve në bashkëpronësi

1. Inspektorati vendor ushtron, me kërkesë të arsyetuar të çdo qytetari apo kryesisht, inspektime të detyrueshme për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij.

2. Pas çdo inspektimi, inspektori përkatës konstaton dhe shprehet me një akt, të cilin e shpall në një vend të dukshëm në godinën e inspektuar dhe njëkohësisht ia njofton kryesisht dhe administratorit apo shoqërisë administruese përkatëse, për gjendjen e përgjithshme të ndërtesës, si dhe për masat që duhet të merren, në rast se ka nevojë për të tilla. Për kryerjen verifikimit teknik mbi gjendjen e përgjithshme, inspektorati mund të veprojë nëpërmjet Institutit të Ndërtimit ose mund të kontrakttojë subjekte private të licencuara në fushat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

3. Asambleja e bashkëpronarëve merr vendim brenda afatit të përcaktuar në aktin sipas pikës 2 të këtij neni dhe autorizon administratorin/shoqërinë administruese për ndreqjen e të metave, duke siguruar financimin e nevojshëm nga bashkëpronarët.

4. Çështjet, që janë subjekt i inspektimeve, rregullat, metodologjia, frekuenca dhe mënyra e njoftimit për kryerjen e inspektimeve, lënia e detyrave, afatet kohore për zbatimin e tyre dhe procedurat që ndjek administratori për zbatimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 47

Bashkia si bashkëpronare

Në rast se bashkia është pronare e një ose më shumë njësive në një ndërtesë, ajo ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si çdo pronar i një njësie individuale.

Neni 48

Inspektime të tjera

Subjektet shtetërore përgjegjëse për inspektimin e normave ushtrojnë kontrolle sipas kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit, ruajtjen e higjienës shëndetësore, kontrollin e



ashensorëve apo të tjera, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme.

Neni 49

Bashkëpunimi me asambletë e bashkëpronarëve

1. Bashkia mund të hartojë një program nxitjeje për restaurimin apo rikonstruksionin e ndërtesave të dëmtuara, duke kontribuar me financime pjesore. Përfitojnë, në mënyrë të privilegjuar nga ky program, ato asamble bashkëpronarësh, që, të paktën, plotësojnë njërin nga këto raste:

a) kërkojnë përshtatjen e hyrjeve dhe të shkallëve për personat me aftësi të kufizuara;

b) kërkojnë ndërhyrje, me qëllim ruajtjen e eficientës së energjisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) fasada e ndërtesës së tyre ose rrjeti i komunikimeve elektronike apo rrjeti kabllor televiziv është në rrugë kryesore dhe në një gjendje tejet të dëmtuar, saqë prish imazhin e bashkisë;

ç) në çdo rast tjetër që zbatimi i atij projekti çmohet i vlefshëm për jetën dhe harmoninë në komunitet.

Në të gjitha rastet, përfituesit duhet të kenë paguar plotësisht taksën për pasurinë e paluajtshme.

2. Bashkia mund të kontribuojë në financimin pjesor për ngritjen e një ndërtese të re kur bashkëpronarët vendosin për ta shembur atë, me kusht që pjesë nga ndërtesa e re t'i kalojnë në pronësi bashkisë, për t'ua dhënë në përdorim apo pronësi familjeve në vështirësi për strehim. Ndërtimi në këtë rast kryhet nga bashkia dhe financohet nga buxheti i saj. Pjesa e përfitimit të bashkisë përcaktohet, për çdo rast, në bazë të vlerave të tregut të banesave dhe të vlerës së investimit që bën bashkia.

3. Procedurat e aplikimit, afatet, shuma e financimit dhe çdo rregull tjetër, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak.

Neni 50

Roli i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës ruan dhe përditëson në regjistrin kadastral të dhënat e pasqyruara sipas aktit të bashkëpronësisë apo ndryshimet lidhur me të.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon ekstrakt të aktit të bashkëpronësisë, që pasqyron emrat e bashkëpronarëve dhe objektet e regjistruara në bashkëpronësi, bazuar në kërkesën e kryesisë ose administratorit ose shoqërisë administruese.

3. Personit të autorizuar nga kryesia mund t'i jepet kodi i hyrjes dhe e drejta e marrjes së ekstrakteve të të dhënave, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kadastra digjitale, duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të saj nëpërmjet sistemit elektronik. E drejta e hyrjes dhe e marrjes së ekstrakteve sigurohet edhe nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.

Neni 51

Roli i organeve të qeverisjes qendrore

Buxheti i shtetit mund të mbështesë me financime realizimin e projekteve për përmirësimin e banesave, infrastrukturës, adaptimit të godinave të vjetra apo edhe ndërtesave me fasada të dëmtuara, në përputhje me legjislacionin për strehimin social.

Neni 52

Sanksionet dhe ankimimet

1. Në rast se policia bashkiake apo struktura përkatëse inspektuese konstaton se pronari i njësisë nuk përmbush detyrimet, që lidhen me respektimin e etikës dhe bashkëjetesës, të përcaktuar në rregulloren e administrimit të banesave dhe ndërtesave, apo pengon bashkëpronarët e tjerë në gëzimin e objekteve, që janë në bashkëpronësi të detyrueshme, kërkon përmbushjen e detyrimit dhe paralajmëron për shkeljen e bërë. Në rast ripërsëritjeje të shkeljes, policia bashkiake apo struktura përkatëse inspektuese ka të drejtë të vendosë gjobë në masën 5 000–10 000 lekë.

2. Në rast se pronari i njësisë nuk lejon kryerjen e inspektimeve dhe të riparimeve të pronës së përbashkët brenda njësisë së pronës së tij, sipas legjislacionit në fuqi, policia bashkiake apo struktura përkatëse inspektuese i vendos një afat për ndreqjen e të metave. Nëse pronari nuk zbaton aktin e inspektimit për ndreqjen e të metave brenda afatit të përcaktuar, policia bashkiake apo struktura përkatëse inspektuese ka të drejtë të vendosë gjobë në masën 5 000–10 000 lekë.

3. Në rast se policia bashkiake apo struktura përkatëse inspektuese sipas ligjit konstaton që



administratori ose shoqëria e administrimit nuk ka përmbushur standardet e administrimit, të përmendura në pikën 1 të nenit 30 të këtij ligji, i vendos një afat për ndreqjen e të metave. Nëse administratori ose shoqëria e administrimit nuk zbaton aktin e inspektimit për ndreqjen e të metave brenda afatit të caktuar, inspektorati ka të drejtë të vendosë gjobë në masën 5 000–10 000 lekë.

4. Për çdo rast të përsëritur, masa e gjobës shtohet me 20 për qind.

5. Kundër aktit të inspektoratit/strukturës përkatëse inspektuese apo policisë bashkiake, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të bëhet ankim gjyqësor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendosjen e gjobës.

6. Ankimi gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin e gjobës.

7. Detyrimet, sipas këtij neni, vilen nga administrata vendore, përgjegjëse për mbledhjen e taksave dhe të tarifave vendore.

KREU IX DISPOZITA KALIMTARE

Neni 53

Ndërtesat e paregjistruara në zyrën e kadastrës

1. Për ndërtesat e paregjistruara në kadastër, por që përdoren nga porositësit e tyre, garant për zbatimin e këtyre rregullave caktohet shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi), si krijues i pronës dhe, në rast falimentimi të saj, kryetari i bashkisë.

2. Shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) detyrohet që në kontratën e sipërmarrjes të vërë si aneks rregulloren e administrimit të banesave dhe të ndërtesave, si dhe aktin e bashkëpronësisë për ndërtesën, ku është porositur njësia e veçantë. Shoqëria ndërtuese është përgjegjëse për të gjitha detyrimet dhe kostot që lidhen me administrimin e bashkëpronësisë për ndërtesën deri në momentin që kryhet kolaudimi i ndërtesës dhe është lëshuar certifikata e shfrytëzimit sipas ligjit. Kjo e drejtë nuk mund të delegohet përveç rasteve të pamundësisë ligjore të ushtrimit të veprimtarisë nga personat, që mundësojnë zhvillimin e pronës.

Neni 54

Detyrimet e shoqërisë ndërtuese dhe të asaj administruese

1. Shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) është automatikisht administruese e ndërtesës derisa ndërtesa të konsiderohet e përfunduar dhe të ketë kaluar në pronësi të porositësve, duke i pajisur ata me certifikatat e pronësisë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës sipas ligjit, përveç nëse porositësit i kanë dhënë shoqërisë ndërtuese të drejta për të administruar ndërtesën, vetë apo nëpërmjet një pale të tretë të caktuar prej saj, të drejtat dhe detyrimet e administrimit. Shoqëria ndërtuese, për këtë periudhë, përmbush detyrimet për t'u regjistruar në bashki sipas nenit 25 të këtij ligji.

2. Nëse për një periudhë prej 3 (tre) muajsh nga kolaudimi i ndërtesës nuk është lëshuar ende certifikata e shfrytëzimit/përdorimit nga autoritetet përgjegjëse sipas ligjit, shoqëria ndërtuese organizon mbledhjen për konstituimin e asamblesë së porositësve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data kur 1/3 e kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi ka porositës të përcaktuar (identifikuar) në bazë të kontratës së sipërmarrjes. Krijimi dhe ushtrimi i kompetencave nga asambleja e porositësve rregullohet sipas dispozitave të kreut IV të këtij ligji deri sa të merret certifikata e shfrytëzimit dhe titulli i pronësisë së ndërtesës t'u kalojë porositësve.

3. Shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) njofton brenda 5 (pesë) ditëve nga lëshimi i dokumentit të regjistrimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës pronarët e njësive të ndërtesës në një nga mënyrat e komunikimit të parashikuara në kontratën përkatëse të fitimit të titullit. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data kur pronarët kanë fituar pronësinë mbi pjesët individuale, ata realizojnë mbledhjen e parë për konstituimin e asamblesë së bashkëpronarëve në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

Neni 55

Afati transitor për deklarimin e të dhënave të aktit të bashkëpronësisë

1. Në të gjitha ndërtesat sipas këtij ligji, që janë të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe kanë ose janë pajisur me aktin e bashkëpronësisë, administratori kryen procesin e përditësimit e të saktësimit të të dhënave në këtë akt,



në përputhje me parashikimet e nenit 8 të këtij ligji, brenda datës 31 dhjetor 2026.

2. Në të gjitha ndërtesat sipas këtij ligji, që janë të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe që nuk janë pajisur me aktin e bashkëpronësisë, asambleja e bashkëpronarëve kryen procesin e deklarimit e të regjistrimit të aktit, në përputhje me parashikimet e nenit 8 të këtij ligji, brenda datës 31 dhjetor 2027.

3. Të gjitha ndërtesat, që janë në proces regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) kryen përditësimin e saktësimin e të dhënave, me qëllim që akti i bashkëpronësisë të lëshohet në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

4. Në të gjitha ndërtesat, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, për të cilat bashkia përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji aplikon pagesën e taksës për zënien e hapësirave publike sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore, pasi territori ose mjedisi nuk rezulton në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si objekt në bashkëpronësi të detyrueshme të bashkëpronarëve të ndërtesës, bashkia do të vijojë ta aplikojë këtë taksë deri në momentin e regjistrimit të kësaj hapësire si objekt në bashkëpronësi të detyrueshme të bashkëpronarëve sipas këtij ligji.

5. Këshilli i Ministrave miraton vendim për procedurat, afatet, dokumentet e nevojshme për regjistrimin, përditësimin dhe saktësimin e të dhënave të aktit të bashkëpronësisë.

KREU X DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 56 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 2; 16, pika 2; 25, pika 3; 36, pika 3; 42, pika 2; 44, pika 4; 45, pika 5; 55, pika 5, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet vendore të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 26, pika 3, 32, pika 3, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet Instituti i Ndërtimit të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim të pikës 4, të nenit 39, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 57

Ligji nr. 10 112, datë 9.4.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” shfuqizohet.

Neni 58 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.7.2025.

Shpallur me dekretin nr. 282, datë 30.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET Nr. 282, datë 30.7.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 55/2025, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET Nr. 260, datë 28.7.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:



1. Jonida Edmond Gjollli

DEKRETOJ:

Neni 2

Neni 1

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

1. Olgerta Përparim Kuçi
2. Daniel Eduard Dajçi

Neni 2

DEKRET
Nr. 261, datë 28.7.2025

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRET
Nr. 263, datë 28.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Elma Xhafer Barjami
2. Elsona Jani Hornung

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 2

Neni 1

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

1. Xhiliola Dhimiter Velika

Neni 2

DEKRET
Nr. 262, datë 28.7.2025

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

**DEKRET****Nr. 264, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fatos Bexhet Mehmeti
2. Dorian Ilirian Cani
3. Erjon Ramadan Muja
4. Endi Shkëlqim Spaho

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 265, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Besar Engyl Pallush

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 266, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Micaela Pietro Mussoni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 267, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ganildo Ramadan Çepele
2. Vladimir Petrit Shabani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
Ë SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 268, datë 28.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gazmend Marash Vukilaj
2. Klarend Vergim Fejzulli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 269, datë 28.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Arthur Mhill Gjoni
2. Edlira Namik Kruja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 270, datë 28.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Generoso Ferdinand Fiore
2. Eduard Fadil Xhindi



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS J SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 271, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ksanthipi Kosta Sidheri
2. Harallamb Thanas Sidheri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 272, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Anton Ukshin Nika
2. Arta Pëllumb Ante (Burimi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 273, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bledar Ferdinand Terziu (Tërziu)
2. Xhens Arben Basha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 274, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Besa Hikmet Hoxhaj
2. Elda Ylli Dedja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 275, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ferit Xhemal Isufaj
2. Ervin Fadil Kasa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 276, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ilir Kujtim Meni
2. Besida Besnik Mekollari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 277, datë 28.7.2025****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Blerina Sadedin Heimbürger

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 278, datë 28.7.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Esmeralda Fetah Bilibashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 592 lekë

